monumentet

DO NOT COPY



10, 1975

qytetit të Sipërm - Shurdhah
restaurimit)

MINISTRIA E ARSIMIT DHE KULTURËS

INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS

TIRANË

monumentet

10, 1975

DO NOT COPY

INST. MON. KULTURES
BIBLIOTEKA
№ INV. 8665

KOLEGJUMI I REDAKSISË

DO NOT COPY

Pronë letrare e' Institutit të Monumenteve të Kulturës
pranë Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës

Adresa e redaksisë: Rruga Alqi Kondi nr. 7

pje Formati 70 x 100/12 Stash: 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik Shtypshkronja «Mihal Duri», Tiranë –

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

ARTIKUJ

Apollon Baçe

– Qendrat e fortifikuara të Gjirit të Vlorës në antikitet. 5

Neritan Ceka

– Qendrat e fortifikuara të Amantëve. 21

Stilian Adhami

– Një monument me vlerë i shek. XVII në Voskopojë. 63

Aleksandër Meksi

– Disa kapela bizantine të vendit tonë. 75

Koço Zheku

– Shtëpitë e banimit në krahinën e Tomoricës. 99

Emin Riza
Hasan Nallbani

– Një ndërtim i tipit kullë në Berat. 117

Gjerak Karaiskaj

– Të dhëna mbi arkitekturën dhe punimet e konservimit në kalanë e Shurdhahut (Sarda). 133

MATERIALE, KRONIKË, BIBLIOGRAFI

Aleksandër Meksi

– Të dhëna të reja për kishën e Mesopotamit. 151

– Veprimtaria e Institutit të Monumenteve të Kulturës gjatë vitit 1975. 161

Lazër Papajani

– Pasqyra bibliografike e serisë «Monumentet» Nr. 1-10 (1971-1975). 165

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERES

Pages

ARTICLES

Apollon Baçe

– Les centres fortifiés de la baie de Vlora dans l'antiquité. 5

Neritan Ceka

– Les centres fortifiés des Amantins. 21

Stilian Adhami

– Un monument de XVII-e siècle à Voskopojë. 63

Aleksandër Meksi

– L'activitée de L'Institut des monuments de la culture pendant l'année 1975. 75

Koço Zheku

– Les maisons d'habitation de la région de Tomoricë. 99

Emin Riza
Hasan Nallbani

– Une habitation de type «kulle» à Berat. 117

Gjerak Karaiskaj

– Données sur l'architecture de la forteresse de Shurdhah (Sarda) et sur les travaux de conservation qui y ont été effectués. 133

MATERIAUX, CHRONIQUES, BIBLIOGRAPHIE

Aleksandër Meksi

– Nouvelles données sur l'eglise de Mesopotam. 151

– Certaines chapelles byzantines de notre pays. 161

Lazër Papajani

– Index bibliographique de la série «Monumentet» 1-10 (1971-1975). 165

DO NOT COPY

Apollon BAÇE

QENDRAT E FORTIFIKUARA TË GJIRIT TË VLORËS NË ANTIKITET

DO NOT COPY

Gjiri i Vlorës (Tab. I), 19 km i gjatë dhe 16 km i gjerë, nis në veri me kepin e Treportit dhe përfundon në perëndim me Kepin e Gjuhëzës, midis të cilëve gjendet ishulli i Sazanit. Nga ana e steresë gjiu rrethohet me male të larta shkëmbore, që e ngushtojnë së tepërmi brezin bregdetar fushor, duke e ndarë gjirin në dy nënnjësi: veriore dhe jugore. Në jug gjendet Fusha e Dukatit, e cila kufizohet prerazi prej maleve, detit dhe lagunës së Pashalimanit. Nënnjësia veriore në perëndim kufizohet me detin, ndërsa nga jugu, lindja dhe veriu qarkohet prej vargut të kodrave të Shashicës, i cili takohet në veri me lagunën e cekët të Nartës. Nënnjësia lidhet lehtë me Myzeqenë e Vlorës dhe me luginën e lumit të Vlorës (Shushicës), të dyja mjaft të përshtatshme për bujqësi.

Pjesa e rrafshtë ka toka të dobëta me kripëzim të lartë, në të kundërt, kodrat mbulohen me një shtresë të fuqishme flyshi, e cila krijon kushte të favorshme për blegtori dhe frutikulturë. Duhet të vëmë në dukje se si nënnjësia jugore, ashtu edhe ajo veriore, gjatë mesjetës i janë nënshtruar një procesi progresiv kënetëzimi.

Kushtet për lundrimin detar dhe qëndrimin e anijeve në gjirin e Vlorës kanë qenë mjaft të mira. Bankinat e rërës në të janë të pakta, ndërsa malet e larta që e qarkojnë nga toka krijojnë një barierë natyrale që e mbron nga erërat, duke lënë të hapët vetëm veriperëndimin. Së fundi pyjet halore dhe sera krijonin mundësi për ngritjen në të të kantiereve detare. Gjiri i Vlorës komunikon relativisht lehtë me qendrat e krahinat e tjera të Shqipërisë si dhe me zonat e brendshme të Ballkanit, pasi në të që në kohën antike përqëndroheshin një sërë rrugësh të rëndësishme[1]) (Tab. I). Me qendrat bregdetare të Adriatikut dhe Jonit, përveç detit, komunikonte me një rrugë meridionale, e cila e lidhte atë dhe me rrugën në luginën e Shkumbinit. Një arter tjetër e lidhte me luginën e Vjosës dhe të Drinos. Së fundi rruga e tretë e lidhte me Ballshin (Bylisin, Gllavenicën) dhe Beratin.

Në kohën antike në këtë rajon lind një varg qendrash, të cilat në funksion të zhvillimit ekonomiko-shoqëror dhe kërkesave politiko-ushtarake luajtën një rol të dorës së parë ose të varur, si në raport me njëra-tjetrën, ashtu dhe me qytetet e hinterlandit, u zhvilluan dhe lulëzuan, ose ranë e u braktisën.

Këto qendra nuk mbetën jashtë vëmendjes së udhëtarëve dhe të arkeologëve, por duhet vënë në dukje se përshkrimet e tyre kanë karakter kalimtar. Në të kundërt, vitet e fundit disa nga qendrat e gjirit të Vlorës dhe zonës përreth u janë nënshtruar gërmimeve arkeologjike dhe studimeve me baza shkencore[2]). Studimet e trashëguara, ekspeditat në zonën përreth dhe rezultatet e punimeve të restaurimit na japin mundësi që qendrat e gjirit të Vlorës t'ia nënshtrojmë një studimi më të plotë. Trajtimi i tyre në grup mendojmë se do të sqarojë dhe rolin e

1) K. Miller, **I.R.** Stuttgart, 1916; O. Cuntz, **I.R.** Lipsiae, 1929; **J. Adam, Historia e rrugëve të Shqipërisë,** B.SH.SH. 1953, 1,3.

2) Rezultatet e ekspeditës së Orikut te Dh. Budina. **Gërmimet në teatrin antik të Orikut,** «Studime historike», 1964, 1. Rezultatet e ekspeditës në Amantie tek S. Anamali, **Amantia,** Iliria, II. Kanina tek A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Kaninës,** Monumentet, 7-8, 1974; D. Komata, **Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në kalanë e Kaninës (vitet 1971, 1973),** Buletin arkeologjik, 4, 1974.



Fig. 1

raportin ndërmjet tyre, duke nxjerrë në pah karakteristikat për çdo periudhë.

* *
*

ORIKU

Oriku që ndodhet në zonën jugore të gjirit të Vlorës (Tab. I), në skajin e tij jugperëndimor, ka një pozitë mjaft të përshtatshme si skelë detare. Ai paraqitej veçanërisht i përshtatshëm si bazë detare, pasi kalimi tokësor për në të kryhej nëpërmjet rrugësh të vështira që bllokoheshin me lehtësi (Rradhima, Llogoraja), ndërsa afrimi nga deti sinjalizohej lehtë, nga pikat e vrojtimit në Karaburun. Por kjo zonë s'është e përshtatshme për bujqësi dhe për më tepër ka një hinterland mjaft të dobët.

Qyteti i fortifikuar zë një kodër të ulët gëlqerore të quajtur Paleokastër[3]), në buzë të detit, në perëndim të lagunës së Dukatit.

Kodra e Paleokastrës, me sipërfaqe rreth 5 ha qarkohej në rrëzën e saj prej një muri mbrojtës 950 m të gjatë (Fig. 1). Në pjesën e sipërme të kodrës gjendej një mur i dytë, i cili krijonte akropolin. Përveç tyre një mur i tërthortë me drejtimin lindje-perëndim e ndante kodrën në dy pjesë simetrike me njëra-tjetrën. Krijohej kështu një sistem mbrojtës i përbërë prej 4 seksionesh të veçuara, të cilët komunikonin ndërmjet tyre dhe që mund të rezistonin në mënyrë të pavarur kur njëra pjesë binte në dorën e armikut.

Veçanti paraqet dhe teatri, numri mjaft i kufizuar i vendeve (rreth 400 vetë) [4]) si dhe ndërtimi i tij brenda mureve rrethuese tregon se ai i përkiste vetëm qytetit dhe jo krahinës.

Porti i brendshëm (portus introitus) i përmendur prej Cezarit[5]) është lokalizuar në lagunën[6]) 2,2 km

3) I pari që e identifikon atë me Orikun është **M.W. Leake (Travels in Northern Greece,** London, 1835, I,3), ndërsa më vonë Oriku vizitohet prej L. Heuzeit, M. Daumet **(Mision archeologique de Macedonie,** Paris, 1876) 403-6, të cilët japin një skicë të fortifikimit, por nuk e përshkruajnë atë. Së fundi gjatë viteve 1958 gërmimet arkeologjike përcaktuan qartë stratigrafinë e qytetit (Dh. Budina vep. cit.). Këto të dhëna dhe gjurmët e pakta që ruhen në sipërfaqe japin një farë mundësie për të krijuar një përfytyrim mbi sistemin e fortifikimit.

4) Dh. Budina, **vep. cit.** 172.

5) Caes. **Bell. Civ.** 40.1.

6) L. Heuzey, M. Daumet, **vep. cit.** 404.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

të gjatë dhe 1,2 km të gjerë, e cila ka formën e një trekëndëshi me bazën të drejtuar nga deti. Prej tij ajo ndahet nga një rryp rranor, në perëndim të të cilit gjendet kodra e qytetit. Në ekstremin perëndimor bankina përshkohet prej një kanali, i cili e lidh te lagunën me detin. Në brendësi të lagunës, nën pasqyrën e ujit, shihen gjurmët e një muri 1.80 m të gjerë, i cili lidhte të dy brigjet e saj. Kemi të bëjmë me një bankinë për akostimin e anijeve, e cila, duke u nisur nga gjërësia e lagunës në këtë vënd, arrinte rreth 200 m gjatësi.

Në kapërcyellin e erës sonë, krahas Apolonisë, Oriku dëshmohet si baza kryesore detare e Cezarit në Shqipërinë Jugore[7]). Përmendja e tij si qytet me mure mbrojtës, i pajisur me garnizon, tregon vazhdimësinë e jetës, si qendër e fortifikuar edhe nga fundi i periudhës republikane. Nga ana tjetër ndërtimi i teatrit në shek. e I të e.sonë[8]) dëshmon se Oriku dhe gjatë kohës perandorake jeton një periudhë lulëzimi. Forcën e tij jetësore e dëshmon dhe veprimtaria ndërtuese e Herod Atikut pas tërmetit të shek. II[9]).

Hezej – Domea dhe Ugolini[10]) na bëjnë të ditur se muri i jashtëm rrethues ishte rindërtuar më vonë me tulla të lidhura me llaç gëlqereje. Në periudhën e Cezarit, kur Oriku luan një rol të rëndësishëm ushtarak, nuk kishte filluar ende zbatimi i teknikës me tulla dhe llaç gëlqereje[11]). Rindërtimin e Herod Atikut e shohim të lidhur me ndërtimet civile dhe jo me muret rrethuese, pasi në shek. e II romakët, të pakërcënuar nga ndonjë rrezik ushtarak, nuk ndërmerrnin punime mbrojtëse në zonat e brendshme. Kështu që rifortifikimi duket se i përket periudhës së vonë antike, shekujve IV-VI.

Të dhënat e sipërme mbështesin dhe rezultatet e gërmimeve të Dh. Budina, të cilat dëshmojnë vazhdimësinë e jetës prej zanafillës së qytetit deri në antikitetin e vonë.[12])

KALAJA E SOFËS (TRAGJAS)

Kalaja e Sofës ndodhet në jug të fshatit Tragjas i vjetër (Tab. I). Në perëndim të saj kalon traseja e rrugës së sotme automobilistike Vlorë-Sarandë, nëpërmjet Llogarasë, ndërsa përbri kalon një rrugë karvanesh, që nëpërmjet Qafës së Shën Gjergjit hidhet në Vranisht për të vijuar gjatë luginës së lumit të Vlorës[13]). Siç shihet, vendi ka rëndësi strategjike, pasi kontrollon dy daljet e vetme jugore nga kjo zonë dhe nga ana tjetër shërben për ta sinjalizuar e deri në një farë mase për ta mbrojtur Orikun nga shpina. Në këtë drejtim fushëshikimi i gjerë mbi det që hapet prej majës së saj jepte mundësi që Oriku të sinjalizohej edhe për rrezikun që i vinte nga deti.

Kështjella ngrihet mbi një kodër, pjesë e një formacioni të pjerët shkëmbor që vazhdon prej juglindjes në veriperëndim (Fig. 2). Platforma e sipërme e kodrës, me tokë të rrafshtë e të mirë, paraqet kushte mjaft të favorshme banimi dhe për më tepër në anën e saj veriore gjenden burime uji të pishëm. Këto rrethana, prania e gurit dhe pozita kyçe, kanë bërë që kjo qendër të banohet, me sa duket, që në periudhën e parë të hekurit, gjë që dëshmohet prej disa fragmenteve murale të ndërtuara me blloqe të mëdha mbi 1 m, të papunuar, dhe të mbushur në vendet e bashkimit me gurë të vegjël. Këto gjurmë, që më qartë i kopim në anën lindore, por dhe këtu shumë të dëmtuara dhe mjaft fragmentare, tregojnë se muret rrethonin tërë platformën rreth 4 hektarëshe. Në të kundërt muret me llaç zënë vetëm pjesën e sipërme të pllajës me sipërfaqe 0,18 ha (Fig. 3), por në platformën lindore shihen dhe gjurmë banesash mjaft të rrënuara.

Kurtinat 1,55-1,70 m të gjera janë ndërtuar me gurë të vegjël të thyer nga formacionet lokale, lidhur me llaç me mjaft gëlqere. Prej kullave ruhet vetëm njëra, në formë drejtkëndëshi, me përmasa 6,1x3,8 m

7) Caes **Bell. civ.** III, 7,8; II, 14,15; Appian, **bell. civ.** II 54, Dio XLI 45, Plut, **Caes** 37; Caes, **Bell. civ.** III, 11,3.

8) Dh. Budina, **Vep. cit.,** 175.

9) Philostr. **Vit. Soph.** 237 k. (Herode Atticus, 5).

10) L. Heuzey, M. Daumet, **Vep cit.** 404; L. M. Ugolini, **Albania antica. Ricerche archeologiche,** Roma-Milano 1927, 105.

11) F. Prendi K. Zheku, **Qyteti Ilir i Lisit,** Monumentet 2, 1970, 16. Këtu mund të sjellim për analogji rindërtimet e kryera prej tij në Lezhë që vazhdojnë të ndjekin teknikën e periudhës helenistike.

12) Dh. Budina **Vep. cit.** 158-161.

13) Veç pranisë së një rruge të sotme kafshësh, qënia e saj në kohën e vonë antike kuptohet dhe prej pranisë së fortifikimeve bashkëkohëse në afërsi të qafës dhe në Vranisht. Ne nga ana jonë supozojmë se kjo rrugë ka qenë më e preferuar se e Llogarasë, pasi ndjek një terren më të përshtatshëm se ajo. Nga ana tjetër përmendja në Itinerarin e Antoninit dhe Tabula Peutingerianën, e stacionit Acroceraunia, në rrugën Vlorë-Finiq (I.A. Cuntz 324,3, T.P. Miller. Coll 559-569) dhe lënia jashtë Himarës tregon se rruga nuk ndiqte bregdetin. Për sa i përket identifikimit të Akrokerauneve me Karaburunin, kjo na duket e padrejtë, ngaqë autorët antikë e shtrinë këtë emërtim në tërë malet e jugut, deri afër Tomorit.



Fig. 2

dhe mure 1,3 m të gjera. Prania e saj në një vend të thikët e thuajse të pasulmueshëm, tregon se dhe anët e tjera kanë qenë paisur me kulla. Fragmentet e qeramikës të gjetura në brendi të kështjellës, si dhe teknika e ndërtimit e datojnë këtë qendër në shek. IV-VI. Nga ana tjetër mungesa e qeramikës si dhe e fazave të mëvonshme të ndërtimit tregon se jeta në të merr fund nga mbarimi i periudhës së vonë antike.

KANINA[14])

Kanina është vendi i vetëm që krijon mundësi të lehtë ndërlidhjeje midis bregut të detit dhe luginës, pasi më në jug malet thepisen, zgjerohen dhe fitojnë lartësi të madhe, ndërsa më në veri largësia midis Lumit të Vlorës dhe detit rritet me mjaft shpejtësi (Tab. I).

Krahas pozitës ekonomike dhe strategjike Kanina plotëson edhe kushtet e tjera të nevojshme për ngritjen e një qendre të fortifikuar, mundësinë e komunikimit, praninë e ujit të pishëm dhe të gurit për ndërtim, si dhe një mbrojtje të mjaftueshme. Megjithëkëtë më afër detit gjenden kodra të tjera, të cilat i plotësojnë tërë kushtet e mësipërme, janë më të mbrojtura nga natyra dhe rruga për në to është më pak e lodhshme. Por prej tyre nuk plotësohet lidhja ndërmjet detit dhe Lumit të Vlorës, e cila siç e pamë mund të arihej vetëm në Kaninë.

Qyteti i fortifikuar gjendet në pjesën e sipërme të kodrës[15]) (Fig. 4). Gjurmët «in situ» të fortifikimit antik që i gjejmë në tërë konturin e rrethimit prej 3,6 ha tregojnë qartë se muri mesjetar ka ndjekur rrethimin antik.

Muri 2,15 m i gjerë përbëhet prej paretit të brendshëm dhe atij të jashtëm, të punuar me blloqe në formë drejtkëndëshe, që rrallëherë shmangen lehtë ndaj trapezit të rregullt (Fig. 5). Blloqet janë vendosur në rreshta horizontale. Faqja e tyre e jashtme është gdhëndur rrafshët në mënyrë të ashpër, ndërsa faqet ansore janë gdhendur me kujdes. Në territorin tonë muraturën e mësipërme e vemë re në Apolloni, Dorz, Irmaj, Jermë, Melan, Lekël, Cerje etj., ndërtime këto të fillimit shek. III ose e shumta fundit të shek. IV.[16]). Ky datim mbështetet dhe nga qeramika e gjetur në brendi të rrethimit, e cila në qendrat e tjera daton në diapazonin shek. III-I p.e. sonë[17]). Në këtë drejtim ajo përcakton dhe vazhdimësinë e jetës për periudhën antike. Vlen të vemë në dukje se fragmenti i një ene «Megare» ka dekor krejtësisht të njëjtë me atë të një kallëpi të zbuluar në Amantia[18]) dhe se brumi e faktura e enëve është mjaft e ngjashme me atë të Amanties.

Përveç trakteve të mësipërme, në dy pika të murit në anën jugore dhe veriore, dolën në dritë dy trak-

14) Kaninën e kemi trajtuar më gjatë në artikullin **Qyteti i fortifikuar i Kaninës,** Monumentet 7-8.

15) M.W. Leake **Vep. cit.** 2, vë në dukje praninë e një fortifikimi antik në Kaninë, por nuk bën fjalë për trakte «in situ»; pak më vonë J.G. Hahn **(Albanesische Studien,** Wien, 1855, 72) arrin të gjejë vetëm blloqe të përdorura e jo trakte «in situ». Po kështu dhe R.L. Beaumont, **Corinth, Ambracia, Apollonia,** «Journal of Hellenic studies», 1952, 66). Ekzistenca e mureve «in situ» vihet në dukje vetëm nga H. Ceka **(Probleme të numismatikës Ilire,** Tiranë, 1972, 92).

16) H. Ceka, **Muri rrethues i Apollonisë,** B.SH.SH., 1963, 3, 131, H. Ceka **zbulimi i një qyteti antik në rrethin e Tiranës,** «BISH», 1951, 1. F. Prendi, Dh. Budina, **Kalaja e Irmajt** B.SH.SH., 1973, 4, 15. Dh. Budina **Antigone,** Iliria, II, 1972. Melani dhe Lekli tek H. Ceka, **Ekspedita arkeologjike në rrethin e Tepelenës,** B.SH.SH., 1952 34-42 dhe A. Baçe **Vështrim mbi qendrat e banuara...** Cerja sipas vrojtimeve në vend të autorit.

17) B. Dauti, **Qeramika e Dimalit** (dorëshkrim); S. Anamali, **Amantie,** Iliria, 2, 1972.. Dh. Budina, **Antigone,** Iliria, 2, 1972; L. Papajani, **Qeramika e qytetit Ilir në Klos** (dorëshkrim).

18) S. Anamali, **Vep. cit.**

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

te muresh 2 m. të gjerë, të ndërtuar me teknikën «opus mixtum» (Fig. 6). Në to në një distancë 1,10 m nga tabani, brezi i gurtë shkëmbehet prej brezit 6 rreshtësh prej tullash. Veçoritë teknike të muraturës[19]) si dhe përmasat e vulat e tullave[20]) e datojnë traktin e mësipërm në shek. e VI. Përveç monedhave të Justinianit, një folisi të prerë në Nikomedi në vitin XVI të mbretërimit (viti 544), të gjetur në fillim të shtresës kulturale të periudhës së vonë antike, ky datim mbështetet dhe nga qeramika.

19) S. Bobçev, **Smeshanata. zidarija v rimskitje i ranjevizentiskite strojezhi,** Sofia 1952, 12-23, Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Elbasanit,** Monumentet 1, 1971, **Të dhëna të reja mbi kalanë e Elbasanit,** Monumentet, 3, 147-152.

20) Në mesin e njerës prej kullave gjendet i stampuar në reliev një kryq simetrik, ndërsa në një fragment tulle të zbuluar gjatë sondazhit, është vizatuar skematikisht një degë ulliri identike me një zbukurim të njërës prej kullave të shek. VI në kalanë

DO NOT COPY

TREPORTI

Në skajin verior të gjirit të Vlorës në Treport (Tab. I), një varg i ulët kodrinor, që vazhdon prej veriut në jug, shtyhet deri në buzë të detit. Në veri të tij gjendet liqeni i Nartës, në perëndim dhe jug deti, ndërsa në lindje, ndërmjet tij dhe një vargu që vazhdon paralel me të, por pa e arritur bregun, gjendet një truall rreth 1 km i gjatë dhe 0,5 km i gjerë. Kodra më jugore e vargut në lindje, ku gjenden dhe disa burime uji të pishëm, bie me pjerrësi 30°-35°, në veri, ku një qafë e bashkon me vargun, ka një pjerrësi më të butë, ndërsa në anët e tjera thepiset me shkëmbinj të lartë (Fig. 7).

Qyteti i fortifikuar dhe skela përmenden prej Evlija Çelebiut Sipas tij «në perëndim të fshatit Zvërnec, në një shkëmb në buzë të detit, gjendet kështjella e Jengjeçit, prej së cilës ruhen vetëm rrënojat e mureve dhe një liman shumë i madh... Me gurët e tyre Sulltan Sulejmani ndërtoi fortesën e Vlorës»[21]). Fakti që muret e kalasë së Vlorës janë ndërtuar me blloqe të thyera, të periudhës antike[22]), na shtyu të vëzhgojmë më me kujdes kodrën e mësipërme. Gjurmët që u gjetën nga sondazhet treguan se linja e mureve ndiqte kodrën në 2/3 e lartësisë së saj, duke rrethuar një sipërfaqe prej afër 3 ha (Fig. 8). Blloqet e murit identike me ata që qenë ripërdorur në kalanë e Vlorës kanë faqe ballore të punuar rrafshët, buzë të skuadruara me kujdes dhe faqe anësore të gdhendura mjaft mirë.



Fig. 5

Skela për të cilën bën fjalë Çelebiu veç shkatrimit kryesor prej turqve, për të ndërtuar me gurët e saj kalanë e Vlorës, është dëmtuar në mënyrë sistematike dhe më vonë, duke shërbyer si gurore për ndërtimet që kryheshin përreth. Megjithëkëtë poshtë pasqyrës së ujit dhe në pjesën e saj të fillimit, ruhen ende gjurmë, të cilat së bashku me disa sondazhe dhe një skicë të K. Paçit[23]) (Fig. 9), na japin mundësi që të rindërtojmë në vija të përgjithshme planimetrinë e saj. Bankina nis në rëzë të kodrës atje ku kjo vazhdon si gjuhë e ngushtë për 200-300 m në thellësi të detit. Shkëmbinjtë e gjuhës, që ngrihen 0,5--1 m mbi ujë, luajnë rolin e një valëthyesi natyral, i cili krijon një zonë të qetë të mbrojtur mjaft mirë prej dallgëve.

Bankina vazhon në vijë të drejtë për 650 m duke qenë kështu një nga më të mëdhatë e kohës[24]) (Fig. 8, 10). Kjo gjatësi jepte mundësi që të akostohe-

---

e Durrësit. Tulla me stampë me kryq janë gjetur në shtresat e shek. V-VI në kalanë e Elbasanit, (Gj. Karaiskaj, **Të dhëna të reja...** 147), po kështu në muret e shek. VI të kalasë së Durrësit janë gjetur tulla që përkojnë tërësisht më atë të Kaninës, si nga stampa ashtu dhe gjatësia e trashësia e tyre (K. Zheku, **Zbulime epigrafike në muret rrethuese të kakalasë së Durrësit:**, Monumentet 3, 1972, 37, 42, (Fig. 9).

21) E. Çelebi **Seyehatnamesi,** Istambul, 1898, 708.

22) A. Baçe, **Kalaja e Vlorës,** Monumentet 5-6, 43-59.

23) C. Patsch, **Das Sandschak Berat in Albanien,** 63, fig. 49, Paçi jep dhe një përshkrim të shkurtër të pjesës së fillimit. L.M. Ugolini (**Albania antica,** Roma-Milano, 1927, 107, fig. 78 në tekst fig. 10) e quan apriori rrugë të zhytur në det. Rruga, e cila mund të ndiqte fare më mirë bregun, i cili nuk është moçalor, nuk kishte asnjë arsye që të futej brenda në det.

24) Shih Lehmann-Hartleben, **R.E.,** 13, 1, 1926, col. 547-569. Bankinat më të mëdha të kësaj kohe rrallë herë arrinin gjatësinë 1 km.



Fig. 6

shin me bord, në mënyrë të njëkohshme, 25-30 anije të rënda transporti, ose një numër 2,5 herë më i madh anijesh lufte[25]). Bankina në pjesën e fillimit, ku i mbështetet bregut të kodrës është punuar me blloqe kuadratike, me faqe të jashtme të rrafshët, faqe anësore të gdhëndura mirë dhe përmasa 0,47x0,40 m. të vendosur në rreshta horizontale. Sipas Paçit, muri që vazhdonte në një gjatësi prej 13,5 m përbëhej prej blloqeve gjatësore dhe blloqeve të lidhjes tërthore[26]), teknikë karakteristike kjo për tërë portet e periudhës helenistike[27]). Pas kësaj distance prej bankinës 2.8-3 m të gjerë ruhet vetëm pjesa nën ujë e punuar me blloqe me formë paralelopipedi, të latuar ashpër. Bankina shërbente njëkohësisht si bazament i rrugës për ngarkimin dhe shkarkimin e anijeve. Këtij qëllimi duket se i kanë shërbyer dhe disa trakte të punuara po me këtë teknikë dhe me të njejtën gjerësi, që gjenden tërthor me bankinën. Prej tyre në skicë, rreth 30 m larg fillimit të molit, shohim një trakt të tillë. Po kështu në fundin e bankinës, që gjendet 30 m larg bregut, gjetëm një trakt tjetër tërthor, i cili sipas sondazheve vazhdonte 45 m në brendi të steresë (Fig. 8). Të dyja muret e mësipërme kanë një largësi 4-5 m nga muri gjatësor, me sa duket për të mos penguar kalimin e barkave ose të anijeve me fund të cekët në pjesën e brendshme të molit, largësi që duket se mbulohej me ura të lëvizshme.

Trualli ndërmjet dy vargjeve kodrinore që përmendëm më sipër është i mbushur me gjurmë ndërtimi dhe fragmente qeramike, togjet me skarcitete të të cilave dëshmojnë për praninë e punishteve. Në afërsi të shpatit të kodrës së fortifikimit (Fig. 8) në një thellësi 3,4 m mundëm të hetojmë gjurmët e një ndërtimi me blloqe të latuara. Nga ana tjetër në ekstremin verior të kodrës buzë kënetës janë gjetur gjurmë të një rruge të shtruar me gurë[28]).

Qeramika e zbuluar gjatë sondazheve paraqitet thuajse e njëjtë me atë të Kaninës. Por ndërsa në Kaninë ajo thuajse zhduket në shekujt e parë të erës sonë, në Treport fragmentet e shumta të qeramikës terasigillata tregojnë për vazhdimin e jetës në këtë periudhë. Një veçori tjetër është se ajo gjendet me shumicë në fillim të shpateve të kodrës së kalasë, ndërsa mungon tërësisht në brendi të fortifikimit. Kjo dukuri si dhe fakti që Treporti nuk lot asnjë rol në operacionet e Cezarit, dëshmon, se ai në këtë kohë e kishte humbur karakterin ushtarak.

25) Për gjatësinë dhe akostimin e anijeve shih J. Kromayer – G. Veith. **Heerwesen und Kriegführung der Grichen und Romer, München, 1928,** 184-7.

26) Në kohën kur e vizitoi Paçi Treportin, muri ruhej i plotë në një lartësi 3,5 m dhe gjatësi 13,5 m. Sot prej tij kanë mbetur vetëm 3 blloqe, në një lartësi 3 m nga niveli i detit.

27) Lehmann-Hartleben, (**Die antiken Haffenanlagen des Mittelmeres,** Leipzig, 1923) vënë në dukje përdorimin e kësaj teknike në Rodos, Elaia, Herekleia, Delos dhe e përgjithësojnë për tërë periudhën helenistike.

28) Ndërtimi u zbulua rastësisht gjatë hapjes së një grope të thellë për qëllime aditjeje. Me gjithë pengesën e ujit dhe baltës mundëm të konstatojmë dy radhë blloesh kuadratike prej gëlqerori të punuara mjaft mirë, 3 m të gjata, të vendosura me një farë shkallëzimi ndaj njëra-tjetrës, si dhe një linjë tjetër 90° ndaj së parës. Gërmimi rrëzës së Kodrës të mbuluar nga dherat, e si pasojë të shpëtuar nga shkatërrimi i plotë do të ishte me interes në të ardhmen. Gjurmët e rrugës patën dalë gjithashtu rastësisht në dritë nga punimet bujqësore.

DO NOT COPY



Fig. 7

* *
*

Lokalizimi i qendrave antike, deri më sot, është i sigurtë vetëm për Orikun. Në të kundërt, për Treportin dhe Kaninën mendimet kanë qenë kontradiktore, kryesisht si pasojë e materialit të pakët burimor, prej të cilit kuptojmë vetëm se gjiri banohej prej amantëve dhe Bylinëve[29]). Duke i lënë tokat në rajonin jugor (deri afër Rradhimës) Orikut, del se në rajonin verior, në një zonë prej Ujit të Ftohët dhe deri në veri të Kënetës së Nartës[30]), gjendeshin Amantët në jug dhe Bylinët në veri. Në këtë bregdet Ptolemeu rreshton Orikun, Amantian, Bylisin dhe Aulonën (qytet dhe skelë) ndërsa më tej ai jep dhe një Amantie të brendshme[31]).

Duke marrë parasysh të dhënat e Ptolemeut, Amantia bregdetare del 15 njësi larg Orikut (15') dhe 40 njësi larg Apolonisë (40'), pra diku afër Ujit të Ftohët.

Nga ana tjetër nuk kanë munguar dhe sprovat për lokalizimin e Kaninës. Pas identifikimit imagjinar të Pukëvilit me Oeneusin e Livit, kemi përpjekjen e Bomosë. Duke u mbështetur në një fragment qeramike, sipas tij të shek. VII-VI p.e.sonë, dhe pasazhit të Pausanias, Bomo e rreshton dhe Kaninën ndërmjet tri qendrave antike ku ai supozon të ketë qenë Throni[32]). Në shikim të parë identifikimi është i pranueshëm[33]), kështu që ai është përkrahur dhe nga mjaft studjues të tjerë, ndërmjet të cilëve N. Hamond, dhe së fundi D. Komata[34]). Por, po të analizohet problemi nga afër, pozita dhe të dhënat arkeologjike e arkitektonike të vetë Kaninës, e rrëzojnë këtë lokalizim. Së pari apoloniatët para Kaninës, e cila konkuronte kryesisht Orikun, kishin më afër Treportin ose qytetin në Cakran, faza e parë e të cilit tregon një teknikë më primitive[35]). Së dyti materiali më i hershëm arkeologjik, pas të cilit vjen shtresa sterile, nuk shkon më

29) Scyl. 27, 4; Ptolem. III 12,4 e 19; Steph. **s.v. Amantia;** Caes, **Bell. Civ.,** III, 12,4; Ptolem. III, 12.

30) Areali i Apolonisë, i cili e kufizonte këtë rajon nga veriu, sipas burimeve historike nuk ka qenë shtrirë së tepërmi në jug, mendojmë se nuk e kalonte rrjedhjen e sotme të Vjosës, që duket se përkon me rrjedhjen e vjetër të lumit të Vlorës.

31) Ptolem. III, 12.

32) F. Pouqeville, **Voyage dans la Grèce,** Paris, 1820; R.L. Beaumont. **Vep. cit.** 66. Sipas Bomosë të dy qendrat e tjera ku mund të ketë qenë Thronioni janë Klosi dhe Ploça. Për sa i përket kohës së ndërtimit të Kaninës, ai muret antike i pranon si të kohës helenistike, por supozon se ajo ka qenë banuar më parë. Këtë ai e mbështet te fragmenti i qeramikës së gjetur në sipërfaqe të kalasë, me brumë portokalli në të verdhë e të pikturuar me shirita ngjyrë portokalli që alternohen me breza kafe dhe hapësira të pikturuara. Gjetja e një fragmenti të tillë lë mjaft për të dyshuar, pasi ajo vështirë se mund të gjendej në sipërfaqen e një trualli të banuar për mijëra vjet me radhë, kur për më tepër gjatë gërmimeve nuk është gjetur asnjë fragment i kësaj kohe. Ndoshta Bomoja e konfondon atë me ndonjë fragment qeramike të mesjetës së vonë, për të cilat është karakteritik dekori i sipërm.

33) Pausania e përcakton Thronin si qytet të ndërtuar nga lundërtarë Eubeas, në afërsi të maleve Keraune, por të shkatërruar prej apoloniatëve (Paus. V. 22, 3 e 4). Gjetja e mbishkrimit votiv apoloniat në Olimp, për të cilin bën fjalë pausania, që daton në gjysmën e I të shek. V (E. Kunze **Berichte uber die Ausgrabungen in Olympia,** 1956, 149), e bën mjaft të besueshëm këtë identifikim.

34) N.G. Hammond, **Epirus,** Oxford, 1967; D. Komata, **Forteresses hautes mediévales Albanaises.** I-er colloque des études Illyriens (comunications) 2.

Pasazhi i Pausanias i bën amantët kolonë dhe i vendos buzës së detit. Pa e diskutuar përkatësinë e tyre etnike, vemë në dukje se ata kishin shtrirje të brendshme dhe qendra e tyre ndodhej në hinterland.

35) Cakrani është vizituar prej Prashnikerit, por për shkak të pyllit të dendur ai dalloi vetëm akropolin. Gjatë një ekspedite informative në vitin 1972, si pasojë e prerjes së pyllit, gjetëm rrënojat e një qyteti me sipërfaqe rreth 12 ha, në muret e të cilit shihen 3 faza ndërtimi, prej tyre më e hershmja me blloqe të mëdhej paksa të punuar.

DO NOT COPY



Fig. 8

tej fillimit të shek. III, e shumta fundit shek. IV, datim ky që përkon dhe me teknikën e ndërtimit të mureve.

Lind pyetja nëse Kanina qytet bregdetar në një zonë të përshkuar prej korentesh të fuqishme ekonomiko-politike i ka shpëtuar vëmendjes së historianëve dhe gjeografëve antikë. Siç e pamë më sipër në këtë zonë përmendet vetëm një qytet me emrin Amantia, me kordinata që përkojnë mjaft mirë me ato të Kaninës. Pozita e tij e kushtëzuar nga lidhja e njëkohëshme me detin, në një zonë të përshtatëshme për qendrimin e anijeve dhe hinterlandin Amantin (luginën e Lumit të Vlorës), në një vend që kontrollon kalimin nga pjesa jugore e gjirit, e zënë prej Orikut, në atë veriore, të zënë prej amantëve, dëshmon mjaft mirë se këtu kemi të bëjmë me një qytet amant. Zhvillimi i Amanties në shek. IV-III p.e.s. dhe kthimi i saj në një nga qendrat më me rëndësi të bregdetit të poshtëm të Adriatikut[36]), sigurisht që kërkonte një qendër buzë detit për kryerjen e tregtisë detare, qendër që sipas nesh ishte pikërisht Kanina. Vetë emri ilir Kaninë[37]) mendojmë se do të ketë mbetur i fshehur nën emrin e fisit dhe qytetit mëmë Amantie.

Për sa i përket qendrës tjetër Straboni ndërmjet Orikut dhe Apolonisë, në bregdet, vendos Bylliakin[38]), ndërsa Ptolemeu pas Apolonisë rreshton Aulonën (qytet dhe skelë) dhe Bylisin. Identifikimi i Aulonës me rrënojat e Treportit[39]) është jashtë dyshimit, pasi asnjë qendër tjetër nuk i përgjigjet më mirë përkufizimit të Ptolemeut. Por në këtë zonë, siç e pamë më sipër, gjendet vetëm një qytet bregdetar ai në Treport, duke u nisur nga kjo Tomashek hedh mendimin se ndoshta Aulona fillimisht ka qenë Bylisi[40]). Ky supozim na duket i drejtë, pasi një qytet i vetmuar pa lidhje të forta me hinterlandin, si ekonomike ashtu dhe ushtarake, do të qe eliminuar me kohë prej Apolonisë fqinjë, e cila duhet të ndiente mirë konkurencën e saj tregtare. Për më tepër vetë emri Aulonë nuk është një emër i përveçëm vendës, siç do të pritej për një qytet ilir, por një emër grek, që për më tepër shfaqet me vonesë, kur tutela e Bylisit ndaj qendrave të tjera ishte dobësuar së tepërmi.

36) H. Ceka, **Probleme....,** 75.
37) A. Mayer, **Die Sprache der alten Illyrier,** Wien, 1957, I. s.v. Kanina.
38) Strab. VII, 316.
39) C. Patsch, **Vep. cit.** 63.
40) W. Tomaschek. R.E. III 1899 col. 1105-1106 s.v. Byllis.

DO NOT COPY



Fig. 9

Identifikimi i qytetit të Kaninës në periudhën e vonë antike mendojmë se mund të arrihet në saje të listave të Prokopit. Ndërmjet fortifikimeve të ndërtuara në Epirin e Vjetër, ai përmend dhe njërin me emrin Kionin[41]). Qenia e Kaninës pikërisht në kufirin midis dy Epireve (siç kuptohet nga burimet, ndarja tradicionale kalonte midis Ujit të Ftohtë dhe Rradhimës), na lejon të supozojmë se ajo mund të jetë vënë gabimisht në Epirin e Vjetër.

Kështjella e Sofës mendojmë se si në kohën antike, ashtu dhe atë antike të vonë, quhej Tragjas, emër të cilin e gjejmë te Stefan Bizantini për një krahinë të Epirit (Tragasai), të njohur për nxjerrjen e kripës[42]), pra në buzë të detit, emër që ruhet dhe sot e kësaj dite për fshatin ngjitur kështjellës.

Për sa i përket Aulonës dhe Orikut ata vazhdojnë të ruajnë dhe sot trajtën e vjetër.

* * *

Ndonëse Oriku, Kanina dhe Treporti janë qendra, qëllimi kryesor i të cilave ishte lidhja me detin, ato kanë karakteristika të ndryshme.

Oriku i vendosur në një kodër të ulët shkëmbore, të bashkuar me tokën me një rrip të ngushtë dhe i pajisur me një skelë të klasës së parë, të mbrojtur nga sulmet prej steresë, paraqet ngulimin tipik të hershëm kolonist. Si skemë urbanistike këtu kemi të bëjmë me tipin e qytetit me akropol në mes. Specifika e veçantë në këtë rast është ndarja e tij në 4 pjesë nga një mur i tërthortë.

Kanina hyn në tipin e qytetit pa akropol. E vendosur në një zonë mjaft të përshtatshme për lundrimin e asokohshëm (afër një plazhi ku thellësia rritet shpejt), ajo jashtë çdo dyshimi ka pasur një skelë të sajën, prej ku rruga për në qytet s'mbante më tepër se 20-25 minuta[43]). Në këtë drejtim ajo ndryshon nga qytetet e lidhura drejtpërsëdrejti me skelën (Oriku, Treporti, Lisi etj.), por dhe nga qyteti i brendshëm bregdetar (Ceria, Mavrova, Zgërdheshi etj.) duke paraqitur kështu një tip më vete që përkon me Himarën dhe Sopotin.

Treporti paraqet gjithashtu tipin e qytetit pa akropol, por synimi për të qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me detin, ka sjellë kapjen e një kodre të ulët (me sa dimë ky është qyteti më i ulët ilir), duke gjetur paralelen e tij në këtë drejtim vetëm tek Oriku. Por, nëse Oriku ka një skelë të mbrojtur nga inkursionet, në Treport kjo është e hapët, gjë që i jep atij një karakter më tepër civil se ushtarak.

Sofa paraqet kështjellën tipike të periudhës së vonë antike në drejtim të pozitës natyrale (kodër e lartë me faqe të rrëpirta), përmasat, si dhe nga pozita strategjike ndaj rrugëve të qarkullimit.

* * *

Në shek. VI-IV p.e.s. Pseudoskylaksi, Herodoti dhe Skymni, pas Apolonisë përmendin vetëm limanin e Orikut, ndërsa bylinët dhe amantët dalin si banues të brigjeve, por pa ndonjë qendër bregdetare[44]), të dhëna këto që mbështeten dhe nga gërmimet arkeologjike. Siç shihet e vetmja qendër qytetare në gjirin e Vlorës ishte Oriku, zanafilla e të cilit i përket shek. VI[45]). Ngulimi në këtë vend, në shikim të parë të papërshtatëshëm, nuk është i rastit. Duke synuar në tregtinë me hinterlandin amantin, orikasve u duhej njëkohësisht që t'i largoheshin rivalitetit të rrezikshëm apoloniat, që do të vinte si pasojë e vendosjes afër tyre në zonën veriore më të përshtatur nga ana ekonomike. Për pasojë ata u ngulitën në jug, larg Apolonisë, në një zonë të mbrojtur nga male

41) Proc. **de aed.** IV, 4
42) Steph. s.v. Tragasai.
43) Sot mund të ndiqet fare mirë traseja e rrugës mesjetare 2-2,5 m të gjërë, të pajisur dhe me vepra arti, e cila ka shumë mundësi të përkonte me rrugën antike. Ajo zbret prej kalasë në plazhin e Ujit të Ftohët.
44) Scyl. 26; Herod. IX. 93; Scymn, V. 440; Scyl. 22, 27.
45) Dh. Budina, **Vep. cit,** 155-177.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

të kalueshme me vështirësi ndonëse të papërshtatshme për bujqësi. Nga ana tjetër, synimi i tyre për marrëdhënie tregtare me amantët, u sigurohej nga rruga që nëpërmjet Qafës së Shëngjergjit të nxirrte në luginën e Lumit të Vlorës. Nëpërmjet kësaj pozite orikasit arrinin të tërhiqnin një pjesë të mirë të tregtisë me Apoloninë, pa pasur kontakt të drejtpërdrejtë me të.

Kjo pamje ndryshon nga fillimi shek. III p.e.s., kur zhvillimi ekonomiko-shoqëror i Bylisit dhe Amanties solli si pasojë domosdoshmërinë e tregtisë së rregullt detare[46]). Mendojmë se pikërisht me këtë nevojë lidhet dhe themelimi i qytetit në Treport (për Bylisin) dhe në Kaninë (për Amantien). Siç e vumë në dukje, këto themelime, mjaft të dëmshme për Apoloninë dhe Orikun, nuk do të toleroheshin, nëse pas tyre nuk do të qëndronin njësitë e fuqishme byline dhe amante. Më tepër prej kësaj duhet të ketë vuajtur Oriku, thuajse i patokë, të cilit i shkëputet hinterlandi (lugina e Lumit të Vlorës), ndoshta duke u bërë shkas për kthimin e tij në një qendër të suksesshme ndërtimi anijesh[47]). Kemi të bëjmë pra me një veprimtari të tillë të qyteteve dhe fiseve ilire, e cila u bie ndeshas interesave të kolonive helene, pa e përfillur reagimin e tyre. Gjatë kësaj kohe duket se në Treport përqëndrohet tregtia byline (zona e Mallakastrës) dhe e vendeve përreth Vjosës, ndërsa në Kaninë tregtia, më pak e rëndësishme, me luginën e Lumit të Vlorës dhe zonat përreth.

Pushtimi i Ilirisë nga Roma, siç kuptohet tërthorazi nga burimet shkrimore dhe gjetjet arkeologjike, nuk pati pasojë shkatërrimin e dhunshëm të qendrave të gjirit të Vlorës[48]). Për më tepër në shekujt e parë të këtij pushtimi, siç e dëshmon qeramika, ka një farë gjallërimi të jetës, me sa duket si pasojë e zhvillimit ekonomik të Bylisit e Amanties[49]). Me vendosjen e pushtetit të plotë romak në shekullin e parë në këto zona dhe përfshirjen e tyre në provincën e Maqedonisë, Amantia dhe Bylisi humbasin të drejtat e mëparshme[50]) dhe tutelën ndaj Kaninës e Treportit. Gjatë kësaj periudhe qetësie relative, Kanina, për shkak të pozicionit të saj të lartë e të lodhshëm për komunikim, e humbet rolin ekonomik, kështu që jeta në të shuhet gradualisht. Treporti si qendër fushore vazhdon të mbijetojë, ndonëse dhe në



Fig. 10

të jeta shpërngulet jashtë mureve rrethuese, në qytetin e poshtëm. Rolin ushtarak përgjatë kësaj kohe vazhdon ta luajë Orikumi. Veçanërisht kjo kuptohet nga operacionet e Cezarit. Ndërsa Kanina dhe Treporti nuk përmenden fare, Oriku luan një rol të dorës së parë si kryeurë për zbarkimin e ushtrive të tij dhe si bazë kryesore për operacionet në drejtim të veriut[51]). Përmendja vetëm e Orikut prej Melës dhe Plinit[52]) tregon se deri në shek. I Oriku luante rolin kryesor, edhe në drejtimin ekonomik.

Duke filluar nga shek. II vërehet një ngritje e Treportit (Aulonës). Pas përmendjes prej Lukjanit dhe Ptolemeut ai del gjithnjë në Itinerarët e fillimit të

46) S. Anamali vë në dukje fillimin e tregtisë me Apulien që në shek. III **(vep. cit.,** 117).
47) Këtë e argumenton në mënyrë bindëse H. Ceka **(Probleme....** 87, 88), por mendojmë se në fillim ndërtimi i anijeve ka pasur një rol të dorës së dytë, krahas tregtisë.
48) Liv. XIIV 30, 10. Pin N.H. IV, 10.
49) H. Ceka **Probleme....** 78, V, 82 V. S. Anamali **Vep. cit.** 119.
50) H. Ceka **Probleme....** 81.
51) Caes **Bell. Civ.** III 11, 3; 12, 1; 13, 1; 16, 2; 40, 1; 74, 4, 6; App, **Bell. Civ.,** II 54-56.
52) Mela II, 3, 56; Plin N.H. III 22.

shek. III-IV. Përmendja e tij në Itinerarin detar të Antoninit, Itinerarin e Antoninit dhe tabula Peutingerianën e dëshmojnë atë si skelë tregtare, ndërsa përmendja në Itinerarin Hierosomylitan si skelë pasagjerësh[53]). Në këtë kohë emri i Orikut humbet dhe nuk haset më ndër burimet. Shkaku i këtij zëvendësimi do parë në pozitën e Orikut, të tërhequr prej rrugëve kryesore, kështu që ai zëvendësohet prej Aulonës me pozitë mjaft të favorshme, të pajisur me një skelë të dorës së parë. Ndoshta në këtë drejtim luajti rol dhe tërmeti i rëndë i shek. II[54]). Megjithatë gjatë kësaj periudhe, si pasojë e afrisë me Apoloninë, Aulona ende nuk i pat marrë tiparet qytetare, kështu p.sh. në Itinerarin e Burdigalës ajo përmendet si mansio, përkrah Apolonisë-civitas[55]). Ndonëse rënia e mëvonshme e Apolonisë, si pasojë e devijimit të lumit dhe eliminimit të saj si skelë, duhet të ketë pasur një ndikim pozitiv në rritjen e Aulonës, zhvillimin e saj nuk e shohim vetëm si pasojë të kësaj rënieje dhe të lëvizjes thjesht mekanike, por si pasojë të zhvillimit të qendrave fushore, nyje të rëndësishme tregtare.

Në periudhën e vonë antike roli i qendrave të gjirit të Vlorës pëson ndryshime. Siç kuptohet nga listat e qyteteve dhe të peshkopatave të kësaj kohe, rajoni i Vlorës kufizohej me rajonet e Onhezmit (Sarandës), Amanties, Bylisit dhe Apolonisë[56]), me sa duket me një shtrirje në gjirin e Vlorës dhe luginën e Lumit të Vlorës. Pikën qendrore në këtë territor e zë Kanina, e cila siç e pamë ishte pika e vetme ku zona e Lumit të Vlorës lidhet lehtësisht me atë anë detare. Nga ana tjetër në këtë periudhë hiqet dorë nga qytetet e mëdha (kategoria e Apolonisë, Jermës etj.), pasi rrethimi i tyre do të kërkonte mund dhe kohë të gjatë në një periudhë kur kjo e fundit ishte mjaft e kufizuar dhe më kryesorja se ato nuk do të mund t'i mbronte kush, pasi popullata qytetare qe reduktuar së tepërmi. Si pasojë kapen qytetet me mbrojtje të mirë natyrale. Kështu Kanina me sipërfaqe 3,6 ha, e destinuar për një rol ndihmës në antikitet, në këtë kohë del në plan të parë, pasi si nga pozita qendrore, ashtu dhe nga madhësia dhe mbrojtja natyrale, ajo u përgjigjej mjaft mirë kërkesave të kësaj periudhe. Punimi i mureve të saj me muraturë të rregullt, me teknikën «opus mixtum», shfaqje që s'e kemi hasur në qendrat e tjera malore, tregon gjithashtu për rëndësinë e kësaj qendre. Me sa duket në këtë kohë lind edhe simbioza, e cila shfaqet më e qartë në mesjetën e mesme, ndërmjet Kaninës, qendër administrative-ushtarake dhe Aulonës, qendër tregtare, e cila në shek. VI del si qytet e skelë[57]). Oriku, i cili vazhdon jetën në zonën jugore, duket se shërben si një nënqendër e saj, pasi ai tashmë ka humbur në burimet historike, dhe skelë ushtarake detare. Kujdesi për kontrollin e vijave të komunikimit, karakteristik për këtë periudhë, sjell ndërtimin e një vargu fortifikimesh në luginën e Vjosës (Gurzezë, Bylis, Kalivaç, Zharës etj.), dhe atë të Lumit të Vlorës (Vranisht, Boder, Cerie, Sopot) (Tab. I). Me vargun e fundit lidhet dhe Kanina, e cila mbyll daljen perëndimore nga kjo luginë për në bregdet, si dhe kështjella e Sofës që kontrollon kalimin prej saj në zonën jugore të gjirit si dhe hyrjen nga rruga e Llogorasë.

POOR COPY

53) Ptolem. III, 12, 2; **T.P. Miller.** col. 559-569 **I.R. Cunt** 323, 10; 329, 2; 608, 10; 609, 2; It. marit. 323, 329, 409, 497.

54) Dh. Budina **(Teatri....** 175) mendon se veprimtaria rimëkëmbëse e Herod Atikut ishte e pasukses. Por sidoqoftë prania e shtresës kulturale dhe e ndërtimeve të periudhës së vonë tregon se jeta në të nuk ndërpritet, megjithëse ai duket se kthehet në një qendër të dorës së dytë, të varur nga Aulona.

55) **I.B. Cuntz.** 608, 10; 609, 2.

56) **Hierocl.** 651-653, Rav. IV. 5; V 13 **Not. Episc.** III 615-697, V. 458. 519-583.

57) Prokopi **(bell. Goth.** I., 14, 24).

Apollon BAÇE

LES CENTRES FORTIFIES DU GOLFE DE VLORE DANS L'ANTIQUITE

R E S U M E

Le golfe de Vlore (Tab. I), qui commence au nord avec le promontoire de Treport et se termine avec le promontoire de Gjuhëze, est entouré du côté de la terre ferme par de hautes montagnes rocheuses retrécissant de beaucoup la bande côtière plate.

Les conditions de navigation et de stationnement des navires sont assez bonnes dans le golfe de Vlore, en plus celui-ci communique facilement avec les autres centres et régions de l'Albanie.

Dans la période antique ont vu le jour dans cette région une série de centres habités, qui, en fonction de leur développement économique et social et des exigences politiques et militaires de l'époque, ont joué un rôle de première importance ou secondaire, aussi bien par rapport les uns avec les autres qu'avec les villes de l'arrière-pays.

L'étude en groupe de ces centres éclaircira, à notre avis, le rôle qu'ils ont joué à l'époque et les liens qui ont existé entre eux, tout en mettant en évidence les caractéristiques particulières à chaque époque.

O r i k occupe une position assez favorable comme escale maritime. Elle communiquait avec la terre ferme à travers des routes difficiles que l'on pouvait bloquer facilement; en plus tout approche du côté de la mer pouvait être remarquer à temps, mais cette zone était peu favorable à l'agriculture et son hinterland assez pauvre.

La cité fortifiée se dresse sur une colline de faible altitude calcarée, longeant la mer, que l'on appelle Paleokaster. Cette colline, couvrant un périmètre de 5 ha environ, est délimitée par une muraille longue 950 m. (Fig. 1). Dans la partie supérieure de la colline s'étend un second mur, qui constituait l'acropole. En plus un troisième mur transversal, en direction est-ouest, divisait la dite colline en deux parties symétriques l'une à l'autre. Il s'agissait donc d'un système de défense comportant quatre sections distinctes l'une de l'autre, mais communiquant entre elles et en état de résister de manière indépendante même lorsqu'une d'entre elles était passée à l'ennemi.

Le port intérieur (portus introitus), mentionné par César, a été localisé dans la lagune. Ici, au-dessous de la nappe d'eau, l'on peut encore voir les traces d'un mur large 1.80 m, qui reliait ses deux bords. Nous sommes en présence d'une quai permettant l'accostage des navires, qui, toute considération faite de la largeur de la lagune en ce point, devait avoir une longueur de 200 m. environ.

Au commencement de notre ère, tout comme Apollonie, Orik a été l'une des principales bases navales de César dans l'Albanie du Sud. Par ailleurs la construction d'un théâtre du Ier siècle montre qu'Orik a connu la prospérité même pendant la période impériale, ce qui est aussi prouvé par l'activité déployée par Hérode d'Attique pour la reconstruction de cette cité après le tremblement de terre survenu au IIe siècle.

L. Heuzey-M. Daumet et Ugolini indiquent que la muraille extérieure a été reconstruite plus tard avec des briques liées avec du mortier de chaux. La reconstruction de cette muraille, à en juger par la technique employée, remonte à la basse antiquité, aux IVe-VIe siècles.

La forteresse de Sofe (Tragjas) occupe une position stratégique, contrôlant les deux seules voies méridionales de sortie de cette zone et servant dans le même temps de poste d'observation et même de défense par derrière pour la cité maritime d'Orik. Les murs liés au mortier entourent la partie supérieure de la zone plate s'étendant sur une surface de 0,18 ha, mais la plate-forme orientale renferme des traces d'habitations en ruine. Les courtines sont en pierres de petites dimensions, liées abondamment avec de la chaux. Une seule tour est conservée actuellement. Les fragments de céramique mis à jour dans son périmètre et la technique de construction attribuent ce centre aux IVe-VIe siècles.

K a n i n e est le seul emplacement créant des conditions de communication favorables entre la côte et la vallée du fleuve de Vlore. En dehors de sa position économique et stratégique, il est à même de satisfaire toutes les autres conditions requises par un centre fortifié: la présence de l'eau et de la pierre, tout comme une défense suffisante. Il est vrai

DO NOT COPY

INST. MON. KULTURES
BIBLIOTEKA
№ INV. 8665


Vjosa
ÇAKRAN
BYLIS
TREPORT
Lumi i Torës
KANINE
MAVROVE
AMANTIE
ORIKUM
Prroi i
Gjon Boçar
Bodër
Sofë
Cerie
Vranisht
KANINE - QYTETE
Cerie - KESHTJELLA ANTIKE
QENDRA TE FORTIFIKUARA ANTIKE
QENDRA TE FORTIF. ANTIKE TE VONA
QENDRA TE FORTIF. MESJETARE
TRASETE E RRUGEVE ANTIKE
0 2 4 6 8 Km.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

qu'à une distance plus proche de la mer et à une hauteur plus optimale se dressent d'autres collines, jouissant d'une meilleure défense naturelle et de routes plus accessibles et moins difficiles, mais elles ne sont pas en mesure d'opérer la liaison entre la mer et le fleuve de Vlore.

En ce qui concerne la fortification ancienne, les traces «in situ» concernent tout le contour de l'enceinte moyenâgeuse couvrant un périmètre de 3,6 ha. Le mur large 2,15 m, comporte des blocs disposés en rangées horizontales, avec des parements plats conservant en général la forme quàdratiques.

La datation effectuée sur la base de la technique de construction attribue cette muraille aux IVe-IIIe siècles, ce qui est également témoigné par la céramique découverte dans partie intérieure de l'enceinte.

En deux endroits du mur, sur son côté méridional et septentrional, ont été mis au jour deux tronçons de mur ayant une longueur de 2 m et construits selon la technique de l'«opus mixtum» à six rangées de briques. Les particularités techniques, les dimensions et les empreintes des briques, la céramique et les monnaies indiquent que les tronçons en question appartiennent au VIe siècle.

Le centre fortifié de Treport et son escale ont été mentionnés pour la première fois par Evliya Celebi. A l'époque de sa visite celui-ci n'a trouvé que les débris de la muraille et d'un grand port, dont les pierres auraient servi à la construction de la forteresse de Vlore. A dire vrai la forteresse de Vlore a été construite avec des blocs de pierre appartenant à la période antique. Les traces encore présentes dans les deux tiers de la hauteur de la colline indiquent que la ligne des murs suivait le contour de la colline pour une même hauteur en y couvrant un périmètre de 3 ha environ. Le quai commence au pied de la colline, là où précisément celle-ci, sous forme de langue de terre allongée et étroite, s'introduit de 200 à 300 m de profondeur dans la mer jouant de la sorte le rôle d'un brise-lames naturel et protégeant le port contre les vagues du large. Le quai se prolonge en ligne droite pour 650 m. Dans sa partie initiale, là où il s'appuyait au flanc de la colline, il est construit de blocs quadratiques ayant des parements bien équarris et plats et disposés en rangées horizontales. A partir de ce point, où, sa largeur varie de 2.8 à 3 m, actuellement on ne voit que la partie du quai située au-dessous de l'eau et travaillée avec des blocs de pierre en forme de parallélépipède mal équarris. Par ailleurs, à l'extrémité septentrionale de la colline, le long de la lagune, ont été mis au jour les traces d'une route couverte de pierres. La céramique découverte pendant les sondages effectués est presque identique à celle de Kanine. Une seule différence à relever: tandis qu'à Kanine elle fait complètement défaut pendant les premiers siècles de notre ère, la présence à Treport d'un grand nombre de fragments de céramique du type «terra sigillata» témoigne de la continuité de la vie au cours de cette période de temps.

Localisation et typologie

Beaumont et d'autres hommes d'étude voient en Kanine l'antique Thronion. Relevons tout de suite qu'avant Kanine, les Apolloniates avaient à deux pas de leurs maisons la cité à Cakran, dont la première phase témoigne d'une technique plus primitive, ou Treport. Puis le matériel archéologique mis au jour à Kanine ne dépasse pas la fin du IVe siècle.

Les historiens mentionnent dans cette zone une seule ville, Amantie, dont les coordonnées coïncident suffisamment avec celles de Kanine. Sa position conditionnée à la fois par la liaison avec la mer, dans une zone favorable à l'escale des navires, et avec l'hinterland amantin (la vallée du fleuve de Vlore), en un endroit contrôlant le passage de la partie méridionale, occupée par Orik, à la partie septentrionale occupée par les Amantins, témoigne de la présence d'une ville amantine. Le développement d'Amantie aux IVe-IIIe siècles ne peut s'imaginer sans un centre riverain facilitant le commerce maritime. A notre sens, cette agglomération maritime a été précisément Kanine.

En ce qui concerne l'autre centre maritime, Strabon dispose le long de la côte, entre Orik et Apollonie, la cité de Byllis, tandis que pour Ptolémée tout de suite après Apollonie viennent Aulone (la ville et le port) et Byllis. L'identification d'Aulone avec les ruines de Treport est hors de doute, du fait qu'aucun autre centre habité ne répond mieux à la délimitation de Ptolémée. Or dans cette zone, comme nous venons de l'indiquer plus haut, il n'y a qu'une cité maritime, soit celle à Treport, aussi Tomaschek réfute-t-il toute opinion qu'au début Aulone a été Byllis. A notre sens le point de vue de Tomaschek est juste, du fait qu'une cité isolée, sans liens solides économiques et militaires, avec l'hinterland, auraient été à la longue liquidée par la ville voisine d'Apollonie, qui ne pouvait pas ne pas ressentir les effets de sa concurrence commerciale.

L'identification de la ville de Kanine dans la période de la basse antiquité ne peut être effectuée, à notre avis, que sur la base des listes dressées par Procope, qui, du nombre des fortifications construites dans l'ancien Epire, en mentionne une portant le nom de Kionin.

En ce qui concerne la forteresse de Sofe, dans l'antiquité elle devait s'appeler Tragjas, nom que Stéphan le Byzantin attribue à une région de l'Epire (Tragasai) renommée pour l'extraction du sel, donc située au bord de la mer. Actuellement ce même nom est porté par un village situé tout près de la forteresse.

Orik, qui surmonte une colline rocheuse de faible altitude, est reliée à la terre ferme par une bande de terre étroite et dotée d'un port protégé des attaques ventuelles de la part du continent. Nous sommes en présence de l'ancien type d'établissement colonial. Quant à son schéma d'urbanisme, il représente le type de cité ayant un acropole en son centre.

Kanine fait part du type de cité sans acropole. Située dans une zone assez propice à la navigation, à proximité d'une

DO NOT COPY

plage dans la profondeur des eaux croît rapidement, elle a certainement eu son propre port, distant de la ville non plus de 20 à 25 minutes à pied.

Treport aussi, à ce qu'il semble, représente le type de ville sans acropole, mais ici la nécessité d'être en contact direct avec la mer a poussé ses fondateurs de l'ériger sur une colline peu élevée, tout comme la cité maritime d'Orik, Tandis que celle-ci est dotée d'un port protégé des incursions éventuelles de l'ennemi, Treport est un port ouvert de caractère plutôt civil que militaire.

En ce qui concerne Sofe, de par sa position naturelle, par ses dimensions et sa position stratégique par rapport aux voies de communication, elle représente le type de forteresse caractéristique à la période de la basse antiquité.

Orik a été, aux VIe-IVe siècles avant notre ère, le seul centre citadin dans le golfe de Vlore. Visent au commerce avec l'hinterland amantin les habitants d'Orik devaient à la fois éviter la dangereuse rivalité d'Apollonie, qui les auraient menacée en cas d'établissement à leur voisinage, soit dans la partie septentrionale de cette zone qui est plus favorable du point de vue économique. Aussi préférèrent-ils s'établir plus au sud, loin d'Apollonie, dans une contrée entourée de montagnes difficiles à traverser mais propices à l'agriculture.

Ce tableau se modifie vers la fin du IVe siècle avant notre ère, alors que le développement économique et social de Byllis et d'Amantie pose la nécessité de commercer régulièrement par voie de mer. C'est à cette nécessité que se rattache, à notre avis, la fondation de la ville de Treport (pour Byllis) et de Kanine (pour Amantie), fondation évidemment nocive à Apollonie et à Orik et qui n'auraient pas été tolérées par ces deux cités si Treport et Kanine n'étaient appuyées par les puissantes villes illyriens de Byllis et d'Amantie. Nous sommes donc en présence d'une activité des villes et des tribus illyriens s'opposant directement aux intérêts des colonies hellènes, sans prendre en considération leur réaction.

L'occupation de l'Illyrie par Rome, comme l'indiquent les sources écrites et les découvertes archéologiques, n'a pas été suivie par la destruction violente des centres urbains situés dans le golfe de Vlore.

Après la stabilisation du pouvoir romain pendant le Ier siècle, Kanine, en raison de sa position difficile en ce qui concerne les communications, perd son importance économique et la vie s'y dégrade petit à petit. Tandis que Treport, centre d'une zone plate, continue à résister, bien que les activités se déplacent hors des murs d'enceinte, dans la ville basse. Pendant cette période, Oricum continue d'être le centre militaire du golfe de Vlore. Son rôle de première importance est prouvé par le fait que César y débarque ses troupes.

Depuis le IIe siècle l'on relève une certaine reprise de la vie à Treport (Aulone), tandis que le nom d'Oricum disparaît et n'est plus mentionné par les sources écrites. Le motif de cette substitution se rattache à la position d'Oricum, située loin des principales voies de communication et qui cède la place à Aulone, jouissant d'une position plus favorable et dotée d'un port de première importance.

Pendant la basse antiquité Kanine devient un point central dans la zone en question, et cela du fait qu'il constituait le seul point où la vallée du fleuve de Vlore communique facilement avec la zone côtière. Par ailleurs, pendant cette période, l'on renonce aux grandes villes parce que, à la suite de la sensible diminution des populations urbaines, il aurait été impossible de les défendre. Ainsi Kanine, destinée à jouer un rôle auxiliaire pendant l'antiquité, gagne successivement une importance de premier plan, du fait que la position centrale qu'elle occupait, tout comme ses dimensions et sa position naturelle, répondaient on ne peut mieux aux exigences de l'époque. C'est pendant cette période que s'exprime également la symbiose, qui plus tard, pendant le Moyen âge, devient plus manifeste, entre Kanine, en tant que centre administratif et militaire, et Aulone, en tant que centre commercial. L'importance accordée au contrôle des voies de communication, qui caractérise cette période, entraîne la construction d'une série d'ouvrages fortifiés dans la vallée de la Vjose et dans celle du fleuve de Vlore. Du nombre de ces ouvrages font également part Kanine et la forteresse de Sofe.

Neritan CEKA

DO NOT COPY

QENDRAT E FORTIFIKUARA TË AMANTËVE

Është vënë në dukje se në Ilirinë e Jugut shtrirja e uniteteve të lashta etnografike, që vazhdojmë t'i quajmë në mënyrë konvencionale fise, përputhet në përgjithësi me territore gjeografike me kufij pak a shumë të qartë natyrorë[1]). Një shembull për këtë do të ishte territori i amantëve[2]) që shtrihej në formën e një paralelogrami ndërmjet Vjosës dhe Akrokeraunëve deri në detë (tab. I). Mund të veçojmë brenda këtij territori një numër ambientesh gjeografikë, boshti i të cilave është lugina e Shushicës. Në pjesën e sipërme të saj, që nga Gjormi, kemi një pellg të mbyllur nga male të larta (nga j.p. vargu Lungarë-Çikë-Bogonicë, ndërsa në anën e kundërt Gribë-Çipin i Bolenës-Gjeshnikosh) që ngushtojnë në dy anët e lumit një zonë më tepër kodrinore sesa fushore. Ky pellg komunikon nga veriperëndimi nëpër rrugët që krijon vetë lugina, ndërsa në anët e tjera ka vetëm qafa, më e lehta e të cilave është ajo e Kuçit që të nxjerr në Borsh. Nëpër të kalonte edhe rruga kryesore që përshkonte luginën. Qafa e Kudhësit, që krijon lidhje me bregdetin Jon dhe ajo e Shëngjergjit (Tragjas) për të kaluar në fushën e Dukatit, janë më të vështira dhe duket se përdoreshin kryesisht për shtegtime bagëtish. Këtë funksion kanë pasur edhe qafat e larta në malet e Kurveleshit. Këtë pellg në kohën antike e zotëronte Kalaja e Cerjes, një fortifikim i vendosur në qendër të tij, pranë fshatit Brataj, në vendin ku lumi i Smokthinës derdh ujërat në Shushicë. Më tepër kështjellë sesa qytet, ajo reflektonte kushtet ekonomike të një zone pothuaj krejt blegtorale. Në kuadrin e përgjithshëm të territorit amant, kështjella e Cerjes kontrollonte edhe rrugën kryesore që lidhte këtë territor me Kaoninë.

Pjesa e poshtme e luginës së Shushicës deri në Vjosë është më e hapur. Fusha aluvionale në të dyja anët e lumit është mjaft pjellore dhe kufizohet nga vargje kodrash të buta, të përshtatshme për zhvillimin e frutikulturës. Në ndryshim nga pjesa e sipërme ajo ka qenë kryesisht një territor bujqësor. Përveç rrugës së Kaonisë, që kalonte përgjatë bregut të lumit, atë e përshkonte edhe një rrugë që vinte nga Gjiri i Vlorës, për të dalë në Vjosë drejt Epirit. Të dy rrugët kryqëzoheshin në këmbët e kodrave të Mavrovës, ku ngrihet Kalaja e Rethunit. Këtu ka qenë një qytet i vërtetë, që konkuronte nga forca ekonomike me vetë Amantien. Në anën tjetër të luginës ngrihet Kalaja e Kaninës, e cila përveç zotërimit të fushës së Babicës siguronte edhe lidhjen e territorit amant me detin.[3])

Ndërmjet luginës së poshtme të Shushicës dhe Vjosës shtrihet një zonë kodrinore e përçarë nga përrenj të shkurtër, që derdhin ujërat në të dy lumenjtë. Luginat e përrenjve si dhe fusha e Sevasterit dhe e Romësit krijonin një bazë të mirë për zhvillimin e bujqësisë. Edhe pjesa kodrinore përveç prodhimit të drithrave ishte mjaft e përshtatshme për frutikulturë

1) S. Islami, **Naissance et développement de la vie urbaine en Illyrie**, «Iliria» II, 1972, f. 11.

2) Si shembuj të tjerë që mbështesin këtë kriter mund të sjellim territorin e bylinëve që zgjerohej në formë trekëndëshi nga rrëza e Trebeshinës duke pasur në një krah Vjosën dhe në anën tjetër vijën ujëndarjes së saj me Osumin. Për Epirin është tepër i qartë ai i prasaibëve, i cili veçohet në Ksamil me murin e Demës, në malin e Milesë me murin e Karaalibejt dhe kullën e Vagalatit, ndërsa nga jugu përfshinte fushën e Konispolit, që mbrohej nga Çuka e Ajtojt.

3) Shih A. Baçe, **Kanina dhe qendrat e tjera të gjirit të Vlorës,** «Monumentet» 7-8, 1974, f. 25.

dhe blegtori. Përveç rrugës së Epirit, që vinte nga gjiri i Vlorës, nëpër këtë zonë kalonte edhe degëzim verior i rrugës së Kaonisë. Të dy këto rrugë kryqëzoheshin rrëzë malit të Tartarit, në qafën e Ploçës, ku ngrihet qyteti Amantia. Në veri të tij, mbi rrugën që vinte nga Bylisi, ndodhet kështjella e vogël e Hadërajt, ndërsa në veriperëndim, në rrugën e Apolonisë, kështjella e Armenit.

Një nga ambientet më të qarta gjeografike të territorit amant është ai që kufizohet ndërmjet harkut të malit të Gribës dhe luginës së Vjosës. Në qendër të tij ngrihet Kalaja e Matohasanajt, që kontrollon luginat e dy përrenjve që e përshkojnë këtë pellg dhe fushën buzë Vjosës. Rrëzë saj kalon edhe rruga që vjen nga Amantia gjatë shpatit të malit për të dalë në ngushticat e Vjosës. Një degë e kësaj rruge që kalonte gjatë bregut të lumit zotërohej nga fortifikimi i vogël i Horës.

Zona rreth gjirit të Vlorës ka dy ambiente të dalluara qartë. Në veri është zona fushore, që kufizohet ndërmjet kodrave të Treblovës dhe Trevëllazrit, Vjosës dhe detit. Qendra e gravitetit ekonomik të kësaj zone në kohën antike duket se ka qenë në bregdet, sepse në zonën kodrinore ndeshim vetëm vendbanime antike të tipit fshat. E vetmja qendër urbane gjendet aty në gjirin e Treportit. Përveç rolit si skelë tregtare, duket se ajo lidhej ngushtë edhe me peshkimin që ushtrohej në detë apo në lagunën e Nartës.

Pjesa jugore e tokave amante rreth gjirit të Vlorës përbëhet nga fusha e Dukatit dhe e Tragjasit, të kufizuara nga harku i maleve Memuç-Çikë-Lungarë dhe Shashicë. Krijimi i kolonisë helene të Orikut e shkëputi politikisht këtë pellg nga territori amant. Kontrolli i rrugës së Akrokeraunëve dhe i skelave natyrale që formojnë këto male me detin Jon, bëri që territori i polisit orikas të shtrihet edhe në bregdetin kaon, të paktën deri në Panorm. Ky i fundit cilësohet nga Straboni (VII, 316) si skelë e Orikut.[4])

Megjithëse nga pikëpamja gjeografike bregdeti i sotëm i Himarës bënte pjesë në Kaoni, duket se politikisht dhe ekonomikisht kjo pjesë është lidhur më tepër me Orikun dhe amantët. Veçanërisht dalja natyrore e territorit amant nëpërmjet përroit të Borshit, ka shumë mundësi që të përbënte edhe kufirin e këtij territori me Kaoninë, bërthama kryesore e së cilës ishte fusha e Vurgut. Për këtë arsye kështjellën e Borshit, që kontrollonte këtë dalje tepër të rëndësishme për amantët dhe mjaft periferike për kaonët, e kemi trajtuar si një fortifikim amant.

Qendrat e fortifikuara amante: vetë Amantia, Mavrova, Armeni, Cerja, Borshi, Matohasanaj, Hadëraj, Kanina, Treporti dhe Hora kanë qenë objekt i vrojtimeve të vazhdueshme arkeologjike dhe, pas çlirimit, edhe të gërmimeve. Megjithatë mungon ende një vështrim përmbledhës mbi fortifikimet e tyre. Një trajtim i tillë është me interes veçanërisht për njohjen e teknikave të ndërtimit, që shfaqen herë si faza të njëpasnjëshme në të njëjtën qendër dhe herë si periudha të vetme në qëndra të ndryshme. Vetë vendi që zë territori amant ndërmjet Epirit dhe pjesës tjetër të Ilirisë së Jugut ka bërë që të pasqyrohen aty edhe rrugët e përhapjes së këtyre teknikave, duke dalë në pah njëkohësisht edhe roli që kanë luajtur amantët në zbatimin e mënyrave të reja të ndërtimit. Nuk janë pa rëndësi edhe të dhënat kronologjike që kemi për këtë territor, qoftë nga përmëndja e qendrave amante nga autorët e lashtë, qoftë nga të dhënat e gërmimeve arkeologjike. Për të sintetizuar këto të dhëna, është e nevojshme në radhë të parë të bëhet një paraqitje e plotë e mureve rrethuese të qendrave amante, pastaj të vihen ato në raport me njëra-tjetrën dhe me fortifikimet e krahinave fqinje dhe, në fund, të arrihet në paraqitjen kronologjike të zhvillimit të teknikës së ndërtimit të tyre.

AMANTIA

Në një artikull të gjatë mbi këtë qendër S. Anamali trajton të gjithë materialin e njohur deri më sot dhe na jep një studim që ka zëvendësuar artikujt e mëparshëm mbi këtë qytet antik.[5]) Për herë të parë ai na paraqet në tërësi sistemin e fortifikimit të qytetit me elementet mbrojtëse të tij. Duke parë në tërë këtë sistem një dorë të vetme ndërtimi ai e daton atë në bazë të gjetjeve arkeologjike dhe teknikës së ndërtimit në gjysmën I të shek. IV p.e. sonë.

Me gjithë kontributin që sjell për qytetin në përgjithësi, trajtimi i sistemit të fortifikimit lë vend për plotësime dhe saktësime të reja. Këto prekin paraqitjen e përgjithshme të planimetrisë (e cila pothuaj nuk kuptohet në rilevimin topografik që shoqëron artikullin), përcaktimin e elementeve mbrojtëse, diferencimin e teknikëve dhe dallimin e periudhave të ndërtimit. Për këtë arsye del e nevojshme të parashtrohet edhe një herë i tërë materiali në një kënd më të gjerë vështrimi.

4) Nga të dhënat e Strabonit dhe të Ptolemeut (III, 13, 2) është e qartë se nuk kemi të bëjmë me një skele të brendshme të Orikut, por me një liman që gjendet në bregdetin e sotëm të Himarës.

5) S. Anamali, **Amantia** «Iliria». II, 1972, f. 61-134, për studimet e mëparshme f. 66-70.

DOKTORE



Fig. 1

POZITA DHE PLANIMETRIA E QYTETIT.

Qyteti i Amanties ngrihet mbi një lartësi shkëmbore që shkëputet nga mali i Tartarit në drejtim të perëndimit (fig. 1). Ky pozicion jepte mundësi që të kontrolloheshin prej aty rrugët që vinin nga deti nëpër luginën e Shushicës dhe përmblidheshin në një kalim të detyruar në qafën e Sevasterit, për të vazhduar gjatë shpatit verior të malit drejt Epirit. Po në këtë qafë shkonte detyrimisht edhe rruga që vinte nga Bylisi për të kaluar gjatë shpatit perëndimor të malit të Tartarit nëpër luginën e sipërme të Shushicës drejt bregdetit të Kaonisë. Territori që lidhet drejtpërdrejt me qytetin antik është kryesisht malor dhe kodrinor, me përjashtim të rripave të ngushtë fushorë në luginën e Vjosës dhe të përrenjve. Në shpinë të qytetit fillonin kullotat e pasura malore dhe duket se ekonomia fshatare bazohej po aq në blegtorinë sa në një bujqësi me vaditje të kufizuar dhe me zhvillim të frutikulturës.

Vetë qyteti zinte pllajën e kodrës shkëmbore në një sipërfaqe 13 ha, duke pasur një shtrirje të kufizuar të lagjeve të jashtme në anën 1, ku gjendet edhe stadiumi. Godinat e tjera që dallohen në sipërfaqe në këtë anë janë të rralla dhe keramika në përgjithësi i takon shek. II-I p.e.sonë. Në anën e kundërt të kurrizit kodrinor, ku bashkohen rrugët që deri aty mund të ndiqnin luginat e degëve të veçanta të Shushicës, gjendet tempulli dhe zona e varreve. Pikërisht në drejtimet kryesore të ngjitjes ndeshen edhe grupe varresh monumentale.

Rrafshi që shtrihet mbi kurrizin e zgjatur të lartësisë shkëmbore ka përbërë gjithmonë vendin e qytetit.[6]) Një qafë e cekët e ndan atë në mes, duke lënë nga lindje pjesën më të lartë që kurorzohet në fund nga një kurorë shkëmbore. Muri rrethues e qarkon plotësisht rrafshin, duke kaluar edhe buzë rrëpirave dhe rënieve shkëmbore që e bëjnë të pangjitëshme lartësinë në tërë anën p. në mesin e faqes j. si dhe në një pjesë të anës v.l. të saj (tab. II, a). Në tërë këtë sipërfaqe të zgjatur nuk vihen re ndarje të brendshme me përjashtim të një shtese në pjesën më lindore të qytetit. Traseja e mureve në përgjithësi ndjek vija të drejta me thyerje të rralla në kënd të drejtë apo të gjërë. Kullat janë të rralla dhe të pazhvilluara, gjë që lidhet edhe me rolin e vogël që

6) S. Anamali, po aty, f. 70 mendon se në siprinën e kodrës ka qenë vetëm akropoli, ndërsa lagjet shtriheshin rreth tij. Në fakt përveç anës lindore ku ndeshen gjurmë banimi relativisht të vona, në anët e tjera nuk ka pasur lagje të jashtme. Mungesa e një muri rrethues që do të mbronte ato, e vë plotësisht në dyshim mendimin e mësipërm.

DO NOT COPY



Fig. 2

luanin ato në kushtet e një mbrojtjeje të fortë natyrale. Shpatet e pjerrëta dhe shkëmbinjtë e pafrueshme kanë përcaktuar edhe një numër të vogël hyrjesh. Pjesa kryesore e tyre gjendet në anën jugore ku rrugët ishin të detyruara të kalonin ndërmjet pjerrësisë dhe mureve që ngriheshin mbi faqet e thikta të shkëmbinjve. Në mesin e anës veriore ka një sistem prej dy hyrjesh, ndërsa gjurmët e një porte të vogël dallohen në këndin v.p.

Për sa i përket teknikës së ndërtimit dhe stilit në të cilin janë realizuar fasadat e mureve[7]) dallojmë muraturën me blloqe trapezoidë të çrregullt, atë poligonale dhe më në fund muraturën katërkëndëshe izodomike, të gjitha me faqe të sheshtë. Megjithëse secili prej këtyre nuk përfaqëson një periudhë të veçantë ndërtimi, ata nuk përbëjnë së bashku një dorë të vetme siç mendon S.Anamali,[8]) kjo duket qartë në anën jugore ku mund të ndiqet shoqërimi i muraturës trapezoidale me atë poligonale me faqe të sheshta nga njëra anë, ndërsa veçohet prej tyre muratura katërkëndëshe izodomike nga ana tjetër. Të dyja grupet diferencohen në një trakt të ruajtur mirë

7) Shpeshherë këto dy terma, teknikë dhe stil ndërtimi, përdoren për të treguar të njëjtën gjë (p.sh. teknikë poligonale dhe stil poligonal). Teknika në këtë rast është një koncept më i gjerë që tregon mënyrën si janë lidhur gurët në fasada dhe brëndësi, ndërsa stili ka të bëjë me trajtimin dekorativ të tyre në fasadë (kështu: teknikë katërkëndëshe, por stil katërkandësh me faqe të sheshtë.

8) S. Anamali, **vep. cit.** f. 72.

DO NOT COPY

po në këtë anë të murit rrethues, ku katërkëndëshi është shtuar në linjën e vjetër të trapezoidit (fig. 2). Gjithashtu në kullën IV dallohen dy periudha ndërtimi, nga të cilat e poshtmja është me muraturë trapezoidale me faqe të sheshtë, ndërsa e sipërmja me katërkëndësh izodomik. Dallimin ndërmjet dy periudhave mund ta vërejmë edhe në ndryshimet që ka pësuar planimetria e qytetit, veçanërisht te hyrjet që ishin pikat më delikate të mbrojtjes. Te hyrja e madhe jugore ndërtuesit e rinj të periudhës së dytë kanë krijuar një linjë të re të murit që kalonte disa metra më lart se e vjetra. Një ndërtim të ri të kësaj periudhe të dytë përbën edhe shtesa lindore në planimetrinë e qytetit, e realizuar me muraturë katërkëndëshe izodomike.

Periudha e parë e ndërtimit. Traktet e kësaj periudhe gjenden kryesisht në anën jugore të kodrës, ku muri rrethues ruhet në gjendje më të mirë dhe mund të ndiqet pa ndërprerje.

Pranë hyrjes 5, në pikën T ruhet një trakt muri 8 m i gjatë. Ai është vendosur mbi shkëmbin e prerë në formën e një faqe muri dhe të rrafshuar lart. Blloqet janë poligonale me faqe të sheshtë.

Ndërsa vetë hyrja ka pësuar një rindërtim në periudhën e dytë, në pikat T-V ndeshet përsëri muratura e periudhës së parë, kësaj radhe në pamjen trapezoidale. Gurët gëlqerorë kanë forma trapezoidale dhe katërkëndëshe të çrregullta dhe vijat horizontale të bashkimit të tyre thyen vazhdimisht. Faqet e dukshme të gurëve janë punuar pothuaj rrafsh. Muri është vendosur para faqes së shkëmbit, duke lënë një hapësirë që është mbushur me gurë të mëdhenj e mesatarë. Në vazhdim drejt perëndimit muri kalon mbi shkëmbin që është rrafshuar në një vijë të përkulur dhe me fole për vendosjen e gurëve (fig. 3). Njëlloj si në traktin poligonal edhe këtu faqja e shkëmbit është prerë duke formuar një të tërë me murin.

Në pikën U takohen muraturat e dy periudhave të ndërtimit (fig. 2). Pjesa p, më e shkurtër e traktit, me gjatësi rreth 3 m dhe lartësi 2 m është ndërtuar me bllogje trapezoidale. Madhësitë e gurëve janë të ndryshme dhe përpjekja e mjeshtërve për të ruajtur vijat horizontale të puthitjes së tyre është zgjidhur nëpërmjet shkallëzimit të vazhdueshëm të rreshtave. Kjo është bërë ose nëpërmjet shkallëzimit të bllogeve, ose duke plotësuar boshllëqet e krijuara me gurë të vegjël. Në një periudhë të dytë një pjesë e shembur e murit ka qenë zëvendësuar me muraturë katërkëndëshe izodomike. Për lidhjen e të dy pjesëve gurët e murit të vjetër në pjesën e bashkimit janë shkallëzuar në lartësinë e rreshtave të murit të ri (rreth 0.60 m). Në këtë mënyrë diferencimi në kohë i të dy stileve është krejt i qartë. Ky dallim duket edhe në mënyrën e mbushjes së dy mureve: te më i her-



Fig. 3

shmi ajo përfaqësohet nga një masë gurësh, ndërsa tek i dyti ndahet nga parete tërthore.

Muri i periudhës së parë dallohet qartë edhe në kthesën para hyrjes 6. Edhe këtu gurët me përmasa të ndryshme kanë përgjithësisht forma trapezoidale dhe faqe të rrafshuara me çekan. Ndeshet edhe ndonjë formë poligonale, veçanërisht në gurët e mëdhenj, të cilët janë marrë nga sipërfaqja dhe janë trajtuar me një ekonomi të volumit dhe punës. Mbushja është bërë me gurë të mëdhenj pa përdorim paretesh ndarëse. Krijimi i një hyrjeje më të mbrojtur në periudhën e dytë, ka zhdukur shenjat e murit më të vjetër. Që këtu, në drejtim të perëndimit, ndërtuesit e periudhës së dytë kanë ngritur një mur të ri, reth 6 m më poshtë se i pari. Në pjesën Z-Y të dy linjat bashkohen përsëri (e vjetra si substruksion) dhe aty dallohet edhe një kullë katërkëndëshe me ballë 9.20 m dhe dalje 2.70 m (fig. 4). Pjesa e poshtme e saj përbëhet nga muratura trapezoidale, ndërsa mbi të është ngritur muratura katërkëndëshe e periudhës së dytë.

Pasi shfrytëzonte shkëmbin, muri i periudhës së parë e spostonte linjën në një rënie paralele shkëmbore duke lënë midis tyre një korridor natyral për hyrje. Edhe këtu hyrja e ruajtur është riformuar (hyrja 1) gjatë periudhës së dytë të ndërtimit, por pa e nxjerrë jashtë përdorimit linjën e vjetër. Ajo përfaqësohet sot nga gjurmë të hyrjes së parë dhe nga disa trakte me gurë gëlqerorë me forma trapezoidale, të cilët mbyllin kalimin për në qafë (tab. II, 2 dhe fig. 5). Përtej hyrjes gjurmët e këtij muri ndiqen përsëri, kësaj radhe të përdorur si substruksion për murin e periudhës së dytë. Në pikën B në një shteg shkëmbor



Fig. 4



Fig. 5

është lënë një hyrje e vogël (hyrja 2) nëpërmjet ndërprerjes së linjës së murit. Pas saj është ruajtur një trakt i mirë i murit trapezoidal (fig. 6). Ai është vendosur mbi shkëmbin e niveluar për këtë qëllim me një rresht gurësh të rrafshuar vetëm në faqen e sipërme. Gurët janë trapezoidalë me madhësi të ndryshme dhe përshtatja e tyre në rreshta është bërë nëpërmjet përdorimit të shkallëzimit apo mbushjes së boshllëqeve me gurë të vegjël katërkëndësh apo trekëndësh. Faqet e gurëve janë punuar pothuaj rrafsh, ndërsa anët janë prerë pak. Gjerësia e murit është 2.60 m, me mbushje gurësh të mëdhenj e të vegjël që përshkohet aty-këtu nga gurlidhës. Në anën p muri lidhet me shkëmbin, i cili për këtë qëllim është punuar me fole për futjen e gurëve. Pranë kësaj lidhjeje, në mur është thelluar një kanal peshimi me seksion katërkëndësh 0.10 x 0.06 m.

Në vazhdim për nga perëndimi shkëmbi është prerë rreth 60 m në një faqe të thepisur në lartësi 4-6 m dhe është gdhëndur në pjesën e sipërme për vendosjen e murit (fig. 7). Në këtë pjesë muratura ndryshon pamjen me përdorimin e gurëve gëlqerorë me forma poligonale (pesë deri në shtatëkëndëshe). Në vendosjen e tyre mungon parimi i rreshtit dhe dallohet se ngritja e murit nuk është bërë gradualisht nga poshtë lart, siç veprohet në muraturën katërkëndëshe, por me një farë pjerrësie nga e djathta në të majtë të fasadës. Kjo gjë lehtësonte përshtatjen e formave poligonale në muraturë. Faqet e gurëve janë daltuar rrafsh dhe fugat theksohen nga prerja e lehtë e anëve. Në fasadë dalin dy lugje për shkarkimin e ujërave.

Në ndërtimin e brendshëm muri përbëhet nga dy parete dhe mbushja me gurë të vegjël dhe çakull. Mungojnë ndarjet tërthore, të cilat ndeshen në muret më të vona. Kjo gjë e lidh murin poligonal me atë trapezoidal edhe nga pikëpamja konstruktive. Në pjesën e fundit të shkëmbit ka një bastion katërkëndësh 6.30 x 0.90 m.

Në vazhdim nga perëndimi muri përshkon një vend të sheshtë ku vihen re forma më të rregullta të gurëve. Më tej vazhdon një muraturë trapezoidale me rreshta të lakuar. Blloqet kanë madhësi mesatare me mjaft forma poligonale. Faqet janë gdhendur me një farë fryrje që bie në sy kur ky mur kalon gradualisht në një pjesë me trapezoidal me punim të rrafshtë të faqeve të gurëve dhe prerje të lehtë të anëve (fig. 8). Ka një kombinim të vendosjes për së gjati dhe për së gjeri të gurëve, por pa krijuar parete ndarëse në mbushjen me gurë të vegjël e mesatarë. Trashësia e murit është 2.70 m. Me gjithë rregullsinë e rreshtave ky trakt muri mbetet si një dorë e veçantë ndërtimi e tipit të muraturës trapezoidale. Kjo provohet edhe nga thyerjet e rreshtave dhe veçanërisht nga përdorimi i plotësimeve, që e afrojnë me traktatin para murit poligonal. Këtu konstatohet një kullë katërkëndëshe me ballë 7.60 m dhe dalje të paktë (2.20 m dhe 2.30 m), prej së cilës ruhet vetëm një qoshe dhe konturet. Gurët trapezoidalë dhe katërkëndësh janë vendosur mbi shkëmbin e punuar.

Drejt perëndimit muri përshkon një terren të thyer shkëmbor, të cilit i përshtatet me përdorimin e formave të çrregullta trapezoidale dhe poligonale, gjë që përcakton edhe pamjen e murit si poligonal i rreshtuar. Edhe këtu shkëmbi është punuar në një faqe që shërben si cokolaturë për murin, si dhe

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7

DO NOT COPY

në pjesën e sipërme për vendosjen e gurëve. Blloqet kanë përmasa të mëdha (1.75 x 2.60; 2 x 1 m., 1.60 x x 1.70 m) dhe janë punuar me faqe të rrafshta ose pak të fryra (fig 9). Shpeshherë gjerësia e murit përftohet midis paretit të jashtëm dhe shkëmbit duke mbushur hapësirën me gurë të vegjël dhe çakull.

Shkëmbi i anës p përbënte një mbrojtje të sigurtë natyrale dhe njëkohësisht kishte pak hapësirë për një sulm frontal. Në këtë pjesë muri ka mbyllur vetëm shtigje midis shkëmbinjve. Janë përdorur për këtë qëllim gurë trapezoidalë me shkallëzime.

Gjatë gjithë faqes veriore muri ndiqet me vështirësi dhe vetëm në anën v.l., ku ai me dy dhëmbëzime i ngjitet pjesës më të lartë të qytetit, ka një trakt të ruajtur mirë (fig. 10). Gurët janë në përgjithësi trapezoidalë, por ka midis tyre edhe poligonalë. Megjithatë përshtypja nga fasada është se kemi të bëjmë me një muraturë poligonale. Kjo përshtypje krijohet nga vendosja e çrregullt e gurëve sa që përveç rreshtit të bazës nuk mund të ndiqet rresht tjetër. Muri ka pjerrësi nga brenda, njëlloj si ai poligonal i anës jugore. Në kthesat janë përdorur vetëm gurë trapezoidalë. Format e gurëve, punim i rrafshtë i faqeve me theksim të fugave dhe përdorimi i plotësimeve e lidh edhe këtë trakt me muraturën trapezoidale. Në pjesën e sipërme të këtij trakti kanë qenë shtuar në një periudhë të dytë ndërtimi tre rreshta me muraturë katërkëndëshe. Për lidhjen e tyre është bërë edhe një shkallëzim në murin e vjetër.

Muri i ngjitej që këtu majës më të lartë dhe e mbyllte rrethimin në anën 1 të kurorës së saj. Sot vihen re aty vetëm foletë e gurëve të murit të gdhendura në shkëmb dhe rrafshimi karakteristik i faqes së shkëmbit, tipik për periudhën e parë. Zgjerimi i murit rrethues në anën lindore gjatë periudhës së dytë, e ka nxjerrë jashtë përdorimit këtë pjesë të murit të vjetër, ndërsa materiali i tij është përdorur në murin e ri.

Siç vumë në dukje gjatë përshkrimit, janë ruajtur pak elementë nga sistemi i fortifikimit të kësaj kohe. Gjurmë të hyrjeve dallohen vetëm në anën jugore, ku janë prekur ku më shumë, e ku më pak nga periudha e dytë. Nga hyrja 5 ruhet vetëm krahu jugor i koridorit ndërsa krahu tjetër, që shkonte perpendikular me te në drejtim të shkëmbit duke lënë hapsirën e hyrjes prej 3 m, është rindërtuar në periudhën e dytë (tab III, 3). Të njëjtin tip hyrje, me takim perpendikular të krahëve të murit, duhet të kemi pasur edhe te porta 6, e cila është rindërtuar plotësisht. Hyrja 1 dhe 2 përbëjnë zgjidhje në përshtatje me terrenin shkëmbor; e para ka një koridor me gjërësi 3 m të formuar ndërmjet murit dhe shkëmbit, ndërsa tek e dyta korridori kalon me shkallë në një të çarë në shkëmb, ndërmjet dy mureve, që janë në nivele të ndryshme. Në të dyja rastet kemi të bëjmë me skemën e hyrjes me korridor të formuar nga krahët paralele të murit.

Të tre kullat bastione të kësaj periudhe janë katërkëndëshe me ballë të gjatë dhe dalje të paktë. Të bie në sy vendosja e tyre në pika të larta ku luanin kryesisht rol vrojtimi në sektorë të gjerë të murit, dhe ishin larg vendeve të mundshme të sulmit.

Periudha e dytë e ndërtimit. Kjo periudhë që karakterizohet nga përdorimi i muraturës katërkëndëshe izodomike me faqe të sheshtë, ka prekur gjithë sistemin e fortifikimit në pikat më të rëndësishme të

tij. Në këtë kohë janë riformuar pothuaj të tëra hyrjet dhe është shtuar pjesa e re në anën 1. të qytetit në pikat P-S. Gjithashtu janë rindërtuar edhe trakte muresh në planimetrinë e qytetit.

Ndërtimi më i plotë që ruhet nga kjo periudhë është muri i gjatë ndërmjet dy hyrjeve të anës veriore të qytetit, prapa të cilit ishte krijuar një tarracë e gjerë. Me këtë funksjon të dytë, si mur mbajtës, lidhet edhe trajtimi i veçantë i strukturës së tij. Gjërësia e dukshme e murit prej 2 m, nuk përbëhet si zakonisht nga dy këmishë dhe mbushja, por është e ndërtuar plotësisht me blloqe të punuara. Në mënyrë të alternuar, të gjithë gurët e një rreshti janë vendosur së gjati (gjatësorë), ndërsa të rreshtit tjetër së gjëri (tërthorë), gjë që i jep fasadës një pamje karakteristike[10]). Përveç kësaj në pjesën qendrore ku terreni është më i pjerrët qëndrueshmëria e murit është rritur nga shkallëzimi i rreshtave dhe nga përdorimi i kontraforteve, çdo 1.90 m. Këta kanë dalje 0.65 m dhe gjerësinë e një blloku, 0.63 m, dhe shkallëzohen së bashku me murin (fig. 11). Lidhja e kontrafortit me murin është bërë me futjen e gurëve të tij në rreshtat e tërthorëve. Blloqet në fasadë kanë forma katërkëndëshe me faqe të rrafshta, me prerje të lehtë të anëve. Lartësia e rreshtave lëviz ndërmjet 0.50 dhe 0.60 m, ndërsa gjatësia e blloqeve është rreth 0.45 për tërthorët dhe 1.45 për gjatësorët. Për të evituar rëshqitjen e tokës, që mund të prekte qëndrueshmërinë e murit, poshtë këtij është ngritur një mur terracimi me të njëjtën vendosje të gurëve sipas sistemit gjatësor dhe tërthor. Ndryshimi qendron në punimin më pak të kujdesshëm të gurëve dhe në ndërtimin e kontraforteve. Këto dalin 0.40 m nga muri dhe kanë gjërësi 1 m, të formuar nga dy lidhës ose një gjatësor i lirë.

Në formën e saj të zakonshme muratura e periudhës së dytë ndeshet në anën j.l, në pikën U, ku shkel në një vijë zigzage mbi atë të periudhës së parë. Në një gjatësi prej 15 m muri ruhet në pesë rreshta. Është ndërtuar kryesisht me gurë gëlqerorë konglomeratë, katërkëndësh, por përdoren edhe gurë solidë gëlqerorë, njëlloj si të murit të periudhës së parë. Rreshtat janë të rregullt, plotësisht horizontalë (shih fig. 2). Në fugat anësore vihet re përdorimi i shpeshtë i brinjëve të pjerrëta. Lartësitë e rreshtave janë 0.57 (dy këmbë), por ka edhe të tillë 0.43 m (një këmbë e gjysëm), megjithatë përshtypja është izodomike. Faqet e gurëve janë punuar rrafsh dhe anët janë prerë lehtë, duke theksuar fugat. Mbi rreshtin e pestë muri krijon një shkallëzim duke u futur 0.30 m më brenda.

Gjerësia e murit është 2.50 m dhe formohet nga dy këmisha dhe mbushja me gurë të mëdhenj, të papunuar. Çdo 2.60 m muri ndahet tërthor nga parete të brendshme, të cilat krijojnë në gjatësinë e tij ndarje katrore, Lidhja e tyre me paretin e jash-



Fig. 8



Fig. 9

10) C. Patsch, **Das Sandschak Berat in Albanien,** col. 35, e ka vënë re këtë teknikë duke e quajtur me termin që përdoret edhe sot **Binder und Läufer.** S. Anamali, **vep. cit.,** f. 73-74 nuk e ka kuptuar se ky mur është pjesë e kurtinës, por e konsideron si një mur mbështetës. Gjithashtu ai nuk ka dalluar veçorinë në mënyrën e ndërtimit dhe as hyrjen në pjesën p. të tij.

FOTOCOPY

tëm dallohet në fasadë nga gurë tërthorë të alternuar çdo dy rreshta. Në këtë mënyrë muri i periudhës së dytë dallohet nga ai i hershëm jo vetëm nga trajtimi i gurëve, por edhe nga ndërtimi i brendshëm.

Një ndërtim ex novo të periudhës së dytë përbën shtesa lindore e planimetrisë së qytetit, që ndahet nga pjesa tjetër nga një mur tërthor[11]), që nis nga hyrja 5, dhe nga vetë kreshta e majës më të lartë. Në ndërtimin e murit vëmë re një veçori: gjerësia e tij prej 1 m përbëhet nga dy blloqe gjatësore të alternuar me një tërthor. Në fasadë kjo dallohet me alternimin karakteristik të një blloku të gjatë me një të shkurtër. Blloqet janë trajtuar njëlloj si në traktin e mësipërm me të cilin kanë të përbashkët edhe lartësitë 0.47 dhe 0.53 m.

Pjesët e tjera të murit rrethues të rindërtuara gjatë periudhës së dytë ruhen dobët dhe një tabllo më e qartë për këtë mund të krijohet nga hyrjet dhe kullat.

Ndërsa kurtinat, që kalonin në një terren të qëndrueshëm shkëmbor dhe në pjesën më të madhe ishin të paprekshme nga sulmet e armikut, e ruajtën vlerën e tyre gjatë tërë kohës, hyrjet e vjetra dolën të papërshtatëshme për arkitektët e periudhës së dytë. Po thuaj të gjithë ato pësuan gjatë kësaj periudhe një transformim rrënjësor.

Hyrja 5, që ruan nga periudha e parë vetëm krahun jugor, nuk e ka ndryshuar trajtën e dikurshme planimetrike, por mbrojtja e saj është forcuar nga krijimi i një koridori brenda hyrjes dhe nga degëzimi lindor i murit të shtesës, që kontrollonte rrugën para saj (tab. III). Kjo komunikonte vetëm me pjesën kryesore të fortifikimit, ndërsa shtesa duhet të ketë pasur një hyrje tjetër.

Hyrja 6 përbën një ndihmë të plotë të periudhës së dytë që është futur në linjën e murit të hershëm trapezoidal. Vendosja e saj pas kthesës këndrejtë që bën muri, me një rrugë që kalonte detyrimisht midis rënies shkëmbore dhe këtij muri pengonte afrimin e sulmuesve ndaj saj, duke goditur krahun e djathtë të tyre.

Hyrja ka një korridor me gjërësi 2.70 m dhe gjatësi 5.30 m (tab. III, 2). Porta dallohet si një ndërtim me hark të vërtetë cilindrik, prej të cilit ka mbetur guri i shpatullës që ruhet **in situ** (fig. 12). Gjerësia e tij prej 0.85 m na jep edhe gjërësinë e qemerit, i cili nga ana e jashtme kufizohej me një kornizë 8 cm të gjerë. Në mbarim të gjërësisë së qemerit ka një kanal vertikal me gjërësi 0.10 m, ku futej binari vertikal i kasës së derës. Pjesa e fundit e korridorit zgjerohet në gjatësinë prej 2.35 m nga 0.20 m nga të dy anët, me sa duket për vendosjen e një porte të dytë[12]). Në një periudhë të vonë hyrja ka qenë mbyllur me gurë të marë nga korridori. Në anën v. të hyrjes, mbi shkëmbin e thepisur ka një kullë katërkëndëshe 8.55 x 3.70 m, e ndarë në dy ambiente. Si korridori ashtu edhe kulla janë ndërtuar me gurë katërkëndësh, me faqe të sheshtë, të vendosur në rreshta izodomikë (fig. 13).



Fig. 10



Fig. 11

11) S. Anamali nuk e ka vënë re këtë shtesë të re dhe as murin ndarës.
12) Një zgjerim të tillë të korridorit e kemi edhe në portën kryesore në Bylis, ku ruhen edhe shenja të qarta të vendosjes së kasës së derës.

DOKTORY



Fig. 12



Fig. 13

Te njëra nga qoshet e ruajtura të kullës ka një vijë peshimi.

Hyrja 1, që ndodhet në mesin e anës jugore përbëhet nga një korridor i kufizuar midis shkëmbit dhe murit rrethues. Fillimi i tij që është në fakt hyrja e vjetër ngushtohet në një shteg ndërmjet shkëmbit të thepisur, mbi të cilin kalon muri rrethues dhe një pragu shkëmbor, kalimet anësore të të cilit janë mbyllur me një mur që përmban trakte trapezoidalë, të tillë katërkëndësh izodomik me faqe të sheshtë dhe nga një pjesë e rindërtuar në kohën e Justinianit.

Shtegu nuk të fut menjëherë në qafën e qytetit, sepse në mbarim të tij fillon një mur tjetër që krijon një oborr me sipërfaqe të kufizuar(tab II, 2). Pas murit janë krijuar dy ambiente katërkëndësh të mbuluara në pjesën më të madhe nga dheu, (fig. 14), të cilat me sa duket, shërbenin si kulla të brendshme për mbrojtjen e hyrjes.[13]) Në fund të tyre muri kthente paralel me buzën e shkëmbit dhe që aty fillonte korridori i vërtetë i hyrjes, nga i cili ruhen vetëm gjurmë të pakta në krahun e djathtë. Në murin e ambientit perëndimor është vendosur një kontrafortë me tek gur, 0.80 m i dalë dhe 0.50 m i gjërë.

Në anën e kundërt të qafës gjendet një kompleks prej dy hyrjesh (hyrja 3 dhe 4) që formohet midis krahëve të murit rrethues dhe një muri të gjatë paralel me drejtimin e tyre.

Hyrja më e ruajtur gjendet në anën 1 ku ka shfrytëzuar një shteg midis dy rënieve shkëmbore. Prej saj është ruajtur vetëm pjesa e majtë e portës me dhjetë radhë, nga të cilat tri të poshtmet i takojnë bazamentit (fig. 15, tab. III, 5). Ndërtimi është bërë me gurë katërkëndësh me faqe të sheshta me rreshta izodomikë (rreth 0.48 m). Ruhet blloku i shpatullës së një qemeri të vërtetë cilindrik, si dhe dy gurë të murit që kalonin mbi qemer. Prej këtyre të fundit duket se është nisur S.Anamali[14]) për ta konsideruar atë, gabimisht, si qemer të rremë. Në gjërësinë e vet muri i hyrjes vjen duke u ngushtuar. Dallohen aty edhe dy thellime katërkëndëshe për fiksimin e kasës së derës. Hyrja ka qenë mbyllur me një mur me gurë e llaç të kohës së Justinianit. Ndërsa nga e majta muri lidhej me shkëmbin, për t'u kthyer sipër tij pas 1.45 m. drejt l., nga e djathta shkonte drejt p buzë pjerrësisë për në hyrjen tjetër që gjendet rreth 120 m larg saj. Kjo hyrje na ruhet më pak, por kuptohet deri diku forma e saj planimetrike. Korridori i saj formohet nga e majta prej murit të gjatë, ndërsa e djathta kufizohej prej një dhëmbëzimi që shkëputej prej krahut të

13) N.G.L. Hammond, **Epirus,** Oxford 1967, f. 222, përveç një orientimi të gabuar të kësaj hyrjeje, jep edhe një skicë që është larg realitetit. Po kështu S. Anamali **vep. cit,** f. 71 nuk ka mundur të përcaktojë formën e saktë të hyrjes dhe e krahason gabimisht me hyrjet e Lisit.

14) S. Anamali, **vep. cit,** f. 71, 73 krahason këtë hyrje me portën e murit mbështetës të Apolonisë dhe me portën e Kalasë së Irmajt, që kanë jo vetëm konstruksion, por edhe zgjidhje të ndryshme planimetrike.

DO NOT COPY



Fig. 14

murit rrethues duke lënë një hapësirë 3 m për hyrjen. Ky do të ketë qenë edhe vendi ku inkastrohej porta, pas së cilës vazhdonte një korridor i mbuluar pjesërisht nga dheu.

Gjatë periudhës së dytë të ndërtimit, kullat mbeten një element i rrallë në planimetrinë e qytetit. Vetëm në shtesën lindore ndeshim dy ndërtime të reja të këtij lloji.

Kulla IV ka formë katërkëndëshe me ballë 4.30 m dhe dalje 3.70 m. Blloqet konglomeratë janë vendosur në rreshta izodomikë me lartësi 0.60 m. Punimi i faqeve është i sheshtë dhe anët pak të prera. Mbushja e brendshme është bërë me gurë të mëdhenj të palatuar, të vendosur me rregull.

Kulla V, e vendosur 20 m më larg, përbën pjesën më ekstreme të një daljeje të murit rrethues me brinjë 9.50 dhe 11 m (tab. II, 6). Vetë kulla diferencohet në një projeksion prej 3 m dhe balli 4.85 m. Muratura ka të njëjtin trajtim me rreshta izodomikë me lartësi 0.47 dhe 0.53 m. Ruajtja më e mirë na jep mundësi të dallojmë një rresht themeli që del 0.15 m dhe vijën e peshimit te qoshet. Gjërësi prej 1 m e murit të kullës përbëhet nga një bllok tërthor ose dy blloqe gjatësore të alternuara, njëlloj si në kullat e Kalasë së Jermës. Mbushja është bërë me gurë të mëdhenj dhe përshkohet së gjati nga një paret gjatësor në mes të kullës.

Teknikën e periudhës së dytë e ndeshim edhe në ndërtime të tjera të qytetit, të cilat nuk kanë karakter mbrojtës. Në anën j.p. të qytetit në vendin e quajtur Lëmi i Peçit gjendet një mur që tarracon j.l. e kodrinës, mbi të cilën ngrihet tempulli. Muri është ndërtuar me gurë konglomeratë katërkëndësh të rregullt. Faqet janë trajtuar rrafsh, fugat janë theksuar nga prerja e anëve të gurëve. Rreshtat janë paralelë me lartësi 0.47 m, por ka edhe rreshta me gjërësi deri 0.61 m. Muri ka kontraforte me gjërësi 0.80 m dhe dalje 0.67 m me gurë të vendosur njëlloj si në murin e teracimit të anës veriore tre radhë pa mbushje.

Ndërtime me gurë katërkëndëshe me faqe të sheshta janë edhe stadiumi, tempulli dhe varret monumentale nga ana perëndimore e qytetit, por prej tyre nuk mund të nxirren ende të dhëna më të sakta për kronologjinë.[15])

15) S. Anamali, **vep. cit.** f. 75, jep si kohë të ndërtimit të murit të terracimit dhe godinave sipër tij në Lëmin e Peçit, gjysmën e dytë të shek. IV p.e.sonë, por më tej, f. 81 propozon për tempullin shekullin III p.e.sonë.

DO NOT COPY



Fig. 15

Në disa pika të anës jugore dhe veriore vumë re edhe gjurmë të një periudhe të tretë ndërtimi të realizuar me blloqe të ripërdorur të murit antik, të lidhur me llaç. Trakte të ruajtura mirë gjenden pas hyrjes 5, në murin e poshtëm të hyrjes 1, në hyrjen 4 dhe në disa pika të planimetrisë[16]). Të gjitha këto rindërtime i takojnë një dore të vetme dhe lidhen pa dyshim me punimet e kryera gjatë kohës së sundimit të Justinianit, kur Amantia del në listën e fortifikimeve të rindërtuara në Epirin e Ri (Prokop, **De Aed.** IV 4,3). Ato tregojnë nga ana tjetër se, qyteti e ruajti tërë sistemin e vjetër të fortifikimit, duke mbyllur vetëm disa hyrje.

Analiza tipologjike. Muratura e periudhës së parë të ndërtimit i takon tipit trapezoidal, por nuk mund të klasifikohet, në bazë të parimit të vendosjes së gurëve, në lloin e çrregullt apo pseudoizodomik të tij. Ajo është e ndërtuar në bazë të formave trapezoidalë, duke zbatuar reshtimin, por jo në pranimin e vijave të drejta, por të një thyerje të vazhdueshme të tyre. Për këtë arsye do të përdornim për cilësimin e saj termin trapezoidal me reshta të thyer. Që ky përbën një tip të veçantë murature provohet nga zbatimi i tij edhe në fortifikimet fqinjë të Matohasanajt dhe Klosit. Muri i Amanties njëkohësisht dallohet prej tyre nga pikpamja stilistike dhe e strukturës; nga trajtimi i rafshtë i faqeve të gurëve dhe nga mungesa e ndarjeve tërthorë në mbushjen e murit.

Përsa i përket planimetrisë shënojmë trajtën e thjeshtë të saj. Hyrjet kanë korridor paralel me murin ose të hapur në gjërësinë e tij; nuk ndeshen kulla pranë tyre, por vetëm rrallë gjatë vijës së murit, ku shërbejnë kryesisht për vrojtim ose si bastione.

Muratura e periudhës së dytë të ndërtimit është një shembull i qartë i katërkëndëshit izodomik me faqe të sheshtë[17]). Në strukturën e tij ai karakterizohet nga ndarjet tërthore me gurlidhës që alternohen në fasadë. Ndeshim si rast të vetëm në vëndin tonë, si një dorë të veçantë të kësaj periudhe, muraturën me gjatësore e tërthore, ndërsa te kullat gjejmë arlternimin e tyre në të njëjtin rresht.

Për sa i përket planimetrisë, në periudhën e dytë ajo nuk pëson ndryshime rrënjësore. Hyrjet mbeten përsëri të thjeshta, me korridor paralel me murin dhe nuk kanë pranë kulla për mbrojtje, megjithëse

16) Numuri i madh i trakteve të rindërtuara, që nuk janë vënë në dukje nga S. Anamali, e bën të paqëndrueshëm mendimin e tij se fortifikimet e Amanties nuk u përdorën më, pas luftës ndërmjet Cezarit dhe Pompeut (**vep. vit.**, f. 73).

17) S. Islami, **Problèmes de chronologie de la cité illyrienne,** «Colloque international Aglomerations fortifiees illyriennes». Mostar 24-26 octobre 1974, f. 44-45, ka dhënë disa nga tiparet themelore të këtij stili në Ilirinë e Jugut, por në të vërtetë muratura katërkëndëshe nuk paraqitet aq unike dhe nuk paraqet një zëvëndësim të stileve të mëparshme, siç do të tregojmë më poshtë.

17 b) Përveç rasteve kur në muraturë kemi rreshta me lartësi të barabartë, rreth 0.60 m, në Amantia ka edhe disa trakte ku është bërë një shoqërim i rreshtave me lartësi dy këmbë (0.60 m) me të tillë një këmbë e gjysmë (0.47 m). Këto të fundit janë përdorur rrallë dhe në përgjithësi ruhet pamja izodomike e fasadës.

DO NOT COPY

për sigurimin e tyre është treguar më tepër kujdes se në periudhën e parë. Efekti i mbrojtjes rritet nëpërmjet kontrollit nga muri të rrugës për në hyrje. Kullat që shtohen gjatë murit lindor, përveç mbrojtjes, luajnë përsëri edhe rolin e kundrafortëve. Nga kjo varfëri e elementeve mbrojtëse në planimetri, periudha e dytë e ndërtimit në Amantia afron me muraturën katërkëndëshe izodomike 17[b] të Bylisit, Klosit, Apolonisë dhe Persqopit dhe dallohet nga ato të luginës së Drinosit, Zgërdheshin dhe Dorëzit, ku këto elementë përdoren gjerësisht.

KALAJA E MATOHASANAJT

Lugina e Sinanajt, që krijohet ndërmjet harkut të malit të Gribës dhe shtratit të Vjosës, ndahet në mes nga një kurriz shkëmbor, pjesa më e lartë e të cilit mban emrin kalaja e Matohasanajt (fig. 16). Që aty kontrollohet i tërë pellgu gjeografik që përbëhet nga një zonë malore e favorshme për blegtorinë në pjesën jugore dhe nga tarraca natyrale me toka të përshtatshme për bujqësi, që zbresin deri në Vjosë nga ana veriore. Rruga natyrore që vjen nga Amantia për në Epir apo Maqedoni përshkonte shpatin e malit pak a shumë në linjën e sotme të rrugës automobilistike, duke kaluar në rrëzë të kalasë së Matohasanajt. Përveç kontrollit të kësaj rruge kalaja siguronte edhe mbrojtjen e territorit të amantëve nga lindja.

Sipërfaqja prej 3 ha e kalasë përbëhet nga sheshe të përshtatshme për banim që ndërpriten në anën perëndimore dhe verilindore nga rrëzime të pakalueshme (tab. IV). Duke e quajtur të tepërt rrethimin e këtyre pjesëve, ndërtuesit e kalasë kanë kaluar një mur gjatë tërë anës jugore dhe juglindore, ku afrimi është më i lehtë. Gjithashtu në anën veriore një mur i gjatë mbyll shtegun që formon kurrizi i kodrës, mbi të cilën ngrihet kalaja.

Planimetria e kalasë paraqitet e thjeshtë, ajo ka vetëm një hyrje permes kullës në anën j. dhe dy kulla të tjera pranë saj një të rrumbullakët dhe një katërkëndëshe. Në linjën e mureve ndeshim kthesa të rralla me kënd të drejtë apo të gjerë në përshtatje me terrenin, por pa funksion mbrojtës.

Në muret rrethues dallohen tri periudha ndërtimi. Më e hershmja, e realizuar me muraturë trapezoidale, ndiqet gjatë tërë linjës së mureve, asaj i takon hyrja për në kala si dhe kulla e rrumbullakët. Periudha e dytë përfaqësohet nga një rindërtim përreth 30 m i murit të anës j.l., nga kulla katërkëndëshe dhe nga shtesa në formë kulle e hyrjes së kalasë, të gjitha me muraturë katërkëndëshe. Periudha e tretë i takon antikitetit të vonë dhe përfaqësohet nga një



Fig. 16

DO NOT COPY



Fig. 17



Fig. 18

DO NOT COPY

trakt me llaç gëlqereje ndërmjet kullës katërkëndëshe dhe hyrjes.[18])

Muratura e periudhës së parë përfaqësohet më mirë në traktin A-B të anës veriore, i cili është ndërtuar mbi kurrizin shkëmbor. Pjesa perëndimore e tij paraqet një ndërtim me blloqe trapezoidale të madhësive të ndryshme (1.40 x 0.94; 0.94 x 1.46 m), që janë inkuadruar në rreshta (fig. 17). Për ta realizuar këtë, mjeshtërit kanë përdorur shpesh shkallëzimet dhe plotësimin e boshllëqeve me gurë të vegjël trekëndësh apo katërkëndësh, si rrjedhim rreshtat thyhen vazhdimisht në pamjen e vijave zigzage deri sa në pjesën lindore kalohet në një muraturë poligonale (fig. 18). Edhe këtu rreshti përgjithësisht vazhdon të ruhet, por në një linjë të thyer dhe jo të lakuar si te poligonali i rreshtuar. Përdoren gjithashtu plotësimet me gurë të vegjël si në pjesën tjetër. Për të gjithë traktin, që përbën një dorë të vetme ndërtimi, është karakteristik i njëjti trajtim i fasadës: gurët janë lënë me faqe guroreje ose janë punuar lehtë me çekan.

Muri është vendosur mbi shkëmb, që diku është punuar pjerrët në vazhdim të faqes së murit si në Amantia. Vetëm në një pjesë ku muri shkel mbi tokë është përdorur themel prej gurësh të punuar trashë, që dalin jashtë planit të fasadës. Trashësia e murit prej 3.20 m, është mbushur me gurë të vegjël dhe ndërpritet çdo 3 m nga ndarje tërthore, të cilat nuk dallohen në fasadë. Në një gur të bazës është thelluar lugu i një kanali që përcillte ujërat që mblidheshin prapa murit.

Ndërsa në anën lindore trakti lidhet me shkëmbin nëpërmjet një kthese këndrejtë, në anën tjetër zbret gjatë pjerrësisë së kodrës deri në takimin me greminën. Në të dy pjesët që janë ruajtur dobët vihet re një zotërim i formave trapezoidalë të gurëve.

Një pamje të ngjashme ka edhe trakti i ruajtur në pikën 1, në takimin e krahut tjetër të murit me greminën e anës perëndimore (fig. 19). Ndiqen qartë pesë rreshta me lartësi 0,70-0,80 m, të plotësuar me gurë trapezoidalë të madhësive të ndryshme dhe me pyka katërkëndëshe dhe trekëndëshe. Si një element i veçantë dallohet një vijë e lehtë peshimi në kthesën këndrejtë të murit ku lidhet me shkëmbin.

Që aty deri te kulla e rrumbullakët (kulla III), muri është i periudhës së parë të ndërtimit. Vetë

18) Rindërtimi ka prekur një pjesë të vogël të murit në pikat D-E, ku dallohet një trakt rreth 5 m që ka ruajtur trashësinë e murit antik prej 3.20 m, duke e përdorur atë si substruksion dhe duke shfrytëzuar faqen e brendshme (fig. 21). Janë përdorur gurë të vegjël dhe mesatarë, të marrë nga mbushja e murit antik, të cilët janë lidhur me llaç gëlqere të përdorur me shumicë dhe mjaft të fortë. Nëpër fuga janë vendosur copa tjegullash antike. Teknika e ndërtimit është e njëllojtë me murin e periudhës së fundit të Amanties dhe të dy i takojnë shek. VI të e.sonë. Rindërtimet të pjesshme te hyrja e kalasë tregojnë se ajo ruhej mjaft mirë në këtë kohë dhe u përdorur me pak punime. Duket qartë se kështjella ishte në këtë kohë përsëri në funksion të Amanties, dhe së bashku me kalan e Zharzës mbronte rrugën gjatë bregut të majtë të Vjosës.

kulla që ka një diametër prej 7 m. (tab. IV, 2) mbron anën më të mundshme të sulmit. Muri i saj ka gjerësinë e një blloku të vetëm, prej 0.80 m. Gurët janë me përmasa të mëdha (1 x 0.85; 1.10 x 0.60 m) trapezoidalë dhe katërkëndësh, me ndonjë formë të rrallë poligonalë. Mbushja e pjesës së poshtme të kullës që është bërë me gurë të vegjël, ndërpritet gjatë diametrit me një mur të brendshëm. E tërë faqja e brendëshme e murit në këtë pjesë është ndërtuar me blloqe të vogla me forma poligonale (fig. 20), gjë që provon edhe një herë se janë përdorur në një periudhë ndërtimi me ato trapezoidalë.

Kësaj periudhe i përket edhe e vetmja hyrje për në kala (fig. 22). Ajo krijohet nga ndërprerja për 2.85 m e vijës së murit, që lejon një korridor me gjatësi sa gjërësia e murit (3.40 m). Muri i saj është ndërtuar kryesisht me blloqe trapezoidalë. Dallohet vija e peshimit në qoshen e portës si dhe njëri prej kanaleve për futjen e asës së derës.

Pjesa me përfaqësuese e periudhës së dytë të ndërtimit është trakti C-D në anën j.l. Për 26 m ai është ngritur drejt mbi shkëmbin që sa është rrafshuar, ose mbi tokë (fig. 23). Në të dy rastet nuk është përdorur bazament i veçantë, vetëm se rreshti i bazës është 2-10 cm më i dalë, pak më i lartë (0.40 m) dhe me punim më të fryrë të faqes. Të pesë rreshtat e tjerë, që vijnë pas një nivelimi prej 0.18 m, janë pothuaj të barabartë (0.34 – 0.36 m). Blloqet janë mjaft të gjata (1.37; 1.45; 1.55 m), me faqe guroreje. Brinjët anësore të tyre janë pothuaj gjithmonë të pjerrëta, gjë që përcakton edhe tipin trapezoidal të muraturës. Si gurore për këtë trakt janë përdorur formacionet gëlqerore që gjenden aty pranë, për të cilat janë karakteristike shtresat e holla që kanë përcaktuar edhe lartësinë e vogël të blloqeve.

Gjerësia e murit prej 3.30 m ndërpritet çdo 2.90 m nga ndarje transversale, ndërmjet të cilave janë hedhur gurë të vegjël dhe çakull. Gurlidhësit e tyre shfaqen regullisht në fasadë në mënyrë të alternuar, gjithmonë në të njëjtin rresht.

Në pjesën j.p. të tij, muri i periudhës së dytë ka përdorur për 14 m si substruksion murin më të hershëm. Lidhja është bërë duke përdorur gurë më të vegjël për plotësimin e rreshtave; gjithashtu në vendin e një ndarjeje transversale muri është rindërtuar që nga themeli për të vënë gurlidhësin (fig. 24).

Kësaj periudhe të dytë i takon edhe kulla III, që ka formë katërkëndëshe me ballë 6.60 m dhe dalje 7.55 m. Ajo është e shtuar mbi hyrjen e vjetër të kështjellës (fig. 25, tab. IV, 3). Është ndërtuar me gurë të mëdhenj konglomeratë të vendosur në rreshta paralele me lartësi 0.53 – 0.64 m. Brinjët anësore të blloqeve janë pothuaj të gjitha të pjerrëta, gjë që i jep pamjen trapezoidale muraturës së kullës. Faqet janë lënë siç kanë dalë nga gurorja. Qoshet e kullës janë trajtuar me vijat e peshimit. Muri i kullës është ngritur drejt mbi shkëmbin që vetëm sa është rrafshuar, ose mbi tokë, njëlloj si te muri i anës j.l. Gjërësia e tij prej 0.95 m formohet nga dy radhë gurësh



Fig. 19

DO NOT COPY

dhe lidhja është bërë me gurlidhës të vendosur në mënyrë të çrregullt. Mbi gurët ka thellime të vogla për mbështetjen e levës gjatë lëvizjes së blloqeve të tjerë që viheshin mbi të.

Faqja v.l. e kullës përshkohet nga një hyrje 2.40 m. Në anët e saj ruhen kanalet me gjerësi 0.15 m për vendosjen e kasës së derës. Në murin j.l. të kullës dallohet një frëngji 0.23 m e gjërë që ngushtohet brenda në 0.06 m. Mbulimi i saj ka qenë bërë me një rrasë guri. Frëngjia ndodhet mjaft ulët dhe i përkiste me sa duket katit të parë të kullës. Në këtë mënyrë kulla krijonte korridor të mbrojtur për hyrjen e kështjellës, që në periudhën e parë ishte krejt e ekspozuar ndaj goditjeve të rrethuesve. Gjithashtu, nëpërmjet ndërtimit të kullës dhe vendosjes së hyrjes në anën v.l. të saj, krijohej një zonë e kontrolluar mirë ndërmjet vetë kullës dhe murit të kështjellës.

Nga traktet e tjera të periudhës së dytë dallohet më qartë një pjesë e murit pranë kullës së rrumbullakët, me ndarje tërthore çdo 2.15 m.

Përveç murit rrethues në sipërfaqen e kalasë nuk dallohet ndërtim tjetër mbi sipërfaqe dhe duket se ajo ka qenë më tepër një qendër me karater ushtarak sesa ekonomik.

Në anën 1. të kalasë janë zbuluar varre[19]) që tregojnë se nekropoli i saj ishte në këtë anë.

Muratura e periudhës së parë të ndërtimit mund të tipizohet si trapezoidale me rreshta të thyer. Si e tillë ajo ngjason me atë të periudhës së parë të Amanties, por përfaqëson një shembull më të përparuar nga pikëpamja teknike. Kjo vihet re në ndërtimin e brendshëm të murit ku janë përdorur ndarjet tërthore të mbushjes. Fasada me faqe gurore e ndan edhe nga pikëpamja stilistike muraturën e Matohasanajt nga ajo e Amanties, që është trajtuar me faqe të sheshtë. Gjithashtu edhe me Klosin, ku kemi të njëjtin tip murature, ka dallime në strukturën e murit dhe në stilin e fasadës. Klosi paraqitet edhe më i avancuar për lidhjen e ndarjeve tërthore me paretet nëpërmjet gurlidhësve që dalin rregullisht në fasadë. Gjithashtu faqet e gurëve janë trajtuar me një fryrje të lehtë.[20])

Muratura e periudhës së dytë të ndërtimit i takon tipit trapezoidal izodomik me faqe guroreje. Në territorin amant ai përbën një rast të vetëm dhe paralelizmin më të afërt e kemi në Berat. Është e njëllojtë dhe struktura e murit me ndarje tërthore që dallohen në fasadë nga dalja e alternuar e gurlidhësve. Kjo ngjashmëri shtrihet edhe në tipin e hy-



Fig. 20



Fig. 21



Fig. 22

19) Një varr monumental i botuar prej nesh në «Monumentet», nr. 9 f. 39, si dhe shenja varresh me rrasa guri.

20) L. Papajani, Qyteti ilir në Klos, «Kuvendi i studimeve ilirë», Tiranë 1974, f. 510.

DO NOT COPY



Fig. 23



Fig. 24

DO NOT COPY

rjes përmes kullës, që përveç Beratit[21]) nuk ndeshet në ndonjë qendër tjetër antike të vendit tonë.

Qyteza e Hadërajt

Vargu i kodrave që nis në vendin e takimit të Shushicës me Vjosën arrin pikën më të lartë në masivin gëlqeror të Hadërajt. Prej majës së tij hapet një vështrim i gjerë mbi luginën e Vjosës dhe drejt lartësive të kodrave në jug të saj; përtej Vjosës drejt veriut dallohet qartë Bylisi dhe Klosi; në vijë të kundërt nga jugu ngrihet qyteti i Amanties, nga j.p. shikohen Mavrova dhe Kropishti. Ka qenë kjo arsyeja që ky vend qe zgjedhur për ndërtimin e një fortifikimi antik. Ndryshe vendi ofronte një mbrojtje të kufizuar natyrale. Maja e kodrës që është përfshirë në muret e rrethimit ka një sipërfaqe të sheshtë, por të kufizuar. Nga ana j. ajo zbret më butë në një lug që të nxjerr në fshatin Hadëraj. Ana p. bie me pjerrësi më të madhe mbi një tarracë të gjerë të përshtatëshme për bujqësi. Në anën e kundërt kalohet lehtë drejt qafës që e lidh me një kodër të ulët fqinje. Vetëm ana v. zbret me pjerrësi të madhe dhe përbën një mbrojtje të vërtetë natyrale.

Zona që kontrollohet nga maja e kodrës është kodrinore e thyer, e përshtatshme kryesisht për frutikulturën dhe blegtori. Dy rrugë kryqëzohen në qafat pranë Majës së Qytetit: nga p. nëpër luginën e përroit të Vllahinës vjen një rrugë që të nxjerr në luginën e Vjosës dhe vazhdon gjatë bregut të majtë të saj drejt lindjes. Rruga tjetër që vjen nga Bylisi, pasi kalon Vjosën, ndjek kurrizin e kodrave që të çon rrëzë qytezës drejt Amanties.

Muret e qytezës me gjatësi rreth 380 m përfshijnë një sipërfaqe afër 0.6 ha mjaft të përshtatshme për banim (tab. V). Linja e mureve është kaluar buzë pjerrësisë në anën v. dhe p., ndërsa në pjesën tjetër është kaluar sipas vijës rrushkulluese. Kjo ka përcaktuar formën shumëkëndëshe të çrregullt të planimetrisë. Muri përshkon në përgjithësi vija të drejta me lakime të buta sipas formës së terrenit. Kthesat merren në kënd të drejtë apo të gjerë dhe në dy vende janë përforcuar me kulla. Këto janë edhe pikat më të mundshme të sulmit. Nga ana 1. ku terreni gjithashtu i favorizonte sulmet, funksionin e kullës e luante vetë balli i ngushtë i murit të qytezës.

Muri është ndërtuar me blloqe gëlqerore të nxjerra nga shkëmbi i kodrës që ka një vendosje gjeologjike në formë shtresash me lartësi të barabartë. Kjo ka përcaktuar edhe formën paralelpipede të zgjatur (1.70 – 2m) të gurëve me lartësi të vogël (0.25 – 0.30 m). Gurët janë vendosur në mur pothuaj ashtu siç janë nxjerrë nga gurorja me faqen e jashtme të papunuar. Në gjërësinë prej 2.80 m muri përbëhet nga këmisha e jashtme dhe e brendshme me mbushjen prej gurësh mesatarë dhe të vegjël. Lidhja e të tri pjesëve arrihet me gurë tërthorë, të cilët herë pas here formojnë parete lidhëse në gjerësinë e murit. Lartësia e ruajtur e murit nuk e kalon një rresht dhe është e vështirë të flasësh më tepër për veçoritë e tjera të tij (fig. 26).

21) Shih A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Beratit,** «Monumentet» 2, 1971, f. 46.

Nga kullat ruhet në gjendje më të mirë ajo nr. 2 në anën j., e cila është inkastruar në murin rrethues. Dallohet si një ndërtim katërkëndësh 8 x 7 m. Paretet me gjerësi 1.20 m përbëhen nga dy gurë gjatësorë. Ambienti i brendshëm lidhej me një derë me gjerësi 2 m. Kulla tjetër lidhet organikisht me murin dhe ka gjithashtu formë katërkëndëshe me ballë 10 m dhe dalje 7.20 m. Hyrja e vetme në qytezë duket se ka qenë në anën j.p., buzë pjerrësisë, ku mund të mbrohej më lehtë.

Në sipërfaqen e qytezës dallohen një numër godinash, prej të cilave, njëra e ndërtuar me gurë të mëdhenj, shkon paralelisht me murin rrethues pranë kullës jugore.

Gjetjet e keramikës janë të zakonshme në territorin e përfshirë nga muret rrethuese dhe në terracën që shtrihet në 1. të qytezës. Mbizotërojnë tjegullat solene me buzë të trashura apo të kthyera. Në keramikën e përdorimit përmendim një grykë amfore dhe një buzë skifosi me vernik kafe të errët, një fund skifosi me vernik gri në qielli dhe dy grykë enësh kuzhine (tab. V. a-c), të cilat datohen si tipa në shek. III-II p.e.sonë.

Qyteza e Hadërajt bën pjesë në grupin e vendbanimeve që kanë pasur si qendër Amantien. Në këtë kuadër roli i saj qëndronte në kontrollin e rrugës Bylis-Amantie si dhe të kryqëzimit të saj me një nga rrugët sekondare për në luginën e Vjosës. Ajo ishte njëkohësisht një qendër e vogël banimi me karakter fshatar. Kjo ka përcaktuar edhe pamjen arkitektonike të mureve, të cilat, për sa i përket zgjidhjes planimetrike dhe strukturës së murit, janë të tipit qytetar, ndërsa nga stili i punimit të fasadës mbeten primitiv. Duke u nisur nga të dhënat që disponojmë, mund të japim si terminus ante quem për ndërtimin e qytezës, shek. III p.e.sonë. Materialet e mbledhura në sipërfaqen e saj tregojnë se jeta nuk vazhdoi aty përtej shek. I p.e.sonë.



Fig. 25

DO NOT COPY



Fig. 26



Fig. 27

DO NOT COPY

KALAJA E MAVROVËS

Kodra me dy maja e Rethunit, mbi të cilën ngrihej qyteti antik i Mavrovës, ndodhet mbi bregun e djathtë të Shushicës, atje ku lumi zgjeron shtratin e tij në një luginë aluvionale. Prej saj kontrollohet një pjesë e mirë e zonës kodrinore që pason në jug të Shushicës si dhe fusha në të dyja anët e lumit. Gjithashtu degëzohej nën këmbët e kësaj kodre rruga natyrale drejt Cerjes për në Kaoni apo drejt Amanties për në ngushticat e Antigonesë.

Pjesa perëndimore e kodrës përbën një shpat të butë, i cili zihet sot pjesërisht nga lagjja «Çakallovë» e fshatit Mavrovë. Ana lindore e saj pritet thikë nga një rënie shkëmbore dhe ka qenë lënë e zbuluar nga ndërtuesit e murit të qytetit. Ky mund të ndiqet pothuaj pa ndërprerje duke u nisur nga këndi j.l. i qytetit, prej ku bën një zbritje drejt perëndimit. Pothuajse në mesin e kësaj distance muri është çarë nga një rrugë e sotme që ka nxjerrë në dukje gjerësinë prej 3.30 m të tij, me mbushjen prej gurësh të vegjël (fig. 27). Nuk dallohet kthesa që bën muri drejt veriut në faqen perëndimore të kodrës, por trakte të veçanta të tij mund të ndiqen në drejtim të vijës rrushkulluese. Pothuaj në mesin e faqes ruhet një trakt në pesë radhë, që qëndron mbi një themel prej blloqesh që janë lënë siç kanë dalë nga gurorja (fig. 28). Mbi njërin prej tyre ruhet kanali i bërë për shkëputjen e gurit dhe vendet e katër pykave të gjëra. Që këtu muri bën një kthesë në drejtim të lindjes, për të kaluar në një hark të gjerë lugun që formon faqja e kodrës në këtë anë. Këtu ruhet edhe trakti më përfaqësues në një gjatësi rreth 30 m dhe lartësi 3 m (fig. 29). Blloqet janë gëlqerore me forma katërkëndëshe dhe pjerje të lehtë të njerës prej brinjëve anësore. Faqet e jashtme të tyre janë trajtuar me goditje çekani me një fryrje të butë. Radhët janë izodomike me lartësi 0,53-0,60 m. Si themel janë përdorur gurë të papunuar, mbi të cilët kalon për nivelim një rresht pllakash më i dalë se muri. Në fasadë, çdo 2,60 m, dallohen gurlidhësit e ndarjeve tërthore që përshkojnë mbushjen prej gurësh të vegjël. Këtu muri bën edhe një kthesë në kënd të gjerë.

Gjurmët e murit humbasin në drejtim të lugut, ku duhet të ketë qenë edhe një nga hyrjet e qytetit. Më tej ai del përsëri në drejtimin v.l., me një trakt që ka shenja të qarta rindërtimi (fig. 30). Vetëm nga tarraca e dheut që është formuar mbi murin, mund të ndiqet traseja e tij, që ngjitet drejt kodrës më të ulët të anës veriore.

Gjatë gjithë kësaj gjatësie të mureve nuk dallohet ndonjë kullë apo hyrje. Që ky nuk ka qenë i vetmi rrethim i qytetit, duket nga një kullë që gjendet brenda sipërfaqes së tij, në faqen e kodrës më të lartë (fig. 31). Është një kullë me ballë 6.60 m e ndërtuar me blloqe trapezoidale me faqe guroreje. Gjatësia e tyre lëviz nga 0.80 m. në 1.90 m, ndërsa lartësia është 0.80 m. Blloqet janë vendosur në radhë të rregullta, por vija horizontale e fugave thyhet nga shkallëzimet. Në qoshet e kullës janë përdorur vija peshimi. Gjithashtu rreshti i parë del më jashtë në ballin e saj, duke formuar një farë cokoli. Vendësit tregojnë edhe për gjurmë të tjera të këtij muri, gjë që vërteton qenien e një muri akropoli që rrethonte vetëm majën më të lartë të kodrës.



Fig. 28



Fig. 29



Fig. 30

Nga teknika e ndërtimit e përdorur në të dy muret, kuptohet se ato u përkasin dy periudhave të ndryshme. Më i hershëm nga pikëpamja stilistike paraqitet muri i kullës (akropolit), që është i tipit trapezoidal me rreshta të thyer, me trajtim të fryrë të faqes. Në krahasim me Amantien ai paraqet një variant të zhvilluar të këtij tipi, ku linja horizontale është më e qetë dhe format e gurëve më të rregullt. Nga kjo veçori ai dallon edhe nga muri i të njëjtit tip në Klos, me të cilin ka të përbashkët faqen e papunuar të fasadës. Më afër është ai me murin e periudhës së dytë të Butrintit (të portës së Liqenit).

Duhet menduar se muri trapezoidal i Mavrovës i takonte fazës më të hershme të zhvillimit të vendbanimit, siç vërtetohet edhe nga gjetja e disa fragmenteve arkaike në majën e kodrës ku gjendet ai[22]). Zgjerimi i vendbanimit dhe kthimi i tij në një qytet bëri të nevojshëm ndërtimin e një muri të dytë rrethues, ndërsa i pari mbeti në funksionin e akropolit.[23]) Muri i periudhës së dytë është i tipit katërkëndësh izodomik me trajtim pak të fryrë të faqes që të kujton deri diku murin e Bylisit dhe veçanërisht atë të periudhës së parë të ndërtimit në Berat. Kjo veçori e dallon atë nga muri i periudhës së dytë të Matohasanajt ku faqet janë shumë të fryra. Mungesa e kullave në planimetrinë e Mavrovës duket se është një veçori që lidhet me një fazë të hershme të këtij tipi.

QYTEZA E CERJES

Mbi rafshin që shtrihet në vendin e takimit të lumit të Kuçit me përroin e Smokthinës ngrihet në formë piramide kodra e Kalasë së Cerjes (fig. 32). Muret antike rrethojnë një sipërfaqe rreth 2 ha në shpatin jugor të saj, që është më pak i pjerrët dhe më i përshtatshëm për banim (tab. VI, 2) Ky shpat ndërpritet në një rrëpirë të pakalueshme mbi bregun e lumit, vend që është lënë i pafortifikuar nga ndërtuesit e qytezës. Anët e tjera të kodrës karakterizohen nga një pjerrësi mesatare.

Planimetria e qytezës është pothuaj katërkëndëshe. Hyrja kryesore gjendet nga ana juglindore, ku një rrugë zbret në breg të lumit, te këmbët e urës antike. Një hyrje e dytë, e mbrojtur me kullë, gjendet në këndin e kundërt të qytezës. Në dy këndet e tjera ka gjithashtu një kullë katërkëndëshe dhe një të rrumbullakët. Gjatë kurtinave vihen re dy thyerje që spostojnë vijën e murit dhe një kullë katërkëndëshe.

I gjithë muri i qytezës paraqet një dorë të vetme ndërtimi. Pjesë të ruajtura të tij takohen në anën v. dhe l., ndërsa ana p. pothuaj është rrafshuar. Në anën l. (në pjesën B-C) ruhet një trakt prej dy radhësh prej blloqesh gëlqerore me forma

DO NOT COPY

katërkëndëshe me lartësi të barabartë 0.63 m. (fig. 33). Faqet e tyre janë rrafshuar me çukitje. Vijat e bashkimit që janë theksuar me prerje të anëve 2-3 cm, janë shpesh të pjerrta, gjë që jep nganjëherë përshtypjen trapezoidale të tyre. Gjërësia prej 3.30 m përbëhet nga dy këmishat dhe mbushja me gurë të vegjël, që ndërpritet çdo 2.15 m nga ndarjet tërthore. Gurlidhësit e tyre dalin rregullisht në mënyrë të alternuar në fasadë. Mbi blloqet ka gjithmonë një ose dy thellime në formë kanali, që shërbenin për vendosjen e levës gjatë lëvizjes së gurit që vihej sipër (fig. 34).

Në anën v. lartësia e rreshtave është 0.59 m, gjë që tregon se kudo muri ishte izodomik. Në anën p. (në pjesën G-H) ruhet një trakt i vendosur mbi shkëmbin e niveluar me anë të një rreshti që del 0.16 m. Mbi të vijnë dy blloqe me lartësi 0.53 m. Disniveli që krijohej nga shkëmbi në pjesën tjetër është eliminuar nëpërmjet shkallëzimeve dhe përdorimit të mbushjeve në formë pykash, që të kujtojnë muraturën e tipit trapezoidal (fig. 35). Në vendet ku muri kalonte në tokë, janë përdorur si themel gurë të punuar vetëm në pjesën e sipërme.

Hyrja juglindore (Hyrja I) formohet nga një kthesë në kënd të gjerë e murit dhe nga vendosja e një muri paralel buzë rrëpirës, ndërmjet të cilëve mbetet një korridor me gjërësi 3 m (tab. VI, 2b). Kjo hyrje, që është një variant i tipit me korridor paralel me murin mbrohet në dy drejtime që nga kthesa këndgjerë në krah të djathtë të saj.

Hyrja veriperëndimore (Hyrja II) paraqet një tip më të zhvilluar me korridorin 2.80 m të gjerë të krijuar buzë kullës që e mbron atë. Kjo e fundit ka formë katërkëndëshe me ballë 6.70 m dhe me dalje 3.50 m përpara hyrjes. Një tip të ngjashëm hyrjeje kemi te porta e liqenit (skea) në Butrint.

Në raport me gjatësinë e kufizuar të kurtinave kulla është një element i përdorur në masën e duhur në planimetrinë e qytetit. Atë e ndeshim në tre prej këndeve të saj dhe në njerën prej brinjëve. Kulla e këndit j.p. (nr. 4) është një ndërtim katëkëndësh, që nga dalja përbën një zgjatim të murit, j. të qytezës. Formën katërkëndëshe e përcakton prerja prej 7 dhe 3.40 m në anën perëndimore. Rreshti i fundit, pak i dalë, përbën njëkohësisht themelimin e kullës. Mbushja është bërë me gurë mesatarë midis murit dhe shkëmbit që kufizon nga prapa ndërtimin.

Pas saj, në një të tretën e murit perëndimor të qytezës, gjendet kulla 3 në formën katërkëndëshe të çrregullt, me ballë 6 m dhe brinjë 4.60 dhe 7 m. Në



Fig. 31

22) Një fragment skifosi dhe disa fragmente enësh me vernik të kuq, karakteristik për fundin e shek. VI p.e.sonë. Materialet do të botohen nga B. Dautaj në një studim të plotë për këtë qendër.

23) Një fenomen të ngjashëm kemi në Zgërdesh (S. Islami, **Qyteti ilir në Zgërdhesh,** «Monumentet», 1, 1971, f.) dhe Lis (F. Prendi, K. Zheku, **Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike,** «Monumentet» 2, 1971, f. 8.

DO NOT COPY



Fig. 32

qoshen e ruajtur ajo ka të gdhëndur një vijë peshimi. Në të njëjtën mënyrë si kulla 4, nga një zgjatim prej 3.50 m i murit verior të qytezës është formuar edhe kulla 2, që mbron hyrjen v.p. Ajo ka formë katërkëndëshe me ballë 6.70 m.

Kulla v.l. (nr. 1) ka formë rrethore me diametër 9 m. dhe del nga muri 7.30 m. Dallohet gjerësia e murit prej 3 m, pas të cilit ka pasur një ambient për mbrojtësit. Rreshti i poshtëm i murit të kullës, punuar njëlloj si të tjerët, del më jashtë në formë cokoli. Mbi të ruhet një radhë blloqesh me lartësi 0.70 m. Në mes të faqes ka një vijë peshimi në formë kanali katërkëndësh me seksion 9 x 5 cm.

Në sipërfaqen e rrethuar nga muret dallohen gjurmë banesash të ndërtuara me gurë të papunuar. Ka edhe mjaft gjetje qeramike të shek. III-I p.e.sonë.

Muratura e qytezës së Cerjes i takon katërkëndëshit izodomik me faqe të sheshtë. Mjaft afër është ajo me muraturën e të njëjtit tip të Kaninës[24]), me të cilin ka të përbashkët lartësinë e rreshtave dhe trajtimin me çukitje të faqeve të sheshta. Megjithëse nga pikëpamja formale ai është i të njëjtit tip si muri katërkëndësh i Amantias, ndërmjet tyre ka një ndryshim që del në pah nga krahasimi i planimetrisë. Në Cerje vëmë re një komplikim të saj nga vendosja e kullave gjatë kurtinave dhe pranë hyrjes në funksionin e vërtetë të tyre. Në këtë pikëpamje Cerja lidhet më tepër me qendrat e luginës së Drinosit, me Zgërdheshin dhe Dorëzin.

Ura e Bogdanit. Nën Kalanë e Cerjes, rreth 70 m para kthesës që bën lumi rrëzë kodrës ku ngrihet ajo, gjenden këmbët e një ure antike (fig. 36). Bregu i majtë i lumit është në këtë vënd më i ulët dhe shtrati zgjerohet duke krijuar një va. Gjithashtu një shkëmb i madh në mes të tij ishte një mbështetje natyrale për hedhjen e urës. Nga ura ruhet më mirë një këmbë që mbështetej në trapin e bregut të majtë. Ajo ka në plan formë trapezi me ballë 3.05 m të gjërë. Nga ana e rrjedhjes muri i këmbës takon në kënd të gjërë me trapin, ndërsa nga ana tjetër në kënd të drejtë (tab. VI, 1).

Nga balli i këmbës ruhen tri radhë blloqesh. Radha e poshtme, që përbën themelin, është vendosur mbi shtufin e bregut për ta niveluar. Faqja e dukshme e tyre është punuar trashë. Nga sipër ata janë niveluar për vendosjen e blloqeve të radhës së dytë, duke lënë edhe një prag 0.10-0,12 m të lartë për mbajtjen e tyre. Blloqet e radhës së dytë janë vendosur 0.10 m më brenda. Format e tyre janë katërkëndëshe, disa herë me brinjë të pjerrëta, me prerje të anëve dhe punim të sheshtë të faqeve, të realizuar me vijëzim, njëlloj si në murin e qytezës (fig. 37). Lartësitë e rreshtave janë 0.48 dhe 0.52 m, gjë që tregon për një trajtim izodomik të fasadës. Mbu-

24) A. Baçe, **Kanina**, f. 26-28.

DO NOT COPY



Fig. 33



Fig. 34

shja ndërmjet faqes së murit dhe trapit është bërë me gurë të vegjël, të hedhur, pa rregull. Këmba ngrihej në këtë mënyrë deri në lartësinë e bregut, rreth 3 m nga themeli.

Gjurmët e këmbës së dytë të urës përfaqësohen nga dy blloqe në vend, mbi një damar shtufi që përshkon zallishtën e lumit, 7 m larg këmbës së parë. Kanë formë katërkëndëshe me gjatësi rreth 1 m dhe lartësi 0.43 m. Dy kanale për lidhje plumbi mbi njërin prej tyre tregojnë se ka pasur edhe gurë të tjerë. Me të vërtetë, 1.50 m më tej dallohet një bllok i tretë, i lëvizur pak nga ujërat, i cili shkon paralelisht me fasadën e këmbës së parë. Prej këtyre elementëve mund të rikonstruktohet në një farë mase këmba e dytë e urës, e cila brinjën kundër rrjedhjes e kishte të pjerrët për t'i qëndruar forcës së ujit. Nuk ruhen gjurmë të këmbës së tretë, ndërsa rolin e këmbës së katërt e luante shkëmbi brënda në lumë që gjendet rreth 7 m larg bregut të djathtë. Pjesa e sipërme e tij, rreth 4 m mbi sipërfaqen e ujit, është punuar për vendosjen e dërrasave të urës. Në bregun e djathtë të lumit nuk ruhen më gjurmë të urës, përveç një blloku të rrëzuar që ka mbetur nga një këmbë, e cila mbahet mend nga vendasit, përpara Çlirimit.

Gjatë bregut të lumit ka edhe mjaft blloqe nga të urës, që janë zhvendosur nga uji, por ndërmjet tyre, ashtu si dhe ndër ata që ruhen në vend, nuk ka asnjë shenjë qemeri. Kjo tregon se ura ka qenë ngritur me këmbë murature, mbi të cilat vendoseshin dërrasat. Ka pasur gjithsej pesë këmbë të tilla në një largësi prej rreth 30 m, në një vendosje rreth 7 m larg njëra-tjetrës. Lartësia e tyre mbi pasqyrën e ujit sipas së dhënës që mund të nxjerrim nga shenjat mbi shkëmbin në lumë, ka qenë rreth 4 m. Ndërtime të ngjashme me shtrojë dërrasash mbi pilona kemi në urën e Topçiasit mbi Shkumbin dhe urën e kalamasit në Epir[25]). Veçoria e urës së Bogdanit qëndron në mungesën e përdorimit të llaçit. Ngjashmëria e muraturës së saj me atë të qytezës së Cerjes na bën të mendojmë se ato janë ndërtime të së njëjtës kohë. Përveç banorëve të qytezës, ura u shërbente udhëtarëve të rrugës që vinte nga Amantia për të dalë në Borsh apo në skelën Panormit nëpër luginën e lumit të Kuçit.

KALAJA E BORSHIT.

Rruga natyrale nëpër luginën e Shushicës, pasi ngjitej në qafën e Kuçit, ndiqte luginën e përroit të Çorrajt për të dalë në bregdet në fushën e Borshit. Në këtë pjesë të dytë rruga ishte e detyruar të ndiqte shpatet në bregun e majtë të përroit, i cili kishte një shtrat të ngushtë dhe tepër të thepisur për t'u kaluar. Qafa e fundit mbi bregdet ndan nga ana e përroit një kodër 385 m të lartë, ku gjenden gjurmët e një fortifikimi antik. Në pjesën e sipërme të kodrës ka disa rrafshe të përshtatshme për banim që përfshihen tani brenda një rrethimi mesjetar. Që aty shpati jugor zbret në pjerrësi mesatare drejt fushës. Një kurriz shkëmbor shënon kufirin e tij me shpatin lindor, i cili së bashku me atë verior vijnë duke u pjerrur deri sa kalojnë në gremina mbi përroin e Çorrajt. Ana lindore që lidhet me qafën është më e

25) Shih respektivisht C. Praschniker, A. Schober, **Archaölogische Forschungen in Albanien und Montenegro,** Wien 1920, f. 61 dhe N. Hammond, Epirus. Oxford 1967, f. 178.

DO NOT COPY



Fig. 35



Fig. 36

butë, me përjashtim të dy kreshtave shkëmbore që ngrihen mbi rrugën që vjen prej saj. Vendi ishte në këtë mënyrë mjaft i mbrojtur dhe përveç kontrollit nga afër të rrugës së Amanties, zotëronte fushën e Borshit dhe gjirin e detit që krijohet pranë saj.

Gjurmët e fortifikimit antik, që mund të ndiqen pothuaj gjatë gjithë gjatësisë së tyre formojnë një paralelogram të çrregullt me perimetër rreth 600 m (fig. 38)[26]). Me një sipërfaqe rreth 1.8 ha dhe mundësitë e kufizuara ekonomike, qyteza e krijuar në këtë mënyrë, ishte kryesisht një qendër me karakter strategjik, që mbronte një nga hyrjet kryesore për në territorin e amantëve dhe njëkohësisht siguronte lidhjen e tij me detin Jon.

Traseja e mureve ndjek vija të drejta duke bërë kthesa në kënd të gjerë apo të drejtë, të paforcuara me kulla. E vetmja kullë e dallueshme gjendet në anën v.l. ku shoqërohet me një kthesë në kënd të ngushtë, për të mbrojtur kurrizin e gjerë që formon kodra në këtë anë. Nga ana e qafës dallohet edhe e vetmja hyrje për në qytezë. Vihen re dy tipe murature. E para, me të cilën është ndërtuar pothuaj krejt fortifikimi, përfaqësohet nga një trakt i ruajtur mirë me anën jugore (fig. 39). Blloqet janë trapezoidale me punim të fryrë të faqes.[27]) Ndeshen edhe forma katërkëndëshe dhe, në një pjesë të vogël të murit, edhe poligonale. Lartësia e rreshtave është e ndryshme (0.25 – 0.75 m) dhe ato thyhen vazhdimisht nga shkallëzimet e shumta, por mbeten gjithmonë horizontale. Në fasadë ka tri vija peshimi të gdhendura rreth 15 m nga njëra-tjetra. Gjerësia e murit është 2.90 m dhe përshkohet krye 2.60 m nga ndarja tërthore që dallohen në fasadë nga gurlidhësit e alternuar. Mbushja midis tyre është bërë me gurë të vegjël. Si tip ky mur i përket trapezoidalit me faqe të fryrë.

Një dorë të dytë, me tipare pseudoizodomike përfaqëson muri i akropolit, nën muret mesjetare të anës p.



Fig. 37

DO NOT COPY

Periudha tjetër e ndërtimit përfaqësohet nga një trakt me pikat A – B, i ndërtuar me gurë pak të punuar në forma katërkëndëshe (fig. 40). Me gjithë pamjen primitive ai duket se përbën një rindërtim për vetë faktin e shtrirjes së kufizuar të tij. Këtij i përket edhe një hyrje e vogël e tipit me korridor paralel me murin, pranë hyrjes kryesore të qytezës.

Siç vumë në dukje, planimetria e qytezës është e varfër në elementë mbrojtës. Kulla e vetme ka formë katërkëndëshe 5 x 7 m dhe nga mënyra e krijimit nëpërmjet zgjatjes së brinjës së murit i ngjan kullës së Cerjes. Edhe hyrja është e pambrojtur nga kulla dhe është krijuar, në një mënyrë të veçantë, në njërën prej kthesave kënddrejta të murit.

Muraturën e Borshit mund ta shohim si një variant të vonë të trapezoidalit me rreshta të thyer të kohës kur rreshti sundon si koncept ndërtimor. Për këtë arsye vëmë re se vijat horizontale të fugave, megjithëse thyhen vazhdimisht, nuk pjerren pothuaj kurrë. Në disa vende shkallëzimet përdoren rrallë dhe muratura kthehet në një trapezoidal të vërtetë pseudozodomik.[28]) Vetëm në një rast ajo merr një karakter poligonal. Për një variacion të tillë të formave dhe linjave të fugaturave, muratura e periudhës së parë të Borshit të kujton Çukën e Ajtojt, me dallim se tek ajo e fundit prirja kryesore është ndaj poligonalit. E përbashkët është gjithashtu edhe varfëria e elementeve mbrojtëse në planimetri.

* * *

Në analizën e përgjithshme të qendrave të fortifikuara amante duhet të nisemi në radhë të parë nga roli i tyre në territorin e koinonit. Për sa u përket kushteve ekonomike dhe veçorive gjeografike ky territor ka dy treva kryesore. Treva e brendshme, që përmbledh luginën e Shushicës dhe zonën malore rreth saj, është edhe pjesa qendrore e territorit amant. Ekonomia e saj bazohej në bujqësinë e favorizuar nga fushat pjellore gjatë luginës së Shushicës dhe degëve të saj. Gjithashtu pjesa kodrinore ishte mjaft e përshtatëshme për zhvillimin e frutikulturës. Këtu kalonin rrugët tregtare që përshkonin territorin amant drejt Epirit. Për vetë këtë territor, kjo trevë kishte rëndësi edhe për lëvizjen e tufave në shtegtimin nga kullotat verore për në ato dimërore.

Në këtë trevë qyteti kryesor ishte Amantia. Mbizotërimi i saj është përcaktuar nga pozita në strategjike mbi territorin amant, nga kushtet më të mira të mbrojtjes natyrale dhe nga kontrolli i afërt i rrugëve tregtare për në Epir. Nuk është pa rëndësi edhe ndodhja pranë zonës së pasur me kullota, që përbëjnë kodrat rreth saj dhe mali i Tartarit. Roli i veçantë ekonomik i Amantias del në dukje në radhë të parë nga prerja e monedhave prej bronci, që u emëtuan në emër të tërë amantëve.[29]) Edhe për sa i përket sipërfaqes së qytetit (15 ha) dhe gjatësisë së mureve (2200 m) Amantia radhitet krahas gjashtë qyteteve kryesore ilire (Bylisi, Klosi, Berati, Lisi, Shkodra). Ajo ishte njëkohësisht edhe qendra politike kulturore dhe shpërtërore e amantëve, gjë që del në dukje nga mbishkrimet, skulpturat, tempulli dhe stadiumi i zbuluar në qytet.

Përsa i përket territorit, radhitet si qytet edhe Kalaja e Mavrovës, ku mund të identifikohet qyteti Olympe, i cili preu monedhë në periudhën 229-148 p.e.sonë[30]). Procesi i rritjes së vendbanimit nga një qendër e vogël e fortifikuar në një qytet del sot për sot vetëm nga raporti i akrepolit me vetë qytetin që zë një territor rreth 4 herë më të madh.

Në zonën bregdetare, vendbanimi i tipit qytet përfaqësohet nga Kanina dhe Treporti, vetëm se roli i tyre ekonomik në krahasim me Amantien dhe Mavrovën ka qenë më i vogël. Si skela të pavarura ato konkuroheshin nga Oriku dhe Aplonia dhe e; luanin këtë rol kryesisht në funksion të zonës së brendshme amante.

26) Skica planimetrike e fortifikimit është bërë mbi rilevimin e botuar nga Dh. Budina, **Harta arkeologjike e bregdetit Jon dhe e pellgut të Delvinës,** «Iliria» 1, 1971, tab. 1. Punimet e kryera vitet e fundit nga J. Koçi sjellin të dhëna të reja, të cilat do të trajtohen prej tij së shpejti.

27) Dh. Budina po aty, f. 284 e përshkruan si ndërtim **«me blloqe gurësh** të mëdhenj me forma paralelopipedi dhe trapezoidali. Blloqet janë punuar mirë nga të gjitha faqet... janë vendosur në radhë të rregullta horizontale. Përshkrimi nuk përputhet me gjendjen e vërtetë të murit, as edhe me ilustrimet e tij në tab. I.

28) Nuk është i saktë përcaktimi që i bën Hamond, **vep. cit.,** f. 122, kësaj murature si e tipit katërkëndësh.

29) Këto monedha janë të llogaritura kryesisht për territorin amant, siç e dëshmon mospërputhja e peshave dhe simboleve me ato apoloniate. Nga raporti i monedhave të gjetura në Amantia (91 të Amanties, 141 të Epirit, 27 të Apolonisë, 17 të Orikut, 8 të Bylisit) del se ato u konkuruan në vetë Amantia nga monedhat e huaja. Nga ana tjetër ato patën një rreze të dobët veprimi në territoret fqinje.

30) H. Ceka, **Probleme të numismatikës ilire,** Tiranë 1965, f. 92, propozon Mavrovën si njerën nga tri qendrat e mundshme për identifikimin me Olympen.



DO NOT COPY

Fig. 38

Tipi i dytë i vendbanimeve përfaqësohet nga Matohasanaj, Cerja, Hadëraj, të cilët në kuadrin e territorit amant kanë kryesisht funksion strategjik. Ato sigurojnë krahët e qyteteve amante dhe njëkohësisht kontrollojnë pjesët e veçanta të territorit dhe rrugët që i përshkojnë ato.

Nuk përjashtohet edhe roli i tyre ekonomik në lidhje me pellgjet e vogla gjeografike, mbi të cilat zotërojnë këto kështjella. Ky karakter i tyre shprehet edhe nga arkitektura që përfaqësohet kryesisht nga fortifikimet. Ndërmjet vetë këtyre qendrave ka ndryshime për sa u përket madhësive, forcë së fortifikimeve dhe realizimit teknik të tyre. Në këtë pikëpamje qëndron në radhë të parë Matohasanaj, pastaj vjen Cerja, Borshi dhe qendrat e tjera më të vogla.

IDENTIFIKIMI

Nga qendrat e amantëve të kumtuara nga autorët antikë, përveç Amanties njohim Thronin dhe vendin e Karias të kumtuar nga Lykofroni identifikimi i Amanties qëndron sot jashtë çdo dyshimi në saje të një njohje më të mirë të mbeturinave të kalasë së Ploçës, gjetjes me shumicë të monedhave amante, dekreteve etj. Për këtë arsye është e tepërt rezerva e shprehur nga Hamondi dhe e pafrutshme përpjekja për ta hedhur atë në bregun tjetër të Vjosë, në Kalanë e Klosit[30]). Me të dhënat e sotme ky problem mund të quhet i zgjidhur përfundimisht.

Ndryshe qëndron puna me Thronin, për të cilin ka përpjekje për ta identifikuar në Kaninë[31]). Kjo hipotezë qëndron më mirë se ajo që e çon në Ploçë[32]), apo në Cakran[33]), por nuk mund të quhet e kënaqshme. Nga shpjegimi i Pausanies dhe nga mbishkrimi[34]) del se apoloniatët nuk luftuan me tërë amantët, por vetëm me njërin prej qyteteve të tyre. Koha e ngjarjes është vendosur rreth vitit 470, gjë që na jep mundësi të kufizohemi në ato qendra amante të fortifikuara, që na kanë dhënë materiale më të hershme. Si të tilla kemi Mavrovën dhe Treportin.[35]) Sidoqoftë është vështirë të mendojmë se apoloniatët në këtë periudhë synojnë drejt tokave të brendshme për të zgjeruar territorin e tyre, gjë që do t'i kishte vënë në armiqësi dhe luftë me tërë bylinët dhe amantët. Është e qartë se ata në këtë periudhë mundoheshin të mbanin marrëdhënie të mira me fqinjët, gjë që siguronte edhe zhvillimin ekonomik të qytetit. Konflikti i vetëm mund të lindte në dete për sigurimin e lundrimit nga pirateria dhe për një skelë rezervë në rast se kalimi në grykën e Vjosës ishte i pamundur në kohë të keqe. Si një qendër e tillë vjen në konsideratë Treporti, i cili është një skelë natyrore, që veçohet lehtë nga pjesa tjetër e territorit amant. Nga mbishkrimi i Olympias del qartë se kemi të bëjmë jo me një qytet të madh, por me një qendër të vogël që mund të përputhet fare mirë me Treportin.

Në territorin amant është supozuar edhe lokalizimi i Olympes, qytet Ilir, i cili deri para tri dekadave njihej vetëm nga një njoftim i shkurtër i Stefan Bizantinit. Gjetja e monedhave të këtij qyteti jo vetëm që vërtetoi këtë njoftim, por dha mundësi që të përcaktohet ajo zonë e Ilirisë ku duhej kërkuar qyteti. Në radhë të parë kjo u bë e mundur nga simbolet e monedhave që ishin të ngjashme me ato të Apolonisë, Amanties dhe Bylisit. Pra qyteti duhej të ndodhej diku ndërmjet këtyre tri qendrave antike[36]). Vendi i gjetjes së monedhave është gjithashtu një tregues që e ngushton edhe më shumë zonën e kërkimit. Të dhëna të sakta kemi për dy monedha të Olympas të gjetura në Amantia dhe tri të tjera nga Mavrova.[37])

Gjetja e monedhave e kufizon kështu zonën ku duhet kërkuar qyteti në bregun e majtë të Vjosës, në territorin e amantëve. Për këtë arsye, nga qendrat e propozuara nga H. Ceka duhet të përjashtojmë Gur-

30) N.G.L. Hammond, **vep. cit.,** f. 233.
31) Po aty, f. 496.
32) R.L. Beaumont, **Corinth, Ambracia, Apollonia,** «Journal of Hellenic Studies», 1952, f. 66.
33) Ky mendim (A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Kaninës** «Monumentet» 7-8, f. 31, përjashtohet vetiu nga fakti se Throni ishte qytet i Abantisë, ndërsa Cakrani gjendet në territorin e bylinëve.
34) – Shih NG.L. Hammond **vep. cit.,** f. 384.
35) Po aty, f. 132. Hamondi përmend gjetjen e fragmenteve të vona mikenase nga kjo qendër. Ndër materialet e gjetura në gërmimet e dy viteve të fundit, që na ka treguar studjuesi i saj Vasil Bereti, kemi parë fragmente skifosash dhe enesh të tjera të fundit të shek. VI dhe të shek. V. që nga faktura ngatërohen lehtë me ato të M.V. IV C. Një supozim për ta kërkuar Thronin në Treport është dhënë nga A. Baçe, **Kanina,** f. 31.
36) H. Ceka, **vep. cit.,** f. 92.
37) Për të parat na kumton H. Ceka, **vep. cit.** f. 92, të dytat na ka dhënë rastin t'i shohim B. Dautaj.

DO NOT COPY



Fig. 39



Fig. 40

zezën,[38]) nga e cila nuk kemi asnjë monedhë të Olympas. Gjithashtu bien edhe Cerja dhe Kanina, të cilat janë kështjella dhe jo qytete që mund të prisnin monedha autonome.

Në një vështrim të tillë simbolet e monedhave përputhen plotësisht me ato të territorit amant: dy tipet e prerjes 229-168, d.m.th. ai me Zeus-Rrufe dhe Apolon-Obelisk lidhen plotësisht nga simbolet dhe peshat me monedhat e Amanties dhe Orikut dhe nuk është e nevojshme të kërkohet analogji edhe me Apoloninë[39]). Kjo tregon se qyteti ndodhej në një zonë ndërmjet Amanties dhe Orikut dhe nëpërmjet ngjashmërisë së monedhave synoi t'i konkuronte ato. Një zonë e tillë përputhet plotësisht me luginën e poshtme të Shushicës, që zotërohet nga Mavrova. Për këtë arsye mund të ndalemi te ky qytet antik për të identifikuar Olympan.

Tipin e tretë të monedhës, atë me Athina-gjarpër, mund ta marrim më pak në konsideratë. Prerja e tij pas vitit 168, në kushtet e reja politike dhe administrative të vendosura nga Roma, presupozon një fushë më të kufizuar veprimi. Në fakt kjo monedhë nuk shpreh një lidhje direkte me monedhat bashkëkohore të Bylisit[40]) që nuk kanë as simbole dhe as pesha që të përputhen me monedhën e Olympas. e vetmja lidhje sinkrone e saj është me Amantien, me të cilën ka të afërt peshën e monedhës.

Qendra e katërt amante, për të cilën kemi të dhëna për të sprovuar identifikimin, është Cerja. Është një pasazh i Lykofronit[41]), që i vendos atintanët mbi Orikinë dhe Karian (ὑπὲρ τῆς Ὁρικίας καί Καρίας). Duket qartë se kemi një reshtim të zonave në drejtim të verilindjes, ku Karia përfaqson luginën e sipërme të Shushicës, fqinjë me teritoret e Atintanisë përtej malit të Gribës. Siç ndodhte shpesh në kohën antike, qendra kryesore qytetare i jepte emrin edhe krahinës, siç ndodhi në rastin tonë me Orikinë. Prandaj duhet menduar se edhe emri i Karias, vjen nga emri i një qyteti, i cili me rastin tonë mund të ishte Ceria, qoftë si e vetmja qendër e fortifikuar qytetare në luginën e sipërme të Shushicës, qoftë nga tingëllimi shumë i afërt i emrit.

SHQYRTIMI ARKITEKTONIK I FORTIFIKIMEVE

Ndër fortifikimet amante të ruajtura më mirë mund të dallojmë përgjithësisht tipin qytetar të planimetrisë në Amantia dhe Mavrovë dhe atë të kështjellës në Matohasanaj, Cerje, Borsh etj.

Në rastin e qyteteve nuk kemi një plan të menduar dhe të realizuar menjëherë, sepse të dy qendrat patën zgjerime më të vona.

Nuk mund të themi se ekzistonte në atë kohë

38) H. Ceka, **vep. cit.,** f. 92 propozon Cerjen, Nivicën, Mavrovën, Kaninën dhe Gurzezën. Nga këto Nivica përjashtohet vetiu për mungesë të mureve antike.

39) H. Ceka, **vep. cit.,** f. 91 vë në dukje ngjashmërinë e madhe me tipin e njëllojtë të Orikut.

40) Sigurisht që në këtë kohë Koinoni i bylinëve është shpërndarë dhe Bylisi pret vetëm monedha me emrin e qytetit (Βυλλις) simbolet e të cilave janë Neoptolemi, rrufeja, apo shqiponja dhe nimfa dhe zjarri.

41) Shih N.G.L. Hammond, **vep. cit.,** f. 522.

DO NOT COPY

vetë koncepti i tipit në zgjidhjen e planimetrive, sepse, ndërsa në Mavrovë zgjerimi i qytetit dha rast për krijimin e një akropoli në zonën e vjetër të tij, në Amantia nuk ndodhi një gjë e tillë. Zona e re ishte aty shumë më e kufizuar se qyteti i vjetër dhe u diferencua prej tij pjesërisht prej shkëmbit natyral dhe pjesërisht prej një muri. Në këtë pikëpamje ajo i ngjan zgjidhjes planimetrike të Apolonisë, ku qyteti ndahet nga disa mure në pjesë të veçanta apo të Bylisit ku një oborr i fortifikuar paraprin hyrjen në qytet[42]). Sido qoftë në Amantia zgjerimi i qytetit bëhet kryesisht për të forcuar mbrojtjen në anën lindore dhe territori i përfshirë rishtas brenda murit pothuajse mbetet i pabanuar.

Pra në të dy rastet nuk mund të flasim për tipa të mirëfilltë, por për ndryshime që ndodhin në planimetrinë e vendbanimeve si rrjedhim i zhvillimit historik të tyre. Edhe në qendrat e tjera të vendit tonë akropoli është gjithmonë një ndërtim i një kohe tjetër. Ai është më i hershëm se muret rrethuese në Lis II dhe më i vonë në Lis IIIb[43]), po kështu në Zgërdhesh[44]), ku murit të vendbanimit të hershëm, që mbetet në rolin e akropolit, i është bërë një përforcim në periudhën e tretë të ndërtimit.[44]) E njëjta gjë ka ndodhur edhe në Apoloni[45]. Që akropoli nuk është konceptuar si i tillë në ndërtimet ilire, duket qartë nga mungesa e tij në qytetet e mëdha si Bylisi dhe Klosi, që u krijuan në një periudhë më të vonë. Mund të shënojmë gjithashtu varfërinë dhe thjeshtësinë e elementeve të mbrojtjes në Amantia edhe Mavrovë. Kullat janë të rralla dhe me dalje të pakët, në krahasim me ballin. Ata nuk shtohen edhe në periudhën e dytë të ndërtimit dhe ndryshimi në këtë kohë vihet re vetëm në një mbrojtje më të mirë të hyrjeve, që mbeten përsëri të tipit me korridor paralel me murin. Por edhe në këtë kohë kullat nuk vendosen pranë hyrjeve, por në vënde ku luajnë kryesisht rolin e vrojtimit dhe të kontraforteve.

Këtë tip planimetrie që përfaqëson një fazë të hershme të zhvillimit të fortifikimeve qytetare e ndeshim në Klos[46]) për periudhën e parë, Bylis. Përsqop (për periudhën e dytë).

Nga kështjellat amante, Matohasanaj dhe Borshi i takojnë tipit të mësipërm për sa i përket planimetrisë, që karakterizohet nga përdorimi i paktë i kullave dhe hyrja e thjeshtë. Cerjo, përkundrazi përfaqëson një tip më të përparuar, ku kullat zënë një vend të gjërë dhe përdoren edhe për mbrojtjen e hyrjeve. Ky tip planimetrie që lidhet me përpunimin e taktikës helenistike në rrethimin e kështjellave[47]), ndeshet në fortifikimet e luginës së Drinos[48]) dhe në një radhë qendrash ilire si Berati[49]), Zgërdheshi[50], Lisi[51]) etj.

VËREJTJE MBI TEKNIKËN E NDËRTIMIT

Gjatë përshkrimit të qendrave të veçanta dolën në pah teknika të ndryshme ndërtimi të mureve rrethuese, që përfaqësojnë pothuaj të gjitha mënyrat e përdorura për këtë qëllim në qytetet ilire.

Krahas zhvillimit të fortifikimeve amante vemë re edhe evolucionin e teknikës së ndërtimit, të cilin mund ta ndjekim në dy linja: njëra e trapezoidal-poligonalit dhe tjetra e katërkëndëshit. Duke pasur fillime të ndryshme në kohë, të dy teknikat kanë njohur më pas një zhvillim paralel.

I. Tek Amantia gjetëm mbështetje për t'i dhënë në këtë raport prioritetin kronologjik **muraturës trapezoidale.** Përmendja para mesit të shek. IV, që fitojmë nga Pseudo-Skylaksi dhe gjetja e materialeve të shek. V p.e.sonë[52]) përputhet edhe me konceptin ende primitiv me të cilin është realizuar kjo muraturë.

42) C. Praschniker, **Muzakhia und Malakastra,** Wien 1922, fig. 26.

43) F. Prendi, K. Zheku, **Lisi...** f. 8. Gjurmët e një akropoli të fazës Lis III b, kanë dalë nën muret mesjetare gjatë punimeve të konservimit.

44) S. Islami, **Qyteti ilir në Zgërdhesh,** «Monumentet» 1. 1971, f. 28 dhe fig. 2.

45) Muri i akropolit ushtarak (arx) të Apolonisë është më i hershëm se pjesa tjetër e murit rrethues. H. Ceka, **Muri i akropolit në Apoloni,** «Buletin Arkeologjik».

46) Shih L. Papajani, **Qyteti ilir në Klos,** «Kuvendi I i Studimeve ilire», Tiranë 1974, f. 509. S. Islami, **Problémes de chronologie..,** f. 42, e bën dallimin e planimetrive vetëm në kuadrin e stilit poligonal.

47) N. Ceka, **Tipare të kulturës qytetare në Ilirinë e Jugut,** «Studime Historike», 2, 1975, f. 150.

48) A. Baçe, **Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos (Gjirokastër),** «Monumentet», 4, 1972, f. 104-109.

49) A. Baçe, **Qyteti i fortifikuar i Beratit,** Monumentet 2, 1971, f. 46.

50) S. Islami, **Zgërdheshi,** f. 27.

51) F. Prendi, K. Zheku, **vep. cit.,** fig. 4.

52) Në një shembje të murit rrethues ne gjetëm një shtresë me materiale të tilla, nga të cilat tipike janë dy pjesë skifosash (shih tab. VI, 2 d), që përsërisin formën e njohur nga tuma 1 e nekropolit të Apolonisë nga një varr i shek. VI-V (v. 74). Shih A. Mano, **Nekropoli i Apollonisë, Tuma 1,** Iliria II, 1971, tab. XXVII, 1.

POROTOMY

a) Blloqet për murin janë nxjerrë në mënyrë ekstensive, duke u thyer nga shkëmbinjtë e sipërfaqes në forma të çrregullta. Kjo ka përcaktuar edhe trajtimin trapezoidal ose poligonal të tyre.

Formimi i grupeve të specializuara të gurgdhendësve në këtë qendër qytetare ka krijuar mundësi të kalohet njëkohësisht edhe në shfrytëzimin intensiv të materialit të ndërtimit nëpërmjet gurioreve. Kjo gjë bëhej e domosdoshme edhe për faktin e sasisë së madhe të blloqeve që nevojiteshin për murin e qytetit dhe të formacionit përgjithësisht të rafshtë të kodrës.

Në gurore apo në shkëmbinjtë e shkëputur është synuar të nxirren blloqe me sipërfaqe sa më të madhe, pa i kushtuar vemendje formës apo lartësisë së tyre. Renditja e tyre në mur ishte në kujdesin e një grupi tjetër mjeshtërish dhe kjo për arsyen e thjeshtë, sepse ende nuk ishte futur në ndërtim koncepti i rreshtit që kërkon pregatitjen e formës së bllokut që në gurore. Si rrjedhim lidhja e blloqeve me forma dhe lartësi të ndryshme sigurohej gjatë murëzimit, nëpërmjet përdorimit të shpeshtë të shkallëzimeve dhe mbushjes së blloqeve me gurë më të vegjël.

Edhe në strukturën e murit mungon një lidhje organike e pareteve me mbushjen nëpërmjet ndarjeve tërthore që dalin vetëm në periudhën e dytë të ndërtimit.[53]) Qëndrueshmëria e kurtinave atje ku ato kalojnë në një vijë të drejtë është siguruar nëpërmjet përdorimit të daljeve në formë bastionesh ose të kthesave 90°.

Në klasifikimin e njohur të muraturave[54]) kjo mënyrë i përket trapezoidalit të çrregullt që vazhdon të përdoret në Greqi deri rreth vitit 360[55]) p.e.sonë. Por nuk mund ta fusim tipin tonë të muraturës plotësisht në këtë stil dhe të përdorim datën e propozuar nga Skrantoni, sepse ai paraqet disa veçori të ndryshme nga Greqia. Në radhë të parë ai nuk është një stil i pastër, sepse kombinohet ngushtë me trakte poligonale, apo me të tilla që afrojnë me trapezoidalin izodomik. Si i tillë ai përfaqëson një periudhë kalimtare kur po hyn koncepti i zbatimit të rreshtit në muraturën trapezoidale. Së dyti stili trapezoidal përmban në vendin tonë elemente të një evolucioni të brendshëm. Në rastet më të hershme, në Amantia dhe Butrint, ai cilësohet nga trajtimi i sheshtë i faqes dhe mungesa e ndarjeve tërthore. Një fazë më të zhvilluar përfaqësojnë muret e të njejtit tip në Matohasanaj dhe Klos, ku këto ndarje vendosen rregullisht. Gjithashtu edhe nga pikëpamja stilistike te këto dy qendra vihet re një ndryshim në trajtimin e fryrë të blloqeve në fasadë. Për të cilësuar këtë tip murature mund të përdorim termin trapezoidal-poligonal që do t'i përfshijë të dy veçoritë morfologjike të saj.

Ky stil murature ka një përhapje mjaft të kufizuar, gjë që lidhet me kohën e shkurtër të përdorimit të tij, që bie ndërmjet fundit të shek. V, kur ky stil ende është në përdorim në vendet fqinje, dhe mesit të shek. IV, kur Amantia ekziston si qytet. Për Klosin mund të pranonim edhe ndonjë datë më të vonë.

Ky datim mbështetet edhe nga të dhënat arkeologjike, sepse në Butrint kemi një shtresë me materiale korintike edhe një numër të konsiderueshëm monedhash të shek. V-IV p.e.sonë[56]), nga Amantia kemi disa fragmente enësh të shek V p.e.sonë. Nga Klosi gjithashtu kemi një shtresë me materiale arkaike[57]) që paraprin krijimin e qendrës qytetare.

b) Futja në ndërtimin e mureve rrethuese e konceptit të rreshtit, që lidh në një të vetëm procesin e nxjerrjes së blloqeve dhe murëzimin e tyre, solli në modë një lloj të ri trapezoidali, të cilin e ndeshim në murin e akropolit në Mavrovë.

Këtu forma trapezoidale e gurit është që në nxjerrje në funksion të rreshtit, por ende nuk është standartizuar plotësisht. Ndryshimet e vogla në lartësitë e blloqeve bëjnë që vijat horizontale të fugave të mos jenë gjithmonë paralele, por të thyhen. Veçori stilistike e kësaj murature është pamja e ashpër e faqes së jashtme të blloqeve, nga ruajtja e thyerjes së gurores, apo trajtimi më i fryrë me çekan. Për sa i përket ndërtimit të brendshëm, tek ajo zbatohen përherë ndarjet tërthore.

Edhe në këtë tip murature mund të veçojmë dy faza në zhvillimin e brendshëm. E para, e përfaqë-

53) F. Winter, **Greek fortifications,** Toranto 1971, f. 135 ka vënë në dukje se ndarjet tërthore janë një element helenistik në strukturën e murit.

54) Shih R. Scranton **Greek Walls,** Cambridge 1941, f. 139 dhe F. Winter, **vep. cit.,** f. 80-81. Klasifikimi dhe datimi përkatës i stileve prej tyre ka vlerë relative për vendin tonë.

55) R. Scranton, **vep. cit.** f. 189 e cilëson këtë stil si tipik për shek V p.e.sonë. dhe vetëm si relik ai vazhdon të përdoret edhe në shek. IV p.e.sonë.

56) D. Mustilli, **Relazione preliminare sugli scavi archeologici in Albania (1937-1940),** në «Rendiconti della classe di scienze morali e storiche, serie VI, II, 1941, f. 686-687.

57) Shih L. Papajani, **Raport mbi gërmimet arkeologjike të vitit 1973 në qytetin ilir në fshatin Klos të Mallakastrës,** «Buletin Arkeologjik» 4, 1974, f. 98.

POROTOSY

suar përveç Mavrovës edhe në Butrint, Finiq dhe Dorëz[58]), karakterizohet nga lartësia pothuaj e barabartë e rreshtave (rreth 0.80 m) dhe planimetria relativisht e thjeshtë.

Ky tip murature paraprin atë trapezoidale izodomike apo katërkëndëshe izodomike dhe mund ta karakterizonim si trapezoidal me rreshta të thyer. Kronologjia relative e tij përcaktohet nga ky tipar tranzitor dhe në bazë të kësaj mund të kërkonim një datim të kësaj murature rreth mesit të shek. IV p.e.sonë. Për Mavrovën kjo mbështetet nga pikëpamja arkeologjike në gjetjen e një shtrese me fragmente të shek. VI-V p.e.sonë në majën e kodrës të rrethuar nga muri i akrepolit, që përfaqsojnë zhvillimin e hershëm të këtij vendbanimi.

c) Në fazën e dytë, për të cilën i referohemi Borshit, rreshtat në fasadë kanë lartësi të ndryshme dhe thyhen vazhdimisht nga përdorimi i shkallëzimeve të shumta. Ka edhe një prirje për të kaluar në trakte të veçanta në një poligonal të rreshtuar. Ky tip murature, i cili përveç tiparit të rrjeshtit të thyer ka edhe veçorinë si psedoizodomik, ndeshet kryesisht në Epir dhe pas një hiatusi ndërmjet Vjosës dhe Matit del në një radhë qendrash si Xibri, Lisi, Oshanici etj. Është provuar se në grupin verior ky tip murature i takon fundit të shek. IV – fillimit të shek. III p.e.sonë.[59]) Duket qartë se origjina e tij është në Epir ku ai ndeshet në planimetri më të thjeshtë se ato të veriut që janë mjaft të përpunuara. Ka mundësi që edhe emri, me të cilin njihen në veri këto mure-**moenia aeacia**[60]), të lidhet me origjinën epirote të tij. Për këtë arsye në zonën e Epirit dhe si rrjedhim edhe në Borsh, duhet të mendojmë se ky tip murature përpunohet nga fundi i shek. IV p.e.sonë. Kjo është edhe koha kur është në modë në viset fqinje të Greqisë perëndimore poligonali i rreshtuar dhe trapezoidale pseudoizodomik[61]).

II. **Muratura katërkëndëshe** në territorin e amanteve ndeshet vetëm në formën izodomike.

a) Në Amantia ajo karakterizohet nga trajtimi i sheshtë i faqeve, lartësia prej një këmbe e gjysmë ose dy këmbësh (0.47 – 0.60 m) e rreshtave dhe planimetria e thjeshtë. Në këtë pikëpamje ai paraqet ngjashmëri me disa qendra ndërmjet Erzenit dhe Vjosës: Persqopin[62]), Bylisin, Klosin[63]) dhe Margëlliçin.

Ende nuk kemi një pikë të sigurtë referimi për datimin e këtij tipi murature, por forma ende e papërpunuar e planimetrisë na çon përpara periudhës helenistike, ndoshta nga mesi i shek IV p.e.sonë. Kjo është edhe koha kur ai ndeshet rëndom në krahinat fqinje të Greqisë[64]). Futja e tij në Ilirinë e Jugut duket se është bërë në dy drejtime: nga Apolonia[65]) (Margëlliç, Bylis, Klos) dhe Dyrahu (Përsqop).

b) Njëlloj si trapezoidali, edhe ky tip murature njeh një fazë të dytë zhvillimi në kushtet e përpunimit të taktikës luftarake. Kësaj kohe i takon Cerja dhe Kanina me planimetritë e përpunuara. Nga kjo pikëpamje ato paraqesin ngjashmëri me një radhë qendrash në veri, si Dorëzi, Zgërdheshi, Shkëmbi i Shëmlliut, Rosuja, ku gjejmë njëlloj trajtimin e sheshtë të faqeve, rreshtat izodomike me lartësi 0.60 m dhe përdorimin e shpeshtë të kullave.[66])

Në jug ky tip murature gjen një përhapje të gjerë në luginën e Drinosit[67]), ku ka si veçori shoqërimin sinkron me poligonalin e rreshtuar me faqe të fryrë[68]), përdorimin e një moduli prej 1 1/2 këmbë (0.45 m) për lartësinë e rreshtit dhe planimetritë e përpunuara.

Në Epir ky stil pothuaj mungon krejt, me përjashtim të murit të Demës. Ky fakt është një tregues i drejtimit verijugë të përhapjes së tij.

Përsa i përket kronologjisë, Zgërdheshi na ka dhënë një mbështetje të mirë për ta datuar këtë fazë

58) Në Butrint me këtë muraturë është ndërtuar pjesa kryesore e murit rrethues, të cilit i takojnë ndër të tjera porta e liqenit (Skea) dhe ajo e Luanit. Në Finiq një trakt i tillë, që duket se është bashkohet me murin katërkëndësh, gjendet në anën lindore. Në Dorës e ndeshim si periudhë të dytë ndërtimi, që paraprin zbatimin e katërkëndëshit izodomik.

59) S. Islami, **Problèmes...** – f. 43.

60) M. Garasahin, **Moenia Aeacia** «Starinar». XVII (1967), f. 27-34.

61) L. Scranton, **vep. cit.,** f. 140.

62) F. Miraj, **Muret antike të Persqopit,** «Monumentet», 2, 1971, f. 153-155.

63) L. Papajani, **Qyteti ilir në Klos,** f. 510.

64) R. Scranton, **vep. cit.,** f. 139.

65) Shih H. Ceka, Muri rethues i Apolonisë, «B.SH.SH», 3, 1963, f. 151-152. Është për tu vënë në dukje fakti se në Margëlliç kemi njëlloj si në Apoloni një mur me tulla mbi cokolaturën katërkëndëshe izodomike me faqe të sheshta.

66) Shih S. Islami, **Zgërdheshi...** f. 26 dhe fig. 2. N. Ceka, Tipare të kulturës.... f; 150; N. Ceka, Vështrim arkeologjik në rrethin e Elbasanit, «Monumentet», 1971, f. 11.

67) A. Baçe, Vështrim.... f. 104-108.

68) Një fenomen të tillë në veri e ndeshim vetëm në shkëmbin e Shënlliut pranë Elbasanit.

DOKTORY

në dhjetëvjeçarët e fundit të shek IV p.e.sonë[69]). Elemente të shkëputura rreth kësaj date i kemi edhe nga Kanina, ndërsa për në luginën e Drinosit, gërmimet e Jermës kanë treguar se qyteti duhet të jetë krijuar në kalimin nga shek. IV në shek. III p.e.sonë[70]). Pra edhe në këtë pikëpamje shfaqja e katërkëndëshit izodomik me faqe të sheshtë në jug, përbën një dukuri më të vonë.

c) Stili i dytë me të cilin zbatohet muratura katërkëndëshe në territorin amant karakterizohet nga punimi i fryrë i faqes. Ky është i vetmi dallim i tij nga katërkëndëshi me faqe të sheshtë, me të cilin ka të njëllojta veçoritë teknike.

Përhapja e këtij stili është mjaft e kufizuar. Në Mavrovë ai gjendet si një periudhë e plotë ndërtimi, që lidhet me zgjërimin e qytetit. Faqet e gurëve, që janë lënë siç kanë dalë nga gurorja, apo që janë përpunuar pak me çekan, të kujtojnë nga pikëpamja stilistike murin e periudhës së parë në Berat. Në Matohasanaj ky stil përdoret vetëm si rindërtim dhe dallohet për një trajtim të fryrë të faqeve, që është tipik për qendrat epirote[71]).

Pozita kronologjike e këtij stili në territorin amant përcaktohet qartë pas trapezoidal poligonalit. Ka mundësi që ai të jetë përdorur njëkohësisht me muraturën katërkëndëshe izodomike me faqe të sheshtë, veçanërisht në fazën e hershme të saj. Duket se kjo bashkëjetesë ka qenë e shkurtër, siç e dëshmon rindërtimi që është bërë në hyrjen e Beratit, ku ky stil i dytë gjendet mbi të parin[72]).

Në të dy stilet muratura katërkëndëshe izodomike është e lidhur ngushtë me ngritjen e qyteteve Ilire gjatë gjysmës së dytë të shekullit IV dhe në fillim të shek. III p.e.sonë. Kjo nuk është një gjë e rastit, as e nxitur nga kërkesa thjesht estetike. Nga koncepti ndërtimor ky tip murature përfaqëson zejtarizimin e procesit të punës. Pregatitja e formës së gurit sipas vendit që do të zinte në mur bëhej që në gurore, ku blloqet nxirreshin me të njejtën lartësi. Për të dalluar rreshtat, lihej një ndryshim i vogël në lartësinë e blloqeve, ndërsa, për të veçuar bllokun, gjatë një procesi të dytë pune, i jepej njërës faqe anësore të tij një pjerrje e lehtë. Në këtë mënyrë arrihej një proçes i pandërprerë në ndërtimin e murit si dhe një kursim i ndjeshëm i punës dhe i materialit të gurtë.

Në këtë mënyrë evolucioni i teknikave dhe i stilit të ndërtimit në territorin amant ishte në varësi të zhvillimit të brendshëm ekonomik dhe shoqëror. Siç vumë në dukje, uhazimin e teknikave, që u bë në bazë të nevojave të reja të urbanizimit, nga krahinat fqinje ose Apolonia, e pasoi në këtë territor një përpunim i vazhdueshëm, që dha forma, të cilat janë tipike për amantët. Që këtu ato rrezatohen rishtas në krahina të tjera të Ilirisë.

Ky fenomen vihet re edhe në drejtime të tjera të arkitekturës, nga të cilat tipike është shembulli i qemerit dhe i tipit të varrit me paradhomë[73]), që përpunohen në një mënyrë të tillë sa bëhen tipare karakteristike të arkitekturës amante.

PO NOT COPY

69) S. Islami, **Zgërdheshi....** f. 30-31.
70) Dh. Budina, **Antigonea,** Iliria II, f. 319.
71) Mund të sjellim për ngjashmëri murin e portës me kulla në Butrint.
72) A. Baçe, **Berati...** f. 44.
73) Shih artikullin tonë në Nr. 9 të kësaj serie.


APOLLONIA
DIMALI
QYTETI I BERATIT (BARGYLI)
QYTETI I MARGELLICIT
QYTEZA E MBOLANIT
QYTEZA E CIRIT
QYTETI I CAMRANIT
KOINONI I BYLINEVE
BYLIS
QYTEZA E ARMENIT
MANAIA
QYTETI I TREPOLIT (AULONA?)
QYTETI I KANINES (THRONI?)
QYTETI I MAVROVES (OLYMPA)
QYTEZA E HALIVRIT
AIKATERINA
QYTEZA MATOHASANAJT
KOINONI I AMANTEVE
GRIBA
QYTEZA E HORRE (DOKAJ)
POLISI I ORIKUT
QYTEZA E CERRIES
QYTEZA E HIMARES (HIMERA)
PANORMI
QYTEZA E BORSHIT

DO NOT COPY

TAB. II



DO NOT COPY



DO NOT COPY

TAB. IV



DO NOT COPY

DO NOT COPY

Kalaja e HADERAJT

SKICE PLANIMETRIKE



QERAMIKE



HADERAJ



AMANTIA

0 1 2 3 4 CM

TAB. VI



DO NOT COPY

Neritan CEKA

LES CENTRES FORTIFIES DES AMANTINS

RESUME

Le territoire des Amantins a une configuration naturelle parmi les plus claires. Il s'étendait sous forme de parallélogramme entre la Vjose et les Acrocérauniens d'une part et le Golfe de Vlore et les monts de Kurvelesh i sipërm de l'autre. A chacune des petites unités géographiques composant ce territoire correspondait au moins un centre fortifié principal. Dans le coeur même de ce territoire, au-dessus de la zone de collines entre les fleuves Vjose et la Shushice se trouvent la ville des Amantins et une petite forteresse à Haderaj. La partie inférieure de la vallée de Shushice, qui en est aussi la plus fertile, est contrôlée par l'Olympe (Mavrovë) et sa partie supérieure par la Forteresse de Cerje. En direction sud-est, entre le mont Gribe et la Vjose s'étend une petite unité territoriale dominée par la forteresse de Matohasanaj. En direction opposée, la zone de collines entre le golfe de Vlore et le fleuve Shushice avait comme centre principal Kanine. L'escale de Treport desservait tous ces centres fortifiés, reliés entre eux par une organisation politique du type de koïne.

L'extension même de la cité d'Orik dans le territoire amantin contourne un milieu géographique délimité par les monts Acrocérauniens. Le renseignement de Strabon selon lequel Panorme était un port orikien atteste que cette extension dépassait le mont Llogara aux dépens du territoire chaonien. Il est raisonnable de penser que les Amantins se soient assurés un débouché naturel sur la mer Ionienne, par exemple Borsh.

Les fortifications des centres habités amantins, qui seront l'objet de notre communication, présentent un intérêt particulier en ce qu'elles nous permettent de connaître l'évolution de la technique de construction des murs d'enceinte et des voies de propagation du style des murailles. Dans le même temps nous disposons d'un terminus sûr pour déterminer leur chronologie. Il s'agit de la mention d'Amantie par Pseudo-Skylax, dont le Pereplus a été rédigé vers la moitié du IVe siècle av. n. ère.

Nous devons donc trouver à Amantie un mur d'enceinte construit avant cette date.

La fortification de ce centre se caractérise par des murailles trapézoïdales, polygonales et rectangulaires. Bien que chacune d'elles ne représente pas une période de construction particulière, elles constituent dans leur ensemble une unité.

Une observation attentive des points où l'on relève un passage continu de la forme trapézoïdale à celle polygonale, montre que ces deux techniques ont été réalisées pendant la même période de construction. La seule muraille appartenant à une période différente est celle quadrangulaire, qui a servi à la reconstruction de presque toutes les entrées de la ville, ainsi que l'adjonction faite sur le côté oriental. On relève aussi une différentiation dans la nouvelle ligne suivie par le mur aux points A-B et dans le fait que cette ligne chevauche l'ancienne muraille aux divers points.

La muraille trapézoïdale comporte des blocs de dimensions différentes. Les maîtres bâtisseurs ont réussi a les relier par une construction solide, en y employant le système des graduations ou en remplissant les espaces vides par des pierres en forme de pieux. C'est pour cette raison que la ligne horizontale des joints se brise continuellement. La tête des pierres est aplatie et leurs côtés sont légèrement taillées, de manière à mettre en relief les joints.

Les éléments polygonaux sont moins nombreux et on les retrouve généralement au-dessus des parties rocheuses, qui sont taillées en continuation du parement. En ce qui concerne les faces de la façade, elles sont quadrangulaires ou septangulaires, légèrement aplaties et taillées sur les côtés. Quant à leur disposition, elle n'est pas en rangée et la muraille appartient au type de polygone authentique.

Dans les deux cas l'épaisseur du mur est de 2.60 m; elle est remplie de pierres de dimensions moyennes et petites, mais on ne retrouve pas les séparations transversales qui sont typiques à la deuxième période.

En ce qui concerne la planimétrie du mur, il convient de relever qu'il fermait complètement pendant cette période la muraille, en passant aussi au-dessus des roches escarpées. Les couloirs des deux entrées conservées à ce jour sont un résultat du déplacement de la ligne du mur; les tours sont rares, peu développées et remplissent principalement la fonction de contre-forts.

Sous l'aspect typologique, ce mur a son analogue dans les murs de la première période construits à Klos, Matohasanaj et dans celui de l'acropole de Butrint.

Le mur de la deuxième période est construit de pierres d'une même hauteur, extraites en série des carrières existantes. Elles sont de forme quadrangulaire avec une légère déviation des côtés latéraux. La tête des pierres a été aplatie et celles-ci sont légèrement taillées sur les côtés. Le mur repose généralement sur des pierres non équarries, servant de fondements et disposées en rangées parallèles sans graduations.

L'épaisseur du mur est de 2.60 m, celui-ci est remplie de pierres de dimensions moyennes séparées transversalement à chaque 2.60 m par des pierres équarries. Les pierres

DO NOT COPY

de liaison apparaissent clairement sur la façade, elles sont disposées alternativement chaque deux rangées.

Les entrées de la deuxième période sont plus élaborées, mais leur défense est toujours assurée par le mur et elles ne sent pas flanquées par des tours. Dans deux entrées on retrouve pour la première fois un arc surmontant la porte. Les tours sont encore rares et remplissent la fonction de contre-forts,

Sous l'aspect typologique, ce mur trouve son analogue à Byllis, dans le mur de la deuxième période de Klos, à Apollonie et à Vile (Persqop).

Dans le deuxième centre important des Amantins, à Mavrove aussi, l'on relève deux périodes de construction presque semblables à celles d'Amantie du point de vue de la technique, mais se différenciant quant au style des façades. La première, de type trapézoïdal, contourne la colline plus élevée où se dressait au commencement la construction. Il n'y reste qu'une seule tour ayant une façade de 6.60 m. Les blocs de calcaires sont de forme trapézoïdale et ont des têtes non équarries. Leur longueur varie de 0.80 à 1.90 m, tandis que leur hauteur atteint 0,80 m. Les pierres sont disposées en rangées, mais la ligne horizontale des joints est fréquemment brisée par des graduations.

Par suite de l'élargissement du centre habité, on a dû construire plus tard un nouveau mur d'enceinte et l'ancien mur a été relégué à la fonction d'acropole. Actuellement on ne relève que des tronçons de ce mur et l'on n'a pas encore retracé quelque tour ou entrée. Le principal tronçon est long de 30 m et haut de 3 m; il se situe sur le côté sud-ouest. Les blocs en pierres calcaires sont de forme quadrangulaire et les parements légèrement enflés et avec les côtés taillés, de manière à mettre en évidence les joints. Ils ont une disposition isodomique avec une hauteur variant de 0.53 à 0.60 m. Le remplissage avec des pierres de dimensions moyennes et petites comporte chaque 2.60 m, comme à Amantie, des murs de refend dont les pierres de liaison apparaissent régulièrement sur la façade.

Le mur de la première période se rattache typologiquement au mur de la deuxième période de Butrint (à celui de la porte du lac et de la porte du lion), ainsi qu'au mur plus ancien de Finiq et jusqu'à un certain point à celui de Himare. La deuxième période a de plus grandes analogies avec celle de Berat et jusqu'à un certain point avec la deuxième période de Matohasanaj.

Du nombre des constructions les plus anciennes mises en place dans le territoire amantin, fait part aussi du point de la technique de construction la forteresse de Matohasanaj. A la différence d'Amantie, ici le tracé des murs ne couvre pas les endroits jouissant d'une protection naturelle. Cette construction est dotée d'une seule entrée, qui est le résultat de l'interruption du mur sur un espace de 2.75 m, et une tour ronde d'un diamètre de 7 m. Ce mur comme la tour appartiennent à la deuxième période de construction qui ressemble fort à celle d'Amantie, en raison de la combinaison de la technique trapézoïdale avec celle polygonale. La différence consiste dans l'aspect ruvide de la façade, du fait que les têtes des pierres ne sont pas équarries et le remplissage du mur est séparé transversalement. Ces séparations sont disposées à chaque 3 m, mais on ne distingue pas régulièrement les pierres de liaison.

A Matohasanaj aussi la deuxième période de construction se caractérise par une muraille quadrangulaire, affectant seulement en partie le système de la fortification. Le tronçon du côté sud-est, conservé sur une longueur de 14 m, présente au-dessus de la construction de la première période des blocs quadrangulaires de pierres calcaires, dont les côtés latéraux sont légèrement inclinés. Les parements non équarris apparaissent enflés au-dessus des joints. Les rangées en disposition isodomique sont moins épaisses, du fait que telle est l'épaisseur des couches de pierres extraites. Le mur est séparé en largeur à chaque 2.90 m par des murs transversaux, dont les pierres de liaison apparaissent régulièrement sur la façade. Au cours de cette même période ont été construits deux tours quadrangulaires. La première, d'une dimension 6.60 x x 7.55 m, surmonte l'ancienne entrée et comporte une deuxième porte sur son côté. N.-E., Les blocs sont travaillés de la même manière que ceux du mur, à la seule différence que la hauteur des rangées varie de 0.52 à 0.64 m.

Se différenciant du mur analogue de Mavrove quant au traitement plus enflé des parements, la deuxième période de Matohasanaj ressemble surtout au mur de la porte flanquée de tours de Butrint.

Le dernier exemple de muraille trapézoïdale dans les centres examinés nous le retrouvons à Borsh, dans une phase plus avancée technique. Le mur d'enceinte conserve ici presque toute sa longueur et contourne un territoire plus vaste que celui de la forteresse moyenâgeuse. On y relève une entrée sur son côté oriental et une tour quadrangulaire sur son côté N.-E. Sur un tronçon conservé en direction sud on distingue bien la technique de construction avec des blocs trapézoïdaux et quadrangulaires ayant leurs parements enflés; on relève aussi des blocs polygonaux, qui donnent l'impression que ce mur ressemble à celui de Çuke (Ajtoj), du fait qu'ils en commun même la brisure des rangées et le remplissage par des pieux de la façade. Toutefois cette muraille se distingue des murs trapézoïdaux du territoire amantin par la présence des séparations transversales à chaque 2.60 m sur la largeur du mur, ayant des pierres de liaison qui apparaissent régulièrement sur la façade, ainsi que par le traitement pseudo-isodomique des rangées.

En ce qui concerne les autres centres amantins, nous ne connaissons à ce jour qu'une seule période de construction réalisée par la technique quadrangulaire et cela à Cerje, Kanine et Dukaj.

Dans la citadelle de Cerje les murs anciens contournent un périmètre de 2 ha, avec une planimétrie quadrangulaire, et ils sont ouverts en direction sud, du fait qu'ici la défense du territoire est assurée par la nature escarpée du terrain. On y relève une entrée flanquée d'une tour à l'angle. N.-O

DO NOT COPY

et une autre de construction plus simple sur le côté opposé. Les autres angles aussi sont flanquées d'une tour, mais une quatrième tour se dresse au milieu du côté occidental.

Tout le mur représente une seule période de construction. Les blocs de forme quadrangulaire ont les parements aplatis et les côtés légèrement équarris. Ils sont placés en rangées isodomiques sur une hauteur de 0.63 m. En ce qui concerne la façade, à chaque 2.60 m on relève les pierres de liaison et les séparations transversales.

Le même style caractérise l'ancien pont de Shushice aménagé en direction de l'entrée I de la Cité. Il n'en reste à présent que deux colonnes qui supportaient le tablier en bois.

Du point de vue de sa planimétrie et de sa muraille, la citadelle de Cerje représente la période du plein développement du style quadrangulaire isodomique et se rapproche des murs d'enceinte de Kanine et du système de fortifications de la vallée de Drinos.

Les fortifications de Kanine, dont nous disposons de la céramique du IVe siècle av. n.è., n'ont pas encore fait l'objet d'études approfondies. Des traces particulières indiquent que le tracé des murs moyenâgeux repose en général sur les fondements anciens. Les tronçons anciens de ce mur appartiennent à une seule période de construction, réalisée avec des blocs quadrangulaires se caractérisant par une légère déviation des côtés latéraux. Les faces des blocs sont aplaties et leurs côtés coupés. En ce qui concerne leur hauteur, y compris la hauteur des blocs qui ont été employés de nouveau, elle varie de 0.45 à 0.54 cm ce qui témoigne un traitement isodomique. La largeur de ce mur se caractérise aussi par des parois transversales.

Si nous avons traité plus à long les fortifications d'Amantie, de Mavrove, Matohasanaj, Borsh et de Cerje, cela est dû au fait que les autres fortifications d'Amantie nous offre des données beaucoup plus limitées. Le système de fortifications de Treport et d'Armen nous est inconnu pour le moment, tandis que celui de Dukaj n'est qu'un répétition de la muraille quadrangulaire. La cité de Haderaj, par ailleurs, se caractérisant par une muraille quadrangulaire de faible réalisation, ne peut nous donner aucune aide en regard de la typologie.

Maintenant nous en mesure de tirer les conséquences de nos observations relatives aux fortifications d'Amantie. En premier lieu il importe de relever que la mise en oeuvre de ces fortifications est en fonction du développement économique de chacun de ces centres. Et cela est d'autant plus vrai pour les agglomérations urbaines du type de polis, comme c'est le cas d'Amantie, de Treport, Mavrove et Kanine, où l'on retrouve les systèmes de fortifications les plus perfectionnés. La mise en place des fortifications dans les autres centres, comme par exemple à Matohasanaj, Dukaj, Haderaj, Cerje ou Borsh, s'explique aussi plus ou moins par le rôle qu'elles exerçaient dans le système général défensif du territoire amantin. Il convient de relever que les forteresses les plus puissantes se dressent en direction des frontières avec l'Epire, qui, particulièrement durant le IVe siècle et au début du IIIe, était un voisin agressif. Les fortifications s'étendant le long du fleuve Vjose sont représentées, par contre, par des forteresses moins puissantes. Ce qui est dû vraisemblablement au fait que la koine des habitants de Bylis représentait un voisin pacifique.

Parallèlement à la création des agglomérations urbaines et des fortifications respectives se développe aussi la technique de construction. Dans le territoire amantin ce processus s'est développé sur deux lignes: la trapézoïdale et la polygonale. Bien que leurs débuts ne correspondent pas dans le temps, plus tard elles ont connu même des périodes de développement parallèle.

Amantie nous offre les arguments nécessaires pour accorder la priorité chronologique à la muraille trapézoïdale. Le terminus de Pseudo-Skylax fixé à la moitié du IVe siècle correspond à la technique de construction encore de conception primitive.

Les pierres sont extraites de manière extensive, en cassant les roches superficielles irrégulièrement, ce qui détermine aussi le traitement polygonal de certains tronçons. La création de groupes de spécialistes dans la taille des pierres dans ce centre urbain a permis dans le même temps le passage à une exploitation intensive de la pierre à travers les carrières. Les blocs extratis sur une surface le plus large possible de la largeur des couches sont de forme trapézoïdale et quadrangulaire; ils ont une hauteur variable. Et cela pour la simple raison qu'on n'avait pas encore adopté dans la construction des ouvrages la conception de la rangée de pierres d'une même dimension, en conséquence les blocs étaient relies entre eux par de fréquentes graduations et des remplissages. La structure du mur aussi dénote un manque de liaison organique entre les parois et le remplissage, aussi a-t-on ressenti le besoin de renforcer la stabilité des courtines à travers des tournants de 90° ou par de rares saillies sous forme de tours. Il s'agit là aussi d'un des éléments le plus avancé dans l'évolution de la planimétrie, qui sans cela se présente assez simple.

Dans la classification connue des murailles, ce mode de construction appartient au trapézoïdal irrégulier. Chez nous toutefois ce mode de construction se distingue par des propriétés particulières comme le sont la combinaison avec des tronçons polygonaux et son évolution interne. Dans les cas les plus anciens, à Amantie et à Butrint, nous relevons un traitement aplati des parements et le manque des séparations transversales, qui font leur apparition plus tard à Matohasanaj et à Klos parallèlement au traitement ruvide des parements. La diffusion limitée de cette technique de construction se rattache principalement à la courte durée de son emploi, vraisemblablement vers la fin du Ve siècle et la moitié du IVe av.n.è. L'introduction de la nouvelle conception de construction fondée sur la rangée, qui unit en un tout le processus d'extraction de la pierre et de son emploi dans le mur, lanca la nouvelle mode trapézoidale que l'on retrouve à Mavrove.

DO NOT COPY

Ici la forme trapézoïdale de la pierre, depuis son extraction, est en fonction de la rangée, sans pour autant atteindre la standardisation. Ainsi les lignes horizontales des rangées ne sont pas toujours parallèles, mais souvent brisées. Le traitement même de la face externe de la pierre est toujours ruvide, du fait que celle-ci conserve le parement qu'elle avait au moment même de son extraction ou en raison de son traitement avec le marteau.

La diffusion de ce style, que nous appellerons trapézoïdal à rangées brisées, à du se déplacer du sud vers le nord.

On distingue deux phases dans le développement de ce style. La première est représentée par Mavrove, Butrint, Finiq et Dorëz II, en tant que période de construction ayant précédée le mur qadrangulaire; elle se caractérise par la hauteur presque égale des rangées (près de 0,80 m) et par une planimétrie relativement simple (particulièrement les entrées qui ne sont pas flanquées de tours). La période d'application de ce style comprend, ce qu'il paraît, la moitié du IVe siècle avant notre ère.

Durant la deuxième phase, exemple Borsh, les rangées ont des hauteurs différentes; on dénote une tendance aux graduations fréquentes et à l'emploi des formes polygonales. La planimétrie se complique par un usage fréquent des tours, surtout à proximité des entrées. Ce type, qui fait part de la muraille trapézoïdale pseudoisodomique, concerne principalement l'Epire et, après une brève interruption entre le fleuve Vjose et Mat, il réapparaît dans une série de centres habités deupis Lis à Oshanic. A ce qu'il paraît le mur même qui le représente ici, moenia aeacia, se rattache à l'origine épirote de ce style.

Au cours de cette deuxième phase, qui date le passage du IVe siècle au IIIe av.n.è., le mur trapézoïdal est employé parallèlement au mur quadrangulaire.

En ce qui concerne la muraille quadrangulaire, on la retrouve dans le territoire amantin sous la seule forme isodomique.

A Amantie elle se caractérise par le traitement aplati du parement et par une planimétrie simple: des tours rares, des entrées ayant un couloir parallèle au mur et non protégées par des tours. En ce qui concerne la planimétrie, on relève aussi une phase plus évoluée de ce style, qui coïncide à la dernière période du IVe siècle, alors que l'application de moyens nouveaux dans la protection des cités avec des murs d'enceinte rend nécessaire l'augmentation du nombre des tours et leur disposition auprès des entrées.

Au cours de sa première phase ce style connaît une diffusion limitée entre l'Erzen et la Vjose (Persqop, Margelliç, Apollonie, Bylis, Klos, Amantie), et il se peut fort bien qu'il soit d'origine apolloniate.

Dans la deuxième phase il s'étend sur le même territoire (Zgerdhesh, Dorez, Kanine, Cerje) et trouve une nouvelle zone d'extension dans la vallée de Drinos. Ici il se caractérise par sa combinaison avec le polygonal aux faces enflées et par l'emploi du module de 1 1/2 pied (0,45 cm) quant à la hauteur de la rangée au lieu du module de 2 pieds (près de 0.60 m) en usage dans la partie septentrionale.

Le deuxième style caractérisant le mur quadrangulaire dans le territoire amantin se distingue par le traitement enflé des faces. Du point de vue des particularités techniques, il est identique à l'autre variante du quadrangulaire aux faces aplaties et il est difficile d'établir une distinction chronologique entre ces deux styles.

La diffusion de ce style est plutôt limitée. Outre Mavrove et Matohasanaj, nous le retrouvons à Berat; tandis qu'en direction sud on relève des parallélismes dans la zone des Chaoniens, mais en aucun cas en tant que période de construction complète. Il est probable que sa présence dans le territoire amantin soit le résultat d'une évolution directe du mur trapézoïdal, dont il conserve aussi le traitement ruvide de la face.

Les données stratigraphiques indiquent comme période de construction du mur quadrangulaire isodomique la deuxième moitié du IVe siècle av.n.è. Et ce n'est pas un fait du hasard si ce type de mur se rattache à la fondation des cités illyriennes pendant cette période. Du point de vue de la conception de construction, il représente le caractère artisanal du travail de la pierre à travers sa taille en blocs dans la carrière même. Ainsi, les blocs de dimensions standardisées ont toutes leurs faces équarris. Mais cela ne signifie en aucune manière que la pierre peut être placée en n'importe quelle place, au contraire elle en à une bien déterminée dans une des rangées qui se distingue par une petite différence de quelque centimètre et dans la rangée même par l'inclination légère de ses côtés.

Si nous nous sommes arrêtés un peu plus à long sur l'aspect technique du problème, c'est que nous avons voulu souligner le fait que la modification des styles de construction examinés dans le territoire amantin est une conséquence directe de son progrès économique, du développement des forces productives qui y opéraient. Evidemment d'autres facteurs aussi ont exercé une influence importante en ce sens, entre autres l'emprunt de techniques de construction des cités voisines, que nous avons relevé dans des cas particuliers. Toutefois, il est indéniable que le territoire amantin a rempli, dans l'Illyrie méridionale, le rôle d'un promoteur dans le domaine des fortifications et de l'architecture en général, et cela du fait que les plus anciens styles de construction rencontrés en cette contrée coïncident aussi avec la priorité chronologique de la forme architectonique de l'arc et de la voûte.

Pour des raisons de confrontation nous avons examiné aussi d'autres fortifications illyriennes et épirotes, mais cela ne nous a pas permis de créer un système typologique et chronologique pour toutes les murailles anciennes de ce pays. L'exemple même examiné comporte tout au plus une certaine valeur pour des territoires limités, mais il nous permettra à l'avenir d'atteindre l'objectif fixé à partir d'études typologiques plus profondes fondées sur des données stratégiques exactes.

Doniconi

Stilian ADHAMI

DO NOT COPY

NJË MONUMENT ME VLERË I SHEKULLIT XVII NË VOSKOPOJË*)

Nga qyteti mesjetar i Voskopojës, që në sajë të një sërë faktorësh me karakter ekonomik dhe politiko-shoqëror arriti kulmin e zhvillimit të tij ekonomik e kulturor në gjysmën e parë të shek. XVIII, trashëgojmë mjaft monumente që i përkasin periudhës së lulëzimit të gjithanshëm të tij. I vetmi monument, që ka arritur deri në ditët tona nga shek. XVII, domethënë nga periudha kur fshati i Voskopojës ishte në kapërcyell të rritjes së tij për të marrë fizionominë e një qendre jo të papërfillshme zejtaro-tregtare, është kisha e manastirit të shën Prodhromit[1]). (fig. 1-2).

Ky manastir gjendet nga ana veriore e Voskopojës, në një largësi rreth dy km tej kodrave të kishës së Shënepremtes, më e hershmja e kësaj qendre mesjetare. Pozita natyrore e këndshme që është zgjedhur për ndërtimin e këtij manastiri, në një lartësi 1279 m në mes të borigave e blerimeve dhe ujërave të rrjedhshme, mbrojtur nga erërat dëmtuese, lejon soditjen e një panorame të rrallë. Horizonti i gjerë, që shtrihet nga ana jugore dhe që përvijon larg drejt kodrave e vargmaleve të mbushura me bimësi, arrin deri në Lenie, Ostrovicë dhe majat e Tomorit.

TË DHËNA HISTORIKE PËR MANASTIRIN

Mbi rrethanat, në të cilat u hodhën themelet e para dhe kohën e ndërtimit të këtij manastiri (fig. 3) si dhe pikturimit të kishës së tij, ka të dhëna dokumentare, që përkojnë midis tyre. Së pari, flet mbishkrimi i gdhendur mbi mermer në faqen e brendshme të derës së kishës, sipas të cilit punimet e ndërtimit të kishës kanë filluar në vitin 1632, kurse pikturimi i saj ka përfunduar në vitin 1659, domethënë 27 vjet pas hedhjes së themeleve[2]). Punimet e ndërtimit të kishës duhet të kenë vazhduar dy vjet. Kjo del nga burimi i dytë, siç është kronika e nxjerrë prej një kodiku të vjetër të këtij manastiri[3]), sipas të cilit ndërtimi i kishës ka marrë fund

*) Rilevimet janë të B. Strazimirit, aksonometria e K. Zhekut, fotot të H. Çollakut, skicat të F. Guralumit.

1) Fjala «prodhromos» (greqisht) do të thotë «pararendësi».

2) Ja përmbajtja e mbishkrimit: «U rindërtua ky tempull nën kujdestarinë dhe shpenzimet e **z. Gjergj Guco në vitin 7140** (llogaritet sipas kalendarit fetar që nga krijimi i botës, barazi me vitin 1632 — S. A.). **U pikturua ky tempull.... me ndihmën dhe mundimin e z. Andon Murg dhe shpenzimet e z. Mihal në vitin 1659.** (Megjithëse flitet për rindërtim, fjala duhet të jetë për hedhjen e themeleve). Krahaso për këtë: **«Alithia»,** Thesaloniqis 5 gusht 1904 dhe 28 korrik 1905; K. Skënderi, **Historia e Voskopojës së vjetër dhe të re,** Athinë 1928, f. 52-53, E. Kurilla, **Voskopoja dhe Akademia e saj e re,** f. 23.

3) Nga hyrja e kodikut të shën Prodhromit marrim vesh se në v. 1779, sipas tregimeve të më të vjetërve, Mihali i Gorës mblodhi me durim të madh shumë nga gojëdhënat e pleqve dhe nga katastiku i vjetër dhe të shkruara të tjera hartoi historinë e ndërtimit të manastirit dhe e parashtroi këtë histori në këtë kodik (**Martianiani, Symbolaieis, tin istoria tis Moshopoleos....,** Athinë 1939, f. 23-31). Lidhur me kodikun, në një

në vitin 1634[4]). Meqenëse shënimi nga kodiku jep datë themelimi vitin 1634, kurse mbishkrimi, edhe pse sqarues, por jo dhe pa të meta, jep vitin 1632, E. Kurilla[5]) jep këtë shënim: **«Sigurisht ndodhi gabim ose në kopjim ose tipografik, sepse nuk pajtohet me sa thotë botuesi më poshtë, i cili nuk pa fare kontradiktën».** Sipas mendimit tonë mundësitë janë që njëri të flasë për hedhjen e themeleve dhe tjetri për përfundimin e punimeve. Në një gojëdhënë korçare bëhet fjalë se manastiri i shën Prodhromit ka qenë një ndërtim i vogël më i vjetër i ngritur nga murgj voskopojarë, boboshtarë e mborjarë[6]).

Rrënojat e ndërtimeve të dikurshme rreth kishës lënë të kuptohet se ç'qendër e madhe ka qenë ky manastir, i cili lidhej me qytetin me rrugë kalldrëmi, që aty-këtu ruhet pjesërisht[7]). Manastiri ka qenë një godinë e madhe dykatëshe, me dhjetëra konakë, në trajtën e shkronjës L. Pranë manastirit dikur ka qenë edhe një kishëzë (paraklis) me emrin e Trearkondëve, por që e lënë me kohë pas dore është kthyer në gërmadhë[8]).

Siç del nga të dhënat e kodikut dhe burime të tjera (Vaigandi, Martiniani, Kurilla, Qafëzezi) ky ansambël monumental u rrit nga një faltore e vogël private, që ka qenë fillimisht[9]). Ndërmejt të tjerëve, në qytet si ktitorë fillestarë të dëgjuar për ndërtimin e këtij manastiri përmenden Andon Shipckjoti dhe Gjergj Guco e Mihal Milingjeri.

Nga kodiku mësojmë gjithashtu se Partheni (1765-1783), krahas rikopjimit dhe plotësimit të kodikut, bëri njëkohësisht meremetime dhe shtesa në ndërtesat e manastirit[10]). Shtesa u janë bërë konakëve të manastirit edhe në vitin 1910. Nga përshkrimet që kemi, para Luftës së Dytë Botërore numri i dhomave të manastirit arrinte në dyzet.

Pjesërisht konakët e manastirit ishin djegur në vitin 1937, (fig. 4) por qenë rindërtuar qysh para çlirimit.

Në kishën e këtij manastiri ruheshin botime, dorëshkrime dhe objekte të tjera me vlerë, që fatkeqësisht u zhdukën e u dëmtuan nga shkatërrimet e pësuara gjatë luftërave të fundit. Për shkak se ky manastir ka qenë një bazë e rëndësishme e Luftës antifashiste Nacionalçlirimtare dhe spital partizan, në qershor të vitit 1943 manastiri dhe pjesërisht kisha, pasi u bombarduan së pari me artileri, u dogjën nga bombardimet ajrore të pushtuesve fashistë, kështu që konakët e sotëm dykatësh të manastirit mbajnë vulën e pasçlirimit. Nga djegiet e atij viti, si pasojë e zjarreve të shumta që pushtuesit e huaj i vunë qytetit-gërmadhë, te ky monument kemi pasur humbje të pazëvendësueshme, duke ngelur vetëm kisha karabina. Përveç zhdukjes edhe të punimeve artistike në ikonografi, dru etj. u dogjën këtu edhe të gjithë ata kodikë të vjetër me vlerë historike, që ruheshin këtu prej shekujsh, midis të cilëve, edhe kodiku i madh i Mihalit të Gorës.

---

botim të vitit 1914 (Wace, A. J. B. and Thompson, M. S., **The nomads of the Balkans,** London 1914; f. 215) jepen këto sqarime; «Në manastir gjëndet një libër historik shënimesh, i quajtur nga vendësit kodik. Ai ka qenë filluar në v. 1772, është shkruar prej së njëjtës dorë, e cila referon mbi ngjarjet e ndryshme shkatërruese të ndodhura në krejt Rumelinë qysh nga v. 1631 e gjer më 1754».

4) Në kodikun pa mbishkrim figuron kjo kronikë e nxjerrë nga një fletë kodiku e çjerur: **«U themelua në vitin 1634** (αχΛδ) **14 korrik ditën e premte. Ktitori i parë ka qenë murgu Andon dhe ndihmoi Guco dhe Milingjeri».** (shih Martiniani, **Symbolai...** f. 124; në këtë botim është trajtuar gjerë historiku dhe përmbajtja e kodikut të shën Prodhromit, kodik që ka qenë parë edhe nga G. Vaigandi në v. 1889).

5) E. Kurilla, **Voskopoja dhe Akademia e saj e re,** f. 30.

6) Nga autori N. Mistakidi mësojmë këtë gojëdhënë të vjetër mbi themelimin e këtij manastiri: **«Themelitë e manastirit të Prodhromit u patën shtirë nga disa murgj voskopojarë, boboshtarë dhe mborjarë, që quheshin prodhromitë, të cilët janë varrosur në avllitë e këtij manastiri»** (K. Skënderi, **Historia e Voskopojës së vjetër dhe të re,** botim i dytë, Athinë 1928, f. 54).

7) Në kodik shënohet se më 1763 u rindërtua kalldrëmi nga lëmi i manastirit të shën Prodhromit deri te kisha e Shënepremtes (K. Skënderi, **Historia.....** f. 53, Martiniani, **Symbolai....** f. 128).

8) Në afërsi të hyrjes së manastirit, rreth 20-30 m nga ana perëndimore, mbi çesmën e sotme, ka ekzistuar edhe një konak, që në kohën e luftërave për liri e pavarësi përdorej prej çetave të komitëve dhe mbante emrin «Konaku i Shahin Matrakut», shkatërruar gjatë Luftës së Dytë Botërore.

9) Në një shënim që na ka lënë Vaigandi lexojmë: **«Në dhomën e murgut gjeta edhe një punim gdhendjeje në dru shumë interesant. Kuadri është punuar nga Theodhor Sina Krudi... djathtas shihet Voskopoja, qyteti, tre përrenjtë dhe tri ura mbi të: për në Korçë, për në manastirin në shën Prodhrom dhe e treta për në Shipckë».** (G. Veigand. **Die Aromenen.** Ethnogr. Phililog. Hist. Untersuchungen. Leipzig. 1894-1895. **v. I,** f. 102-104, vizita më 3 shtator 1889).

10) Martiniani, **Symbolai....** f. 68.

ZOKTOOPY

ARKITEKTURA E KISHËS

Ndryshe nga kishat e tjera të Voskopojës, të tipit bazilikal, kisha e manastirit të shën Prodhromit dallohet në arkitekturë si tip tjetër në konceptimin e hapësirës së brendshme, duke qenë kishë e stilit bizantin në formë kryqi, e përbërë nga narteksi i thjeshtë, katolikoni në trajtë qemerësh me ndricim të pamjaftueshëm me kube në gjysmë rrethi, nga absida në formë kamare shumë harmonike. Ajo ka një organizim planimetrik e vëllimor më të zhvilluar se kishat e tjera të kësaj kategorie. Në të kemi një hapësirë përpara absidës, që krijohet nga vendosja e dy pilastrave suplementare.

Kisha është trekonkëshe me kupolë mbi tambur dhe me qemere e kalota sferike mbështetur mbi dy pilastra të lirë dhe katër shtylla, tip trenefshe, me përmasa që përkapin 10.65 m x 6,45 m, ndërsa lartësia e nefit qendror arrin 9,30 m.



KISHA E MANASTIRIT TE SHEN PRODHROMIT

Fig. 1





Fig. 2

DO NOT COPY



Fig. 3

Nga një kalkografi e shek. XVIII[11]) ku figuron manastiri me gjithë kishën, vrojtojmë se kisha ka qenë e pajisur me dy kupola me tambur poligonal (6-faqëshe) me nga tri dritare të ngushta në çdo faqe. Me kalimin e kohës, siç duket, dy kupolat janë degraduar e rrëzuar dhe në vendin e tyre sot ka vetëm një, që është rindërtim i vonshëm me tambur po gjashtëfaqësh, por vetëm me 4 dritare gjithsejt.

Muret e anëve veriore, perëndimore e jugore të narteksit (fig. 5) përmasat e të cilit arrijnë 6,45 m x x 5,60 m janë rindërtuar sërish, kështu që prej narteksit të njëkohshëm me ndërtesën fillestare të kishës sot qëndron vetëm muri lindor.

Në ndryshim me kishat e tjera, që në shumicën e rasteve kanë hyrje si nga ana jugore e naosit ashtu edhe nga ana perëndimore e narteksit, në kishën që ne kemi në shqyrtim hyrja e vetme është ajo e narteksit, nga dera e brendshme e të cilit



Fig. 4

11) Këtë kalkografi e kemi botuar në art. **«Të dhëna rreth fizionomisë urbanistike dhe arkitektonike të qytetit mesjetar të Voskopojës»** («Monumentet» Nr. 3-1972. f. 108).

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6

kalohet në naosin e kishës. Në të dy krahët e portës kryesore ka nga një dritare me hark. Të njëjtat përmasa e trajtë ka edhe një dritare tjetër nga ana jugore e narteksit.

Absida është pesëfaqëshe dhe ndriçohet nga një dritare e vogël, kurse dy të tjera anash në faqen lindore të murit të kishës plotësojnë deri diku ndriçimin e protezisit dhe diakonikonit. Me nga një dritare janë pajisur edhe dy konkat anësore.

Nga ana jugore e kishës, për mbrojtjen e së cilës janë vendosur dy kundërforca (fig. 6) në të dy krahët e konkës, janë çelur vonë dy dritare të reja për të përmirësuar ndriçimin e pamjaftueshme të saj. Në pandativat e kishës janë vendosur 12 enë boshe nga 3 në secilën, që me brimat e tyre ato dalin në interierin e kishës. Këto enë vendoseshin në kupolat e kishave për akustikë dhe për të lehtësuar peshën[12]).

I tërë ansambli i manastirit nga ana jugore dominohet nga një kumbanore e madhe katrore në hyrje (fig. 7), e cila ka pësuar cungime e deformime. Përmes portës së hyrjes, ndën kumbanore, me një kalim të harkuar, dilet në oborrin e manastirit, përballë të cilit (brenda mureve rrethuese) ndodhet kisha.

Në vitin 1955 në këtë monument me vlerë janë kryer disa punime konservimi e konsolidimi, në saje të të cilave kisha u shpëtua nga rreziku i shembjes[13]). Të kësaj kohe janë dhe dy kundërforcat që përmendëm më sipër.



Fig. 7

12) V. Puzanova, **Voskopoja, Onufri nga Neokastra, Shpati dhe Berati,** drsh. në Institutin e Historisë, G. I. 10 f. 8.

13) **«Disa rezultate nga puna e sektorit të arteve të mësjetës dhe arkitekturës gjatë vitit 1955»** në Bul. Shk. Shoq.

DO NOT COPY



Fig. 8

PIKTURA DHE PUNIME TË TJERA ARTISTIKE

Krejt monumenti është i mbuluar me afreska, nga të cilat ruhen në gjendjen fillestare të padëmtuara vetëm ato të faqes lindore të narteksit të vjetër (fig. 8).

Eksplozionet e forta nga zjarri i vitit 1943 shkaktuan plasje të mëdha në kube të kishës dhe në murin jugor të saj, duke dëmtuar rëndë pikturat e naosit dhe të zonës së absidës, të cilat sot paraqiten të çngjyrosura (fig. 9, 10). Këto piktura kanë pësuar një proces transformimi për shkak të djegies, që ka sjellë zhdukjen e pelikulit të ngjyrave, duke lënë të dukshëm krejt vizatimin si dhe intonacionin e ngjyrave bazë gati në monokrom në kafe dhe në disa vende në intonacione blu.

Piktura e faqes lindore të narteksit, i cili nuk mori zjarr, ruan pak a shumë konfiguracionin e mbulesës së vjetër të narteksit dhe përbëhet nga dy skena gati të plota në të dy anët sipër derës së hyrjes që të çon në naos, si dhe nga disa portrete më këmbë dhe në medalione. Dy nike në të dy krahët e derës janë gjithashtu të pikturuara. Këto piktura i përkasin shekullit XVII dhe janë të një niveli artistik të mirë, që dëshmojnë se kisha ka qenë e pikturuar nga mjeshtër të sprovuar.

Mjeshtri freskograf zotëron mirë tematikën si edhe mjeshtërinë e pikturimit, figurat janë të vizatuara ngurtësisht simbas traditës, duke vënë re dhe



Fig. 9



Fig. 10

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12



Fig. 13

një farë karakteri skematik në trajtimin e tyre. Ngjyrat në pjesët e pikturës së padëmtuar janë të fuqishme, e kuqja dhe e zeza janë kryesisht ngjyra që mbizotërojnë. Piktura është e mbuluar nga një shtresë verniku dhe është bërë vetëm një tentativë e vogël pastrimi në figurën e një engjëlli në nikën e krahut të majtë të narteksit. Brezi i poshtëm i narteksit, pikërisht nděn pikturat murale, përshkohet nga një dekoracion me një sërë motivesh, që përmbajnë kryesisht figura bimore e shtazore si shpendë, grifone e të tjera figura mitologjike të trajtuara në formën e një motivi dekorativ të përsëritur, që të kujton gërshetime stilesh të ndryshme dhe karakterin e motiveve të përdorura për zbukurimin e ikonostaseve të gdhendura në dru dhe nëpër drapëri (fig. 11). Përdorimi i një motivi të tillë, me sa dimë, është një rast shumë i rrallë që ndeshet në pikturën murale të kishave tona.

Për të përcaktuar autorin e pikturimit të kësaj kishe, duhet të shërbehemi nga shqyrtimi kritik i dy dokumenteve historike: dokumenti mbishkrimor mbi pllakën e murosur në arkitrarin e derës së kishës dhe te kodiku i botuar nga Martiniani. Prej këtij të fundit (**Symbolai....** f. 124) nxjerrim vetëm se **«Ktitori i parë ka qenë murgu Andon dhe ndihmoi Guco dhe Milingjeri»**. Duke e krahasuar këtë me përmbajtjen e mbishkrimit, të bie në sy menjëherë kontradikta. Sipas mbishkrimit ktitor del Gjergj Guco dhe jo murgu Andon. Kjo duhet të jetë më e besueshme dhe mund të nxirret si përfundim edhe nga vetë zbërthimi i

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 15

shkrimit të kodikut, sipas të cilit Guco vihet në rolin e atij që ka ndihmuar (sigurisht nga ana materiale). Për sa i përket pikturimit të kishës, mbishkrimi na duket se është më i qartë: «U pikturua ky tempull..... me ndihmën **dhe mundimin** (nënvizimi ynë) e z. Andon Murg...». Më tutje mbishkrimi sqaron për njerëzit që kanë përballuar shpenzimet e pikturimit, kështu që përfundimi që nxjerrim ne është se pikturat e kësaj kishe janë vepër e murgut Andon Shipckjoti nga fshati më i afërt i Voskopojës, Shipcka. Origjinën e tij e marrim vesh nga hyrja e kodikut të shën Prodhromit[14]), ku murgu Andon Shipckjoti përmendet ndër tre ktitorët më të dëgjuar për ndërtimin e këtij manastiri. Edhe në ndonjë shkrim të mëvonshëm lexojmë se stolisja me kujdes e kishës me piktura ka qenë vepër e murgjve të atëhershëm të këtij manastiri.

Në përshkrimet që na jepen nga vizitorë para djegies së vitit 1943 flitet për pajisje të brendshme të kishës mjaft të pasura në ikona e piktura murale, punime të skalitura në dru, kandelabra (shandanë) gjigande e llampa të varura, gjë që pasqyron edhe dashurinë e voskopojarëve për artin, gjendjen e tyre të pasur ekonomike dhe qytetërimin që ata kishin arritur. Ikonostasi (fig. 12, 13, 14) dhe froni i dhespotit, në të cilët janë ekzekutuar me mjeshtëri punime të gdhendura në dru me teknikën e tejshpimit, me motive bimore dhe shtazore, janë sjellë këtu pas çlirimit nga kisha e Shënepremtes[15]). Megjithatë ruhet këtu edhe një pjesë e anës së sipërme të ikonostasit të vjetër (fig. 15) të vetë kësaj kishe, ngelur nga djegia e vitit 1943, nga e cila mund të vërehet niveli artistik i punimit të tij, objekt i gdhendur mjeshtërisht në dru, me figura bimore e shtazore të trajtuara bukur.

* * *

Kisha e manastirit të shën Prodhromit është një monument i rëndësishëm jo vetëm për vlerën historike që ka si ndërtim i vetëm i shek. XVII që ruajmë nga ky qytet mesjetar. Ajo dallohet edhe për sa u përket elementeve dhe trajtimit arkitektonik si kishë trekonkëshe e stilit bizantin në formë kryqi dhe si e tillë zë një vend të posaçëm në monumentet e kësaj kategorie në mbarë vendin. Jo më pak të rëndësishme janë edhe vlerat artistike, që me gjithë rrebeshet e kohës, kanë mundur të ruhen në këtë monument, veçanërisht pikturat murale që janë vepra të bukura të një artisti vendës.

14) Martiniani, **Symbolai...** f. 23-31.

15) Në këtë kishë, duke përfshirë dhe ikonostasin, sot ndodhen dhe 23 ikona me përmasa të ndryshme që luhatin nga 20 x 15 deri në 100 x 57, që sigurisht janë sjellë nga kisha të tjera të rrëzuara apo të djegura të Voskopojës.



PREMJE GJATESORE



PREMJE TERTHORE



PAMJE NGA LINDJA

DO NOT COPY

DO NOT COPY



AKSONOMETRI

Stilian ADHAMI

UN MONUMENT DU XVIIe SIECLE A VOSKOPOJE

RESUME

Les monuments que nous avons recueillis de la ville médiévale de Voskopoje appartiennent principalement à la première moitié du XVIIIe siècle, période pendant laquelle celle-ci a connu le maximum de son développement économique et culturel. Le seul monument du XVIIe siècle, conservé à ce jour, correspond à la période pendant laquelle le village de Voskopoje se trouvait à la veille de sa croissance continue pour acquérir avec le temps la physionomie d'un centre artisanal et commercial. Il s'agit précisément du monastère de Shën-Prodhrom, dont le présent article traitera tant sur le plan historique que sur le plan architectonique et artistique.

Après une brève description géographique du milieu environnant le monastère de Shën-Prodhrom, l'auteur relève la position naturelle qui a été choisie pour sa construction. Il s'agit d'une position très favorable: le monastère s'élève sur un terrain protégé de la violence des vents, entouré de sapins et noyé dans la verdure, où jaillissent des eaux cristallines.

En ce qui concerne les circonstances dans lesquelles ont été jetés les fondements de ce monastère et a été réalisée la peinture de son église, il existe des données documentaires qui s'accordent entre elles. Se fondant sur une inscription de l'église, ainsi que sur une chronique tirée d'un ancien codex du monastère, l'auteur a situé la construction de l'église entre les années 1632 et 1634; quant à sa peinture, elle a été achevée en 1659.

Les ruines des anciennes constructions entourant l'église montrent combien grand était autrefois ce monastère (une bâtisse à deux étages, sous forme de la lettre L, et comportant des dizaines de pièces). Parmi les premiers promoteurs de construction figurent, entre autres, Andon Shipckjoti, Gjergj Guco et Mihal Milingjeri.

Il est ensuite question des adjonctions et des réparations effectuées au monastère à des périodes de temps différentes, ainsi que de l'incendie qui a en partie détruit ses dépendances en 1937.

Ayant constitué une importante base militaire de la Lutte antifasciste de libération nationale et servi aussi d'hôpital, en juin 1943 le monastère lui-même et une partie de l'église ont été incendiés par suite des incursions aériennes effectuées par les envahisseurs fascistes. Aussi les habitations actuelles à deux étages attenantes au monastère sont-elles de construction récente postérieure à la Libération. Les dégâts causés en 1943, par suite des incendies provoqués par les envahisseurs étrangers, entraînèrent des destructions analogues à celles que la ville déjà en ruines de Voskopoje avait subi dans le passé. Aussi notre monument a-t-il enregistré des pertes irréparables et son église ne conserve plus que les murs de soutien. Les violentes secousses provoquées par les explosions causèrent de profondes fêlures à la coupole de l'église et endommagèrent les peintures du naos et d'abside, qui ont perdu leur couleur. Outre la disparition de maints travaux artistiques d'ordre iconographique, sur bois, etc., furent brûlés nombre d'anciens codex de valeur historique, conservés au monastère depuis des siècles, entre autres le grand codex de Mihal de Gore aussi.

A la différence des autres églises de type basilical, l'église du monastère de Shën-Prodhrom se distingue sur le plan architectural par la conception de son espace intérieur, du fait qu'elle appartient au type byzantin en forme de croix et comprend un narthex simple, un catholicon en forme de voûte insuffisamment illuminé par de petites coupoles en demi-cercle et une abside en forme de niche très harmonieuse. En ce qui concerne l'organisation de sa planimétrie et de son volume, elle est plus avancée que celle des autres églises de la même catégorie. Elle se distingue par la présence d'un espace devant l'abside, créé par deux pilastres supplémentaires.

L'église en question est à trois conques; elle est du type à coupole surmontant un tambour et à voûtes et calottes sphériques reposant sur deux pilastres libres et quatre colonnes du type à trois nefs de dimensions 10.65 m x 6.45 m., tandis que la nef centrale est haute de 9.30 m.

On ne conserve actuellement que le mur oriental du narthex, dont la construction est contemporaine à celle du premier édifice de l'église.

L'abside est à cinq faces; elle est illuminée par une petite fenêtre, mais deux autres fenêtres aménagées sur le mur oriental de l'église complètent plus ou moins l'illumination du prothésis et du diaconicon.

DO NOT COPY

En 1955, période pendant laquelle ont été effectués des travaux de conservation et de consolidation, on a placé deux contreboutants sur les deux flancs de la conque afin de protéger la partie méridionale de l'église.

En ce qui concerne les peintures de notre monument, qui ne furent pas détruites par le feu et conservées actuellement rien que sur la face orientale du narthex, elles appartiennent au XVIIe siècle et sont d'un niveau artistique élevé, ce qui montre que cette église a été peinte par des maîtres de talent. Outre les portraits grands et petits, quelques-uns encadrés dans des médaillons, comme cela se voit dans les églises du XVIIe-XVIIIe siècles, il y a même une niche peinte sur les deux côtés de la porte du narthex conduisant au naos. La partie inférieure du narthex est traversée de part en part par une bande décorée d'une série de motifs se renouvellant et comportant principalement des figures floréales et animales, ce qu'on rencontre rarement dans les monuments de culte chrétien.

Se fondant sur l'examen critique des documents et des autres sources historiques, l'article fournit des arguments permettant de déterminer l'auteur de la peinture. Il en ressort qu'elle est due au pinceau du moine Andon Shipckjoti, originaire du village de Shipcke situé à proximité de Voskopoje.

Des descriptions faites par des personnes ayant visité ce monument avant qu'il ne fut détruit par le feu en 1943, il ressort que l'église de Shën-Prodhrom était richement dotée d'icones et de peintures murales, de travaux sur bois, de candélabres géants et de lampes suspendues, ce qui témoigne du grand amour voué à l'art par les habitants de Voskopoje, de leurs conditions économiques aisées et du haut degré de civilisation atteint par cette ville.

L'iconostase et le siège du prêtre représentent entre autres des travaux sur bois exécutés avec art et selon la technique du perforation; ils sont agrémentés de motifs floréaux et animaux et ont été ramenés ici après la Libération de l'église de Shën-Premte, considérée comme l'une des plus anciennes de Voskopoje. Tout de même on peut voir encore sur place une partie du côté supérieur de l'ancienne inconostase, qui a échappé à l'incendie de 1943 et montre son niveau artistique élevé d'éxécution.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DISA KAPELA BIZANTINE TË VENDIT TONË

Krahas monumenteve të tjera të arkitekturës bizantine të vendit tonë, ka edhe një sërë kishash të vogla, në mjaft raste pa pretendime arkitekturale, por që paraqesin interes si dëshmi me vlerë për zhvillimin e shtrirjen e arkitekturës bizantine të vendit tonë dhe pasqyrojnë jo vetëm nivelin e ndërtimeve, por edhe atë ekonomik e kultural të zonave ku janë ngritur. Në këtë shkrim do të trajtojmë kapelat që ruhen në vendin tonë. Nga një shqyrtim tipologjik i tyre mund ti ndajmë në tre grupe kryesore: 1. – Kishat me kupolë mbi tambur, 2. – Kishat njënefshe me çati druri, dhe 3 Kishat njënefshe me qemer. Mbi bazën e këtij klasifikimi do t'i trajtojmë më poshtë. Ato që i bashkojnë këta monumente janë tipologjia (ndërtimi planimetriko-vëllimor), teknika e ndërtimit dhe në rastet më të arritura edhe forma arkitekturale.

A. KISHAT ME KUPOLË MBI TAMBUR

Kisha e manastirit të sh. Mërisë në Dhërmi (Vlorë)

Fshati Dhërmi shtrihet në kodrat e bregdetit të Jonit. Në pjesën më të lartë të tij dikur ndodhej manastiri i sh. Mërisë, nga i cili sot ruhet vetëm kisha. Ajo përbëhet prej dy pjesësh që dallohen nga njëra-tjetra: një ambient drejtkëndësh në plan, në anën perëndimore, që shërben sot si sallë e kishës dhe një kapelë në anën lindore (fig. 1). Pjesa e parë është një shtesë e vonë; ndërsa kapela që përbën dhe objektin e këtyre shënimeve është një ndërtim i periudhës para pushtimit turk.

Nga salla e kishës hyhet në kapelë (që sot shërben si ambient i altarit) nëpërmjet tri dyerve të ngushta të hapura në murin perëndimor të kapelës. Në murin lindor ndodhet bema me një dritare të vogël e të ngushtë e anash saj dy nike më të vogla si protezis e diakonikon. Kapela është kuadratike në plan. Ajo mbulohet me një kupol sferike mbi tambur. Veçori e kësaj kishe është se tamburi nuk mbështetet direkt e mbi muret anësore, gjë që do të vështirësonte drejtpeshimin e forcave shtytëse, po të kemi parasysh trashësinë jo të madhe të mureve. Baza e tamburit krijohet nëpërmjet një pjese pak a shumë sferike që del nga muret me planimetri kuadratike dhe që duke u ngushtuar formon rrethin. Në këtë mënyrë dhe trekëndëshat sferikë këtu janë në formën e tyre normale. Në brendësi tamburi nuk është edhe aq i ulët sa duket nga jashtë. Brendësia është interesante, sepse sensi i vertikalitetit bëhet akoma më dinamik nëpërmjet ngushtimit të tamburit, i cili duket sikur qëndron i varun mbi ne.

Po ta shohim nga jashtë këtë kapelë (Tab. I; 1, 2) do të vërejmë, edhe pse është pranë volumit të gjatë të sallës, se ajo ka një hedhje të ndjeshme vertikale dhe një siluetë elegante. Muret e saj janë të rrafshta dhe përfundojnë me frontone. Të gjitha këto frontone lakohen nëpër qoshet e mureve, pa pasur elemente në nivel më të ulët për të formuar në çati formën e kryqit.[1]). Çatitë fillojnë mbi korniza me dy radhë tulla të trasha, njëra e vendosur në formë dhëmbësharre e tjetra të drejtë. Në çdo timpan frontoni me dy rreshta tullash është vizatuar nga një kryq me përmasa dhe proporcione të goditura. Siç vërejtëm, në anën e jashtme tamburi me kupolën duken më të ulët, duke kontrastuar deri në një farë

1) E këtij lloji është çatia e kishës së shën Mëhillit në Berat. Shih A. Meksi **«Tri kisha bizantine të Beratit,** Monumentet 4, 1972, 79, fig. 27.

DO NOT COPY



Fig. 1

mase me proporcionet e pjesës tjetër. Tamburi cilindrik përfundon me një kornizë të rrafshtë si ajo e frontoneve. Katër dritaret e tamburit që sot janë pjesërisht të mbyllura mbulohen me hark prej tullash të vendosura në mënyrë radiale brenda një rreshti tullash për së gjati.

Muret e kishës janë ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje. Vende vende kemi dhe copa tjegullash e rrallë tullash të përdorura njëra mbi tjetrën ndërmjet gurëve sipas mënyrës që hasim në mjaft kisha të tjera bizantine. Vetë vendi shkëmbor ka përcaktuar dhe materialin e përdorur.

Nga ana tipologjike kemi të bëjmë me një kishë kuadratike me kupolë me veçantitë që thamë, që mund të jenë rezultat i një improvizimi, që s'i kemi hasur në ndonjë vend. Me të tilla të dhëna datimi nuk mund të jetë i lehtë. Proporcionet, dekori dhe teknika e ndërtimit na shtyjnë të mendojmë se kjo kishë duhet të jetë ndërtuar rreth shek. XIII-XIV.

Kisha e sh. Kollit në Armen (Vlorë)

Rrënojat e kishës së sh. Kollit ngrihen mbi një kodër në perëndim të fshatit Armen. Sidoqoftë ato ruajnë elementat për një studim të plotë të monumentit.

Kisha është drejtkëndëshe në plan me një apsidë të nxjerrë pak në anën e lindores (Tab. II). Në të hyhet nga një portë në anën perëndimore, që duhet të ketë qenë me arkitra të gurtë një copësh, por që sot mungon. Mbi të ruhet pjesërisht një kamare. Në brendësi kisha ndahet në tri pjesë nëpërmjet katër pilastrave që dalin në murin jugor e verior. Pjesa qendrore mbulohet me një kupolë mbi bazë eliptike dhe të stërgjatur në lartësi. Kjo ndodh për shkak se pilastrat janë të vendosura në cepat e një katërkëndëshi të zgjatur në drejtimin verijug. E gjithë kupola është e çrregullt. Kyçet e harqeve mbajtëse verijug, duke qenë më të mëdha janë në kuotë më të lartë. Nga kyçet e harqeve të vogla deri aty muri vjen duke u mbledhur me sipërfaqe të kurbëzuara. Prej andej fillon «kupola», një paraboloid i zgjatur mbi bazë eliptike. Pjesa e poshtme e kupolës është ndërtuar me gurë, ndërsa pjesa e sipërme me copëra tullash. Të gjitha harqet mbajtëse janë ndërtuar me gurë të skuadruar. Dy pjesët anësore janë të mbuluara me qemere cilindrike me formuesa perëndim-lindje. Duke filluar nga niveli i harqeve gjatësore të vogla qemeret nuk janë më pjesë e murit dhe ndërtohen veças. Gurët janë të vendosur në mënyrë radiale. Nga gjurmët në llaçin e dalë ndërmjet gurëve duket qartë mënyra e ndërtimit të tyre mbi armaturë druri. Qemeret kanë pasur nga dy tiranda, ndërsa harqet mbajtëse nga një, për të cilat dëshmojnë vrimat që sot duken në muret.

Muret janë ndërtuar me gurë shtufi ose konglomerati dhe llaç gëlqereje me rërë të ashpër. Nuk mungojnë në të tullat që shpesh përdoren dhe për ndonjë radhë rrafshuese. Muret janë të trasha dhe

faqja e poshtme në anën jugore është shkëputur vende-vende duke na treguar mbushjen e brendshme me gurë, llaç dhe copëra tullash e tjegullash. Në qoshen verilindore të kishës shohim në brendësi të murit gjurmë të brezave të dikurshëm.

Volumi kryesor i kishës është paralelopiped, mbi të cilin në të dyja anët ngrihen qemeret, ndërsa në mes tamburi me kupolën (Tab. III). Tamburi siç pamë është mbi një bazë ndërmjet drejtkëndëshit dhe elipsit. Mbi të në formë koni ngrihet pjesa tjetër e kupolës. Në fasadën veriore në pjesën e tamburit në një lartësi rreth 1 m kemi një kufi të qartë ndërmjet zonës së sipërme më të errët dhe zonës poshtë më të hapët. Mendojmë se kjo ndodh ngaqë muri anësor duhet të ketë qenë në nivel më të lartë duke mbuluar këtë pjesë të tamburit, sepse në rast të kundërt çatia dyujëse mbi qemeret s'kishte si të formohej; ndërsa çatia e kupolës në pjesën mbi tambur duket se do të ketë qenë si zakonisht një çati konike.

Po ta shohim në interier, do të vërejmë se kisha është mjaft e errët. Dyshemeja është prej dheu dhe duhet të jetë në një nivel më të lartë se zakonisht, sepse tirandat e qemereve janë sot shumë ulët dhe do të pengonin. Kisha ndriçohet vetëm prej një dritareje të vogël të absidës dhe një tjetër në anën jugore të kupolës (për këtë s'jemi shumë të sigurtë). Në murin lindor përveç absidës kemi dy kamare, njëra protezisi, mbuluar me hark, ndërsa diakonikoni kuadratik.

Për nga planimetria dhe volumetria kemi të bëjmë me një kishë të tipit sallë me kupolë. Sigurisht që aplikimi i tipit është pak a shumë primitiv, gjë që duket në përgjithësi edhe në teknikën e ndërtimit. Ndër kishat bizantine kjo kishë është e vetmja e këtij tipi që ruhet në vendin tonë, kështu që, pavarësisht nga mungesa e vlerave arkitekturale, ky monument përbën një dëshmi me rëndësi.

Për datimin vetë monumenti nuk ofron të dhëna për shkak të nivelit të ulët të ndërtimit, duke mbetur si mbështetje veçse forma planimetrike. Siç dihet kisha të këtij tipi fillojnë të ndërtohen që në sh. V-VI dhe vazhdojnë deri vonë. Le të shohim kur gjejmë kisha të përafërta me të në vendet fqinjë. Kështu në Jugosllavi gjejmë kisha të tilla në fund të sh. XI dhe në fillim të sh. XII (Kotorr)[2]). Po kështu edhe në Bullgari (Stanimak, Baçkovo)[3]) këto kisha ndërtohen kryesisht në sh. XII. Duke u nisur nga kjo, nga formati primitive dhe ndërtimi me gurë, ne mendojmë që kjo kishë është ndërtim i shekullit XI-XII.

Kisha e manastirit të sh. Mërisë së Zvërnecit (Vlorë)

Manastiri i sh. Mërisë së Zvërnecit ndodhet në një ishull brenda liqenit të Nartës, përballë fshatit Zvërnec. Konakët e manastirit të tipit me çardak janë në anët veriore, verilindore e veriperëndimore, duke u hapur çardhaku në drejtim të kishës. Kisha vetë është e tipit kryq, i lirë me kupolë, me narteks dhe ekzonarteks e një hajat të hapur me kolonadë në anën veriore. Pjesa e vjetër përbëhet vetëm nga naosi në formë kryqi të lirë me narteks, ndërsa pjesa tjetër është shtuar më vonë. Në të hyhet nga një derë, në murin perëndimor të narteksit, nëpërmjet ekzonarteksit të vonë, si dhe nga një derë në anën veriore të narteksit. Narteksi është drejtkëndësh në plan, me brinjë më të gjatë atë verijug dhe me një dritare të vogël në murin jugor. Ai ka në anën perëndimore portën të mbuluar me arkitrar të rrafshtë dhe dy dritare anash saj.

Narteksi është i mbuluar me qemer cilindrik me formuese në drejtimin verijug. Prej tij kalohet direkt në naosin, me të cilin lidhet së tepërmi, sepse ky kalim është me një hapësirë sa krahu perëndimor i kryqit. Qemeri me formuese lindjeperëndim që mbulon këtë të fundit, ndërpritet me qemerin e narteksit.

Naosi ka në planimetri formën e kryqit me krahët lindorë dhe perëndimorë më të gjatë se ata veriorë dhe jugorë. (Tab. V). Në fund të krahut lindor ndodhet bema që shkon deri në tokë dhe që ndriçohet nga një dritare e ngushtë dhe e lartë. Nga suvaja e rënë dallohet se absida është e ndërtuar me tulla sipas meridianeve. Në të dyja anët e krahut lindor janë dy kamare, protezisi me bazë gjysmë rrethi dhe diakonikoni drejtkëndësh.

Nga një dritare kanë dhe krahët veriorë dhe jugorë të kryqit. Krahët e kryqit mbulohen me qemere cilindrike që shërbejnë si harqe mbajtëse të tamburit me kupolë. Harqet janë me gurë të skuadruar në pjesët në qoshe, ndërsa pjesët e tjera me tulla dhe gurë. Tamburi ngrihet mbi harqet mbajtëse dhe trekëndëshet sferikë të ndërtuar me tulla të vendo-

2) G. Millet. **L'ancien art Serbe, Les eglises.** Paris 1919, 50; A. Deroko **Monumentalna i dekorativna arhitektura Srbij,** Beograd, 1961, fig. 45, 46.

3) N. Mavrodinov, **Ednokorabnata i Krestovidnata Cërkva na Bëllgarskite zemi,** Sofia 1931, 49-50.

POROTORY

sura në mënyrë të rregullt. Një kornizë rrethore e hollë nënvizon fillimin e tamburit, që ka katër dritare të ngushta dhe të vogla, të orientuara në katër pikat e horizontit. Sot dyshemeja e naosit është e shtruar me llaç çimentoje dhe në nivel pak më të lartë se dyshemeja e narteksit, e shtruar me pllaka guri gëlqeror.

Në anën perëndimore ku duket qartë fuga e kontaktit të dy mureve është shtuar më vonë, ekzonarteksi i mbuluar me qemer cilindrik me formuese lindjeperëndim. Ai, siç thamë dhe më lart, ka në anën perëndimore një portë si dhe dy dritare drejtkëndëshe që ka të ngjarë të jenë hapur më vonë. Vetë ekzonarteksi ka një portë në anën veriore dhe dy dritare, një në veri e një në perëndim. I një kohe me të është hajati me kolona që ze tërë anën veriore. Ai është i hapur gati në tërë këtë anë duke pasur hyrjen në mes, përballë derës së narteksit.

Forma e kryqit në anën e jashtëme është jo kaq e theksuar sa në brendësi, sepse krahët jugorë dhe veriorë janë më të shkurtër dhe më të ngushtë se narteksi (Tab. IV). Kjo gjë ka prurë që forma e kryqit të mos jetë e qartë si zakonisht. Për këtë ka influencuar dhe fakti që çatia e narteksit dhe krahut perëndimor janë në nivel më të lartë se krahu lindor.

Frontoni i krahut jugor nuk është i plotë, vetëm nga lindja ai përfundon me çati të pjerrët. Një sistem harqesh të verbra zë pjesën e sipërme të murit. Një hark i madh dhe më i lartë në mes, dy të tjera më të vogla anash. Harqet dalin pak ndaj murit dhe kanë një gur të punuar si mbështetje.

Lidhja e arkadës me muret bëhet me gurë të rrafshtë që dalin nga muri dhe që mbështetesh në qoshet në pilastra të ngushtë që zbresin deri në tokë. Po ky sistem harqesh, veçse i ndryshëm, ndodhet dhe në faqet e tjera. Në fushën brenda harkut të madh ndodhet një dritare, nën të cilën është një gur ku është gdhendur një kryq brenda një rrethi.

Ndërsa mjaft nga gurët e pilastrit të qoshes dhe harqeve janë skuadruara, muri është ndërtuar me gurë të zakonshëm duke patur edhe copëra tullash. Si lidhës është llaçi i gëlqeres. Nga që kisha është pranë detit, gurët dhe llaçi janë gërryer në anën e jashtme, gjë që ka kërkuar më vonë mbushjen e fugave me llaç të ri që ka ndërruar dhe pjesërisht ka fshehur pamjen e parë të mureve. Në anën veriore kemi jo tri, po pesë harqe. Këtu dritarja është në nivel më të ulët. Në anën perëndimore pamja është e ndryshme. Aty kemi pesë harqe, njëri më poshtë se tjetri, që ndjekin frontonin e dikurshëm, ndërsa harku qendror përfundon deri në tokë me dy pilastra për të nënvizuar hyrjen kryesore.

Po me gurë të çrregullt e llaç është ndërtuar dhe ekzonarteksi dhe hajati i vonë me kolona të ndërtuara me rrotulla guri. Hajati me ritmin e arkadës ka futur një notë mjaft të gjallë në pamjen e re të kishës, duke zhdukur monotoninë e murit të gjatë dhe duke balancuar tamburin me kupolën. Tamburi ngrihet me mbi një bazament drejtkandor. Ai zë pjesën më të madhe të volumit që i takon naosit duke e dominuar atë dhe duke qenë elementi bazë. Ai është gati i gjithë i suvatuar, por megjithatë në pjesët e rrëzuara, shihet teknika e ndërtimit të murit me gurë dhe coprra të shumta tjegullash e tullash ndërmjet tyre. Proporcionet e rënda të tamburit bëhen të pandjeshme nga korniza e trashë që përfundon atë, e cila ndryshe nga kishat e tjera bizantine të vendit tonë i ka të dyfishta radhët me tulla në formë dhëmbë sharre. Korniza fillon me dy tulla të drejta që dalin pak njëra nga tjetra dhe nga sipërfaqja e tamburit.

Megjithëse për shkak të shtesave të vona sot është vështirë të gjykohet mbi vlerat arkitektorale të kishës, jemi të mendimit se kjo kishë e vogël është një ndërtim me vlerë (fig. 2). Ndërtuesit e saj e kanë arritur këtë nëpërmjet proporcioneve dhe trajtimit të fasadave me arkada, fragmentimit të mureve nëpërmjet krahëve të kryqit dhe kupolës mbi tambur, që nënvizojnë sensin vertikal, i cili balancon deri në një farë mase zgjatjen e narteksit.

Në interier, pak ndryshe nga kishat e tjera të vogla në formë kryqi, kemi një aks gjatësor shumë të ndjeshëm, sidomos sapo hyjmë nga narteksi, sepse lidhja naos-narteks këtu është e madhe duke krijuar ato gati një volum. Vetëm kur futemi brenda naosit e për më tepër nën kupolë kemi theksimin e vertikalitetit, element bazë për kishat e tipit me kupolë.

Në një shkrim tonë të mëparshëm kemi datuar këtë kishë si më të re se kisha e Marmiroit, e cila për mendimin tonë, duke u nisur nga arkitektura, duhet të jetë jo më e vonë se e shekullit XIII[4]). Për një datim të tillë na shtyjnë format më të arritura dhe më të stërholluara të kishës së manastirit të Zvërnecit që flasin gjithashtu dhe për një mjeshtëri më të madhe të ndërtuesve të tij. Një element tjetër për të datuar kishën në studim si të sh. XIII-XIV është edhe trajtimi i fasadave me arkada, një paralel të së cilës gjejmë në kishën e sh. Kollit në Kurjan të Fierit[5]), një ndikim të arkitekturës romanike në arkitekturën bizantine.

4) A. Meksi, **Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Marmiroit,** Monumentet 2, 1971, 78.
5) A. Meksi, **Dy kisha trekonkshe,** Monumentet 7-8, 1974, 231, 236, fig. 1.

ISTORIA

DO NOT COPY



Fig. 2

B. KISHAT NJËNEFSHE ME ÇATI DRURI

Dy kisha bizantine të Butrintit

Krahas monumenteve të tjera mesjetare më të rëndësishme të Butrintit, dalluam atje dy kisha bizantine të vona që ruhen në gjendje rrënojë me mure pak mbi tokë.

Kisha Nr. 1. Kjo kishë ndodhet në anën veriore të Baptisterit paleokristian, muri jugor i së cilës është ndërtuar mbi një mur të tij. Muret e saj ruhen në lartësi të ndryshme. Kisha është me planimetri drejtkëndëshe (Tab. VI) dhe përbëhet nga narteksi, naosi dhe ambienti i altarit që ka si zakonisht në lindje një absidë gjysmërrethore. Narteksi duhet të jetë i mëvonshëm, sepse muret e tij ndahen nga një fugë e rregullt prej mureve të naosit. Narteksi ka një portë në anën perëndimore dhe lidhet me naosin nëpërmjet portës që ky ka në anën e narteksit. Naosi ka patur dhe dy porta të tjera në muret veriore dhe jugore, të cilat sot janë të zëna. Ikonostasi është prej muri me gurë dhe ka dy porta, të cilat lidhin naosin me ambientin e altarit. Muri i ikonostasit nuk lidhet me muret e kishës.

Teknika e ndërtimit të mureve të kësaj kishe është e ngjashme me atë të kishave bizantine për prezencën e tullave në të. Ato përdoren rrallë dhe janë të vendosura ndërmjet radhëve të gurëve zakonisht nga një tullë, por ndonjëherë dhe dy tulla njëra mbi tjetrën.

Kisha Nr. 2. Kjo kishë ndodhet pranë mureve rrethuese antike në afërsi të portës Skea. Ajo është e vendosur përpendikular murit rrethues, i cili shërben dhe si mur perëndimor i kishës. Kisha ruhet e rrënuar me mure që në disa vende arrijnë lartësinë 2 m. Në anën lindore të saj del një absidë gjysmërrethore me një dritare të ngushtë si frengji.

Në të (Tab VI) hyhet nga një portë në anën jugore që është e hapur dhe sot. Ka mundësi të ketë pasur një portë sot e murosur dhe në anën veriore përballë së parës, por ne nuk u bindëm për një gjë të tillë, sepse vetëm një fugë vertikale ishte e qartë. Si dhe kisha e mësipërme, muret e saj janë ndërtuar me gurë e llaç gëlqereje duke pasur në të rrallë dhe tulla.

Përsa i përket datimit të tyre nuk kemi të dhëna të sakta përvec teknikës së ndërtimit jo shumë të përcaktuar në kohë, por sidoqoftë e periudhës para pushtimit turk.

Kisha e sh. Sergjit e Bakut në Himarë.

Kisha e sh. Sergjit e Bakut që është në vendin më të lartë të kalasë së Himarës, mbahet si katedralja e epikospatës së Himarës. Ajo është një kishë e vjetër që ruan gjurmë të shumë rindërtimeve. Kisha

përbëhet prej narteksit sot të zbuluar, naosit dhe ambientit të altarit që ndahet nga naosi me një ikonostas të vonë prej guri shtufi të gdhendur, që riprodhon motivet e ikononostasiseve prej druri.

Kisha (Tab. VI) u përket dy fazave kryesore të ndërtimit. Naosi i përket ndërtimit të vjetër ndërsa narteksi është shtesë e mëvonshme. Dallim për këtë janë jo vetëm fugat e kontaktit, por edhe teknika e ndërtimit. Muret e kishës së vjetër janë ndërtuar me gurë gëlqerore të punuar e kryesisht të madhësive mesatare dhe të vogla. Të skuadruara janë vetëm gurët e qosheve. Veçanti e murit të vjetër janë prezenca në të e copërave të tjegullave të vëna horizontalisht, në radhë të shkurtra ndërmjet radhëve të gurëve ose njëra mbi tjetrën ndërmjet gurëve (Tab. IX,3). Një vendosje e tillë e çrregullt në dukje ka prapë se prapë një rregullshmëri. Kaq e vërtetë është kjo, saqë është e mundur të dallohen merematimet në pjesët e sipërme të mureve ku janë munduar të imitojnë teknikën e vjetër duke përdorur copëra tjegullash.

Narteksi ka tri porta, nga një për çdo anë. Nga këto porta veriore është sot më e vogël, duke ngushtuar me mure portën e dikurshme. Në naos sot hyhet nga porta perëndimore që e lidh me narteksin dhe nga porta jugore. Naosi është i mbuluar me çati druri e tjegulla. Nga naosi në ambientin e altarit hyhet nëpërmjet tri portave të ikonostasit, mbasi ngjitet një këmbë shkallë. Karakteristikë dalluese për ambientin e altarit është hapësira e tij si rezultat i madhësisë së bemës. Nën suvanë e re, në faqen veriore të ambientit të altarit dallojmë gjurmë të pikturës së vjetër murale, të cilat hyjnë dhe nën ikonostas.

Muret veriore dhe jugore të kishës së vjetër kanë mjaft meremetime. Në murin verior i përket një meremetimi pjesa më e madhe e qoshes verilindore që në një gur mban datën 1783. Është gjithashtu meremetim brezi i sipërm i murit nën çati për një lartësi gati 80 cm. Në murin e vjetër dallojmë një portë sot të mbyllur dhe që i mungon arkitrau nga i cili kemi vetëm një pjesë në shpatullën e djathtë të portës. Faqja lindore është e suvatuar në pjesën më të madhe dhe prandaj mundëm të shohim dhe të dallojmë si teknikë të vjetër vetëm pjesën në dukje. Muri jugor ka dhe ai një meremetim të ri në pjesën e sipërme, të shkaktuar sigurisht nga rindërtimet e ndryshme që kjo kishë ka pësuar në strukturat e çatisë. Dallojmë gjithashtu që porta për në naos është në një mur të ri. Kontakti nga lindja e këtij muri të ri me murin e vjetër është një vijë e qartë vertikale që na shtyn të mendojmë se këtu muri i vjetër ka pasur një portë. Nga ana perëndimore fuga është e çrregullt.

Përafërsisht në vendin ku është muri ndarës naos-narteks janë fugat e kontaktit të mureve të vjetra të naosit me ato të narteksit. Megjithëkëtë muri ndarës nuk duket se është i njëkohshëm me muret e narteksit, sepse ai është i lidhur me ta. Është e vështirë që naosi të ketë qenë në këtë gjatësi, mundet të ketë pasur tjetër mur ndarës ose muri i sotëm mund të jetë i njëkohshëm me narteksin, por për këtë na mungojnë të dhënat për ta thënë.

Nga përshkrimi i deritanishëm kuptohet se kemi të bëjmë me një kishë njënefshe më se të zakonshme, me të vetmen shenjë dalluëse në absidën gjysmërrethore të madhe. Që kemi të bëjmë me një kishë të ndërtuar para pushtimit turk, bindemi nga teknika e ndërtimit me copëra tjegullash të vendosura në një mënyrë që ne e hasim dhe në monumente të tjerë bizantine të vona të vëndit tonë. Për datimin e këtij monumenti nuk kemi të dhëna, përveç se i përket kultit të dy martirëve sirian, që dëshmon për lidhje të vjetra me orientin. Në se kemi të bëjmë me një kishë të ndërtuar mbi një tjetër më të vjetër nuk mund të themi. Do të prananim si kohë të mundshme ndërtimi për këtë kishë, duke u nisur nga teknika e ndërtimit, shekujt XIII-XIV.

Kisha e Profet Ilisë në Buhal të Përmetit.

Kisha e Profet Ilisë ndodhet në një bregore në anë të fshatit dhe pranë lumit Vjosë. Ajo përbëhet nga naosi drejtkëndësh i gjatë në drejtim lindje-perëndim, narteksi thuajse kuadratik në perëndim të tij dhe një hajat i hapur mbi pilastra kuadratike në anën jugore në tërë gjatësinë e kishës (Tab. VII). Në naos hyet si nëpërmjet narteksit ashtu dhe nga hajati jugor. Mbi këtë portë të fundit ndodhet një pllakë me mbishkrim, që na jep datën e një rindërtimi të bërë kishës.

Studimi i mureve të kishës na bëri të qartë se cila është pjesë e vjetër dhe cilat janë shtesat që i përkasin këtij rindërtimi. Në këtë vit është shtuar narteksi dhe hajati. Gjatë këtij rindërtimi është prishur muri perëndimor i kishës për ta bërë më të madh naosin. Njëkohësisht në brëndësi janë shtuar disa pillastra, që lidhen njëri me tjetrin me harqe. Mbi këto dy arkada ngrihej një qemer cilindrik nga i cili ruhen vetëm pjesët e poshtme, ndërsa kisha mbulohet sot me çati druri. Në përgjithësi pilastrat ishin ndërtuar të shkëputura nga muri i vjetër, me përjashtim të njerës pilastër në murin verior që është lidhur me murin e vjetër. Duke qenë kisha e pikturuar nuk arritëm dot të dallojmë në se pilastrat janë të njëkohëshme me rindërtimin e mësipërm apo më të hershme. Dallohen dy shtresa pikture, një e re mbi pilastrat dhe thëmbrat e qemerit dhe një e

ARCHIVE COPY

vjetër nën të. Vënde vënde dallohet që kjo e fundit hyn nën pilastrat. Ka mjaft të ngjarë që kjo të jetë piktura e vjetër e kishës, në këtë rast, po të ruhej në sipërfaqe të mëdha, do t'ishte mjaft e rëndësishme. Suvaja e re është hedhur në një shtresë gëlqereje 5 m/m duke çukitur sipërfaqen e afreskut të vjetër.

Muratura e kishës së vjetër mund të shikohet në faqet veriore dhe lindore, sepse faqja jugore është e suvatuar. Nga faqja lindore del një absidë 3-faqeshe e rregullt, me një dritare të mbuluar me hark me tulla radiale. Mbi të është një rresht dhëmbësharre i mbyllur brënda një harku të formuar me tulla të vendosura për së gjati. Dy dritare më të vogla e si frengji, të mbuluara me nga një gur, janë anash absidës. Njëra i takon protezisit, tjetra diakonikonit. Muri lindor është ndërtuar kryesisht me gurë. Në të ka mjaft tulla, të cilat janë të vendosura sipas një rregullshmërie. Ka vende-vende tulla horizontale, diku edhe të vëna në rreshta, pra një teknikë që ka një afrim me atë që kemi hasur në Perondi,[6]) por që këtu është jo e vazhdueshme, fragmentare. Në anën jugore të absidës kemi tulla të vendosura zigzag brënda rreshtash horizontalë. Vende-vende kemi dhe gjysma tullash të vendosura pjerrtas pranë tullave vertikale, nga njëra anë e tyre ose nga të dyja, ndërsa rrallë hasen tulla vertikale pa të pjerëta pranë. Në absidë ka më tepër tulla, ndërsa në anën veriore pranë saj ka më pak e kryesisht me teknikë të përafërt me atë të Perondisë.

Në anë veriore (Tab. IX, 1) teknika paraqitet më e qartë. Këtu vetëm pjesa e sipërme dhe lidhja e pilastrit të dytë janë të reja. Pjesa tjetër është me tulla dhe në rreshta horizontalë dhe kryesisht me tulla si ato të teknikës që përshkruam më lart. Në ndonjë rast të rallë ka dhe tullat e vogla zëvendësohen shpesh edhe me copëra tjegullash. Gjithë ky dekor është vendosur jo në mënyrë të rregullt, por sidoqoftë flet qartë për një teknikë me fizionomi të vetëm në këtë kishë.

Muri verior i tillë është vetëm në pjesën e vjetër. Pjesët e reja janë mur i zakonshëm me gurë. Si edhe muret e vjetra, guri i përdorur këtu është gur shtufi.

Ana jugore e murit të vjetër, siç thamë, është suvatuar; në pjesën e sipërme të saj dallohen tri dritare të murosura. Ato janë të vogla, të mbuluara me hark, me tulla radiale dhe përgjatë harkut. Mbi to ka në dukje rreth 25-30 cm mure ku mundëm të shohim tulla me rreshta horizontalë, tulla vertikale dhe rrathë ose rrombe të formuara me tulla dhe copëra tjegullash.

Të tilla ishin muret e vjetra të kishës. Kemi të bëjmë me një kishë bizantine një nefshe jo të vogël për nga madhësia dhe që ka një rëndësi të veçantë për teknikën e ndërtimit dhe dekoracionin me tulla të mureve. Kemi të bëjmë me një rast të ndërmjetëm të kishave të Perondisë, Kosinës[7]) dhe Labovës së Kryqit.[8]) Këtu vërejmë se kemi të shpërbërë teknikën me tulla horizontale që hasim në Perondi si edhe futjen e dekorit me tulla vertikale e të pjerrëta si në Labovën e Kryqit, por që këtu, si dhe në Kosinë, akoma s'ka marë formën e qartë. Pra, duke u nisur nga teknika e ndërtimit të mureve, do ta datonim kishën ndërmjet Perondisë dhe Kosinës që është pranë Buallit, në anën tjetër të Vjosës. Kemi datuar fazën më të vjetër të kishës sh. Kollit në Perondi si të sh. XI, ndërsa P. Thomo ka datuar kishën e sh.Mërisë në Kosinë si të mesit sh. XII.[9]), me të cilin jemi dakord edhe ne. Duke u nisur nga kjo mendojmë se kisha e Profet Ilisë në Bual duhet të jetë ndërtuar në periudhën nga gjysma e dytë e sh.XI në gjysmën e parë të sh.XII.

Kisha e sh. Jovanit Boboshticë (Korçë)

Kisha e sh. Jovanit ndodhet mënjanë fshatit, në anën perëndimore të tij. Është një kishë njënefshe e madhësisë mesatare e përbërë nga vetë kisha dhe një hajat i vonë i mbyllur në anën perëndimore të tij. Vetë kisha është drejtëkëndëshe në plan (Tab. VII) dhe sot paraqitet si një ambient i vetëm, por dikur ka pasur të ndarë ambientin e altarit me një ikonostas të drunjtë, gjurmët e të cilit në mur duken edhe sot. Bema këtu është mjaft e madhe dhe shkon deri në tokë, ndërsa protezisi dhe diakonikoni përfundojnë rreth 1 m nga toka. Dyshemeja është pjesërisht e shtruar me çimento dhe pjesërisht me tulla 30 x x 30 cm. Gjithë muret e brendshme të kishës si dhe muri perëndimor i saj nga ana e hajatit, janë të pikturuara me afreske që ruhen tërësisht dhe në gjendje të mirë. Kemi të bëjmë me një pikturë më të vonë sesa ndërtimi i kishës, sepse në anën veriore, kur është bërë pikturimi, janë murosur dhe pikturuar dritaret që kisha ka pasur në këtë anë.

6) A. Meksi, **Arkitektura dhe restaurimi i kishës së shën Kollit në Perondi,** Monumentet 5-6, 1973, 21.
7) P. Thomo, **Mbi dy monumente të arkitekturës sonë mesjetare** në sh. XI-XIV., S.H. 4; 1972; 28;
8) A. Meksi, **Dy kisha bizantine në rreth të Gjirokastrës,** Monumentet 9. 1975., 87.
9) P. Thomo, **vep. cit.,** 28.

Pozitiv

Nga ndërtimi i parapushtimit turk ruhen dy faqet lindore dhe veriore të kishës të ndërtuara me gurë smërçi dhe tulla (me përmasa 36 x 18 x 5 cm), ndërsa muret e tjera janë ndërtuar vetëm me gurë dhe kanë vendevende breza druri. Le të shqyrtojmë më parë murin verior (Tab. IX, 4), ku teknika karakteristike e kësaj kishe është më e qartë. Në pjesën e poshtme kemi një bazament prej dy-tre radhësh gurësh smërçi, të lidhur me llaç të bollshëm dhe pa tulla. Mbi të kalojnë dy radhë tullash të vendosura horizontalisht me një fugë të trashë llaçi ndërmjet tyre. Nga ky brez e deri në një tjetër po me dy radhë tullash, kalojnë dy radhë me gurë e tulla, të vendosura në një mënyrë të veçantë që ne nuk e hasim në kishat e tjera të kësaj periudhe të vendit tonë. Në pjesën e poshtme alternohen gurë smërçi me dy tulla vertikale, ndërsa në pjesën e sipërme gurë dhe tulla vertikale, të cilat janë brenda tullash horizontale. Zakonisht tullat vertikale janë katër. Në këtë radhë gurët e smërçit janë më të mëdhenj, sepse lartësia e tyre duhet të jetë sa e grupit të tullave vertikale dhe horizontale.

Mbi këtë brez janë tre radhë me gurë smërçi dhe tulla, mbi të cilat kalojnë katër radhë tullash. Edhe këtu smërçi me tullat janë të vendosura në mënyrë alternative. Zakonisht janë katër tulla vertikale, rrallë përdoren tre e më rrallë akoma dy tulla vertikale. Rreshti i mesit ka vetëm tulla vertikale, ndërsa dy të tjerët kanë dhe nga një tullë horizontale mbi të. Për të mënjanuar përdorimin e gurëve të mëdhenj të smërçit, nuk kemi të përdorura tullat horizontale sipër e poshtë tullave vertikale. Në ndonjë vend ka dhe tulla horizontale të vëna në vend të gurit.

Më lart kemi radhë gurësh smërçi pa tulla në mes tyre që alternohen me dy-tre radhë tullash horizontale. Në këta breza ndodhen dy dritare të ngushta të mbuluara me hark me tulla radiale dhe me shpatullat me gurë smërçi të vënë në këmbë. Siç thamë më lart, ato janë të murosura, kur është suvatuar interieri i kishës për tu pikturuar. Pjesa mbi to duket se është merematim i vonë, kur është ribërë dhe çatia.

Pjesën më të madhe të faqes lindore të kishës (fig. 3), e zë një absidë 3-faqëshe. Edhe kjo është punuar me të njëjtën teknikë si të faqes veriore. Brezat që vijnë nga kjo faqe vazhdojnë dhe këtu. Pjesa ndërmjet tyre është me gurë smërçi dhe tulla të vendosura në të njëjtën mënyrë si në murin verior. Kjo rregullshmëri prishet atje ku janë tri dritaret pjesërisht të murosura, që ka absida nga një në secilën faqe. Dritaret janë të ngushta dhe të larta e të mbuluara me hark tullash radiale brenda një harku tullash të vendosura përgjatë tij. Absida përfundon me një çati mbi një kornizë prej tullash të nxjerra pak poshtë. Si edhe në murin vertikal pjesa e sipërme e muraturës është e re. Mbi absidë kalon një brez i drunjtë që lidh mbështetëset e kapriatave në murin verior dhe jugor. Gjithë muri mbi të është i ri dhe i ndërtuar me gurë smërçi të vegjël. Dikur aty ka qenë një dritare (sot është e murosur).

Brezat e tullave që përshkojnë murin lindor ndërpriten pranë qoshes. Duket se ajo pjesë e qoshes dhe gjithë muri jugor janë të rinj, sepse muri është ndërtuar vetëm me gurë. Në këtë anë jugore ka qenë dhe një portë, sot e murosur, dhe një nikje me afresk. Vënde-vënde muri ka suva me gjurmë afresku dhe gjurmë trarësh. Këto na shtyjnë të mendojmë se në këtë anë ka pasur një hajat (sot është zhdukur).

Muri perëndimor i kishës së vjetës është i suvatuar dhe në anën e jashtme, kështu që ne nuk mund të shikonim nëse është i tëri i ri apo jo. Megjithëkëtë, po të shohim pjesët që nuk janë me suva, pjesa e sipërme menjëherë nën çati dhe shpatullat e portës, do të vërejmë se s'ka gjurmë tullash. Kjo na shtyn të mendojmë se muri është i ri, gjithnjë duke pasur rezervë për këtë. Hajati i mbyllur që ndodhet në anën perëndimore, është shtuar mbas rindërtimit të kishës, sepse një fugë e drejtë i ndan ata dhe muret e tij janë ndërtuar me gurë dhe llaç balte.

Duke mos pasur të dhëna burimore ose epigrafike për kohën e ndërtimit të kishës së shën Jovanit në Boboshticë, mbetet të shqyrtojmë vetëm të dhënat që na ofron arkitektura e saj, kryesisht teknika e ndërtimit. Është e qartë se këtu nuk kemi të bëjmë me kluasonazh, por me një teknikë jo më të hershme se ai, sepse vendosjen e tullave vertikale ndërmjet gurëve ne e hasim vetëm pas futjes së kluasonazhit. Gjithashtu edhe numri i madh i tullave vertikale pranë njëra-tjetrës dëshmon për një kohë të vonë. Ne do ta kuptonim këtë teknikë si shpërbërje të kluasonazhit, si një tentativë për të fituar nga kombinimi i tullës me gurin efekte të reja, gjithnjë duke përdorur elemente të njohura si brezat me tulla dhe tullat vertikale. Në një kënd të tillë vështrimi do ta datonim këtë kishë si të vonë. Për mendimin tonë kisha e sh. Jovanit në Boboshticë duhet të jetë datuar gjatë fundit të shekullit XIV.

Kisha e sh. Mitrit në Bezmisht (Korçë).

Kisha e sh. Mitrit ndodhet në pjesën veriore të fshatit Bezmisht në buzë të liqenit të Prespës. Ajo është një kishë e vogël njëpefshe e rindërtuar disa herë, që kuptohet lehtë se është një kishë e zakon-

shme fshati. Nga koha e pararushtimit turk kjo kishë ruan murin lindor, të ndërtuar me teknikën e zakonshme kluasonazh, me dy tulla vertikale ndërmjet gurëve dhe dy radhë tullash horizontale (Tab. IX, 2). Me këtë teknikë është absida trifaqëshe me një dritare të vogël në mes. Në pjesët e murit lindor deri afër qosheve, ka të çara, që shkojnë në tërë lartësinë e murit, dhe që tregojnë vendtakimin e murit të vjetër lindor me murin e ri verior e jugor. Për murin verior jemi të bindur që është i ri, edhe pse ai duket mirë që është i tëri me gurë. Për murin jugor një siguri të tillë nuk e kemi, ngaqë ai është i suvatuar. Dy faqet anësore të absidës kanë si dekor nga një tullë të rrumbullakët.

Në planimetri (Tab VI) kisha është drejtkëndëshe, si zakonisht e zgjatur në drejtim perëndim-lindje. Në të hyhet nga dy dyer, njëra nga perëndimi, tjetra nga jugu. Ajo ndriçohet vetëm nga një dritare në anën veriore dhe dritarja e ngushtë si frengji e absidës. Një ikonostas pa vlerë ndan naosin nga ambienti i altarit. Në këtë të fundit kemi tri nikje të harkuara bemën, protezisin dhe diakonikonin. Të trija këto nuk vijnë deri në tokë, por përfundojnë rreth 80 cm nga toka. Një brez druri kalonte nën to në tërë murin lindor.

Nuk patëm mundësi të ndiqnim planimetrinë e kishës së vjetër, por ka mjaft të ngjarë që kisha e re të jetë ndërtuar mbi themelet e së vjetrës. Të dhëna direkte për datimin e saj nuk kemi, por do të ishim të prirur për një datim të vonë, duke u nisur nga teknika e ndërtimit të kluasonazhit me dy radhë tullash horizontale. Mendojmë se kjo kishë duhet të jetë ndërtuar gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV.

Kisha e shën Kollit në Shelcan (Elbasan).

Kjo kishë është e njohur për afresket e piktorit të madh shqiptar të shekullit XVI, Onufrit. Kisha është njënefshe, me hajate të vona, sot të zbuluara, nga jugu dhe perëndimi (Tab. IX, 5). Në naos hyhet nga ana perëndimore, ndërsa dikur ka pasur dhe një portë në anën jugore, që sot është murosur. Kisha është me dysheme me pllaka guri të çrregullta, ndërsa është e mbuluar me çati me kapriata pa tavan, restaurim i vitit 1969.

Naosi (Tab VI) ndahet nga ambienti i altarit nga një ikonostas prej muri të pikturuar. Ai ka dyer, një në qendër dhe një në anën veriore. Me përjashtim të murit lindor të kishës, muret e tjera janë të suvatuara, kështu që nuk dallohet teknika e ndërtimit të tyre.

Është pikërisht muri lindor që dëshmon se kisha



Fig. 3

e sh. Kollit ka qenë ndërtuar përpara pushtimit turk. Muri lindor ka në qendër një absidë rrethore me një dritare të ngushtë dhe të lartë në mes. Dritarja mbulohet nga një hark me tulla radiale, rrethuar nga tulla për gjatë harkut. Absida ka në pjesën e sipërme nën kornizë një dekor tullash të vendosura zigzag, që duket të jetë i vonë. Si absida ashtu edhe i gjithë muri lindor janë ndërtuar në kluasonazhe me dy tulla vertikale apo që kanë nga dy rreshta tullash horizontale a në ndonjë vend edhe tre (fig. 4). Muri lindor përfundon me fronton, i cili del më lart se çatia e naosit. Gjatë punimeve të restaurimit rezultoi se në anën e brendshme formohej një dhëmb në nivel më të ulët se kreu i frontonit, që dëshmon se edhe në fillim çatia ka qenë më e ulët. Ne nuk mundëm të dallonim nëse dhe muri verior dhe jugor ka gjurmë të periudhës para pushtimit turk, ç'pjesë janë të reja dhe në përgjithësi formën e dikurshme të kishës. Për këtë do të duheshin kërkime të mëtejshme. Për sa i përket datimit ne mendojmë se duhet t'i takojë fundit të shekullit XIV, duke u nisur për këtë nga teknika e ndërtimit me dy, madje dhe tre radhë tullash horizontale.

DO NOT COPY



Fig. 4

C. KISHAT NJË NEFSHE ME QEMER

Kisha e shpërfytyrimit në Herbel (Peshkopi)

Kisha e shpërfytyrimit në fshatin Herbel të Peshkopisë, për sa njohim deri më sot, është monumenti më në veri të vendit tonë i arkitekturës bizantine. Kisha ndodhet në një breg në jugperëndim të fshatit dhe përbëhet prej dy pjesësh. Pjesa nga lindja që i takon periudhës së parapushtimit turk dhe që shërben si ambient altari për pjesën tjetër më të madhe për nga vëllimi në anën perëndimore. Siç shihet dhe nga planimetria (Tab. VI) një pjesë e dytë i është mbivënë kapelës së vjetër, duke prishur më parë murin perëndimor të saj. Sot të dyja kishat janë me çati dyujëse, ndërsa më parë, pjesa e vjetër, ka qenë mbuluar me qemer me seksion gjysmërrethor. Nga ky ruhen në brendësi vetëm pjesët e thembrave të ndërtuara me gurë smërçi. Po në anën e brendshme dallohet struktura e mbulesës me çerek sfere të absidës, e cila në pjesën në dukje është me tulla të vendosura në mënyrë radiale me një rresht tullash përgjatë harkut. Në anën e brendshme absida nuk arrin deri në dysheme, po kështu edhe dy nikjet që lozin rolin e protezisit e të diakonikonit.

Muratura, sidomos ajo në pjesën e absidës trefaqëshe është me gurë gëlqerorë e smërçi me tulla. Tullat janë vendosur ndërmjet gurëve dhe vende-vende edhe ndërmjet rreshtave (fig. 5), pra, diçka e ndërmjetme në mes teknikës së mureve të Perondisë dhe asaj të pjesës së poshtme të kishave të Beratit. Mirëpo, duke qenë larg zonave të Shqipërisë jugore, ku kemi vërejtur një rregullshmëri në teknikën e ndërtimit të mureve, këto tipare nuk mund të na shërbejnë tërësisht për datimin e monumentit.

Në mes të absidës është një dritare e ngushtë dhe e lartë, me dy gurë të vendosur në këmbë për shpatulla dhe një të tretë mbi ta për mbulesë, të gdhendur në mënyrë të harkuar në pjesën e mesit. Në vendtakimin e murit të ri me atë të vjetrin në anën jugore, ndodhet një nikje, në pjesën e poshtme të së cilës është hapur një dritare e re. Nikja zihet pjesërisht nga muri i ri. Ajo mbulohet me hark, në të cilin alternohen gurë smërçi me nga dy tulla.

Datimi i kësaj kapele siç vërejtëm dhe më lart është vështirë. Ne mendojmë megjithëkëtë se sipas teknikës së ndërtimit të mureve ajo duhet të jetë ndërtuar në sh. XII-XIII.

Kisha e Maxharës pranë Mulletit (Tiranë)

Aty ku sot janë dyqanet e fshatit Mullet, në një breg pranë rrugës automobilistike Tiranë-Elbasan, ndodhet e rrënuar një kishë e vogël, që vendësit e njohin me emrin kisha e Maxharës.

Kisha është drejtkëndëshe me një absidë rrethore që ruhet pak mbi tokë (Tab. VI). Në brendësi të kishës ruhen blloqe të mëdha murature nga muret dhe nga qemeri i rrëzuar. Muret ruhen më tepër në anët veriore dhe jugore, ndërsa fare pak në anët lindore dhe perëndimore. Në faqet lindore forma e absidës duket e qartë në pjesët më nga veriu, ku dallojmë pak dhe shpatullat e një dritareje në mes të absidës. Në murin verior është një kamare e mbuluar me hark, ndërsa në murin jugor dallojmë shpatullën e pjerrët të një dritareje të vendosur në lartësi në pjesën pranë absidës. Si në murin verior ashtu edhe në atë jugor ruhen fillimet e qemerreve të ndërtuara me gurë smërçi. Muret janë të ndërtuara krejtësisht me gurë shtufi dhe gurë lumi duke pasur sidomos pjesën e poshtme të faqes jugore me tulla të vendosura në mënyrë të rregullt. Një rresht rrafshues tullash ndodhet në nivelin e fillimit të qemereve. Në murin perëndimor ka qenë porta e hyrjes, shpatullat e së cilës nuk ruhen, sepse muri është i rrënuar.

Për përkatësinë e ndërtimit në periudhën para pushtimit turk u bindëm nga prezenca e tullave në

DO NOT COPY

vjetër nën të. Vënde vënde dallohet që kjo e fundit hyn nën pilastrat. Ka mjaft të ngjarë që kjo të jetë piktura e vjetër e kishës, në këtë rast, po të ruhej në sipërfaqe të mëdha, do t'ishte mjaft e rëndësishme. Suvaja e re është hedhur në një shtresë gëlqereje 5 m/m duke çukitur sipërfaqen e afreskut të vjetër.

Muratura e kishës së vjetër mund të shikohet në faqet veriore dhe lindore, sepse faqja jugore është e suvatuar. Nga faqja lindore del një absidë 3-faqeshe e rregullt, me një dritare të mbuluar me hark me tulla radiale. Mbi të është një rresht dhëmbësharre i mbyllur brënda një harku të formuar me tulla të vendosura për së gjati. Dy dritare më të vogla e si frengji, të mbuluara me nga një gur, janë anash absidës. Njëra i takon protezisit, tjetra diakonikonit. Muri lindor është ndërtuar kryesisht me gurë. Në të ka mjaft tulla, të cilat janë të vendosura sipas një rregullshmërie. Ka vende-vende tulla horizontale, diku edhe të vëna në rreshta, pra një teknikë që ka një afrim me atë që kemi hasur në Perondi,[6]) por që këtu është jo e vazhdueshme, fragmentare. Në anën jugore të absidës kemi tulla të vendosura zigzag brënda rreshtash horizontalë. Vende-vende kemi dhe gjysma tullash të vendosura pjerrtas pranë tullave vertikale, nga njëra anë e tyre ose nga të dyja, ndërsa rrallë hasen tulla vertikale pa të pjerëta pranë. Në absidë ka më tepër tulla, ndërsa në anën veriore pranë saj ka më pak e kryesisht me teknikë të përafërt me atë të Perondisë.

Në anë veriore (Tab. IX, 1) teknika paraqitet më e qartë. Këtu vetëm pjesa e sipërme dhe lidhja e pilastrit të dytë janë të reja. Pjesa tjetër është me tulla dhe në rreshta horizontalë dhe kryesisht me tulla si ato të teknikës që përshkruam më lart. Në ndonjë rast të rallë ka dhe tullat e vogla zëvendësohen shpesh edhe me copëra tjegullash. Gjithë ky dekor është vendosur jo në mënyrë të rregullt, por sidoqoftë flet qartë për një teknikë me fizionomi të vetëm në këtë kishë.

Muri verior i tillë është vetëm në pjesën e vjetër. Pjesët e reja janë mur i zakonshëm me gurë. Si edhe muret e vjetra, guri i përdorur këtu është gur shtufi.

Ana jugore e murit të vjetër, siç thamë, është suvatuar; në pjesën e sipërme të saj dallohen tri dritare të murosura. Ato janë të vogla, të mbuluara me hark, me tulla radiale dhe përgjatë harkut. Mbi to ka në dukje rreth 25-30 cm mure ku mundëm të shohim tulla me rreshta horizontalë, tulla vertikale dhe rrathë ose rrombe të formuara me tulla dhe copëra tjegullash.

Të tilla ishin muret e vjetra të kishës. Kemi të bëjmë me një kishë bizantine një nefshe jo të vogël për nga madhësia dhe që ka një rëndësi të veçantë për teknikën e ndërtimit dhe dekoracionin me tulla të mureve. Kemi të bëjmë me një rast të ndërmjetëm të kishave të Perondisë, Kosinës[7]) dhe Labovës së Kryqit.[8]) Këtu vërejmë se kemi të shpërbërë teknikën me tulla horizontale që hasim në Perondi si edhe futjen e dekorit me tulla vertikale e të pjerrëta si në Labovën e Kryqit, por që këtu, si dhe në Kosinë, akoma s'ka marë formën e qartë. Pra, duke u nisur nga teknika e ndërtimit të mureve, do ta datonim kishën ndërmjet Perondisë dhe Kosinës që është pranë Buallit, në anën tjetër të Vjosës. Kemi datuar fazën më të vjetër të kishës sh. Kollit në Perondi si të sh. XI, ndërsa P. Thomo ka datuar kishën e sh.Mërisë në Kosinë si të mesit sh. XII.[9]), me të cilin jemi dakord edhe ne. Duke u nisur nga kjo mendojmë se kisha e Profet Ilisë në Bual duhet të jetë ndërtuar në periudhën nga gjysma e dytë e sh.XI në gjysmën e parë të sh.XII.

Kisha e sh. Jovanit Boboshticë (Korçë)

Kisha e sh. Jovanit ndodhet mënjanë fshatit, në anën perëndimore të tij. Është një kishë njënefshe e madhësisë mesatare e përbërë nga vetë kisha dhe një hajat i vonë i mbyllur në anën perëndimore të tij. Vetë kisha është drejtëkëndëshe në plan (Tab. VII) dhe sot paraqitet si një ambient i vetëm, por dikur ka pasur të ndarë ambientin e altarit me një ikonostas të drunjtë, gjurmët e të cilit në mur duken edhe sot. Bema këtu është mjaft e madhe dhe shkon deri në tokë, ndërsa protezisi dhe diakonikoni përfundojnë rreth 1 m nga toka. Dyshemeja është pjesërisht e shtruar me çimento dhe pjesërisht me tulla 30 x x 30 cm. Gjithë muret e brendshme të kishës si dhe muri perëndimor i saj nga ana e hajatit, janë të pikturuara me afreske që ruhen tërësisht dhe në gjendje të mirë. Kemi të bëjmë me një pikturë më të vonë sesa ndërtimi i kishës, sepse në anën veriore, kur është bërë pikturimi, janë murosur dhe pikturuar dritaret që kisha ka pasur në këtë anë.

6) A. Meksi, **Arkitektura dhe restaurimi i kishës së shën Kollit në Perondi,** Monumentet 5-6, 1973, 21.
7) P. Thomo, **Mbi dy monumente të arkitekturës sonë mesjetare** në sh. XI-XIV., S.H. 4; 1972; 28;
8) A. Meksi, **Dy kisha bizantine në rreth të Gjirokastrës,** Monumentet 9. 1975., 87.
9) P. Thomo, **vep. cit.,** 28.

Pamje

Nga ndërtimi i parapushtimit turk ruhen dy faqet lindore dhe veriore të kishës të ndërtuara me gurë smërçi dhe tulla (me përmasa 36 x 18 x 5 cm), ndërsa muret e tjera janë ndërtuar vetëm me gurë dhe kanë vendevende breza druri. Le të shqyrtojmë më parë murin verior (Tab. IX, 4), ku teknika karakteristike e kësaj kishe është më e qartë. Në pjesën e poshtme kemi një bazament prej dy-tre radhësh gurësh smërçi, të lidhur me llaç të bollshëm dhe pa tulla. Mbi të kalojnë dy radhë tullash të vendosura horizontalisht me një fugë të trashë llaçi ndërmjet tyre. Nga ky brez e deri në një tjetër po me dy radhë tullash, kalojnë dy radhë me gurë e tulla, të vendosura në një mënyrë të veçantë që ne nuk e hasim në kishat e tjera të kësaj periudhe të vendit tonë. Në pjesën e poshtme alternohen gurë smërçi me dy tulla vertikale, ndërsa në pjesën e sipërme gurë dhe tulla vertikale, të cilat janë brenda tullash horizontale. Zakonisht tullat vertikale janë katër. Në këtë radhë gurët e smërçit janë më të mëdhenj, sepse lartësia e tyre duhet të jetë sa e grupit të tullave vertikale dhe horizontale.

Mbi këtë brez janë tre radhë me gurë smërçi dhe tulla, mbi të cilat kalojnë katër radhë tullash. Edhe këtu smërçi me tullat janë të vendosura në mënyrë alternative. Zakonisht janë katër tulla vertikale, rrallë përdoren tre e më rrallë akoma dy tulla vertikale. Rreshti i mesit ka vetëm tulla vertikale, ndërsa dy të tjerët kanë dhe nga një tullë horizontale mbi të. Për të mënjanuar përdorimin e gurëve të mëdhenj të smërçit, nuk kemi të përdorura tullat horizontale sipër e poshtë tullave vertikale. Në ndonjë vend ka dhe tulla horizontale të vëna në vend të gurit.

Më lart kemi radhë gurësh smërçi pa tulla në mes tyre që alternohen me dy-tre radhë tullash horizontale. Në këta breza ndodhen dy dritare të ngushta të mbuluara me hark me tulla radiale dhe me shpatullat me gurë smërçi të vënë në këmbë. Siç thamë më lart, ato janë të murosura, kur është suvatuar interieri i kishës për tu pikturuar. Pjesa mbi to duket se është merematim i vonë, kur është ribërë dhe çatia.

Pjesën më të madhe të faqes lindore të kishës (fig. 3), e zë një absidë 3-faqëshe. Edhe kjo është punuar me të njëjtën teknikë si të faqes veriore. Brezat që vijnë nga kjo faqe vazhdojnë dhe këtu. Pjesa ndërmjet tyre është me gurë smërçi dhe tulla të vendosura në të njëjtën mënyrë si në murin verior. Kjo rregullshmëri prishet atje ku janë tri dritaret pjesërisht të murosura, që ka absida nga një në secilën faqe. Dritaret janë të ngushta dhe të larta e të mbuluara me hark tullash radiale brenda një harku tullash të vendosura përgjatë tij. Absida përfundon me një çati mbi një kornizë prej tullash të nxjerra pak poshtë. Si edhe në murin vertikal pjesa e sipërme e muraturës është e re. Mbi absidë kalon një brez i drunjtë që lidh mbështetëset e kapriatave në murin verior dhe jugor. Gjithë muri mbi të është i ri dhe i ndërtuar me gurë smërçi të vegjël. Dikur aty ka qenë një dritare (sot është e murosur).

Brezat e tullave që përshkojnë murin lindor ndërpriten pranë qoshes. Duket se ajo pjesë e qoshes dhe gjithë muri jugor janë të rinj, sepse muri është ndërtuar vetëm me gurë. Në këtë anë jugore ka qenë dhe një portë, sot e murosur, dhe një nikje me afresk. Vënde-vënde muri ka suva me gjurmë afresku dhe gjurmë trarësh. Këto na shtyjnë të mendojmë se në këtë anë ka pasur një hajat (sot është zhdukur).

Muri perëndimor i kishës së vjetës është i suvatuar dhe në anën e jashtme, kështu që ne nuk mund të shikonim nëse është i tëri i ri apo jo. Megjithëkëtë, po të shohim pjesët që nuk janë me suva, pjesa e sipërme menjëherë nën çati dhe shpatullat e portës, do të vërejmë se s'ka gjurmë tullash. Kjo na shtyn të mendojmë se muri është i ri, gjithnjë duke pasur rezervë për këtë. Hajati i mbyllur që ndodhet në anën perëndimore, është shtuar mbas rindërtimit të kishës, sepse një fugë e drejtë i ndan ata dhe muret e tij janë ndërtuar me gurë dhe llaç balte.

Duke mos pasur të dhëna burimore ose epigrafike për kohën e ndërtimit të kishës së shën Jovanit në Boboshticë, mbetet të shqyrtojmë vetëm të dhënat që na ofron arkitektura e saj, kryesisht teknika e ndërtimit. Është e qartë se këtu nuk kemi të bëjmë me kluasonazh, por me një teknikë jo më të hershme se ai, sepse vendosjen e tullave vertikale ndërmjet gurëve ne e hasim vetëm pas futjes së kluasonazhit. Gjithashtu edhe numri i madh i tullave vertikale pranë njëra-tjetrës dëshmon për një kohë të vonë. Ne do ta kuptonim këtë teknikë si shpërbërje të kluasonazhit, si një tentativë për të fituar nga kombinimi i tullës me gurin efekte të reja, gjithnjë duke përdorur elemente të njohura si brezat me tulla dhe tullat vertikale. Në një kënd të tillë vështrimi do ta datonim këtë kishë si të vonë. Për mendimin tonë kisha e sh. Jovanit në Boboshticë duhet të jetë datuar gjatë fundit të shekullit XIV.

Kisha e sh. Mitrit në Bezmisht (Korçë).

Kisha e sh. Mitrit ndodhet në pjesën veriore të fshatit Bezmisht në buzë të liqenit të Prespës. Ajo është një kishë e vogël njëpefshe e rindërtuar disa herë, që kuptohet lehtë se është një kishë e zakon-

Botoret

shme fshati. Nga koha e parapushtimit turk kjo kishë ruan murin lindor, të ndërtuar me teknikën e zakonshme kluasonazh, me dy tulla vertikale ndërmjet gurëve dhe dy radhë tullash horizontale (Tab. IX, 2). Me këtë teknikë është absida trifaqëshe me një dritare të vogël në mes. Në pjesët e murit lindor deri afër qosheve, ka të çara, që shkojnë në tërë lartësinë e murit, dhe që tregojnë vendtakimin e murit të vjetër lindor me murin e ri verior e jugor. Për murin verior jemi të bindur që është i ri, edhe pse ai duket mirë që është i tëri me gurë. Për murin jugor një siguri të tillë nuk e kemi, ngaqë ai është i suvatuar. Dy faqet anësore të absidës kanë si dekor nga një tullë të rrumbullakët.

Në planimetri (Tab VI) kisha është drejtkëndëshe, si zakonisht e zgjatur në drejtim perëndim-lindje. Në të hyhet nga dy dyer, njëra nga perëndimi, tjetra nga jugu. Ajo ndriçohet vetëm nga një dritare në anën veriore dhe dritarja e ngushtë si frengji e absidës. Një ikonostas pa vlerë ndan naosin nga ambienti i altarit. Në këtë të fundit kemi tri nikje të harkuara bemën, protezisin dhe diakonikonin. Të trija këto nuk vijnë deri në tokë, por përfundojnë rreth 80 cm nga toka. Një brez druri kalonte nën to në tërë murin lindor.

Nuk patëm mundësi të ndiqnim planimetrinë e kishës së vjetër, por ka mjaft të ngjarë që kisha e re të jetë ndërtuar mbi themelet e së vjetrës. Të dhëna direkte për datimin e saj nuk kemi, por do të ishim të prirur për një datim të vonë, duke u nisur nga teknika e ndërtimit të kluasonazhit me dy radhë tullash horizontale. Mendojmë se kjo kishë duhet të jetë ndërtuar gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV.

Kisha e shën Kollit në Shelcan (Elbasan).

Kjo kishë është e njohur për afresket e piktorit të madh shqiptar të shekullit XVI, Onufrit. Kisha është njënefshe, me hajate të vona, sot të zbuluara, nga jugu dhe perëndimi (Tab. IX, 5). Në naos hyhet nga ana perëndimore, ndërsa dikur ka pasur dhe një portë në anën jugore, që sot është murosur. Kisha është me dysheme me pllaka guri të çrregullta, ndërsa është e mbuluar me çati me kapriata pa tavan, restaurim i vitit 1969.

Naosi (Tab VI) ndahet nga ambienti i altarit nga një ikonostas prej muri të pikturuar. Ai ka dyer, një në qendër dhe një në anën veriore. Me përjashtim të murit lindor të kishës, muret e tjera janë të suvatuara, kështu që nuk dallohet teknika e ndërtimit të tyre.

Është pikërisht muri lindor që dëshmon se kisha



Fig. 3

e sh. Kollit ka qenë ndërtuar përpara pushtimit turk. Muri lindor ka në qendër një absidë rrethore me një dritare të ngushtë dhe të lartë në mes. Dritarja mbulohet nga një hark me tulla radiale, rrethuar nga tulla për gjatë harkut. Absida ka në pjesën e sipërme nën kornizë një dekor tullash të vendosura zigzag, që duket të jetë i vonë. Si absida ashtu edhe i gjithë muri lindor janë ndërtuar në kluasonazhe me dy tulla vertikale apo që kanë nga dy rreshta tullash horizontale a në ndonjë vend edhe tre (fig. 4). Muri lindor përfundon me fronton, i cili del më lart se çatia e naosit. Gjatë punimeve të restaurimit rezultoi se në anën e brendshme formohej një dhëmb në nivel më të ulët se kreu i frontonit, që dëshmon se edhe në fillim çatia ka qenë më e ulët. Ne nuk mundëm të dallonim nëse dhe muri verior dhe jugor ka gjurmë të periudhës para pushtimit turk, ç'pjesë janë të reja dhe në përgjithësi formën e dikurshme të kishës. Për këtë do të duheshin kërkime të mëtejshme. Për sa i përket datimit ne mendojmë se duhet t'i takojë fundit të shekullit XIV, duke u nisur për këtë nga teknika e ndërtimit me dy, madje dhe tre radhë tullash horizontale.

DO NOT COPY



Fig. 4

C. KISHAT NJË NEFSHE ME QEMER

Kisha e shpërfytyrimit në Herbel (Peshkopi)

Kisha e shpërfytyrimit në fshatin Herbel të Peshkopisë, për sa njohim deri më sot, është monumenti më në veri të vendit tonë i arkitekturës bizantine. Kisha ndodhet në një breg në jugperëndim të fshatit dhe përbëhet prej dy pjesësh. Pjesa nga lindja që i takon periudhës së parapushtimit turk dhe që shërben si ambient altari për pjesën tjetër më të madhe për nga vëllimi në anën perëndimore. Siç shihet dhe nga planimetria (Tab. VI) një pjesë e dytë i është mbivënë kapelës së vjetër, duke prishur më parë murin perëndimor të saj. Sot të dyja kishat janë me çati dyujëse, ndërsa më parë, pjesa e vjetër, ka qenë mbuluar me qemer me seksion gjysmërrethor. Nga ky ruhen në brendësi vetëm pjesët e thembrave të ndërtuara me gurë smërçi. Po në anën e brendshme dallohet struktura e mbulesës me çerek sfere të absidës, e cila në pjesën në dukje është me tulla të vendosura në mënyrë radiale me një rresht tullash përgjatë harkut. Në anën e brendshme absida nuk arrin deri në dysheme, po kështu edhe dy nikjet që lozin rolin e protezisit e të diakonikonit.

Muratura, sidomos ajo në pjesën e absidës trefaqëshe është me gurë gëlqerorë e smërçi me tulla. Tullat janë vendosur ndërmjet gurëve dhe vende-vende edhe ndërmjet rreshtave (fig. 5), pra, diçka e ndërmjetme në mes teknikës së mureve të Perondisë dhe asaj të pjesës së poshtme të kishave të Beratit. Mirëpo, duke qenë larg zonave të Shqipërisë jugore, ku kemi vërejtur një rregullshmëri në teknikën e ndërtimit të mureve, këto tipare nuk mund të na shërbejnë tërësisht për datimin e monumentit.

Në mes të absidës është një dritare e ngushtë dhe e lartë, me dy gurë të vendosur në këmbë për shpatulla dhe një të tretë mbi ta për mbulesë, të gdhendur në mënyrë të harkuar në pjesën e mesit. Në vendtakimin e murit të ri me atë të vjetrin në anën jugore, ndodhet një nikje, në pjesën e poshtme të së cilës është hapur një dritare e re. Nikja zihet pjesërisht nga muri i ri. Ajo mbulohet me hark, në të cilin alternohen gurë smërçi me nga dy tulla.

Datimi i kësaj kapele siç vërejtëm dhe më lart është vështirë. Ne mendojmë megjithëkëtë se sipas teknikës së ndërtimit të mureve ajo duhet të jetë ndërtuar në sh. XII-XIII.

Kisha e Maxharës pranë Mulletit (Tiranë)

Aty ku sot janë dyqanet e fshatit Mullet, në një breg pranë rrugës automobilistike Tiranë-Elbasan, ndodhet e rrënuar një kishë e vogël, që vendësit e njohin me emrin kisha e Maxharës.

Kisha është drejtkëndëshe me një absidë rrethore që ruhet pak mbi tokë (Tab. VI). Në brendësi të kishës ruhen blloqe të mëdha murature nga muret dhe nga qemeri i rrëzuar. Muret ruhen më tepër në anët veriore dhe jugore, ndërsa fare pak në anët lindore dhe perëndimore. Në faqet lindore forma e absidës duket e qartë në pjesët më nga veriu, ku dallojmë pak dhe shpatullat e një dritareje në mes të absidës. Në murin verior është një kamare e mbuluar me hark, ndërsa në murin jugor dallojmë shpatullën e pjerrët të një dritareje të vendosur në lartësi në pjesën pranë absidës. Si në murin verior ashtu edhe në atë jugor ruhen fillimet e qemerreve të ndërtuara me gurë smërçi. Muret janë të ndërtuara krejtësisht me gurë shtufi dhe gurë lumi duke pasur sidomos pjesën e poshtme të faqes jugore me tulla të vendosura në mënyrë të rregullt. Një rresht rrafshues tullash ndodhet në nivelin e fillimit të qemereve. Në murin perëndimor ka qenë porta e hyrjes, shpatullat e së cilës nuk ruhen, sepse muri është i rrënuar.

Për përkatësinë e ndërtimit në periudhën para pushtimit turk u bindëm nga prezenca e tullave në

DO NOT COPY

muret e kishës dhe vendndërtimi i saj në një vend të dukshëm e përballë kalasë së Petrelës, gjë që nuk do të lejonte ndërtimin e saj në shekujt e parë të pushtimit turk dhe se zona islamizohet shpejt. Për datimin e saj ne nuk kemi asnjë të dhënë direkte, ndërsa monumenti na ofron vetëm teknikën e ndërtimit, që e hasim në mjaft kisha bizantine të vona, çka na shtyn të mendojmë se kisha u takon shekujve XIII-XIV.

Kisha e Shënepremtes në Sop (Fier)

Kisha e Shënepremtes është në një vend larg qendrave të banuara, pranë fshatit Sop, në tokat ku dikur shtrihej kështa e Hoxharës. Duke qenë në një vënd të tillë dhe e braktisur për një kohë të gjatë, ruhej në gjendje rrënoje. Kjo është një kishë e vogël njënefshe (Tab X) e mbuluar me qemer, që është pjesërisht i rrëzuar. Në të hyhet nga një derë në anën veriore e mbuluar me një arkitra të gurtë njëcopësh. Si i tillë është përdorur një gur antik pjesë e frizës së një tempulli dorik (triglif) nga rrënojat e Apolonisë që është aty pranë. Në shpatullat e derës janë dy palë vrima për dy katarahe. Kisha është e vendosur mbi një xokol të ndërtuar me muraturë guri, mbi të cilin, duke u futur pak më brenda, ngrihet muri. Në faqen lindore të kishës aty ku del absida gjysmërrethore është bema që ka anash një protezis gjysmërrethor mbuluar me hark tullash dhe një nikje drejtkëndëshe si diakonikon. Dyshemeja e kishës është e shtruar me baltë dhe në nivel të njëjtë me tokën në anën lindore të kishës, ndërsa duke filluar nga dera e deri në anën perëndimore terreni është gati një metër më i ulët duke zbuluar themelet e kishës në këtë anë. Duket se këtu ka qenë dhe bregu i këtetës.

Po të shikojmë muraturën nga ana e jashtëme, do të vërejmë se ajo mban gjurmë teknikash të ndryshme (Tab. I; 3, 4, 5, 6). Kisha është e vendosur mbi një xokol të ndërtuar me muraturë guri, mbi të cilin, duke u futur pak më brënda, ngrihet muri. Pjesa e poshtme është e ndërtuar me gurë paralelopipedikë të mëdhenj dhe me tulla të vendosura horizontalisht ndërmjet gurëve, njëlloj si pjesa e poshtme e mureve të trapezarisë së manastirit të Pojanit.[10]). Mbi këtë pjesë të murit është një brez prej pesë rreshta tullash të trasha, që kalon rreth e qark kishës. Tullat e radhës së tretë dhe të katërt lidhen ndërmjet tyre me copa të vogla kuadratike prej tullash, fundi i së poshtmes me fillimin e së sipërmes,



Fig. 5

duke krijuar në këtë mënyrë një motiv që vazhdon për tërë brezin. Në anën lindore këtë motiv e krijojnë tullat e dyta dhe të treta. Ky brez kalonte dhe përgjatë absidës duke e përfunduar atë.

Në faqen lindore ku gurët janë kryesisht të mëdhenj, shihet qartë se tullat ndërmjet tyre janë element teknik jo vetëm tradicional, por edhe i përcaktuar nga nevoja të lidhjes së murit me gurë të mëdhenj. Absida trifaqëshe ka në këtë anë një dritare të vogël si frengji. Mbulesa e absidës mungon dhe është e dëmtuar, bile një vrimë çan pikërisht qemerin e saj me tulla. Mbi këtë të fundit, në pjesën në dukje mbi çatinë e dikurshme të absidës, vërejmë se muratura është me kluasonazhë me dy tulla vertikale. Kjo muraturë përfundon me dy rrjedhje duke pasur mure shtesë në anët. Kontakti i këtyre të dyjave dallohet qartë pikërisht në anën lindore. Në faqet jugore e veriore janë të murit të vjetër dy radhë me gurë mbi brezin me tulla, ndërsa pjesa mbi të është shtesë. Kontakti ndërmjet tyre është i dukshëm. Ndërmjet gurëve të pjesës së vjetër kemi edhe ndonjë tullë vertikale, por jo kluasonazh. Në faqen veriore, tamam mbi portën kemi një nikje, e cila duhet të jetë shtuar më vonë, sepse kalon në të dyja pjesët e murit, atë të vjetër dhe atë të re. Pra kisha gjatë ekzistencës së saj i është nënshtruar

10) A. Meksi, **Dy kisha trekonshe,** Monumentet 7-8, 1974, 234, fig. 5.

DO NOT COPY

një meremetimi në pjesën e sipërme, mbase për të zbutur pendencën e çatisë, ose për ndonjë arsye tjetër.

Pjesa qendrore mbi brezin me tulla të fasadës perëndimore është e rrëzuar bashkë me qemerin e mbulesës. Pikërisht në këtë vend ruhen gjurmët e një harku me tulla radiale dhe tulla për së gjati mbi to. Në anën e brendshme të murit është një gur i dalë më tepër se sa harku, që na bën të mendojmë se ky hark i takon një nikjeje. Ka shumë të ngjarë që në mes të nikjes të ketë pasur ndonjë dritare për të ndriçuar kishën.

Qemeri që mbulonte kishën fillon menjëherë mbi brezin me tulla. Në pjesën e poshtme të lidhur me murin ai është me gurë dhe tulla, ndërsa në pjesën e sipërme vetëm me tulla. Në vendtakimin e këtyre dy pjesëve të qemerit të ndërtuara me materiale të ndryshme, ka disa gjurmë të lëna nga skeleti mbajtës i armaturës të bërë për të ndërtuar pjesën e sipërme të qemerit. Që vetëm pjesa e sipërme është ndërtuar me armaturë druri, e tregon dhe fakti që në pjesën e poshtme fugat janë të punuara, d.m.th. kanë qenë të lira gjatë ndërtimit. Në nivelin e fillimit të qemerit kemi gjurmët në mur të tirandave të drunjta. Një brez druri në brendësi të murit që dilte deri në fasadën perëndimore i lidhte ato. Për sa i përket kohës së ndërtimit të kishës duhet të nisemi në mungesë të të dhënave direkte nga teknika e ndërtimit të mureve. Me të njëjtën teknikë është ndërtuar trapezaria e manastirit të shën Mërisë të Apolonisë: në pjesën e poshtme gurë me tulla horizontale ndërmjet tyre, në pjesën e sipërme kluasonazh me dy tulla vertikale. Për datimin e trapezarisë kemi si të dhëna datimin e afreskeve si të shekujve XIII-XIV që na është dukur i mundur dhe për arkitekturën. Pra, duke përfunduar, do të pranojmë se gjatë sh. XIII-XIV është ndërtuar dhe kisha e Shënepremtes në Sop.

DO NOT COPY













DO NOT COPY

DO NOT COPY

SHËN KOLLI ARMEN



PLANIMETRIA



PAMJE NGA VERIU



PREMJE TERTHORE



PREMJE GJATESORE

DO NOT COPY



PAMJE NGA LINDJA



PAMJE NGA PERENDIMI







TAB. IV









DO NOT COPY

DO NOT COPY

SHËN MËRIA ZVERNEC



PLANIMETRIA



PAMJE VERIORE



PRERJE GJATESORE



PAMJE JUGORE



PRERJE TERTHORE



PRERJE TERTHORE



PAMJE LINDORE

TAB. VI



HIMARE



BEZMISHT



HERBEL



SHELCAN



MULLET



BUTRINT



BUTRINT

DO NOT COPY

DO NOT COPY

SHËN ILLIU BUAL



PAMJE VERIORE



PAMJE LINDORE



PRERJE TERTHORE



PLANIMETRIA



SHËN JOVANI - BOBOSHTICË



PLANIMETRIA



PREMJE TERTHORE



PAMJE VERIORE



PAMJE LINDORE

DO NOT COPY











DO NOT COPY

TAB. X

SHËN E PREMTE SOP



PLANIMETRIA



PRERJE TERTHORE



PAMJE JUGORE



PAMJE LINDORE



PAMJE PERENDIMORE



PAMJE VERIORE

0 2 3m

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

CERTAINES CHAPELLES BYZANTINES DE NOTRE PAYS

RESUME

Dans cet écrit il est question de certaines chapelles byzantines conservées dans notre pays et constituant un témoignage de valeur pour l'histoire de l'architecture. Elles ont été classifiées selon la typologie en trois groupes: 1. Eglises à coupole sur tambour; 2. Eglises à nef unique ayant un toit de bois; 3. Eglises à nef unique ayant des voûtes.

A. Les églises à coupole sur tambour

L'église du monastère de Shën Meri à Dhërmi (Vlore) *se trouve dans le village de même nom. Actuellement on ne conserve du monastère que l'église en question, dont nous ne traiterons que la chapelle bizantine située sur son côté oriental et remplissant la fonction de l'autel. Le plan de la chapelle est de forme quadratique et celle-ci est couverte par une coupole sur tambour. Le tambour repose sur une surface sphérique sortant des murs pour former la base en forme de cercle. Sous l'aspect extérieur caractéristique est le toit à frontons rejoignant les angles, sans mettre donc en relief la forme de la croix. Cette église est construite de pierres, les briques sont employées seulement dans la décoration et l'on trouve des morceaux de tuiles et rarement de briques parmi les pierres disposées selon la technique caractérisant les églises de l'époque. En ce qui concerne sa datation, en partant du décor, des proportions et de la technique de construction, il ressort qu'elle a été construite pendant les XIIIe-XIVe siècles.*

L'église de Shën Koll à Armen (Vlore), *dont les ruines se trouvent à l'ouest du village de même nom, conserve de nos jours encore tous les éléments permettant d'entreprendre son étude. Elle représente une construction non fort régulière, dont la forme est du type de salle à coupole reposant sur un système d'arcs surmontant des pilastres. Sa partie centrale n'étant pas quadratique, la «coupole» résulte être un paralélépipède ayant une base elliptique. Les murs sont en pierres et rarement en briques. Il s'agit là de la seule église byzantine de ce type qui se conserve encore chez nous. Partant des formes primitives et des confrontations avec les églises des pays limitrophes, il apparaît que notre monument a été construit pendant les XIe-XIIe siècles.*

L'église de Shën Meri de Zvernec, *construite dans l'île de Zvernec, au centre de lac de Narte, est une digne représentante du type d'église à croix libre sur tambour à coupole. Elle comprend l'église byzantine et exonarthex, ainsi qu'une cour ouverte à colonnes. En ce qui concerne sa planimétrie, elle se caractérise par le fait que ses ailes orientales et occidentales sont plus longues que les deux autres et que son narthex se relie directement à l'aile occidentale. Dans sa partie inférieure le système des arcs ornant la façade rappelle l'église de Kurian (Fier) et la double corniche de tambour. A notre sens cette église est de valeur architecturale et, partant de son type, de ses éléments particuliers et de sa technique de construction, il semble qu'elle appartient aux XIIIe-XIVe siècles.*

B. Les églises à nef unique ayant un toit de bois

L'église N° 1 à Butrint *se trouve à proximité du baptistère paléochrétien. Dans son état actuel on n'en conserve que les murs. Elle comporte le naos, le narthex qui a été revêtu plus tard et la pièce de l'autel séparée du naos par une iconostase en mur de pierres. La technique de construction se caractérise par des murs de pierres et briques disposées comme dans les églises byzantines récentes.*

L'église N° 2 à Butrint *est également en ruines, dont les restes s'étendent tout près des anciens murs d'enceinte à proximité de la porte «Skea». Elle manque du narthex et sa construction est analogue à celle de l'église mentionnée plus haut. En ce qui concerne la datation de ces deux monuments, par manque de points d'appui nous sommes enclins à l'attribuer à la période précédant l'occupation turque.*

L'église de Shën Sergj et de Baku à Himare *est considérée comme la cathédrale de l'ancien épiscopat de Himare. Elle comporte un narthex de construction récente et actuellement mise au jour, un naos et la pièce de l'autel séparé plus tard par une cloison de pierres. Ce monument se caractérise par la technique de construction de ses murs en pierres et morceaux de briques, l'abside circulaire de vastes proportions, ainsi que*

DO NOT COPY

par le fait qu'elle est dédiée au culte des deux martyrs syriens. Compte tenu de sa construction, il semble qu'elle appartient aux XIIIe-XIVe siècles.

L'église du prophète Ilia à Bubal de Përmet comporte un naos à angle droit prolongé, un narthex de construction plus récente et une cour ouverte dans sa partie méridionale. L'étude des murs de l'église a mis clairement en évidence ses parties anciennes et celles qui lui ont été ajoutées. Pendant les travaux de reconstruction a été détruit son mur occidental; on a ajouté dans son intérieur des pilastres se reliant entre eux et servant d'appui à la voûte détruite qui recouvre actuellement cette église après sa reconstruction. On a relevé deux couches de peinture, l'une couvrant les anciens murs et l'autre les pilastres. Les anciens murs sont en pierres et briques. Les briques sont disposées horizontalement parmi les pierres, en rangées verticales et inclinées (demi-briques) à proximité des briques verticales. Nous sommes donc en présence d'une technique de construction représentant une forme intermédiaire à celle des églises de Perondi, de Kozine et de Labove e Kryqit, ce qui induit à attribuer notre monument à une période allant de la deuxième moitié du XIe siècle à la première moitié du XIIe.

L'église de Sh. Jovan à Boboshtice (Korçe) comporte l'édifice de l'église même et une cour fermée sur son côté occidental de construction plus récente. De la construction se rapportant à la période précédant l'occupation turque, on ne conserve que ses murs septentrional et oriental en pierres équarries et briques. Ces dernières sont disposées en rangées horizontales et verticales parmi les briques et ne représentent en aucun cas un cloisonnage mais une déformation de celui-ci. Toutefois, ces deux murs et particulièrement le mur oriental ont un aspect attrayant en raison du contraste créée par la présence simultanée de la pierre et de la brique. Considérée sous ce prisme, en tant que déformation du cloisonnage, cette église appartient au XIVe siècle.

L'église de Shën Miter à Bezmisht de Korçe, à proximité du lac de Prespe, conserve les traces de maintes constructions successives. En ce qui concerne la période précédant l'occupation turque, il n'en reste que son mur oriental en pierres et briques, construit selon la technique du cloisonnage, soit deux briques verticales et deux rangées de briques horizontales. Ce qui nous induit à attribuer ce monument à la deuxième moitié du XIVe siècle.

L'église de Shën Kolei à Shelcan (Elbasan) est surtout renommée pour ses fresques peintes par Onufer. Son mur oriental, le seul appartenant à la période précédant l'occupation turque, n'est pas recouvert de mortier et est construit selon la technique du cloisonnage avec deux rangées de briques horizontales. Manquant de données directes sur la période de construction de ce monument, nous nous sommes fondés sur sa technique de construction pour l'attribuer à la fin du XIVe siècle.

C. Les églises à nef unique ayant une voûte

L'église de la Transfiguration à Herbel (Peshkopi), à ce que nous sachions jusqu'à présent est le plus ancien monument de l'architecture byzantine située dans la partie septentrionale du pays. C'est à cette période qu'appartient son mur oriental servant actuellement d'autel. La chapelle n'existe plus et l'église et couverte d'un toit de bois. Comme nous avons eu l'occasion de le constater pendant les travaux de conservation, dans le temps elle été couverte par une voûte cylindrique dont on ne voit aujourd'hui que les socles. Ses murs sont construits de pierres calcarées, de tufs et de briques. Celles-ci sont disposées entre les pierres et par endroits entre les rangées aussi. Nous sommes donc en présence d'une technique intermédiaire à celle des églises de Berat et de Perondi. Malgré les difficultés existantes pour la datation de cette chapelle, à notre avis elle doit appartenir aux XIIe-XIIIe siècles.

L'église de Maxhare à Mullet (Tirana), actuellement en ruines, se caractérise par une planimétrie à angle droit et comporte une abside circulaire s'élevant légèrement au-dessus du niveau du sol. Son mur oriental comme celui méridional conservent encore la partie initiale des voûtes construites de pierres. Les murs sont surtout de pierres ayant aussi des briques. Par suite de l'islamisation immédiate de cette zone, l'église en question doit appartenir aux XIIIe-XIVe siècles.

L'église de Shën Premte à Sop (Fier), actuellement en ruines, se situe dans la zone jadis marécageuse de Hoxhare. Il s'agit d'une petite église couverte d'une voûte en partie détruite. Sous son aspect extérieur, les murs se caractérisent par des traces de techniques différentes. Leur partie inférieure comporte des blocs de pierres et des briques disposées horizontalement parmi les pierres, comme dans le réfectoire du monastère d'Apollonie. Plus haut viennent quatre rangées de briques et de pierres surmontant la construction précédente. Encore plus haut il y a des adjonctions. L'ancien fronton du côté oriental est en cloisonnage. Etant donné que le réfectoire de notre monument se caractérise par une technique identique à celui du monastère d'Apollonie, nous sommes d'avis que cette église date les XIIIe-XIVe siècles.

DO NOT COPY

Koço ZHEKU

DO NOT COPY

SHTËPITË E BANIMIT NË KRAHINËN E TOMORICËS

Tomorica është një nga krahinat më të thella të zonës malore të Shqipërisë së Jugut dhe përfshin pjesën më të madhe të pellgut të lumit të Tomoricës. Kjo krahinë ka një përkufizim natyral të qartë, rrethuar nga vargu i maleve Bregu i Madh në anën lindore. Nga Jugu me malin Kulmak dhe nga ana perëndimore me malin e Tomorit.

Sipërfaqja më e madhe e krahinës së Tomoricës ka qenë mbuluar me pyje dhe kullota verore. Toka e bukës në kohën e kaluar ishte shumë e kufizuar përreth fshatrave. Në këto rrethana popullsia e kësaj krahine merrej kryesisht me blegtori dhe më pak me bujqësi.

Fshatrat që përfshihen në krahinën e Tomoricës janë të vendosura në të dyja anët e lumit që, siç e pamë, mban emrin e krahinës. Në anën e djathtë të rrjedhës së lumit, fshatrat zënë vend në dy breza, duke filluar nga lartësia 400-600 m ndodhen fshatrat Shëmbërdhenj i Poshtëm, Kotka, Lemnusha, Dobrej. Në brezin e sipërm prej lartësisë 650--850 m rreshtohen fshatrat Shëmbërdhenj i Sipërm, Ermenji, Vidhari, Sqinari, Burraj, Çorotati, Cerrica. Në anën e majtë të lumit nga lartësia 450 m deri në 850 m në rrëzë të Tomorit ndodhen fshatrat: Kërpicë, Terrovë, Romës, Dushk dhe Trebël. Fshatrat e kësaj krahine malore janë të vendosura në vende të mbrojtura nga rrymat e erërave të ftohta, në afërsi të burimeve. Në përgjithësi ato formohen nga dy-tri lagje me nga 5-15 shtëpi të ndërtuara në afërsi të njëra-tjetrës. Secili fshat ka pasur të përcaktuar mirë kufirin e territorit të tij ku përfshihej toka e bukës, kullota dhe pylli ku nxirren lënda e drurit për ndërtimin e banesave dhe për djegie.

Materiali mbi banesat e kësaj krahine që analizohet në këtë artikull është mbledhur gjatë një ekspedite të kryer në vitin 1964 në fshatrat: Shëmbërdhenj (i Poshtëm dhe i Sipërm), Ermenj, Vidhar, Dobrej, Romës, Terrovë dhe Kërpicë.

Nga analiza e materialit të grumbulluar në fshatrat e lartpërmendura, vihet re se banesat, me gjithë tiparet themelore të përbashkëta, kanë një larmi të madhe për sa i përket kompozimit, numrit të ambienteve dhe trajtimit arkitektural në përgjithësi. Në llojet e ndryshme të këtyre banesave gjejmë lidhje gjenetike që i bëjnë ato hallka të një zinxhiri të vetëm.

Banesat që merren në analizë janë të ndërtuara para kolektivizimit të bujqësisë dhe madje shumica e tyre para Çlirimit të Shqipërisë. Të nisur nga fakti i njohur që banesa është në radhë të parë edhe një pasqyrë, ku reflektohen të qarta kushtet shoqërore-ekonomike, respektivisht me kohën e ndërtimit të tyre, mendojmë se ja vlen që të bëjmë përpjekje për një shtresëzim shoqëror të banorëve që kanë banuar në këto banesa.

Banorët e kësaj krahine (për periudhën para Çlirimit) mund t'i ndajmë në tri shtresa kryesore: fshatarë të varfër, të mesëm dhe të pasur, pra si rrjedhim edhe banesat e tyre formojnë respektivisht tri grupe kryesore. Grupit të parë i përkasin banesat me një ose dy kthina banimi, grupit të dytë ato me tri kthina banimi dhe grupit të tretë shtëpitë e mëdha me 4-6 dhoma banimi të ndryshme.

Banesat janë njëkatëshe (përdhese) dhe dykatëshe. Në këto të fundit kati i parë përdoret zakonisht për strehimin e bagëtisë, kurse kati i dytë përdoret për banim. Në banesat njëkatëshe bagëtia strehohet në kasolle të ndërtuar në oborrin e banesës.

Format më primitive të banesës së hershme të Tomoricës përfaqësohen në kasollet, aksesorë të ndryshëm, të cilët kanë qenë në përdorim për strehimin e bagëtisë dhe depozitimin e ushqimit të tyre. Këto kasolle kanë qenë të ndërtuara me parete prej gardhi të thurura me purteka dhe të mbuluara me kashtë thekre. Kasollet kanë planimetri në formë eliptike dhe apsidoidale.



Fig. 1

Kasollet e Tomoricës për nga forma, materiali dhe teknika e ndërtimit janë replike të banesave të periudhave shumë të largëta dhe kanë arritur deri në ditët tona pa ndryshuar, thuajse asgjë, nga tipat e tyre fillestarë[1]).

Për sa i përket gjurmimit të formave më të thjeshta, në krahinën e Tomoricës me interes janë edhe ndërtimet që ngrihen si strehë provizore nga fshatarët që ruajnë prodhimet bujqësore në arat, të cilat janë larg fshatrave.

Këto strehë karakteristike (Fig. 1) kanë një konstruksion të njëllojnë me një gjysmëçati në formë samari (e prerë për së gjati). Dy furkat që mbajnë kulmin e strehës, janë të futura direkt në tokë. Këto strehë ndërtohen me drejtim të tërthortë me pjerrësinë e terrenit dhe shtrati i ndenjjes apo i rojtarit krijohet duke gërmuar terrenin derisa të krijohet një vend i sheshtë ose duke e krijuar shtratin me anën e një konstruksioni druri të thurur me thupra. Për ndërtimin e këtyre strehimeve përdoret i njëjti material që përdoret për kasollet.

Ambientet e banimit. Në banesën e Tomoricës ambienti kryesor ku zhvillohej jeta familjare e përditshme ka qenë **«shtëpia e zjarrit»** ose **«shtëpia e punës»**, siç e quajnë vendësit kthinën ku gatuhej e hahej buka dhe rrinin gratë e fëmijët. Shtëpia e zjarrit për familjet e varfra përdorej për fjetje dhe pritjen e miqve. Në banesat me shumë kthina shtëpia e zjarrit zë vendin kryesor në kompozimin planimetrik të banesës. Ajo ka hyrje të veçantë nga jashtë dhe komunikon përbrenda me odën e miqve dhe ambientet e tjera. Ka një planimetri në formë drejtkëndëshe me përmasa zakonisht 4.50 x 6.00 m. Në këtë ambient gjendet gjithmonë vatra e zjarrit, elementi kryesor i banesës fshatare. Vatra është e vendosur ngjitur me murin, në anën e ngushtë të shtëpisë së zjarrit. Ka formë katrori ose drejtkëndëshi me sipërfaqe 2.50 m^2 dhe ndërtohet me pllaka të vendosura horizontalisht të lidhura me llaç balte. Shtresa e dyshemesë së vatrës ngrihet 10 cm mbi truallin e ambientit. Në banesat dykatëshe vatra ndërtohet mbi një konstruksion prej druri të ndërtuar nën nivelin e trarëve të dyshemesë. Në sipërfaqen e rrafshtë të vatrës dhe në afërsi të oxhakut lihet një gropë me forma të ndryshme (katrori, drejtkëndëshi elipsoidal ose rrethor). Kjo gropë ndërtohet me thellësi 6-8 cm nga sipërfaqja e vatrës, në të ndizet, fillimisht zjarri dhe quhet **gropa e zjarrit.** Tymi i zjarrit del nëpërmjet oxhakut, por, meqenëse shtëpia e zjarrit është gjithmonë pa tavan, në kohën e dimrit, kur zjarri është i madh, tymi del me lehtësi edhe nëpërmjet çatisë.

Oxhakët e ndërtuar në shtëpinë e zjarrit janë mjaft karakteristikë dhe paraqiten në forma primitive, të cilat mund të konsiderohen si gjurmët e fazave fillestare të zhvillimit të tyre.

Shtëpia e zjarrit ndriçohet me 1 ose 2 dritare që zakonisht hapen me murin anës së oxhakut. Takohen raste që ndriçimi i këtij ambienti bëhej me anën e baxhave, vrima të hapura në mbulesën e çatisë. Ky ambient ka të bashkangjitur jashtë mureve perimetrale një nyje sanitare më vete. Në shtëpinë e zjarrit gjejmë orenditë e përdorimit të përditshëm që shërbejnë për gatimin e ushqimeve, për gatimin dhe pjekjen e bukës, sofrën dhe enët e ngrënies si edhe enët e përpunimit të bulmetit etj. Ambienti i dytë është oda, e cila përdoret kryesisht për pritjen e miqve dhe për fjetjen e pjesëtarëve të familjes. Ky ambient në banesën e Tomoricës zakonisht vendoset në katin e dytë e ka gjithmonë hyrje më vete dhe shkallë të veçanta si edhe një derë të brendshme që komunikon me shtëpinë e zjarrit.

Në shumicën e rasteve odën e miqve e gjejmë të bashkangjitur me shtëpinë e zjarrit, përmasat e saj janë përafërsisht 5.00 x 6.00 m. Ky ambient është gjithmonë i pajisur me vatër zjarri me oxhak të vendosur zakonisht përkarshi hyrjes. Në të dyja anët e oxhakut gjejmë dy kamare të vogla dhe dy dritare. Ajo është e suvatuar dhe e shtruar me dysheme e tavan të ndërtuar me dërrasa. Në anën e hyrjes së odës së miqve zakonisht ndërtohet një nëndarje, ndërtuar me skelet druri të veshur me dërrasa, ku

1) K. Zheku. **Të dhëna mbi kasollet fshatare të vendit tonë dhe gjurmët e tyre në Iashtësi.** Monumentet Nr. 5 – 1975.

BOTIMORY

zakonisht vendoset musandra e rrobeve të fjetjes, oda e miqve ka gjithmonë një nyje sanitare të veçantë dhe në shumicën e rasteve komunikon direkt me të.

Ambiente të tjera të banesës janë kthina që përdoren për fjetjen nga pjesëtarë të familjes, kanë pothuaj përmasa të përafërta me odën e miqve dhe me të njëjtin orendim. Ambientet ndihmëse të banesës janë hajati, divani, që shërbejnë kryesisht si hapësira qarkullimi ndërmjet ambienteve të banimit si edhe për depozitimin provizor të orendive, veglave të punës apo të prodhimeve bujqësore.

Ambientet sanitare (hamami dhe nevojtorja) në të shumtën e rasteve i gjejmë të ndërtuara si shtesa të planimetrisë kryesore të banesës, por të ndara njëri nga tjetri.

Në banesën dykatëshe në katin përdhes vendosen gjithmonë katonjtë, siç i quajnë vetë fshatarët stallat e bagëtisë; ndonjëri prej tyre përdoret edhe për depozitimin e prodhimeve blegtorale.

Kompozimi i banesës. Në kompozimin arkitektonik të banesave të Tomoricës vihet re një vendosje asimetrike e ambienteve të banimit në banesat dykthinëshe, kurse ato me më shumë ambiente banimi janë trajtuar në mënyrë simetrike si në planimetri, ashtu edhe në pamjen voluminore të përgjithshme të tyre.

Zhvillimi i mëtejshëm i banesës është arritur me vendosjen e ambienteve në fazën e parë pjesërisht bashkangjitur me bërthamën fillestare zakonisht në krahun e djathtë të saj dhe në fazën e dytë në të dyja anët e saj. Planimetria e banesës gjatë gjithë rrugës së zhvillimit të saj merr forma të thyera me dalje të theksuara të ambienteve në të dy krahët ose në qendrën e saj.

Në lartësi banesa e Tomoricës nuk ngrihet më tepër se dy kate, prandaj nga ana konstruktive ajo zhvillohet në drejtimin horizontal. Komunikimi me katin e dytë bëhet nëpërmjet shkallëve të jashtme. Në banesat me dy kate që kanë dy ose më tepër kthina, ndërtohen dy palë shkallë, nga të cilat njëra është prej druri, dhe u shërben vetëm pjesëtarëve të familjes, kurse tjetra ndërtohet gjithmonë prej guri dhe i shërben odës së miqve.

Në banesat me planimetri në formë kryqi me dalje të theksuar të ambienteve në qendër të banesës, shkallët vendosen gjithmonë brënda banesës.

Si përfundim mund të shprehim mendimin se në banesën e Tomoricës gjejmë një zgjidhje racionale në vendosjen e ambienteve të banimit dhe të atyre ndihmëse si në shtrirjen horizontale ashtu edhe në zhvillimin vertikal të banesës. Në përgjithësi kompozimi i banesës dhe vendosja e saj inkuadrohet dhe kombinon mjaft mirë edhe me peisazhin e ambientit që e rrethon.



Fig 2

Fig. 2

Banesa me një kthinë banimi. Për krahinën e Tomoricës banesa më e thjeshtë ka qenë me një ambient të vetëm banimi, variante të ndryshme të saj kemi gjetur në katër nga fshatrat që përmendëm më sipër, janë dykatëshe dhe me planimetri katrori dhe drejtkëndëshi (fig. 2,3,4,5). Banesa të tilla njëkatëshe (përdhese) që do të ishin variantet fillestare të këtyre banesave nuk i kemi hasur në asnjë nga fshatrat që ne kemi parë.

Banesa që paraqitet në fig. 2. ka një planimetri katrori me përmasa të jashtme 5,50 x 5,50, kurse ato në figurat 3-4-5 kanë formë drejtkëndore me përmasa 7 x 5 m.

Banesa me planimetri katrore do të thoshim ka qenë tipi fillestar nga ka zënë fill banesa me mure guri e krahinës së Tomoricës.

Kthina e banimit, të cilën siç thamë e kemi në rastet konkrete në katin e dytë, ruan përmasat e katit përdhes, ajo është e shtruar me dysheme dërrasash të sharruara dhe pa tavan, ka një hyrje kryesore të hapur në murin gjatësor të ndërtesës dhe komunikon direkt me ambientet sanitare që ndërtohen gjithmonë si shtesë ngjitur mureve perimetrale të ndërtesës.

Banesat që kemi parasysh (fig. 2,3,4,5) janë variante të ngjashme njëri me tjetrin dhe ndryshojnë vetëm për sa i përket vendosjes së disa elementeve, si hyrja kryesore, vendosja e shkallëve, dritareve, va-

DO NOT COPY



Fig. 3

DO NOT COPY

trës së zjarrit dhe ambienteve sanitare. Vendosja e këtyre elementeve në rastet konkrete është zgjidhur nga vetë fshatarët sipas nevojave rrethanore, pjerrësisë së terrenit, lidhja e banesës me rrugët e fshatit dhe komunikimi i saj me anekset ndihmëse të banesës.

Banesa me dy kthina banimi. Ambienti i dytë që i shtohet banesës fshatare është kthina, e cila, siç e kemi thënë, përdoret kryesisht për pritjen e miqve dhe për fjetjen e pjesëtarëve të familjes, për funksionimin e tij kryesor ky ambient quhet oda e miqve.

Në banesat me dy kthina që kemi gjetur në krahinën e Tomoricës vihen re dy rrugë kryesore, nëpërmjet të cilave është arritur zhvillimi i tyre duke pasur gjithmonë si pikënisje banesën njëkthinëshe. Këto banesa i kemi gjetur të ndërtuara me një kat (përdhese) si edhe me dy kate. Në të dyja rastet kati i banimit paraqitet në variante të ngjashme njëri me tjetrin. Sikurse duket në banesën fig. 6, ambienti i dytë ishte i vendosur në anën e djathtë të shtëpisë së zjarrit dhe ngjitur me murin e saj dhe në një çati të përbashkët. Kjo vendosje pra na paraqet rrugën e parë të zhvillimit të banesës dykthinëshe në drejtimin horizontal. Në banesën fig. 7, oda e miqve është vendosur në katin e dytë, kurse shtëpia e zjarrit qëndron akoma në katin përdhes. Raste të tilla



Fig. 4

mund të merren si faza fillestare të zhvillimit të banesës në drejtimin vertikal.

Në fig. 8-9-10 (tab. I-II) paraqesim tri banesa me dy kthina, dykatëshe, të cilat vërtetojnë ngjashmëri në konceptin e formulimit arkitektonik ndërmjet tyre dhe respektivisht me banesat njëkthinëshe me dy kate.

Vendosja e odës së miqve pjesërisht të ngjitur, në drejtim të tërthortë ose paralel me shtëpinë e zjarrit dhe pjesërisht të dalë në fasadë të banesës, i jep planimetrisë së përgjithshme një formë të thyer. Me anën e kësaj vendosjeje është arritur edhe krijimi i një ambienti përpara hyrjes së shtëpisë së zjarrit. Ky ambient në banesën njëkatëshe merr emrin hajat dhe është disi i mbrojtur nga konditat atmosferike. Në banesat dykatëshe me një vendosje të tillë përveç hajatit, krijohet një çardhak i vogël, ku dalin shkallët që të çojnë në shtëpinë e zjarrit.

Në anën e mbrapme të banesës, në qoshen që krijohet me zhvendosjen e odës së miqve përpara, ndërtohen zakonisht ambientet sanitare që i përkasin kësaj së fundit. Ambientet sanitare, sikundër shihet në variantet e tjera, nuk zënë ndonjë vend të caktuar në planimetrinë e banesës dykthinëshe. Kjo gjë na bind edhe më tepër se këto ambiente i janë afruar banesës fshatare të kësaj krahine në kohët e vona.

Në drejtim të rrugës që përmendëm nuk kemi gjetur gjurmë të tjera që të tregojnë për një zhvillim të mëtejshëm, pra mund të themi se në këtë mënyrë është arritur ndërtimi i një banese, e cila ka plotësuar, me sa duket, të gjitha nevojat e jetesës për një familje me një ekonomi mesatare. Kjo zgjidhje, për sa i përket vendosjes së ambienteve të banimit, është përdorur që prej shumë kohësh si një tip banese shumë i preferuar në këtë krahinë.

Rrugën e dytë për sa i përket zhvillimit të banesës mund ta ndjekim me lehtësi në banesat që paraqesim në figurat 11-12 (tab. II-III). Banesat në fjalë na paraqesin një planimetri në formë drejtkëndëshi të zhvilluar në drejtimin horizontal. Ambientet e banimit janë vendosur përkundrejt njëri-tjetrit dhe janë të ndara me anën e një ambienti plotësues siç është hajati për banesat njëkatëshe ose divani për ato dykatëshe. Në rrugën e parë që përshkruam më sipër që të dyja këto ambiente plotësuese ishin krijuar jashtë mureve perimetrale të banesës.

Me një vendosje të tillë vërejmë se banesa ka në të gjitha variantet një hyrje qendrore të vetme, e cila në banesat dykatëshe përdoret nga pjesëtarët e familjes gjithashtu edhe për futjen e kafshëve që, siç kemi thënë në këto raste, strehohen në katin e parë të banesës. Një veçori e këtyre banesave është vendosja e shkallëve në hajat dhe gjithmonë përbrenda banesës.

Ambientet kryesore të banimit ruajnë gjithmonë karakteristikat e tyre, sikundër i kemi përshkruar edhe në banesat e mësipërme.

Një tjetër karakteristikë që e gjejmë në të gjitha banesat e këtij lloji, është vendosja e hyrjes kryesore (1.00 m deri 2,50 m). më brenda mureve të fasadës, duke i krijuar në këtë mënyrë portës një pozicion disi të mbrojtur. Meqenëse në këtë mënyrë pakësohet sipërfaqja e hajatit, shpeshherë ky i fundit e fiton sipërfaqen e humbur duke dalë në gjithë gjerësinë e tij në anën e mbrapme të banesës. Kjo zhvendosje e hajatit krijon kushte të përshtatshme për



Fig 5

Fig. 5

PHOTOCOPY



Fig. 6

ndërtimin e ambienteve sanitare në të dyja qoshet që formonohen në këtë rast prapa banesës.

Në banesat dykatëshe të këtij lloji vërejmë se sipër portës kryesore ndërtohet zakonisht një ballkon i vogël, i cili komunikon me divanin. Siç do të shohim në vazhdim, ky ballkon zhvillohet edhe më tej duke marrë pamje të ndryshme.

Duke pasur parasysh numrin e banesave të ndërtuara me një planimetri e vendosje të tillë, mund të themi se edhe këto banesa përbëjnë një lloj më vete të banesës me dy ambiente banimi.

Banesa me tri kthina banimi. Banesat me tri kthina banimi i gjejmë të ngjashme me të dyja tipet e banesave dykthinëshe që përshkruam më sipër. Por, duke u bazuar vetëm në ato variante banesash që kemi gjetur në këtë krahinë, mendojmë se forma e planimetrisë së banesës trikthinëshe është zhvilluar duke pasur si bazë planimetrinë e banesës dykthinëshe. Kjo gjë jo vetëm që duket po të krahasojmë banesën fig. 13 (tab III) me ato që paraqiten në fig. 11-12, (tab II-III), por vërtetohet edhe nga vetë fakti që shtëpia e zjarrit është e vendosur në mes të dy ambienteve të tjera, odës së miqve dhe odës së fjetjes. Pra ambienti i tretë (oda e fjetjes) është shtuar në krahun tjetër të shtëpisë së zjarrit, përkundrejt odës së miqve.

Banesa trikthinëshe që kemi paraqitur në figurën 13 (tab III) e kemi gjetur në fshatin Shëmbërdhenj. Kjo banesë është nga më të vjetrat që ruhen deri në ditët tona. Ndërtimi i saj nuk mbahet mend nga pronari që banon sot në të. Kjo banesë jo vetëm që ka një formë planimetrie afërisht të përbashkët me banesat fig. 12-14, (tab III-IV); por edhe vendosja dhe madhësia e ambienteve të banimit



Fig. 7

DO NOT COPY

është pothuaj krejtësisht me përmasa të njëllojta. Kjo gjë lejon të supozojmë se mjeshtrat popullorë në të kaluarën kishin përmasa të caktuara për ndërtimin e njërit apo tjetrit variant banese.

Banesa fig. 14 (tab IV), paraqet një interes të veçantë, për arsye se në të gjejmë të ndërtuar në një qoshe, ngjitur me hajatin, një ambient të ri, i cili nuk përsëritet në banesat e tjera. Ky ambient ruan të gjitha karakteristikat e një kulle të vogël, e cila ka vetëm një kthinë të ndërtuar në një lartësi që ngrihet përmbi çatinë e banesës. Hyrja e kullës, mjaft e sigurtë, kalon nëpërmjet odës së miqve. Ngjitja për në kullë bëhet me anën e një palë shkallëve prej druri të vendosura në të djathtë të hyrjes. Kulla është e shtruar me dysheme dërrasash, ka tri dritare të vogla dhe një vatër zjarri pa oxhak. Mungesa e këtij të fundit na tregon se përdorimi i kullës ishte shumë e kufizuar dhe ngrohja bëhej, me sa duket, me anë të prushit të ndezur.

Në këtë kullë nuk gjejmë ndonjë shenjë që të tregojë se ajo ishte ndërtuar me qëllim mbrojtjeje nga ndonjë mësymje e papritur, mendojmë se ajo më tepër është një ndikim i huaj për këtë krahinë. Në grupin e banesave trikthinëshe mendojmë të hyjnë edhe banesa që paraqitet në fig. 15. (tab. IV). Sikundër vërehet edhe në planimetrinë e saj, ajo na paraqet një variant, prejardhjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të të cilit nuk kemi mundur ta shpjegojmë. Me rezervë mund të themi se ky variant është një zhvillim i banesës dykthinëshe duke vendosur odën e miqve në një drejtim dhe përbri shtëpisë së zjarrit. Në këtë mënyrë është krijuar banesa me dy hyrje të veçanta në fasadën e saj. Ky supozim gjen mbështetje edhe nga fakti se ambienti i tretë që është vendosur në drejtim të tërthortë me fasadën e banesës është një shtesë e bërë më vonë, sikundër pohohet nga pronari i banesës.

Banesa që paraqitet në fig. 16 (tab. V) është gjithashtu shumë e vjetër dhe ndërtimi i saj nuk mbahet mend. Në këtë banesë ruhen akoma edhe sot gjurmë që tregojnë disa elemente të arkitekturës popullore që ishin në përdorim në kohët më të lashta në krahinën e Tomoricës. Një nga këto elemente që na tërhoqi vëmendjen e gjejmë në odën e miqve të kësaj banese. Në këtë banesë vërejmë se gjysma e fasadës së katit të dytë është e ndërtuar me një konstruksion druri, veshur nga brenda me dërrasa të vendosura në drejtim vertikal. Në këtë pjesë të fasadës përfshihen porta kryesore e banesës, dy dritare me kafaz druri dhe një konstruksion druri (fig. 21) i dalë nën strehë të çatisë. Në anën e brendshme ky konstruksion është i gjithi i hapur dhe përdoret për vendosjen e enëve me bulmet në stinën e verës.

Vendosja e ambienteve të banimit në këtë banesë na duket diçka e veçantë edhe për vetë faktin se hyrja kryesore e banesës të çon menjëherë në odën e miqve, kurse hyrja e shtëpisë së zjarrit dhe e odës së fjetjes bëhet po nëpërmjet odës së miqve. Një qarkullim i tillë përbrenda banesës, siç e kemi vënë re në banesat e tjera, evitohet me çdo kusht, pra mendojmë se ambienti që sot e gjejmë, oda e miqve, është përdorur më përpara si një divan apo çardhak i mbyllur.

Banesa me shumë kthina banimi. Sikundër kemi thënë që në fillim banesat me shumë ambiente banimi ndërtoheshin në të kaluarën nga shtresat e pasura të fshatit. Banesa të tilla kemi gjetur në Vidhar (Fig. 17, tab V), Dobrej (Fig. 18 tab VI). etj. Këto banesa, për sa i përket planimetrisë, paraqesin variante të ngjashme njëri me tjetrin, të cilat tregojnë fazën më të zhvilluar të banesave trikthinëshe. Karakteristika e këtij zhvillimi është pjesë qëndrore e banesës, kurse ambientet anash mbeten të pandryshuara.

Në fazën e parë të këtij zhvillimi vërehet dalja e hyrjes qendrore të banesës në plan të parë të fasadës. Në zhvillimin e plotë të këtij varianti planimetria merr formën karakteristike të një kryqi me krahë pothuajse të barabartë. Nga dalja përpara që bëhet në të dyja katet e banesës shtohet sipërfaqja e hajatit e po ashtu dhe ajo e divanit. Në fazën e dytë portën kryesore të banesës e gjejmë në një plan me ambientet që ka anash. Përpara saj krijohet një portik me një ose katër harqe (Fig. 18 tab VI). Në katin e dytë gjejmë odën e pritjes të vendosur sipër portikut. Kjo banesë na paraqet njëkohësisht variantin më të përkryer të banesës që kemi gjetur në krahinën e Tomoricës.

Në këtë banesë ambientet sanitare si në katin e parë ashtu edhe në katin e dytë janë përfshirë brenda planimetrisë së banesës. Kjo gjë na tregon se këto ambiente janë bërë tashmë të nevojshme për secilin ambient banimi.

Në fig. 19, tab VII, paraqesim një banesë, e cila tregon përpjekjen e një fshatari për të ndërtuar një banesë të tillë, por, siç duket, gjendja ekonomike nuk e ka lejuar t'ia arrijë qëllimit dhe, siç shihet, banesa është ndërtuar vetëm përgjysmë.

Në fshatin Dobrej kemi gjetur një banesë, e cila si nga forma e planimetrisë, nga vendosja e ambienteve dhe pamja e jashtme e saj nuk ka asnjë element të përbashkët, me banesat vendëse (fig. 20). Simbas informatave që morëm nga pronarët e sotëm, kjo banesë ka qenë pronë e një fshatari të ardhur në këtë fshat nga krahina e Gjirokastrës. Pronari i i parë i kësaj banese, sipas mendimit tonë, duhet të ketë qenë vetë mjeshtër murator, vetëm në këtë mënyrë mund të shpjegohet ndërtimi i një banese, e

DOKTORI



Fig. 20

cila ruan kaq me besnikëri elemente arkitektonike të banesës së rrethit të Gjirokastrës. Kjo gjë shihet shumë qartë në teknikën e ndërtimit, sidomos në kornizën karakteristike të strehëve. Këtë element konstruktiv dhe shumë dekorativ e gjejmë në banesat e qytetit e të shumë fshatrave të rrethit të Gjirokastrës. Kjo influencë e huaj për krahinën tonë nuk ka ndikuar në as edhe një rast në banesat e ndërtuara më vonë në këtë fshat.

Ndërtimi i banesave. Banesat fshatare të krahinës së Tomoricës janë me mure guri të lidhura me llaç balte dhe me breza druri të vendosur çdo 0.80 — — 1.10 m lartësi muri. Gurët janë të nxjerrë nga formacionet ranore, që gjenden me shumicë pranë çdo fshati. Muret kryesore mbajtëse kanë një trashësi që luhat nga 0.60 m për banesat përdhese, deri 0.80 m për banesat dykatëshe. Muret e brendshme janë 0.50-0.65 m. Ndarjet që bëhen në ambientet e fjetjes për vendosjen e musandrave dhe të dollapëve ndërtohen me skelet druri të veshur nga një anë me dërrasë. Një teknikë të tillë e gjejmë të përdorur edhe për ndërtimin e disa mureve të jashtme në katin e dytë të dy banesave. Fugaturat në muret me gurë nga jashtë bëhen me llaç gëlqereje për të mënjanuar futjen e ujit të shiut në kohën e rreshjeve me erë.

Qoshet e mureve dhe paturat e dyerve dhe të dritareve ndërtohen me gurë të latuar me daltë ose të gdhendur me çekiç. Ambientet e banimit janë të suvatuara me llaç balte ose gëlqereje dhe të lyera me sherbet gëlqereje të bardhë. Çatia e banesës është me katër flegra dhe e ndërtuar me konstruksion druri që mbështetet në muret mbajtëse. dhe trarët e tavanit. Mbulesa e saj bëhet gjithmonë me rrasa guri. Strehët e çatisë dalin jashtë vertikalitetit të mureve normalisht 60-70 cm.

Ambientet e banimit në banesat përdhese shtrohen me baltë të ngjeshur, kurse në banesat dykatëshe me dysheme prej dërrase të sharruar. Tavanet që zakonisht përdoren vetëm në odën e miqve dhe ngandonjëherë në ato të fjetjes, ndërtohen me dërrasa të holla, Fugaturat e tavanit mbyllen me listela me profile të thjeshta. Në banesat e mëdha të ndërtuara rreth viteve 30 në ambientet kryesore tavanet janë trajtuar në mënyrë të veçantë si në formë, kompozim të sipërfaqes, ngjyrës së dërrasave dhe janë të njëllojta me tavanet e banesave të qyteteve të kohës së tyre.

Dyert dhe dritaret Në banesën e kësaj krahine dyert e hyrjeve kryesore si edhe ato të ambienteve të brendshme të saj janë të ndërtuara zakonisht në mënyrë të thjeshtë me dërrasa të mbërthyera mbi tre binarë horizontalë. Por në disa raste kemi vënë re se dyert kryesore si ajo e shtëpisë së zjarrit dhe e odës së miqve janë shpesh të dekoruara me figura gjeometrike të formuara me anën e gozhdëve me kokë të mëdha ose me anën e kornizave të profiluara të mbërthyera në sipërfaqen e dukshme. Këto dekorime shpeshherë janë punuar shumë bukur dhe të lënë përshtypjen se mjeshtrat marangozë që kanë punuar në këtë krahinë kanë lënë gjurmët e tyre që tregojnë se ata kanë zotëruar shumë mirë mjeshtrinë e punimit të drurit.

Mbyllja e dyerve bëhet nga ana e brendshme me anën e llozeve, të cilat rrëshqasin nëpërmjet një kanali që është lënë posaçërisht në kohën kur janë ndërtuar muret e banesës. Për fiksimin e dyerve në gjendje të hapur ose të mbyllur përdoret gjerësisht sistemi i madallave të dhëmbëzuara.

Forma më e vjetër e mbulesës së hapësirës së dyerve kryesore të banesës ka qenë gjysmëharku i formuar me gurë të gdhendur.

Ambientet e banimit ndriçohen me anën e dritareve të hapura në të katër muret perimetrale të banesës. Dritaret kanë hapësirë me formë drejtkëndëshi dhe të harkuara në pjesën e sipërme. Në ambientet e katit të parë, kur këto përdoren si stalla bagëtish, dritaret janë shumë të vogla, por, edhe

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 21

kur ambientet e katit të parë përdoren për banim, dritaret janë gjithmonë më të vogla nga ato të katit të dytë.

Dritaret më të vjetra kanë qenë me kafaz druri të gdhëndur me sqepar, me një mënyrë që, kur kryqëzoheshin binarët vertikalë të kafazit me ata horizontalë, formoheshin hapësira drite në formë kryqi të brendashkruar në rrathë të vegjël. Ky lloj kafazi përdorej zakonisht në dritaret e fasadës së banesës dhe sidomos në ato të odës së miqve.

Kafazi më i thjeshtë në dritaret e shtëpisë së zjarrit bëhet me anën e një binari, i cili futet në dy kllapa të hapura në 1/3 e lartësisë së kasës së dritares dhe një binari tjetër më të shkurtër të vendosur vertikalisht. Në këtë mënyrë hapësira kryesore e dritareve ndahet në tri hapësira, një e madhe e dy të vogla nën të. Të gjitha dritaret e banesës mbyllen nga brenda me kanat prej dërrase, me një ose dy fletë.

Në dritaret e katit të parë vihen re edhe kafazë hekuri të rrumbullakët të kryqëzuar në drejtim horizontal dhe vertikal.

Dritaret në formë drejtkëndëshi arkitraun e kanë prej një guri të gdhendur. Në këto raste sipër tyre ndërtohen harqe prej guri në formë gjysmërrethi të plotë (forma më e vjetër) ose harqe me majë të mprehtë.

Shkallët e banesës ndërtohen prej druri ose edhe prej guri. Ato ndërtohen prej druri kur janë të vendosura jashtë banesës, në hajat që është gjithmonë një ambient i mbuluar, ose kur vendosen brenda banesës. Shkallët e ndërtuara me mur guri, të shtruara me gurë të gdhendur, janë të vendosura gjithmonë jashtë, bri mureve të banesës. Këto lloj shkallësh përfundojnë në një shesh pushimi përpara hyrjes së banesës. Ky shesh pushimi është i shtruar me dërrasa dhe i mbuluar zakonisht nga zgjatimi i strehës së çatisë, e cila në këto raste mbështetet në dy shtylla druri. Këto lloj shkallësh, të cilat, duke qenë të mbështetura për mur të banesës, në përgjithësi nuk kanë parmakë gjatë ngjitjes as edhe në sheshpushimin e tyre. Gjerësia e shkallëve prej druri është zakonisht 1.00 m dhe e atyre prej guri luhat nga 1.00 m deri në 1,20 m.

Nga analiza e materialit që paraqitëm mbi banesat e Tomoricës mund të arrijmë në përfundimin se banesa njëkthinëshe me planimetri katrore ka qenë banesa fillestare prej guri në këtë krahinë dhe zhvillimi i saj i mëtejshëm ka ndjekur rrugë të ndryshme duke përfunduar në banesën në formë kryqi.

DO NOT COPY





KATI I



KATI II



KATI II



Fig. 8



KATI I

0 1 2 3 4m

Fig. 9





KATI I



KATI II

Fig 10





KATI I



KATI II

Fig 11

DO NOT COPY

DO NOT COPY





Fig 12



Fig 13



KATI I



0 1 2 3 4m



KATI II

0 1 2 3 4m



Fig 14

KATI III





KATI I KATI II

Fig 15

DO NOT COPY









Fig 16





Fig 17

DO NOT COPY







Fig 18



Fig 19

DO NOT COPY

Koco ZHEKU

LES MAISONS D'HABITATION DE LA REGION DE TOMORICE

DO NOT COPY

RESUME

Tomorice est une des régions la plus reculée de la zone montagneuse de l'Albanie méridionale et embrasse la plus grande partie de la vallée du fleuve de Tomorice. Cette région a des limites naturelles évidentes, en direction est elle est entourée par la chaîne des montagnes de Bregu i Madh et en direction ouest par le mont Tomorri. Les villages de cette contrée s'étendent sur les deux rives du fleuve. Sur son côté droit en aval sont disposées en deux rangées les villages de Shemberdhenj i poshtëm, Kotka, Lemnushe et Dobrej, plus haut viennent Shemberdhenj i sipërm, Ermenj, Vidhar, Sqinar, Burraj, Çorotat e Cerrice. Sur la rive gauche de la Tomorice, au pied du mont Tomor, sont alignés les villages de Kerpice, Terrove, Rome, Dushk et Trebel.

Dans la majorité des cas ces villages sont disposés à proximité des sources d'eau et en des endroits n'étant pas exposés à la rigueur des vents glaciaux. Chacun de ces villages comprend de deux à trois quartiers ayant pas plus de 5 à 15 maisons construites les unes auprès des autres.

Le matériel relatif aux habitations de cette région, examiné dans cet article, a été recueilli au cours d'une expédition effectuée en 1964 dans les villages de Shemberdhenj (bas et haut), d'Ermenj, de Vidhur, Rome, Dobre, Terrove et Kerpice.

L'analyse du matériel relatif aux villages précités a montré que leurs habitations, malgré les traits fondamentaux qui leur sont communs, se caractérisent par une grande variété quant à leur composition, le nombre des pièces qu'ils contiennent et leur traitement architectural en général. Dans les différents types d'habitation l'on relève des liens génétiques qui en font les maillons d'une seule et même chaîne.

Les habitations examinées ont été construites avant la collectivisation des campagnes, voire même avant la Libération de l'Albanie. Partant de la vérité notoire que l'habitation est avant tout un miroir reflétant clairement les conditions socio-économiques à l'époque de leur construction, à notre avis il serait utile d'étudier la stratification sociale des habitants de ces maisons.

Les habitants de cette région (dans la période d'avant Libération) peuvent être répartis en trois couches principales: paysans pauvres, moyens et riches, en conséquence leurs habitations aussi constituent respectivement trois groupes principaux. Au premier groupe appartiennent les maisons à une ou deux pièces, au deuxième groupe les maisons à deux ou trois pièces et au troisième les maisons plus grandes ayant de 4 à 6 chambres.

Ces habitations sont à un étage (au rez-de-chaussée) et à deux étages, dans ces dernières le premier étage étant habituellement destiné aux animaux et le deuxième aux habitants. Dans les habitations à un étage les animaux sont logés dans une cabane construite dans la cour.

Les formes primitives de l'ancienne maison de Tomorrice sont représentées par les chaumières, servant au logement des bestiaux et à l'entreposage de leur nourriture. Ces chaumières avaient des parois en treillage et elles étaient couvertes d'un toit en paille de seigle. Quant à leur planimétrie, elle était de forme elliptique et apsidoïdale.

Les chaumières de Tomorrice, quant à leur forme, les matériaux de construction employés et leur technique de construction, sont une réplique des habitations les plus anciennes et n'ont pas presque perdu leurs traits initiaux jusqu'à nos jours.

En ce qui concerne les formes encore plus simples de ce genre d'habitation, dans la région de Tomorrice présentent un certain intérêt les hangars provisoires construits par les paysans pour conserver les produits agricoles dans les champs se trouvant loins du village.

Ces abris caractéristiques (fig. 1/a) ont une construction ressemblant à un demi-toit en forme de selle (coupé longitudinalement).

Dans l'habitation de Tomorrice la pièce principale était représentée par la «maison du feu» ou la «maison du ménage», comme les habitants du pays appellent la pièce où les femmes préparaient la nourriture et passaient la journée avec leurs enfants. La «maison de feu» servaient aux paysans pauvres à la fois de chambre à coucher et de chambre des amis. Dans les habitations à plusieurs pièces, la maison du feu occupe la place principale dans la composition planimétrique. On y accède de l'extérieur par une entrée particulière et elle communique à l'intérieur avec la chambre des amis et les autres pièces de la maison. Elle se caractérise par une planimétrie rectangulaire généralement de dimensions 4,50 x 6,00 m. Dans cette pièce on trouve toujours le foyer, élément essen-

DO NOT COPY

tiel de l'habitation paysanne et contiguë au mur, du côté plus étroit de la «maison du feu».

La «maison du feu» est illuminée par 1 ou 2 fenêtres aménagées habituellement dans le mur près du foyer. Parfois l'illumination de cette pièce est assurée par une lucarne aménagée dans la couverture du toit. Dans la «maison du feu» nous trouvons les ustensiles de ménage servant à la préparation de la nourriture et du pain, la table à manger, la vaisselle et d'autres récipents servant au traitement du lait.

La deuxième pièce, par ordre d'importance, est la «chambre des amis» servant principalement à recevoir les amis et de chambre à coucher aux membres de la famille. Cette pièce se trouve d'habitude au deuxième étage dans l'habitation de Tomorrice, elle dispose toujours d'une entrée distincte et des escaliers particuliers et d'une porte intérieure communiquant avec la «maison du feu».

Dans la majorité des cas la «chambre des amis» est contiqü a la «chambre du feu», ces dimensions sont approximativement 5.00 x 6.00 m. Elle est toujours dotée d'un foyer à chéminée disposé généralement en face de l'entrée.

Les autres pièces de l'habitation sont celles où dorment les membres de la famille. Les pièces auxiliaires sont le hayat, le divan, et servent principalement d'espace assurant la communication entre les pièces d'habitation et l'entreposage provisoire des ustensiles de ménage, des instruments de travail ou des produits agricoles.

En ce qui concerne les noeuds sanitaires (le hammam et la toilette), dans la majorité des cas ils constituent des adjonctions de la planimétrie principale de la maison, mais sont séparées les unes des autres.

Dans les maisons à deux étages, le rez-de-chaussée est toujours destiné au logement des bestiaux, parfois même à l'entreposage des produits animaux.

La composition architectonique de l'habitation de Tomorrice se caractérise par une disposition asymétrique des pièces destinées à l'habitation dans les maisons à deux pièces, tandis que dans celles ayant un plus grand nombre de chambres on relève un traitement symétrique soit pour ce regarde la planimétrie que le volume général.

L'évolution ultérieure de ce type de maison se caractérise dans la première phase par la disposition partielle des pièces tout près du noyau initial, d'habitude sur son côté droit, et plus tard, au cours de la deuxième phase, sur ses deux côtés. La planimétrie de ce type d'habitation, pendant son évolution, acquiert des formes brisées avec une disposition plus en saillie des différentes pièces sur ses deux côtés ou en son milieu.

En hauteur l'habitation de Tomorice a tout au plus deux étages, aussi sur le plan de la construction se développe-t-elle en direction horizontale. La communication avec le deuxième étage est assurée par des escaliers disposés hors de l'habitation.

L'habitation à une seule pièce. — En ce qui concerne la région de Tomorice, l'habitation la plus simple a été celle à une seule pièce. Nous avons repéré certaines de ses variantes dans quatre des villages mentionnés plus haut, elles sont à deux étages et se caractérisent par une planimétrie carrée et rectangulaire. De telles habitations à un étage (au rez-de-chaussée), vraisemblablement les variantes initiales de ce type de maison, nous ne les avons trouvées en aucun des villages susmentionnés.

L'habitation de la figure 1 a une planimétrie carrée avec des dimensions extérieures 5,50 x 5,50, tandis que celles des figures 3, 4 et 5 sont de forme rectangulaire et de dimension 7 x 5 m.

L'habitation à planimétrie carrée, à notre avis, représente le type initial dont s'est inspiré la maison en murs de pierres de la région de Tomorrice.

Les maisons à deux pièces rencontrées dans la région de Tomorrice ont suivi deux voies principales de développement, mais ayant toujours comme point de départ l'habitation à une seule pièce. Ces types de maison sont à un étage (au rez-de-chaussée) et à deux étages. Dans les deux cas l'étage destiné à l'habitation se présente en différentes variantes semblables les unes aux autres. Comme on le voit dans l'habitation de la fig. 6, la deuxième pièce est disposée à droite de la «maison du feu», partageant un mur avec celle-ci, et sous un toit commun. Cette disposition indique donc la première voie de développement de l'habitation à deux pièces en direction horizontale. Dans l'habitation de la figure 7, la chambre des amis se trouve au deuxième étage, tandis que la «maison du feu» encore au rez-de-chaussée, ce qui montre que nous sommes en présence des premiers-exemples de développement de l'habitation en direction verticale.

Les figures 8, 9 et 10 reproduisent trois habitations à deux pièces et à deux étages, se caractérisant par une analogie quant à la conception architectonique entre elles et par rapport aux habitations à un étage ayant une seule pièce.

Les figures 11 et 12 représentent la deuxième voie de développement suivie par l'habitation de Tomorrice. Nous sommes en présence d'une planimétrie rectangulaire qui s'étend en direction horizontale. Les pièces destinées à l'habitation sont disposées les unes en face des autres et séparées par une pièce complémentaire, qui est le «hayat» dans les maisons à un étage et le «divan» dans les maisons à deux étages. Dans la première voie de développement décrite plus haut ces deux pièces complémentaires se trouvaient hors des murs délimitant l'habitation.

L'habitation à trois pièces. — Les habitations à trois pièces sont analogues aux deux types d'habitations décrites un peu plus haut. En nous basant seulement sur les variantes de maisons trouvées dans la région de Tomorrice, nous pensons que la forme de la planimétrie de la maison à trois pièces s'est développée à partir de la planimétrie de l'habitation à deux pièces.

La maison de la figure 14 présente un intérêt particulier du fait que dans un de ses angles, à proximité de la «mai-

son du feu», a été construite une pièce nouvelle que l'on ne retrouve pas dans les autres types d'habitation. Cette pièce conserve toutes les caractéristiques d'une petite tour («kulle») s'élevant au-dessus du toit de l'habitation. La tour en question ne comporte aucun signe montrant qu'elle remplissait des fonctions de défense à l'égard d'une éventuelle attaque de l'extérieur, nous sommes donc en présence d'une influence étrangère à cette région.

L'habitation à plusieurs pièces appartenait aux couches aisées de la population rurale. Exemple les maisons de ce type rencontrées à Vidhar (fig. 17), Dobrej (fig. 18) et ailleurs. Leur planimétrie présente des variantes semblables les unes aux autres et témoigne la phase la plus évoluée de l'habitation à trois pièces. Cette évolution concerne principalement la pièce centrale de l'habitation, alors que les pièces latérales ne subissent aucune modification.

Dans la première phase de cette évolution l'entrée centrale occupe une place de premier plan dans la façade. L'évolution complète de cette variante se caractérise par le fait que sa planimétrie se présente sous la forme d'une croix ayant des bras de dimensions presque égales. Par suite de la disposition de l'entrée en premier plan dans les deux étages de l'habitation, nous avons un accroissement de la surface du «hayat» et du «divan». Pendant la deuxième phase la porte principale de l'habitation se trouve sur un même plan que les pièces latérales. En face de l'entrée principale se trouve un portique ayant un ou quatre arcs (fig. 20). Dans le deuxième étage la chambre des amis est disposée au-dessus du portique. Cette habitation représente dans le même temps la variante plus parfaite de ce type que nous avons trouvé dans la région de Tomorrice.

Construction des habitations. — Les habitations paysannes de la région de Tomorrice sont en murs liés avec de la boue et par des bandes de bois disposées à chaque 0.80-1.10 m. de hauteur.

En conclusion nous pouvons affirmer que la maison de Tomorrice présente une solution rationnelle quant à la disposition des pièces destinées à l'habitation et des pièces auxiliaires, soit en ce qui concerne l'extension horizontale que le développement verticale de l'habitation. En général la composition de l'habitation et sa disposition même s'encadrent et se combinent on ne peut mieux avec le paysage et le milieu environnant.

POOR COPY

DO NOT COPY

Emin RIZA
Hasan NALLBANI

NJË NDËRTIM I TIPIT KULLË NË BERAT

(Arkitektura, dekoracioni dhe restaurimi[1])

Në ansamblin e lagjes «Partizani (Gorricë) të qytetit-muze të Beratit, ndërmjet banesave, trajtuar në pamjet e tyre, kryesisht me erker e dritare të shumta, përpos disa ekzemplarëve me çardhak, shquan për kompozimin volumor dhe trajtimin e jashtëm arkitektonik një ndërtim, në pjesën e ulët të ansamblit, thuajse në qendër të tij[2]). Kompozimi në lartësi i këtij ndërtimi dhe karakteristikat e veçanta të elementeve arkitektonike e shkëpusin atë qartazi nga masa e ndërtimeve të lagjes ku ai ngrihet. Ai bart karakteristikat e njohura të banesave të tipit kullë. Në gjendjen e sotme, vetëm në pamjen kryesore dhe atë lindore, ndërtimi ruhet i pacënuar, ndërsa dy faqet e tjera kanë humbur mjaft nga pamja e tyre fillestare për shkak të ndërtimeve të mëvonshme bashkangjitur kullës, siç tregojnë qartë fugat në pjesët e kontaktit dhe mbyllja e dritareve të kullës në faqen perëndimore. Këtyre argumenteve themelore, lidhur me raportin në kohë të kullës me ndërtimet bashkëngjitur, i shtohet dhe trajtimi krejt i ndryshëm në planin arkitektonik i këtyre ndërtimeve. Pra në gjendjen fillestare kulla qëndronte si njësi më vete. Ndërtimet e mëvonshme rreth saj dhe kalimi në pronësi të ndryshme i kullës kanë krijuar gjendje të reja që janë pasqyruar në transformimet e vetë asaj dhe të ambientit rrethues. Kështu sot trualli përreth kullës është i copëtuar nga oborre të veçanta, që lidhen me ndërtimet e mëvonshme, duke bërë të pamundur krijimin e një ideje të saktë rreth truallit që rrethonte atë dhe, madje, të ekzistencës dhe formës së mureve rethuese. Në gjendjen e sotme kulla është në të njëjtin oborr me ndërtimin bashkëngjitur në jug të tij.

Qëllimi i këtij artikulli është të japë arkitekturën dhe dekoracionin e brendshëm të këtij monumenti unikal, me vlerë të veçantë jo vetëm për arkitekturën e banesës së qytetit të Beratit, por dhe të mbarë banesës qytetare shqiptare, punimet e restaurimit të kryera në të, të cilat nxorën në dritë dhe dekoracionin e brendësisë, si dhe ndryshimet që ka pësuar ndërtimi në kohë mbi bazën e rezultateve të punimeve të restaurimit dhe krahasimit me monumente të tjera.

Kulla në volum është një prizëm me bazë katërkëndësh kënddrejtë që ndahet në tri kate, me lartësi që vijnë duke u rritur, 205 cm, 253 cm, 342 cm (Fig. 1, 2, gjendja para dhe mbas restaurimit). Bashkëngjitur këtij volumi qëndron «kamerieja» pranë hyrjes për në ambientet e banimit të ndërtimit. Ajo mbahet nga dy qemerë cilindrikë me formuese veri-jug (Fig. 3, Tab. I, II). Platforma mbi të me nivel më të lartë se dyshemeja e katit të parë dhe në ndërlidhje me të rrethohet me një mur të ulët, pjesërisht përtej planit të strukturës mbajtëse, mbi gurë në formë konsoli, siç përgjithësisht përdoren në kamerietë e Beratit. Platforma e kamerieve shërbente si vend qëndrimi në stinët e ngrohta. Qemeri, që mbështetet me njërën thembër në murin lindor, duket qartë se është ndërtim i njëkohshëm me banesën, ndërsa fuga që fillon prej thembrës perëndimore të qemerit të dytë dhe vazhdon lart tregon se qemeri i dytë është një shtesë e mëvonshme. Trajtimi i tij konstruktiv dhe arkitektonik është i njëllojtë me pjesën origjinale të

1) Pjesa mbi arkitekturën është shkruar nga E. Riza, ajo mbi dekoracionin nga H. Nallbani. Rilevimi është kryer nga autori, E. Harxhi dhe B. Penxha, vizatimet janë të B. Penxhes, fotot të R. Veselit dhe H. Çollakut.

2) Ndërtimi ndodhet në Rr. Kristaq Tutulani Nr. 7.

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

kameries, përpos hapësirës së dritës rreth 40 cm më të madhe. Kati përdhe, është në pjesën më të madhe i pa shfrytëzuar, sepse është i mbushur me dhe, duke shërbyer vetëm si platformë për shtresën e katit të parë. Vetëm dy hapësira, një qilari i vogël, me hyrje nga hapësira nën qemerin e parë të kameries dhe një sterë e vogël, mbuluar të dyja me qemerë cilindrikë, përbëjnë volumet e shfrytëzueshme të këtij kati. Hapësira ndërlidhëse e qilarit në murin perëndimor, duket qartë se është e vonë. I paqartë mbetet zhvillimi planimetrik në perëndim të qilarit, siç duket tjetërsuar, lidhur me shtesat e mëvonshme. Stera furnizohet me tub qeramik të futur në trashësinë e murit (Fig. 4), sigurisht duke grumbulluar ujin e çatisë. Ajo ndërlidhet me ambientin mbi të për të bërë të mundshëm pastrimin. Marrja e ujit bëhet nga jashtë (Fig. 5). Mbi këtë kat të pabanuar, të shfrytëzuar vetëm pjesërisht, me anë të shkallëve të jashtme prej guri, mbi qemer cilindrik, të ndërtuar përbri kameries, kalohet në katin e parë. Porta e hyrjes, mbuluar nga jashtë me hark gjysmërrethor, më të thelluar se muratura, është njëflegërshe dhe sigurohet me katarah.[3]) Volumi i këtij kati ndahet në tri pjesë: në odën, në ballin e tij, në një ambient të vogël, improvizim i mëvonshëm, dhe në hapësirën ndërlidhëse me katin e sipërm, në të cilën gjejmë shkallët e thjeshta prej druri. Në faqet jugore të hapësirës ndërlidhëse një derë, e hapur vonë, siguron komunikimin e kullës me ndërtimet e mëvonshme, përbri kësaj faqeje. Një derë tjetër e hapur dhe e mbyllur gjithashtu më vonë, ka siguruar ndërlidhjen me ndërtimet shtesë në drejtimin perendimor të kullës. Në ambientin e improvizuar, krahas sajimit të tij, është hapur një dritare. Oda ka pothuaj formën e katrorit, ajo ndriçohej nga 12 dritare, të vendosura në dy breza paralel në lartësi (në gjendjen e sotme dritaret e faqes perendimore janë murosur, për shkak të ndërtimit mbështetur në të, gjithashtu në faqen veriore është hapur më vonë një dritare). Dritaret e sipërme kanë duke filluar nga jashtë rrjeta hekuri dhe dritare fikse prej skeleti allçie, një e dytë e tillë vendoset në drejtim të faqes së brendshme. Të poshtmet kanë nga jashtë një rrjetë hekuri në formë azhuri (kjo u është hequr më vonë dritareve nga lindja); shenjat tregojnë për ekzistencën e kapakëve të drurit përdorur në kasën e rrjetës prej hekuri. Të gjitha dritaret e poshtme mbu-

3) Një shul horizontal që rrëshqet në mur dhe siguron portën.



Fig. 3



Fig. 4

lohen me arkitra, ndërsa të sipërmet nga jashtë, në trashësinë e paturës me arkitra; kurse nga brenda me qemer. Oxhaku është ndërtuar në faqen lindore, tamburi i tij formohet nga pjesa e poshtme prizmatike ndërsa e sipërmja konike. Tavani (Fig. 6) prej druri ka në qendër një rozetë karakteristike. Në faqen perëndimore pranë hyrjes një sqoll i shërbente këtij ambienti (ai është mbyllur më vonë me ndërtimin përbri të ndërtesës tjetër). Duke shikuar tavanin, duket qartë se ndarja e lehtë që kufizon odën me hapësirën e prapme të katit është zhvendosur përpara disa cm.

Hapësira e katit të dytë ndahet në dy pjesë prej një perdeje me konstruksion çatmaje, e cila në pjesën e brendshme është trajtuar me tri thellime që kurorëzohen me hark. Sipas gjurmëve duket qartë se më vonë këto thellime, nën nivelin e sergjeneve, janë rrafshuar, ndërsa sipër dritaret me persiane janë mbyllur. Në dallim nga ambienti i poshtëm, oda e vetme e këtij kati ndriçohet nga 16 dritare gjithashtu të vendosura në dy breza në lartësi. Të gjitha dritaret e sipërme mbulohen me qemer, ndërsa të poshtmet me arkitra. Dritaret e sipërme, sipas shenjave, duket se kanë qenë me skelet allçie fiks në të dyja faqet, ndërsa të poshtmet në gjendjen e sotme kanë hekura nga jashtë dhe po në atë kasë flegrat e dritareve. Për të njëjtën arsye ashtu si dritaret e ambientit kryesor të katit të parë nga perendimi, dhe ato të odës së katit të dytë janë murosur më vonë. Oxhaku në faqen veriore, siç treguan ornamentet rreth tamburit, që tashmë s'ka asnjë gjurmë, duket se ka qenë dekorativ. Nga tavani nuk ruhej asnjë gjurmë. Hapësira e dytë e këtij kati nuk ka ndonjë funksion të përcaktuar. Të tërheqin vëmendjen dy dritare të vogla dhe mjaft të larta në faqen jugore dhe një e tretë më e madhe dhe më e ulët pranë faqes perëndimore. Gjithashtu një dritare e lartë është ndërtuar në faqen perendimore (ajo në faqen lindore është e mëvonshme). Nga jashtë, anash qoshes juglindore, duken hapësirat e dy frengjive.

Muratura është ndërtuar me gurë kave shtresor, thuajse në rreshta horizontalë, ajo lidhet me llaç gëlqereje dhe përforcohet me breza druri që nuk dalin në faqen e jashtme. Nga jashtë në muraturë duken vrimat e vendosjes së skelave për ndërtimin e saj. Muratura në lartësi vjen e ngushtohet nga brenda për çdo kat 5-10 cm. Ndërsa ka pësuar në shumë sipërfaqe dëmtime dhe rindërtime të suvasë origjinale. Duke vrojtuar gjurmët që ruhen, del se dora e parë ka qenë me llaç gëlqereje përzier ma kashtë, ndërsa dora e dytë me patinaturë gëlqereje përzier me fije liri. Dyshemeja e katit të parë është shtruar me pllaka guri, ashtu si dhe kamerieja, ndërsa ajo e katit të dytë sigurisht me dërrasa, prej së cilës nuk ruhet shtresa origjinale. Nga tavani i ambientit të katit të dytë nuk ruhej asgjë, por copa dërrasash të ornamentuara me ngjyra, gjetur në ndarjen që kufizon kë-

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6

të ambient nga jugu, tregojnë se ai ka qenë i dekoruar. Nga dyert e brendshme nuk ruhet asnjë në vendet e tyre por një flegër origjinale është ripërdorur më vonë për ambientin e improvizuar, në katin e parë, ndërsa dy të tjera i gjetëm në portën e jashtme të oborrit (Fig. 7). Këto janë punuar me teknikën me zemra në formë katrori dhe katërkëndëshi kënddrejtë, të kllaposura me bordurat e njohur gjerësisht në Gjirokastër.

Në gjendjen e sotme ndërtimi ka humbur mjaft në karakterin e ashpër monumental dhe hedhjen në lartësi për shkak të ndërtimeve përngjitur, që e bëjnë të vështirë përceptimin e tij veçuarazi tyre. Megjithatë prapë ndërtimi shquan në gjithë ansamblin e lagjes «Partizani». Ai formohet në volum prej dy njësish: kullës, me volum prizmatik mjaft të lartësuar dhe kameries me shtrirje horizontale dhe transparente për shkak të qemereve mbajtës, e cila sidoqoftë pa konkuruar volumin kryesor e gjallëron atë dhe i thyen disi karakterin monumental. Pamja e jashtme ku mbisundon muratura e gurit thyhet nga dritaret e grupuara çift në lartësi, të cilat me trajtimet e ndryshme janë të vetmet elemente arkitektonike që spikasin dhe lehtësojnë volumin e kullës. Tri pamjet; veriore, lindore dhe ajo perendimore janë barastrajtuar në dallim nga ajo jugore thuajse e shurdhër. Ndërtimi nga jashtë me karakterin e mbyllur dhe të ashpër flet mjaft qartë për tipin kullë të tij në kuptimin klasik të termit, dmth të një ndërtimi mbrojtës kompozuar në lartësi.

Restaurimi

Ndërtimi, siç do të përpiqemi të argumentojmë më poshtë, ka pësuar transformime të mëvonshme, qoftë në planin kompozicional, ashtu dhe në atë dekorativ; në këtë të fundit janë prurë vlera të reja. Argumenta të shumta provojnë ndryshimet që ka pësuar ndërtimi në kohë, kështu që gjendja fillestare mund të konceptohet, si të thuash, tipologjikisht, duke hedhur ide të qarta mbi formën fillestare. Por ato për sa u përket detajimeve mbeten në fushën e hipotezës dhe si të tilla nuk mund të shërbejnë kurrsesi si mbështetje për një restaurim rikonstruksioni, i cili përndryshe do të ishte i pranueshëm për karakterin e veçantë të këtij monumenti. Këto arsye shpjegojnë vendimin për ruajtjen e strukturës së sotme planimetrike me përjashtim të kthimit në gjendjen fillestare të perdes ndarëse të ambientit të katit të parë, siç ta sugjeron konturi i tavanit. Gjithashtu për vlerat e tyre, veçanërisht si pjesë e ansamblit të lagjes, ndërtimet e mëvonshme përngjitur kullës do të ruhen. Rikonstruksioni i pjesëve munguese u zbatua gjatë restaurimit me dy kritere të ndryshme, në disa raste u bënë përpjekje për rikompozim në bazë të

gjurmëve origjinale, siç u veprua me tamburin e oxhakut të ambientit të sipërm, ose u pranua rindërtimi i elementeve munguese që nuk kishin lënë asnjë gjurmë, me një teknikë fare të thjeshtë me funksione vetëm utilitare. Kështu u rindërtua tavani i ambientit të sipërm dhe dritaret e poshtme, si dhe ato të faqes së brendshme në brezin e sipërm. Punime plotësuese simbas teknikës ekzistuese u kryen në bordurën që rrethon kamerien. Punime me karakter rindërtimi u kryen dhe në strukturat e mureve kryesore dhe të çatisë. Një pjesë e mirë e murit lindor u prish dhe u rindërtua për shkak të dëmtimeve të rënda që kishte pësuar, gjithashtu konstruksioni i çatisë u rindërtua krejtësisht. Lidhur me strehët u pranua ajo dyfishe e hapur, duke u bazuar në disa elemente origjinale të ripërdorura më vonë në konstruksionin e çatisë. Në disa faqe, veçanërisht në ambientin mbas odës së katit të dytë, u kryen suvatime të reja. U vendos që të gjitha dritaret e hapura më vonë të mbyllen, ndërsa dera në ndërlidhje me pjesën jugore do të ruhet, mbasi i përgjigjet skemës së re planimetrike, e cila, siç përmendëm, nuk u ndryshua. Ambienti i improvizuar në katin e parë gjithashtu do të hiqet. Si përfundim restaurimi arkitektonik pranoi fazën përfundimtare në strukturën kompozicionale, me ndonjë përjashtim; kurse në elementet e veçanta konstruktiv dhe arkitektonik u pranua rikonstruksioni.



Fig. 7

Fig. 8



Dekoracioni

Gjatë sondazheve, në të dyja ambientet e banuara, u vunë re gjurmë të pikturës nën shtresat e sherbetit të gëlqeres, kështu që punimet e restaurimit u shtrinë dhe mbi pikturën murale, e cila mbas kryerjes së punimeve u zbulua krejtësisht.

Ndërtesa ka pësuar tri faza pikturimi në kohë të ndryshme. Piktura e fazës së parë në ambientin e sipërm përbëhet nga motive dekorative në trajtë baroke me shtrirje vertikale (Fig. 8,9). Në qendër janë forma elipsi, ose rrathë të kornizuar dhe mbushur me motive bimore ose peisazhe tepër lineare, me paraqitje kodrash dhe pemësh në funksion vetëm dekorativ pa trajtim volumor dhe shtrirje në prespektivë. Këto motive janë të shpërndara përgjatë një brezi dekorativ që kornizohet me bordure të kuqe, horizontalisht, në një të tretën e sipërfaqes së sipërme të mureve të dhomës. Bordura e kuqe përkufizon vertikalisht sipërfaqe katrore, që ndryshojnë në madhësi sipas sipërfaqeve të lira të kushtëzuara nga dritaret e dhomës. Këto të fundit janë gjithashtu të kufizuara me bordura të kuqe, që nga sipër zakonisht kanë të pikturuara pemë, ndoshta, për të krijuar një lidhje më të madhe me natyrën.

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 10

DO NOT COPY

Piktura, është tepër rudimentare dhe ngjyrat kufizohen vetëm në blu dhe të kuqe, të hapët. Gëlqerja ka shërbyer si e bardhë për të modeluar format në dritë. Gjithashtu po të kësaj faze ruhen gjurmë edhe sipër oxhakut dekorativ të dhomës së katit të dytë, që pasqyrojnë një drapëri dekorative të kuqe, të pikturuar me lule në ngjyrë blu. Poshtë brezit të pikturës nën sergjen ka qenë një fashaturë druri, e cila duhet të ketë qenë, gjithashtu e pikturuar. Gjurmë të saj gjejmë vetëm në odën e katit të parë, mbi brezin e drurit të faqes jugore.

Sistemi dekorativ i odës së katit të dytë, vazhdon edhe më tej ndarjes me çatma. Sipërfaqet e poshtëme të mureve të këtij ambienti nuk janë të pikturuara.

Piktura e fazës së dytë përdor gjërësisht motivin e luleve dhe të gjetheve të stilizuara, duke ndërtuar një sistem kuadratik të kornizuar me dy shirita të kuq dhe kafe. Gjithashtu, sipër këtyre ndarjeve kuadratike, shtrihet një fashaturë dekorative që shërben si një kornizë ndarëse midis tavanit dhe brezit të gjërë të pikturës. Në qendër të çdo ndarjeje dekorative, ndërtohen rozeta, ku pasqyrohen zakonisht peisazhe me paraqitje shtëpish, urash etj. (Fig. 10). Gjithashtu me motive të tilla (arabeska) janë pikturuar edhe strishet e nikeve të ndarjes së çatmasë (Fig. 11,12) Ngjyrat janë e kuqja, bluja, jeshilja, e verdha dhe e zeza. Oda e katit të parë gjithashtu është e dekoruar në pjesën e sipërme, në 1/3 e sipërfaqes së tre mureve, me breza të ndarë në kuadrate që ndryshojnë simbas sipërfaqeve të lira të mureve të dhomës (Fig. 13). Përveç brezit të pikturës që arrin poshtë deri në nivelin e sergjenit të drurit, sipërfaqet e lira të odës së katit të parë janë të dekoruara me një shirit prej gjethesh, që kornizojnë krejt pjesën e poshtme të mureve dhe brezin dekorativ nga sipër. Faqja lindore e odës së katit të parë, ku ndodhet një oxhak funksional, është e dekoruar edhe poshtë në të dyja anët e oxhakut mbi kamaret anësore, me motive dekorative më të pasura se pjesët e tjera të mureve (Fig. 14). Në brezin e sipërm të dekorit, përveç motivit floreal të stilizuar, përdoren gjerësisht: zambakë, karafilë e lule të tjera, të trajtuara në mënyrë tepër lirike dhe reale. Gjithashtu gjatë brezit dekorativ janë ndërtuar skena të plota me peisazhe të arkitekturës myslimane si dhe të karakterit lirik, siç është ai i faqes veriore ku pasqyrohet një peisazh detar, dy anije me shumë vela, njera më e madhe se tjetra dhe në plan të parë një peshk i madh që ha të voglin. Në krah të majtë: të kësaj skene është pikturuar një peisazh arkitektonik që të kujton ndërtimet ndihmëse të kultit të sh.XVIII. Një skenë e arkitekturës myslimane, me një xhami me pesë minare dhe shumë kupola që të kujton xha-

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12

mitë e Stambollit është pikturuar (Fig. 15) në këndin e djathtë të faqes perëndimore. Motivet dekorative prej lulesh, trajtohen edhe në formën e vazove dhe ibrikëve që mbajnë lule. Ngjyrat janë tepër të ndezura, të gëzueshme, motivet më pak të stilizuara dhe me afër formave të natyrshme. Gama e ngjyrave disi është më e pasur dhe disi e ndryshme nga ajo e odës së katit të dytë. Këtu elementet natyrale bëhen qendra e dekorit dhe motivet bimore e plotësojnë atë.

Në odën e katit të parë, ndodhet një tavan që ka një rozetë rrethore të gdhendur, të kornizuar me një fashaturë gjashtëkëndëshe. Qendra e rozetës është një rreth që përsëritet në formë sektori përreth qendrës, duke trajtuar po atë motiv në formën e prizmave dhe rrezeve të shpërndara. Fusha e tavanit ndahet në kuadrate. Gjithashtu në këtë dhomë në faqen perëndimore ruhen edhe dy dritare dekorative të fiksuara nga brenda. Dritaret me copa xhamash shumëngjyrësh (Fig. 16) dekorohen nga forma të stilizuara tepër të holla, të bëra me stuk reliev. Nga këto vetëm njëra ruhet në gjendje më të mirë. Oxhaku gjithashtu ka qenë i dekoruar dhe gdhendur në stuk reliev. Gjatë punimeve restauruese u gjetën disa fragmente të vogla të tij.

Piktura e fazës së tretë përbëhet vetëm nga tri sipërfaqe të pikturuara që kanë mbyllur kafazet e nikeve të çatmasë së dhomës së katit të dytë dhe disa zonave të shkëputura që kanë restauruar pikturën e dëmtuar të fazës së dytë të po kësaj dhome dhe një bandë të kornizuar qartë në faqen lindore ku janë pikturuar një kryq e dy zogj të vegjël, në të dy anët (Fig. 17,18,19). Piktori ka shfrytëzuar motivin e dhomës së poshtme, kryesisht ibrikun dhe lulet. Piktura është e dobët artistikisht. Në qendrën e ndarjes me çatma poshtë dekorit shënohet data 1869 me shifra latine.

Piktura e vjetër është kryer mbi suva, e cila ka pasur dorën e parë mjaft të trashë prej rëre lumi dhe pak gëlqere, mbi këtë është vendosur një shtresë gëlqereje e pastër, pa lidhës me trashësi disa mm. Trashësia e llaçit jo uniforme, arrin 5-6 centimetra. Piktura është ekzekutuar mbi shtresën e gëlqeres, në teknikën e asekos. Në këtë mënyrë është suvatuar edhe dhoma e katit të parë, e cila gjithashtu mund të ketë qënë e pikturuar me të njëjtën teknikë.

Piktura e fazës së dytë ka shfrytëzuar si shtresë niveluese bazën e pikturës së parë, duke e goditur suvanë me çekiç, për të krijuar llaçi i ri lidhjen e duhur me suvanë e vjetër. Shtresa e suvasë së pikturës së re është deri 5 mm e trashë, e përbërë nga gëlqere e pastër dhe fije lini si lidhës. Pikturimi është kryer mbi shtresën e njomë të gëlqeres dhe ngjyrat janë fiksuar në bazë të teknikës gjysmë fresko. Ngjyrat e shtresës së dytë janë rezistente ndaj ujit.

Piktura e fazës së tretë, siç përmendëm, përfshin disa pjesë që mbulojnë kafazet qendrore të tri nikeve të çatmasë dhe në pjesë të pikturës së murit jugor si dhe pjesë të fragmentuara të pikturës në zona të tjera. Ajo është ekzekutuar mbi suva, të përbërë nga gëlqere dhe kashtë e shtypur si lidhës.

RESTAURIMI

Masat restauruese të pikturës patën si qëllim zhveshjen e krejt sipërfaqeve të dy odave nga shtresat e trasha të gëlqeres që i mbulonte, përforcimin e llaçit pregatitor, mbushjen e zonave të dëmtuara, njësimin e tyre me krejt shtresën e pikturës së ruajtur, pastrimin e pikturës si dhe tonimin e saj. Gjatë procesit të largimit të shtresave të gëlqeres doli se në disa zona të faqes lindore, veriore e perëndimore të odës së katit të dytë ruhej vetëm piktura e shtresës së parë. Problemi i ruajtjes së dy shtresave të pikturës si dhe i zhvendosjes së një zone rreth 3m^2 piktura



Fig. 13

të faqes lindore, që për arsye konstruktive kërkonte rikonstruksionin e murit mbajtës, ishin detyra të veçanta që u trajtuan gjatë punës restauruese. Ndryshe nga oda e katit të dytë, ajo e poshtmja nuk paraqiste nevojën e ruajtjes së dy shtresave të pikturës, as edhe probleme konstruktive të mureve, por këtu mbas largimit të patinës së gëlqeres doli një shtresë e trashë prej një lloj dheu gëlqeror, që populli e quan vapem, e cila ishte e vendosur në disa shtresa. Mbas largimit të saj, piktura doli krejt e errësuar, nga një shtresë tjetër e trashë dhe e zezë prej bloze, e cila në shumë vende kishte marrë pamjen e një grasoje mjaft të lidhur me pikturën. Gjithashtu dhe në dhomën e poshtme ekzistonte problemi i përforcimit dhe integrimit të boshllëqeve.

Radha e masave restauruese në odën e katit të dytë filloi me largimin e shtresës së gëlqeres në mënyrë mekanike, me spatula të dimensioneve të ndryshme. Në disa zona gëlqerja ishte mjaft e lidhur me shtresën e pikturës dhe u largua me anë të bisturish[2]). Mbas pastrimit të pikturës nga gëlqerja problemi më kryesor e i vështirë ishte zhvendosja e pikturës së faqes lindore, e cila do të rikonstruktohej prej nivelit të dyshemesë e sipër. Mbas provave mbi pikturë, të bëra për të parë rezistencën e ngjyrave ndaj ujit, vumë re se përgjithësisht ngjyrat ishin të larshme dhe nuk lejonin procesin e ngjitjes së napave përforcuese mbi pikturë. Për këtë arsye dhe sepse piktura kishte mjaft çarje të thella, u vendos të shkëputej pjesa e pikturës me gjithë suvanë, simbas konfiguracionit të plasjeve, ndërsa në pjesët ku ato nuk ekzistonin, të bëhej prerja e suvasë, në vendet ku nuk kishte motive dekorative. Këto masa u lehtësuan në shkallë të mjaftueshme, për arsye se lidhja e suvasë me murin e gurit ishte tepër e dobët dhe heqja e gurëve të murit, nga sipër-poshtë, e bënte të kontrollueshme dhe krejtësisht të sigurtë shkëputjen e pikturës. Problem i veçantë gjatë procesit të shkëputjes së shtresës së llaçit doli ai i largimit të njëkohshëm të të dyja shtresave të pikturës, të cilat vende-vende kishin humbur lidhjen me njëra-tjetrën. Me anë të planshetave krijuam mundësinë e mbështetjes së suvasë së pikturës së shkëputur dhe sistemit të tyre në një ambient ku do të bëhej rikonstruksioni figurativ i pjesëve. Mbas këtij procesi mbi një shtresë horizontale u bë reduktimi i barabartë i llaçit nga prapa deri në nivelin e trashësisë që ishte me rezistencë. Për përforcimin e llaçit përdorëm një shtresë vinovili të përzier me pluhur guri gëlqeror dhe të spërkatur me açetat polivinil. Gjithashtu, për t'i bërë fragmentet e pikturës së shkëputur të transportueshme,

2) Gjatë punës për largimin e shtresës së gëlqeres punuan dhe dy puntorë të ateliesë së Beratit.

Do not copy

ngjitëm nga prapa një napë të hollë pambuku. Mbas tharjes prej disa ditësh mbi bazën e dokumentacionit grafik dhe shënimeve përkatëse të pjesëve dhe vendeve të prerjes u bë rikonstruksioni dhe ngjitja e pikturës së hequr mbi suportin e ri të murit, duke filluar nga poshtë-lart. Për lidhjen e pikturës me sipërfaqen e murit u përdor llaç i pasur me gëlqere dhe i spërkatur me acetat polivinil. Një sasi e vogël çimentoje u përdor për të siguruar një lidhje më të shpejtë. Fragmentet e ngjitura u mbajtën të fiksuara me plansheta dhe transversa mbi skelë për disa ditë, derisa u forcua llaçi lidhës. Plotësimi i zonave të dëmtuara dhe i vendeve ku kishte çarje të suvasë u krye me allçi të përzier me gëlqere.

Duke dashur që të tria fazat e pikturimit të ishin të dallueshme qartë, u vendos të bëhej gjeometrizimi i konturеve që ndanin shtresat e ndryshme të pikturës. Për të mos krijuar shumë thyerje dhe copëtime të pikturës u synua që ky gjeometrizim të bëhej në masa sa më të gjera. Një shtresë të hollë acetat polivinili u përdor si fiksues i ngjyrës së shtresës së parë, e cila paraqitej veçanërisht e dobët. Si masë e fundit, mbas pastrimit përfundimtar u bë retushimi i mbushjeve me tempera të përziera me të verdhë veze. Retushimi në disa zona u bë duke ndjekur kriteret e rimëkëmbjes piktorike, meqë dekoracioni kishte kryesisht karakter ornamental. Në dhomën e katit të parë mbas largimit të gëlqeres dhe shtresës së vapemit, në mënyrë gjithashtu mekanike, piktura doli krejt e mbuluar dhe gati e padukshme nga shtresa e blozës. Në këtë rast bëmë disa prova, me qëllim sondazhi, për të përcaktuar tretësit dhe mënyrën e largimit të blozës. Provat me açeton, diluent, ksilot etj. nuk dhanë asnjë rezultat. Në faqen jugore në të majtë të oxhakut u bënë disa sondazhe në formë kuadratesh të vogla me një përzierje bikarbonat amoni, të tretur, në raport një me dy, në ujë duke shtuar pak glutofiks, për të bërë një masë xhelatinoze të aplikueshme mbi pikturë dhe të mundëshme për të qëndruar disa kohë mbi shtresën e blozës. Sondazhe të tilla u kryen edhe në të djathtë të oxhakut, me një përzierje të barabartë bikarbonat amoni dhe sodë të tretur në dy masa uji. Rezultatet ishin të kënaqshme në të dyja rastet, mbas rreth dy orësh. Mbas largimit të glutofiksit dhe larjes disa herë me ujë të pastër, doli shtresa e pikturës, e cila mbante në vetvete, sidomos në sfondet e bardha, një pamje në okër, që e kishte fituar me kohë, për shkak të tymrave e blozës që kishte depërtuar në porozitetin e shtresës së pikturës. Disa njolla yndyrore ruanin ende dallime të dukshme me tonin e përgjithshëm të sfondeve. Por ashtu edhe shtresa e blozës në disa zona mbetej ende e lidhur me pikturën. Mbas pastrimit të përgjithshëm të pikturës me bikarbonat sode dhe glutofiks mbetej të trajtoheshin veçanërisht zona të shkëputura, ku gjurmët e blozës ishin të dukshme. Për këtë qëllim u përdor në mënyrë të kufizuar bikarbonati i sodës në një afat kohe më të shkurtër dhe u arrit kështu të pastrohej e gjithë piktura nga bloza.

Mbas përforcimit dhe mbushjeve të çarjeve të zonave të dëmtuara mbeti për t'u kryer retushimi i tyre. Njëkohësisht u rindërtua në këtë dhomë edhe tavani duke ngritur nivelin që kishte pësuar deformime si dhe zëvendësuar pjesët e kalbura të fushës dhe bordurave me pjesë të reja simbas karakterit dhe motiveve ekzistuese të tavanit. Me këto masa u bë e mundur zbulimi dhe evidentimi i vlerave estetike të pikturës që ruan banesa, u sigurua piktura nga rreziku i degradimit të mëtejshëm dhe u integrua piktura e të tri fazave të pikturimit.

PËRFUNDIME

Siç kemi përmendur, ndërtimi në kohë ka pësuar një sërë transformimesh, të cilat mund të grupohen në disa faza, përpos atyre që kanë prekur elemente të veçantë lidhur me plotësimin e nevojave imediate, pa pasur synim një ritrajtim për arsye funksionale apo



Fig. 14

PO TO COPY

DO NOT COPY



Fig. 15



Fig. 16

thjeshtë estetike. Në këtë ecuri ndryshimesh, për të përcaktuar ato që përbëjnë faza, na vjen në ndihmë në radhë të parë dekoracioni i brendësisë së dy ambienteve të banuara, i cili krijon mundësi për një shpjegim dhe lidhje të këtyre fazave dhe me arkitekturën. Kështu është e mundur të vendosen në kronologji relative tri faza rindërtimi të monumentit, duke qenë faza e tretë e vendosur saktësisht në kohë nga mbishkrimi në pikturë, që mban datën 1869.

Në fazën e parë që i përgjigjet gjendjes së monumentit mbas ndërtimit, gjatë së cilës ai qëndronte si njësi më vete pa ndërtimet bashkëngjitur, dekoracioni mural ka veshur si ambientin e poshtëm, ashtu edhe atë të sipërmin. Në ambientin e poshtëm gjejmë ende të ruajtura dy dritare ornamentale në faqen perëndimore (fig. 16), njëra nga të cilat është më e plotë me elemente dekorative, gjithashtu dhe pjesë në fashaturën e sergjenit, të cilat ruajnë gjurmë të pikturës dekorative. Këto na bëjnë të pranojmë se edhe brezi i sipërm i dhomës së katit të parë ka qenë i pikturuar sikurse ai i dhomës së katit të dytë në të tri faqet e mureve, ndërsa sipërfaqet poshtë brezit të fashaturës së sergjenit kanë qënë të lira. Gjithashtu në fazën e parë edhe oxhaku i dhomës së katit të dytë, i cili është vetëm dekorativ, ka qenë i pikturuar dhe dekoruar në stuk reliev sikurse dëshmojnë gjurmët e pikturës që ruhen nën shtresën e fazës së dytë të pikturës si dhe fragmentet e pjesëve të oxhakut, që më vonë është transformuar. I kësaj faze duket se është edhe tavani i dhomës së katit të parë, analogji tipologjike me të cilin gjejmë në disa banesa të vjetra po në Berat si dhe në Gjirokastër e madje në Shkodër.

Nga ana arkitektonike ndërtimi ka pasur një formë tjetër. Në radhë të parë duhet të shënojmë se vendi i shkallëve nuk duhet të ketë qenë aty ku ato janë sot. Hapja e derës për të ndërlidhur katin e parë me ndërtimin në jug ka bërë që shkallët të spostohen, duke marrë formën që kanë sot. Gjurma e një trari dyshemeje të prerë për të mundësuar hapjen e kafazit të shkallëve për rampën e dytë, e bën dhe më të sigurtë këtë zhvendosje. Trajtimi arkitektonik i të dyja ambienteve e bën të domosdoshme, nga ana tipologjike, qenien e kompleksit musandër-mafil. Në ambientin e katit të dytë ky kompleks duhet të ketë qenë shtrirë në të gjithë sipërfaqen përbri odës, siç tregojnë dhe dritaret e larta që ende ruhen në hapësirën që sot është pranë. Tipologjikisht ka shumë mundësi që mafili i katit të parë të ketë qënë i hapur, ndërsa ai i katit të dytë i mbyllur. Tri flegra dyersh origjinale, punuar me teknikën e kllaposjes, me zemra katërkëndëshkënddrejt, të bëjnë të supozosh se trajtimi i kompleksëve mafil-musandër duhet të ketë qenë analog me ato të disa banesave gjirokastrite të ndërtuara në kapërcyellin e shekujve 18-19.

Është e padyshimtë se sipërfaqja e të dyja ambien-



Fig. 17

teve të banuara ka qenë më e madhe. Në katin e parë kjo shihet sheshit, mbasi perdja ndarëse futet brenda sipërfaqes së tavanit, kurse oda e sipërme duhet të jetë zvogëluar për shkak të zhvendosjes së shkallëve. Gjurmët e dekoracionit të fazës së parë përtej perdes ndarëse të sotme e mbështesin këtë mendim. Gjatë fazës së dytë kemi dhe prishjen e kompleksit musandër-mafil të katit të dytë, i cili zëvendësohet me një kompleks të ri, në frymën e kohës. Gjithashtu gjetja e pjesëve të pikturuara të tavanit të odës së katit të dytë në konstruksionin e perdes së kompleksit të ri tregon se ai gjatë fazës së dytë nuk ka ekzistuar. Për sa i përket dekoracionit, gjatë fazës së dytë, ai ka prekur të dyja odat poshtë e sipër. Në odën e katit të parë është kryer ripikturimi i të tri faqeve. Piktura e re është ngritur nga niveli i dritareve ornamentale të faqes perëndimore dhe ka mbuluar kornizën e tyre. Gjatë kësaj faze pikturimi është shtuar mjaft motivi dekorativ dhe ka përfshirë edhe sipërfaqet nën fashaturën e sergjenit, të cilat janë dekoruar me bordura ornamentale që përsëriten si zinxhirë gjethesh të stilizuara. Në këtë fazë është pikturuar edhe dhoma e sipërme nga një mjeshtër tjetër, siç dëshmon karakteri i ndryshëm i trajtimit të motivit, ngjyrat, teknika dhe tematika e përdorur. Në katin e sipërm ripikturimi ka prekur edhe faqen e mafilit që sheh nga dhoma deri në nivelin e sergjenit. Ky sistem dekorativ nuk ka prekur brezin poshtë fashaturës së sergjenit, i cili ka mbetur i lirë, në ndryshim nga ai i dhomës së poshtme.

Faza e tretë është e datuar, ajo i përket vitit 1869. Dekoracioni i kësaj faze përfshin kryesisht tri sipërfaqet e dritareve të mafilit të odës së katit të dytë, një panel të faqes lindore, ku është pikturuar një kryq i madh dhe disa plotësime e ripikturime të shpërndara në zona të ndryshme të sistemit, që, siç duket, kanë qenë dëmtuar në këtë kohë. Po ashtu gjatë kësaj faze janë kryer dhe disa retushime e transformime në elementet dekorative të odës së katit të parë, siç janë minaretë e skenës në të majtë të faqes perëndimore, të cilat janë mbuluar me ngjyrë dhe transformuar në pemë; ndërsa në arkitekturë gjatë kësaj faze kemi prishjen e mafilit të ambientit të sipërm dhe rrjedhimisht mbylljen e dritareve. Përpos këtyre fazave, në arkitekturë, më vonë kemi dhe transformime të tjera, ndër të cilat mund të përfshihet dhe prishja e kompleksit musandër-mafil të katit të parë dhe ndërtimi i perdes brenda sipërfaqes së tavanit, për të mundësuar sajimin e ambientit të vogël që ruhet ende sot.

Një problem që kërkon përgjigje është dhe ai i



Fig. 18

DO NOT COPY

destinacionit që ka pasur ky ndërtim, të cilin gjatë trajtimit jemi rezervuar ta cilësojmë për nga funksioni. Të dhënat gojore e lidhin atë me një teqe, pranë tij, duke qenë ndërtimi në shqyrtim pjesë e këtij kompleksi. Kjo e dhënë na duket e pranueshme për fazën e parë të jetës së ndërtimit në funksionin e shtëpisë së pritjes. Argumente për këtë shërbejnë si tipologjia e tij në planin arkitektonik dhe dekorativ, ashtu dhe fakti se ndërtimit i mungon shtëpia e zjarrit; element themelor për një banesë të kësaj periudhe. Ambienti i katit të parë me dekoracion nuk ka se si të ketë qenë në këtë funksion. Përgjigje kërkon gjithashtu dhe pyetja: Pse ky ndërtim ka pësuar këto transformime, ndër të cilat ritrajtimi dekorativ ka luajtur një rol me rëndësi? Për mendimin tonë kjo duhet shpjeguar me kalimin nga një pronësi në tjetrën. Kështu rikonstruksioni i fazës së dytë duhet lidhur me kalimin në pronësi të ndërtesës nga institucioni i kultit një personi laik, me të njëjtin besim. Ndërtimet përreth të kësaj faze flasin qartë për këtë, gjithashtu ato tregojnë se pronari i ri ishte në gjendje të tillë ekonomike ta mbante ndërtesën sërish si shtëpi miqsh. Ripikturimi i ambienteve dhe veçanërisht fryma laike e atyre të ambientit të katit të parë tregojnë preokupimin e pronarit të ri për t'i hequr ndërtesës karakterin që e lidhte me funksionin e parë. Më vonë ndërtesa kalon në një pronësi të tretë, pronari i ri i së cilës ishte me besim kristian. Pikërisht kjo e detyron atë të riprekë pikturën më 1869, ndofta dhe viti i blerjes, duke ndryshuar shumë simbole që tregojnë sheshit sa më sipër. Pra, si përfundim, ndërtimi në fjalë, nuk mund të konsiderohet banesë, por shtëpi miqsh, funksion që siç duket e ruajti për shumë kohë, derisa vonë ai në mënyrë të sforcuar merr funksionin e banesës, që pruri dhe dëmtime, ndër të cilat më i madhi qe ai i gëlqerosjes së dekoracionit.

Në lidhje me datimin e këtij ndërtimi jemi të prirë të mendojmë se ai i përket fundit të shek. 18. Për këtë datim na shtyn veçanërisht dekorimi i tavanit të odës së sipërme dhe ai i asaj të poshtme. Këto tavane i gjejmë përgjithësisht të ndërtuara nga



Fig. 19

fundi i shek. 18. Është me interes të vërejmë se ne kishën e Perondisë,[4]) gjejmë një tavan të tillë ndërtuar në vitin 1786, gjithashtu dhe dritaret dekorative në ambientin e këtij tavani, për nga motivi afrojnë mjaft me ato të kullës. Gjithashtu dekoracioni i fazës së parë të odës së sipërme, nga pikëpamja kompozicionale lidhet me atë të teqesë së Helvetive, ndërtuar në Berat në vitin 1780. Nuk përjashtohet mundësia që të tria këto vepra të jenë dekoruar nga i njejti grup mjeshtërish.

4) A Meksi, **Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Perondisë** «Monumentet», 5-6. 1973, f. 20.

DO NOT COPY



KATI PERDHE



PAMJE NGA LINDJA



KATI PARE



KATI DYTE

DO NOT COPY

DO NOT COPY



PRERJA B-B

PAMJE NGA VERIU





PRERJA C-C



PRERJA A-A

E. RIZA, H. NALLBANI

UNE HABITATION DE TYPE «KULLË» A BERAT

DO NOT COPY

RESUME

Dans l'ensemble du quartier Partizani (Goricë) de la ville musée de Berat se détache, par sa composition volumétrique et son traitement extérieur architectonique, une habitation disposée dans sa partie inférieure, presque en son milieu. Elle a les caractéristiques bien connues des habitations de type «kullë». Actuellement sa face principale et celle orientale sont les seules a n'avoir pas changé d'aspect, tandis que les deux autres ont perdu beaucoup de leur physionomie initiale à cause des constructions adjacentes mises en place plus tard. Au début la «kullë», constituait une unité à soi. Nous sommes en présence d'un monument unique en son genre, qui occupe une place à part dans l'architecture de l'habitation populaire albanaise, et cela aussi bien sur le plan typologique que pour ce qui concerne le mode dont à été décoré son intérieur.

Sous l'aspect du volume, la «kullë» représente un prisme à base rectangulaire comportant trois étages dont les dimensions augmentent en hauteur. Tout auprès de ce volume se trouve la «kamare», soutenue par deux voûtes cylindriques. L'étage au rez-de-chaussée n'est pas utilisable dans sa plus grande partie du fait qu'il est rempli de terre et sert de plateforme au plancher de l'étage supérieur. Les seuls volumes utilisables du rez-de-chaussée sont une espèce de cave et un réservoir pour recueillir et conserver les eaux de pluie. Le volume du premier étage se répartit en trois pièces: une chambre dans sa partie frontale puis une autre pièce improvisée plus tard et l'espace mettant en communication le premier étage avec le second à travers des escaliers de bois. L'espace du deuxième étage est divisé en deux par une cloison légère en pan de bois. La partie frontale constitue la pièce principale du deuxième étage, tandis que celle postérieur remplie une fonction auxiliaire. Les deux principales pièces des étages destinés à l'habitation sont illuminées par deux rangées de fenêtres disposées en hauteur, celles supérieurs étant fixées dans une ossature de plâtre et pourvues de vitres.

L'état dans lequel se trouvait notre monument imposait la réalisation de travaux de restauration. Cette construction, comme nous allons tenter de le démontrer, a subi maintes modifications dans le temps aussi bien sur le plan de la composition que sur celui de la décoration. En ce qui concerne ce dernier aspect, il a été enrichi de valeurs nouvelles. Nombre d'arguments attestant les modifications que cette habitation a subies dans le temps, l'unique voie à suivre pour se faire une idée de son état initial, sur le plan typologique, est celle de se former des idées bien claires sur sa forme première. Mais ces idées, surtout en ce qui concerne les détails, restent dans le domaine des hypothèses et en tant que telles ne peuvent aucunement servir de base pour la restauration de ce monument, dont la réalisation aurait été autrement souhaitable en raison même de son caractère particulier. Dans certains cas des tentatives ont été faites pour procéder à sa recomposition sur la base des traces originales ou pour reconstruire les éléments qui manquaient complètement, et cela en l'absence de toute trace et en appliquant une technique simple ayant des fonctions uniquement utilitaires. Donc la restauration architectonique s'est fondée sur la phase conclusive du monument quant à sa structure compositionnelle, tandis que la restauration des différents éléments de construction et architectoniques s'est basée sur la reconstruction.

Au cours des sondages effectués, dans les deux pièces destinées à l'habitation on a relevé des traces de peinture audessous de la couche à base de lait de chaux. Ainsi les travaux de restauration ont englobé aussi la peinture murale, qui a été complètement mise au jour une fois ces travaux terminés.

L'habitation en question avait été peinte trois fois en des périodes différentes. La peinture de la première phase, dans la pièce du deuxième étage, comporte des motifs décoratifs de style baroque à extension verticale (Figs. 8 et 9). Elle est rudimentaire et les couleurs employées se limitent au bleu et au rouge clair. La peinture de la deuxième phase utilise amplement le motif à fleurs et feuilles stylisées, en formant un système quadratique encadré par deux rubans de couleur rouge et brun. Au milieu de chaque ornement se trouve une rosette reproduisant d'habitude des paysages (Fig. 10) parsemés de maisons, ponts et autres. Les bandes des niches de la cloison en pan de bois sont enjolivées d'arabesques (Figs. 11, 12). En ce qui concerne la pièce du premier étage, qui ne conserve aucune trace de peinture de la première phase, sa partie supérieure est également décorée de bandes

réparties en carrés sur le tiers de la surface des murs (Fig. 13). Le long de la bande décorative on retrouve aussi des scènes complètes comprenant des paysages de l'architecture musulmane, ainsi que des scènes de caractère lyrique (Fig. 15). Ici les couleurs sont plus vives, les motifs moins stylisés et plus proches des formes naturelles. La gamme des couleurs est plus riche et diffère quelque peu de celle de la chambre du deuxième étage. Les éléments naturels constituent le centre du décor, qui est complété par des motifs floréaux. La peinture de la troisième phase concerne trois seules surfaces peintes et précisément le grillage des niches de la cloison en pan de bois (Figs. 17, 18 et 19) de la pièce du deuxième étage et certaines zones détachées. La peinture se caractérise par un niveau artistique peu élevé, elle porte la date de 1869.

La peinture de la première phase, dans la pièce du premier étage, a été exécutée selon la technique a secco, celle de la deuxième phase selon la technique mezzo a fresco.

Quant aux mesures de restauration concernant la peinture elles consistèrent dans les opérations suivantes: élimination de toute la surface des deux pièces d'habitation des couches épaisses de chaux qui la recouvrait, renforcement de la couche de mortier, remplissage des zones endommagées et uniformation de ces zones sur toute la couche de peinture conservée, nettoyage de la peinture et réintégration de sa tonalité. Pendant le processus d'élimination des couches de chaux on s'est aperçu que certaines parties des murs oriental, septentrional et occidental de la chambre du deuxième étage ne conservaient que la peinture de la première phase. Le problème de la conservation des deux couches, ainsi que celui du déplacement d'une surface de 3m² environ de peinture au parement oriental, dont il fallait reconstruire le mur, furent des tâches particulières que les restaurateurs durent affronter pendant leur travail. La peinture de la chambre du premier étage, après l'élimination de la patine de chaux et d'une espèce de terre calcaire, est apparue très sombre étant recouverte d'une couche de suie. Pour faire ressortir clairement toutes les trois phases de peinture dans la pièce d'en haut, les restaurateurs procédèrent à la géométrisation des contours séparant les différentes couches de peinture. Afin de ne pas causer maintes ruptures et fractures à la peinture, la géométrisation a été réalisée dans des proportions les plus amples possibles. La couleur de la première couche de peinture, étant particulièrement faible, il a fallu la fixer. En dernier lieu, après le nettoyage définitif, les restaurateurs retouchèrent les remplissages par détrempe mélangée avec le jaune de l'oeuf.

Un autre problème qui exige une réponse est celui de la destination qu'avait l'habitation que nous sommes en train d'examiner. Les traditions orales la rattachent à une teqe (couvent religieux), dont elle aurait constittué une dépendance. Nous sommes en présence d'une réponse acceptable du moins pour sa première phase d'existence, en tant que maison de réception des hôtes. En témoigne sa typologie particulière sur le plan architectonique et décoratif et le fait que dans notre habitation manque la chambre du feu, élément fondamental pour les habitations de l'époque. La pièce du premier étage richement décorée ne pouvait aucunement exercer une fonction semblable. Une autre question qui se pose est celle de savoir pourquoi notre habitation a subi dans le temps toutes ces modifications, entre autres celles concernant la décoration qui ont joué un rôle d'importance. En ce qui concerne ce dernier point, à notre avis il s'explique par le passage successif du droit de propriété. Ainsi la reconstruction de la deuxième phase doit être rattachée au passage de la propriété d'une institution religieuse à un laïc de la même confession. Le fait que les différentes pièces ont été repeintes, et surtout l'esprit laïque caractérisant les chambres du premier étage, montrent on ne peut mieux combien le nouveau propriétaire se préoccupait d'enlever à l'habitation en question son caractère initial. Plus tard elle devient propriété d'une personne de confession chrétienne. Le nouveau propriétaires est contraint de mettre la main à la peinture en 1869, date probable de l'achat, et d'en modifier différents symboles, ce qui confirme les énonciations faites plus haut. Donc, on peut tirer la conclusion que ce bâtiment ne peut être considéré comme une habitation pure et simple, mais comme une maison de réception, fonction qu'elle a du remplir pendant un long temps et que plus tard, par la force des choses elle s'est transformée en habitation, ce qui a entraîné maints dégâts, le plus important étant celui d'avoir couvert d'une couche de chaux la décoration. En ce qui concerne la datation de cette habitation, nous sommes enclins à la situer vers la fin du XVIIIe siècle. En témoigne particulièrement la décoration du plafond de la chambre de l'étage supérieur, dont a récupéré certains fragments, et celle de la pièce de l'étage inférieur (Fig. 6). Ces plafonds font leur apparition vers la fin du XVIIIe siècle. Il convient de relever ici que l'église de Perondi comporte un plafond semblable, dont la construction porte la date de 1786. Dans le même temps les fenêtres décoratives aménagées au plafond se rapprochent suffisamment à celles de notre habitation type «kullë». La décoration de la première phase, exécutée dans la chambre de l'étage supérieur, ressemble du point de vue compositionnel à celle de la teqe des Helveti construite à Berat en 1780. Il est probable que ces trois ouvrages aient été décorés par le même groupe de maîtres.

Pomoćni

Gjerak KARAISKAJ

DO NOT COPY

TË DHËNA MBI ARKITEKTURËN DHE PUNIMET E KONSERVIMIT NË KALANË E SHURDHAHUT (SARDA)

Qyteti mesjetar i Shurdhahut kohët e fundit është bërë objekt i një studimi të hollësishëm, në sajë të gërmimeve arkeologjike sistematike që u kryen gjatë viteve 1967-1970, nën drejtimin e H. Spahiut dhe D. Komatës[1]). Nuk kanë munguar përshkrime dhe shënime të shkurtëra edhe nga autorë të mëparshëm por që kishin më tepër një karakter sipërfaqësor.[2]).

Si rezultat i gërmimeve u zbulua një lëndë e pasur arkeologjike dhe një kompleks banesash dhe ndërtesash kulti. Si ndërtimet që ruheshin mbi sipërfaqe ashtu edhe ato të posa zbuluara paraqitnin nevoja të ngutshme konservimi, ndërmjet tyre një trakt i murit rrethues pranë portës së qytetit të sipërm, rrezik shëmbje paraqitnin dhe dy kullat gjysmërrethore që mbronin këtë portë si dhe disa objekte kulti. Për këto arsye u ndërmorën punime konservuese gjatë viteve 1975-1976, si rezultat i të cilave u mënjanuan rreziku i degradimit të mëtejshëm i monumenteve të arkitekturës së këtij qyteti të rëndësishëm mesjetar. Qëllimi i këtij shkrimi është vënia në dukje e këtyre punimeve si edhe disa të dhënave të reja të nxjerra nga vrojtimet e bëra me këtë rast.

Kalaja e Shurdhahut (tab. I) e cila ndodhet rreth 8 km. në jug të qytetit të Shkodrës, ngrihet mbi një kodër shkëmbore, me lartësi 130 m. mbi nivelin e detit, në bregun e djathtë të lumit Drin. Dikur kjo kodër lidhej me një qafë me vargun e kodrave që shtrihesin në bregun jugor të këtij lumi, por me krijimin e liqenit artificial të hidrocentralit «Mao Ce Dun», kodra e Shurdhahut u kthye në një ishull.

Shurdhahu i identifikuar nga Hani me qendrën e peshkopatës mesjetare të Sardës[3]), mbrohej nga dy rradhë muresh, që e ndanin qytetin në dy pjesë, qytet i sipërm dhe i poshtëm, dhe përfshin së bashku një sipërfaqe prej 4,7 ha. Muret mbrojtëse kanë patur një gjatësi të përgjithshme prej rreth 1 km., të përforcuar nga një sërë kullash me forma gjysëm rrethore, në formë të shkronjës U, trekëndëshe dhe katërkëndëshe.

Me krijimin e liqenit, nga ana perëndimore e kalasë u përmbyt një pjesë e murit të jashtëm rrethues me gjatsi rreth 300 m. në të cilin ndodheshin dhe 7 kulla, prej të cilave 4 kulla katërkëndëshe, 1 gjysëm rrethore dhe 2 në formë U-je (tab. I). Muri i parë rrethues nis nga ana lindore me një kullë trekëndshe që ndodhet vetëm 5 m. larg një buze të thiktë shkëmbore. Kjo e fundit vazhdon prej kullës në një distancë prej 150 m. duke bërë të pa nevojshme muret mbrojtëse në këtë anë.

Kulla (A)[4]) (Fig. 1, Fig 2) ruhet në një lartësi prej 5 m., duke dalë nga kurtina rreth 4 m. Muret e saj janë 0,70 m, të gjërë. Në murin e brendshëm nuk ruhen gjurmët e ndonjë hyrje, prandaj ka mundësi që ajo të ketë qenë e mbushur me dhe deri në një fare lartësije sa të mund të bënte të përdorshme frenë

1) H. Spahiu, D. Komata, **Shurdhahu-Sarda, Qytet i fortifikuar mesjetar shqiptar** Iliria 3 1974 257-313.
2) Po aty, shih shënimet 2-14 f. 260-261.
3) J.G. Hahn, **Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar,** Wien 1867, 43.
4) Sipas planimetrisë së dhënë nga H. Spahiu – D. Komata **vep. cit.** 259. Në emërtimin e kullave dhe objekteve të tjera do ti përmbahemi gjithashtu studimit të mësipërm.



Fig. 1

gjinë e vetme të saj që shikon në drejtim të perëndimit dhe ndodhet në lartësi 2,2 m. nga niveli i brëndëshëm. Frengjia ka një lartësi prej 0,44 m. Gjersi të brendshme 0,32 m dhe të jashtëme 20 cm. Në pjesën e sipërme ajo mbulohet me rrasa guri të vendosura horizontalisht.

53 m larg kullës A ndodhen dy kulla të tjera të vendosura pranë njëra tjetrës (B_1, B_2) midis së cilave kalonte hyrja për në kala. Të dyja kullat kanë në planimetri trajtën e germës U të çrregullt (Tab. I, fig. 3). Trashësija e mureve të tyre është rreth; 0,80-0,90 m, ndërsa lartësija e ruajtur 2-3 m. Kullat dalin prej mureve 4 m dhe janë vendosur 2 m larg njera tjetrës duke krijuar kështu një koridor të ngushtë në fund të cilit ndodhej hyrja për në qytetin e poshtëm. Një hyrje e vogël që komunikonte me koridorin ndodhej dhe në faqen perëndimore të kullës B_1 gjë që kuptohet nga patura e ruajtur në anën veriore të kësaj hyrje.

Rreth 30 m në perëndim të kullës B_2 ndodhet një kullë tjetër (C_2) e cila në planimetri paraqet një trajtë ndërmjetse midis kullave në formë U me ato trekëndshet megjithse me brinjët ansore të rrumbullakosura në pjesën ballore ajo përfundon me majë. Ajo del nga kurtina 5,60 m dhe ka një gjërësi në bazë prej 5,64 m trashësija e mureve është 0,80 m, ndërsa lartësija e ruajtur rreth 4,5 m. Kjo kullë u gërmua plotësisht dhe brenda saj u zbulua një kullë tjetër në formë të shkronjës U me përmasa më të vogla (C_1)[5]) (Fig. 3, Fig. 4). Kulla C_1 i përkiste një periudhe më të hershme, sipas autorëve të gërmimit shek. VI-VIII[6]). Siç kanë vërejtur me të drejtë këta të fundit, kulla C_1 lidhet me një mur të brendshëm me gjersi 1,10 m të ruajtur në lartësi 1-2 m i cili ndahet me fugë nga një mur shtesë me gjerësi 60-70 cm që i mbështetet atij nga ana e jashtëme, në këtë të fundit lidhen edhe gjithë kullat e tjera të përshkruara më sipër. Për këtë arsye këto ndërtime janë përcaktuar si të një periudhe të dytë[7]).

Muri rrethues i qytetit të poshtëm vazhdonte dhe për 200 qind metra në drejtim të veri-perëndimit dhe pastaj kthehej nga verilindja për të rrethuar plotësisht kodrën e kalasë deri pranë rënies shkëmbore nga lindja. Ana perëndimore ku ndodheshin kullat D,E,F,G,H, (tab. I) e cila ishte pjesa më e lehtë për tu sulmuar, u përmbyt nga ujrat e liqenit. Pikërisht në këtë pjesë të kalasë do të mund të hetonim një periudhë të tretë ndërtimi. Tani mund të gjykojmë vetëm nga përshkrimi dhe skicat planimetrike të dhëna prej H. Spahiut dhe D. Komatës[8]). Kulla D ka patur trajtë katrori me përmasa 2,20x2,20 m trashësi muresh 0,60 m dhe lartësi të ruajtur 1,8 m. Kulla E (Fig. 2) kishte gjithashtu trajtë katërkëndëshe me përmasa të jashtëme 2,65x2,70 m dhe trashësi muresh 0,60 m. Nga ana brendshme e kullës në një kohë më të vonë qe ndërtuar një mur tjetër tërthor pranë murit ballor të saj për të cilin autorët e gërmimit mendojnë se kryente funksjon përforcues për këtë të fundit[9]). Me që një funksjon të tillë ky mur nuk mund ta ketë qëllimi i ndërtimit të tij ka një shpjegim të vetëm; Gja-

5) H. Spahiu – D. Komata, **Vep. Cit.** 264.
6) **Po aty** 310
7) **Po aty** 310
8) **Po aty** 266-267 fig. 5.
9) Po aty, 266.

DO NOT COPY

BOTIMOPY

të një periudhe rrethimi muri ballor i kullës që dëmtuar rëndë nga bombardimet dhe paraqiste rrezik shëmbje kështu mbrojtësit kanë qenë të detyruar të ndërtojnë një mur të dytë pranë të parit për të mos lejuar prishjen e kullës dhe hapjen e një shtegu kalimi për në kala.

Duhet kujtuar dhe një herë se kulla E së bashku me kullat F,G,H, ndodhen në pjesën më të sheshtë dhe më të ulët të kodrës, ku sulmi ishte më i efektshëm. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për kullën F, me trajtë katërkëndëshe, e cila na përshkruhet me mure të dyfishtë, me gjerësi 110-120 m dhe mendohet që muri i jashtëm ti përkasi një periudhe të dytë ndërtimi me qëllim riforcimin e kullës[10]). Do të ishte më e besueshme që muri i brendshëm i kësaj kulle të jetë ndërtuar në periudhë rrethimi, mbas dobësimit të përgjithshëm të mureve të saj.

Kulla G (Fig. 2) ka patur një formë të ngjashme me kullën C_1, gjatë gërmimit brenda saj u zbulua një mur tërthor, për të cilin autorët mendojnë se i përket një kulle më të hershme[11]). Kulla H (Fig. 2) ka patur trajtë katërkëndëshe me qoshe të rrumbullakosura gjerësi muresh 0,70 m dhe lartësi të ruajtur 1,5 m.

Në skicën e paraqitur në fig. 5 (Ilirija III, 267) brenda kullës H është shënuar një mur që krijon nga ana e brendshme kënd të ngushtë me kurtinën dhe lidhet organikisht me të, për të cilën autorët nuk japin ndonjë shpjegim. Ky mur nuk mund të dëshmojë tjetër vetëm se egzistencën e nji kulle trekëndëshe më të hershme e cila ka qenë krejtësisht e rrënuar në kohën kur u ndërtua kulla H. Kjo hollësi ka një



Fig. 2

rëndësi të veçantë, pasi duke ju shtuar faktit që në këtë vënd kemi të bëjmë me pjesën më të dobët të kështjellës, na lejon të mendojmë se kullat katërkëndëshe janë më të vona se ato trekëndëshe dhe si përfundim, që ato i përkasin një periudhë të tretë ndërtimi.

Muri rrethues i qytetit të sipërm (Tab. I, Fig. 5) dominon pjesën më të lartë të kodrës, ai ka nji gjatësi të përgjithëshme prej rreth 400 m. Pjesa më e ruajtur është nga jugperëndimi ku për një gjatësi prej rreth 70 m ai ruhet në lartësi 2-4 m. Në këtë anë ndodhet edhe hyrja kryesore për në qytetin e sipërm, e mbrojtur nga dy kulla gjysëm rrethore (Tab. I,



Fig. 3

10) Po aty, 266.
11) Po aty, 266.



Fig. 4



Fig. 5

Fig. 6, Fig. 7), si dhe një kullë tjetër me të njejtën formë 14 m në verilindje të hyrjes (H) (Fig. 5).

Kullat që mbrojnë hyrjen për në qytetin e sipërm (Fig. 7) dalin 2,80 m nga kurtinat, dhe janë vendosur 2,10 m larg njera tjetrës. Trashësija e mureve të tyre është 0,70 m. Hyrja ka një gjerësi prej 1,56 m lartësi 2,5 m dhe mbulohet me një qemer guri me gjerësi 0,60 m. Nga ana e mbrendëshme një qemer me bazë më të gjërë ngrihet 2,30 m mbi të parin. Në pilastrat mbështetëse të tij në dy anët e portës ndodhen brimat për lëvizjen e katarahut me seksion 0,20x0,20 m. Kulla tjetër(H) në verilindje me formë gjysmë rrethore del nga kurtina vetëm 2,15 m dhe ruhet në lartësi rreth 1 m. Pas kullës H muri rrethues kthen në drejtim të veriut dhe ruhet vende-vende në rrafsh me tokën. Ndërsa nga ana lindore muri i qytetit sipërm ndërpritet rreth 30 m. larg buzës shkëmbore pasi mbi trasenë e tij është ndërtuar një kishë (kisha VIII) e cila edhe sot ruhet në gjëndje të mirë. Pranë kishës muri rrethues me gjerësi 90 cm përshkohet nga një frengji. Kjo e fundit 60 cm e lartë ka një gjerësi të brendëshme prej 40 cm dhe të jashtëme 20 cm në pjesën e sipërme mbulohet me pllaka guri të vendosura horizontalisht.

TEKNIKA E NDËRTIMIT TË MUREVE RRETHUESE

Karakteristikë për muret mbrojtëse mesjetarë të Shurdhahut është trashësija e tyre e vogël 0,60 m — — 0,90 m dhe mungesa e brezave të drurit. Muret janë ndërtuar me gurë kave, të nxjerë nga formacjonet shkëmbore në vënd, të cilët lidhen me llaç të përdorur me kursim me mbushës të imët dhe shumë gëlqere, gurët kanë forma të përzgjatura por nuk krijojnë rreshta të rregullte, madhësija e tyre mesatare është rreth 0,35x0,15 m. Në mure gjithashtu nuk janë përdorur copra tullash. Një tipar tjetër karakteristik për teknikën e ndërtimit është se muret e kullave lidhen me kurtinat vetëm në pjesët e sipërme. Kështu dy kullat që mbrojnë portën e qytetit të sipërm lidhen me kurtinat vetëm mbi lartësinë 3 m. Përjashtim bën vetëm kulla trekëndëshe (A). Një veçori e tillë të çon në përfundime nga njëherë të gabuara, në përcaktimin e fazave të ndërtimit, në rastet kur kemi të bëjmë: me rrënoja. Si kurtinat ashtu edhe muret e kullave nuk ndjekin linja të drejta e të rregullta, por të valëzuara për këtë arsye, disa studjues i kanë hetuar këto ndërtime si të rëndomta e primitive[12]). Në gjëndjen që ruhen sot muret dhe kullat nuk mund të gjykojmë për lartësinë e tyre fillestare. Mungesa e shkallëve në faqet e brendëshme të kurtinave, na çon në përfundimin se këto kanë qenë prej druri, gjithashtu me plantforma dërrasash të mbështetura mbi trarë duhet të kenë qenë ndërtuar edhe rrugët e kalimit mbi mur në nivelin e bedenave, ashtu si në kalanë e Drishtit[13]). Muret e hollë pa breza druri, mënyra e vendosjes së gurëve në faqet e mureve cilësija e llaçit si dhe kullat e vogla gjysëm rethore në formë të shkronjës U të kujtojnë ndërtimet mbrojtëse në Drisht. Kulla portë në Akropolin e Drishtit gjithashtu nuk lidhet plotësisht me kurtinën, por ndryshe nga kullat e Shurdhahut lidhja realizohet në pjesën e poshtëme deri në lartësinë 2 m.

Dy kulla të vogla (3,5x3 m) në formë patkoi të cilat nuk lidhen me kurtinat, por janë të njëkohëshme me to i takojmë në kalanë e Kaninës. Njera

12) I.G. Hahn, Reise durch die Gebiete des Drin Und Wardar, Wien 1867, 43 K. Jirecek, Skutari und sein Gebiet im Mittelalter, Ilyrisch Alb-Forsch. I, 1918, 116.

13) A. Baçe — **Qyteti mesjetar i Drishtit,** Monumente të kulturës në Shqipëri, Tiranë 1975/2, 51-53.

DO NOT COPY

prej tyre, kulla 8 lidhet me kurtinën vetëm në pjesën e sipërme të saj, por këtë lidhje autori i studimit e heton si të një faze më të vonë[14]) duke e datuar këtë fazë së bashku me kullat në shek. XIV-XV[15]). Ndërsa kulla A të kujton kullat trekëndëshe, në Butrint.

Ajo që e dallon periudhën e parë të ndërtimit si teknikë nga ato të mëvonshmet, është pikërisht lidhja e plotë e kullës me kurtinën si dhe një far rregullshmërie e formës planimetrike të saj.

Fortifikimet mesjetare të Shurdhahut ndryshojnë në shumë pikpamje nga fortifikimet e tjera të kësaj periudhe në Shqipëri, megjithse paraqesin ngjashmëritë e mësipërme me ndërtimet mbrojtëse që përmëndëm. Ky ndryshim bije në sy më tepër në trajtim arkitektonik të hyrjeve, mungesën e brezave të drurit si dhe në formën planimetrike të kullave. Hyrjet e mbrojtura nga dy kulla të vogla anësore në formën e shkronjës U të vendosura fare pranë njera tjetrës janë një tip i njohur që të kujtojnë ato të fortifikimeve të vona antike si Elbasani, Vigu, Paleokastra etj, të cilat kanë shërbyer si modele për Shurdhahun.

TË DHËNA RRETH ARKITEKTURËS SË DISA MONUMENTEVE TË KULTIT

Objekti që ruhet më mirë nga gjithë ndërtimet e tjera të kultit është kisha e Zojës (ndërtesa nr. 8 (shih planimetrinë, VIII) e ngritur mbi murin e rrënuar të rethimit të sipërm të qytetit në skajin lindor të tij. Ajo ruhet deri në nivelin e çatisë, e cila ka qenë me dy kullime e mbuluar me rrasa guri. Kisha (Fig. 8, 9, 10) është e tipit «bazilikë njënefëshe». Nga lindja ka një apsidë gjysmë rrethore të mbuluar me rrasa guri. Muret ruhen deri në lartësinë e tyre origjinale 4,40 m. Kisha ka dy hyrje të formuara me qemer guri (njera ndodhet në mesin e murit perëndimor, ndërsa tjetra në murin jugor), si dhe tre dritare të vogla në murin jugor. Apsida ka gjithashtu një dritare të vogël 0,40x0,30 m të mbuluar me nji pllakë guri e cila në mes mbështetet mbi një kollonë me seksion rrethor prej guri monolit. Dyshemeja ka qenë shtruar me pllaka të mëdha guri ndërsa në ambientin e altarit ruhet tryeza e altarit. Në faqen e brendshme të murit jugor në të djathtë të hyrjes ka qenë vendosur një gur që mbante datën 1564[16]). H. Spahiu – D. Komata, kanë vënë re një fazë më të herëshme, nën kishën egzistuese



Fig. 6



Fig. 7

dhe pikërisht gjurmët e apsidës së vjetër që dalin para apsidës së re[17]). Autorët nuk japin mendim të plotë rreth datimit të ndonjerës nga fazat e ndërtimit.

Duke vazhduar tek gjurma e apsidës së vjetër mund të ndiqet në trakte të shkëputura edhe muri verior i kësaj kishe ndërsa nga perëndimi një pjesë e murit të saj në lartësi 1.80 m është përfshirë në murin e kishës së re. Nga këto, të dhëna del se kisha fillestare kishte një gjatësi thuajse sa ajo ekzistuese, por ishte 1,60 m me e gjerë (Fig. 8). Por edhe në kishën që ruhet sot mund të dallojmë dy periudha ndërtimi. Periudhës më të herëshme i takon muri perëndimor si dhe një pjesë e mureve veriorë dhe jugorë, në një gjatësi prej 8,50 m, ndërsa

14) A. Baçe – **Qyteti i fortifikuar i Kaninës,** Monumentet 7-8, 1974, 37-38.
15) **Po aty,** 42.
16) H. Spahiu – D. Komata **Vep. Cit.** 288 në tekst jepet data 1456 ndërsa në foton e cituar (Tab. XIV) lexohet viti 1564.
17) Po aty. 288.

DO NOT COPY





Fig. 8

gjysma lindore e kishës me gjatësi 11,30 m duke përfshirë apsidën është rindërtuar duke përbërë kështu periudhën e tretë të ndërtimit. Kjo duket qartë sidomos në fugën e bashkimit të dy periudhave në murin verior, ku muri më i ri i mbështetet në pjesën e sipërme të vjetrit (Fig. 11). Periudhës së dytë të ndërtimit i takon dhe data 1564. Nga kjo periudhë ruhet pjesa perëndimore e kishës egzistuese, dy hyrjet dhe dy dritare nga jugu, këto të fundit ndryshojnë prej dritares së vetme që i përket periudhës së tretë të ndërtimit. Ndërsa të parat janë më të mëdha dhe formohen me harqe gurësh monolitë, dritarja e periudhës së tretë ka trajtën e një frëngjije, e mbuluar në pjesën e sipërme me një pllakë guri të vendosur horizontalisht.

18) H. Saphiu, – D. Komata, **Vep.Cit.** 274, fig. 7.



Fig. 9

Trashësija e mureve në periudhën e dytë ka qenë 0,60 m. ndërsa në të tretën 0,50 m muri verior dhe 60 cm jugori. Ka shumë mundësi që kisha e vitit 1564 të ketë qenë më e vogël se e para sepse nuk hetohen nënstruktura të kësaj periudhe në absidën egzistuese dhe nga që raporti midis gjatësisë dhe gjerësisë bije në kundërshtim me gjithë monumentet e tjera të kësaj gjinije në Shurdhah, një gjë e tillë mund të pranohet në periudhë rënie të plotë të arkitekturës së këtij qyteti siç është ajo pas shek. XVI-XVII.

Duke gjykuar nga data 1564, për periudhën e dytë si dhe nga rrënimi i plotë i kishës së vjetër para këtij ndërtimi do të pranonim si kohën më të vonë të mundshme për ndërtimin e kishës së parë periudhën nga fundi i shek. XIV ose fillimi i shek. XV. Si dhe këtë periudhë ose diçka më herët për lenien pas dore së paku të rrethimit të sipërm të qytetit, ndërsa për periudhën e tretë na duket më i mundshëm datimi në shek. XVII-XVIII.

Vlen të theksojmë se teknika e ndërtimit të tri periudhave na paraqitet më primitive nga disa ndërtime të tjera kulti më të hershme që do ti përmëndim më poshtë.

Kisha XI (Ndërtesa VI) Ndërtesa VI është emërtuar nga autorët e gërmimit, një kompleks ndërtimesh në pjesën lindore të qytetit, midis dy mureve rrethuese[18]). Në fakt këtu kemi të bëjmë me dy ndërtime të ndryshme njera kishë (nga veriu) dhe tjetra banesë (nga jugu). Sipërfaqja midis këtyre dy ndërtimeve është konsideruar si koridor i banesës, ndërsa një adaptim i mëvonshëm që synonte të çfrytëzonte një pjesë të kësaj sipërfaqeje bashkë me muret ansore egzistuese është hetuar si ambjenti (f) i banesës. Duke lënë mënjanë këtë të fundit, ndërtimi në veri të saj është një kishë e tipit bazilikë njënefëshe, e për-

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 10

bërë nga salla kryesore (naosi) dhe parasalla (narteksi). Naosi ka një gjerësi prej 5.30 m dhe gjatësi të ruajtur 9,70 m, me trashësi muresh rreth 0,50 m. Dyshemeja ka qenë shtruar me pllaka guri të prera në forma të rregullta katërkëndëshe, ndërsa muret të suvatuara nga brenda me një shtresë gëlqereje 2 cm të trashë[19]). Ruhen edhe gjurmët e fillimit të ambjentit të altarit në formën e një shkallzimi të dyshemesë me lartësi 0,10 m. Apsida dhe muri që e mbyllte këtë ambjent nga lindja nuk ruhen. Naosi komunikon me ambjentin e jashtëm me një portë, në murin verior si dhe me një portë tjetër me narteksin. Narteksi ka një gjerësi prej 1,5 m. dhe komunikon me ambjentin e jashtëm nëpërmjet një porte në anën jugore. Rreth kishës janë ndërtuar me mure guri pesë varre (varret 5,6,7,8,9) njeri prej të cilëve ndodhet brenda në narteks, në anën veriore përballë hyrjes. Teknika e ndërtimit të kësaj kishe, nga gurët gjysëm të punuar të vendosur në rreshta horizontale ndryshon nga të trija periudhat e ndërtimit të kishës së Zojës. Në një nga varret pranë kishës (varri 8) u gjet një unazë bronxi mbi fushën e së cilës ishte inçizuar një yll pesëcepësh, brenda shkruar një rrethi[20]). Unaza të tilla kanë qenë të përhapura në viset e perandorisë bizantine dhe datohen në shek. XI, datë që i përket pak a shumë kohës së ndërtimit të kishës.

Nga kisha VI ruhej në këmbë apsida dhe një pjesë e vogël e mureve anësore pranë saj (fig. 13, 14). Apsida ka qenë mbuluar me rrasa guri dhe përshkohet nga një dritare e stërgjatur me gjerësi 0,35 m dhe lartësi 1,35 m e mbuluar me një hark gurësh të



Fig. 11

punuar. Gjurmët e një dritareje identike me të ruheshin edhe në murin verior. Nga rënojat e ruajtura mund të kuptohej se kisha ka patur një lartësi prej rreth 5,60 m. Para fillimit të punimeve konservuese, u pastrua nga dherat dhe mbeturinat e shëmbjes krejt planimetria e kishës ajo kishte një gjatësi prej 12,70 m (muri jugor) dhe 13,90 m (muri verior), dhe një gjerësi të brendshme prej 4.10 m. Muret kanë një trashësi prej 0,55 m.

Dyshemeja ishte shtruar me rrasa guri të prera në forma të çrregullta. Në një kohë më të vonë qe shtuar nga ana perëndimore një narteks me gjerësi 1.80 m i cili komunikonte me nji portë në murin verior. Një mur me gjerësi 0,50 m ngjitur me murin fundor të naosit ishte ndërtuar për të mbështetur thembrën e qemerit të një qimiteri, thembra tjetër e të cilit mbë-

19) **Vep.cit.** 276-277.
20) H. Spahiu – D. Komata **Vep.Cit.** 292 (Tab. X, 13).



Fig. 12



Fig. 13

shtetej detyrimisht në murin fundor të narteksit. Muret e kishës në faqet e jashtëme janë ndërtuar me gurë gjysëm të punuar me forma të rregullta katërkëndëshe por me lartësi të ndryshme. Nën strehën e apsidës ku teknika ruhet më mirë, fugat e llaçit midis gurëve janë vizuar me mistri për të theksuar formën këndrejtë të gurëve (Fig. 15). Teknika e ndërtimit të kësaj kishe të kujton atë të kishës XI (Tab. I) dhe duhet ti përkasi një periudhe të afërt me të shek. XI ose XII.

RRETH DATIMIT TË MUREVE RRETHUES DHE PERIUDHAVE TË LULËZIMIT TË QYTETIT

Në Shurdhah janë zbuluar një tok objektesh qeramike të antikitetit të vonë, midis tyre një fibul bronxi në trajtë kryqi me mbaresa kokë qepe[21]) që datohet tipollogjikisht nga fundi i shek. III në shek. IV. Kjo është një periudhë në të cilën u ngritën shumë fortifikime në teritorin e Ilirisë, për tu mbrojtur nga dyndja e popujve. Ne jemi të prirur të lidhim me këtë periudhë ndërtimet më të hershme mbrojtëse në Shurdhah të cilat përfaqësohen nga muri i brëndëshëm i qytetit të poshtëm si dhe nga kulla C_1 e lidhur organikisht me këtë mur. Nga teknika e ndërtimit dhe nga forma planimetrike e kullës së vetme të ruajtur nga kjo periudhë është vështirë të përcaktohet me saktësi një kohë më e përafërt datimi. Vlen të theksojmë se kulla në trajtë patkoi apo në formën e gërmës U i takojmë në kalanë e Elbasanit datuar në gjysmën e parë të shek. IV[22]) në Vig. (shek. III-IV), në Grazhdan etj. Një preferencë ka patur për këtë tip kullash në periudhën e sundimit të perandorit Kostandin[23]). Argumenti se këto ndërtime i përkasin shek. VI-VIII, nga trajta e kullave që janë karakteristike për mesjetën e hershme[24]), na duket i pa bazuar.

Në pjesën e brendëshme të murit të parë rrethues u zbuluan një sërë rënoja banesash. Ndryshe nga banesat e zbuluara në pjesën e brendëshme të rrethi-

21) H. Spahiu – D. Komata Vep.Cit. 300.
22) Gj. Karaiskaj – **Të dhëna të reja për datimin e kalasë së Elbasanit.** Monumentet 3, 1972, 147-152.
23) S. Soppronі – **Der Spätromische Limes zwischen Visegrad und Esztergom.** Limes romanus. Konf. Nitra, Bratislava 1959, 131-135.
24) H. Spahiu – D. Komata vep.cit. 310.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 15

mit të dytë të cilat janë më të hershme nga muri rrethues, ato pranë rrethimit të parë janë më të vona nga brezi i brëndëshëm i murit, që i takon periudhës së vonë antike. Ato ose i mbështeten këtij të fundit ose i mbivendosen në vendet ku muri ka qenë tepër i rrënuar. Në këtë zonë ku kemi të bëjmë me dy periudha të ndryshme ndërtimesh pritet një përzierje e materialit dhe pikërisht në të njejtin kuadrat e thellësi pranë murit rrethues (ndërtesa III e mbështetur mbi murin rrethues të periudhës së vonë antike ambjenti b) u gjet fibula në formë kryqi e shek. IV dhe një monedhë e shekullit XII[25]).

Pa qenë nevoja ta konsiderojmë fibulën si relike për të shtyrë kohën e përdorimit të saj deri në shek. VI-VIII[26]) të dy këto objekte mund të përfaqësojnë fare mirë dy periudha ndërtimi, atë të murit të brendshëm të kalasë në shek. IV dhe të banesës në shek. XII. Vendosja e mureve të banesave, që datohen nga materiali arkeologjik në shek. XI-XII mbi murin mbrojtës të periudhës së vonë antike tregon se në këtë periudhë të mesjetës muri antik i vonë ka qenë krejtësisht i rrënuar; për pasojë qyteti ka mbetur i pa fortifikuar për një kohë të gjatë. Kjo mund ti dedikohet dyndjeve sllave të shek. VI të cilat shoqëruan me masakra prishjen e qytetit dhe të fortifikimeve të tij. Një dëshmi për këtë është gjetja e një morije skeletesh brenda kullës C_1. Me interes është edhe përmendja e Shurdhahut, në vitin 594, në trajtën Sardicens[27]) për më tepër në këtë dokument Shurdhahu na del si qendër peshkopate. Rreth këtyre viteve Sarda duhet të jetë pushtuar nga sllavët, nga sa mund të kuptohet nga fati i një qendre tjetër pranë saj Lisit, i cili në vitin 592 rezulton »në dorë të armikut» (sub. hostilus)[28]).

Në burimet e mëvonshme mesjetare Shurdhahu përmëndet si qendër peshkopate midis viteve 1190--1460, (episcopi Sardanenses) e varur nga kryepeshkopata e Tivarit. Por nga sa mësojmë nga lënda arkeologjike dhe arkitektura e qytetit, në këtë periudhë ky i fundit e pat kaluar kohën e lulëzimit të tij më të madh. Këtë e dëshmojnë monedhat që mbulojnë periudhën nga viti 1081-1195, objektet e tjera arkeologjike, shumica e banesave që i përkasin kësaj kohe si dhe rënia e arkitekturës së monumenteve të kultit pas kësaj periudhe (krahaso kishën 4,6 dhe kishën 8).

25) H. Spahiu – D. Komata vep.cit. 300.
26) Po aty. 300.
27) L. Thalloczy, C. Jiricek, E. Sufflay – Acta. Alb. vol. I, dok. 42.
28) Po aty dok. 40.

Përsëri do të kemi një pushtim të Sardës rreth viteve 1184 nga Sërbët, Midis kalave të pushtuara nga Nemanja ndërmjet Danjës Drishtit dhe Shkodrës përmëndet edhe «Sarda»[29]). Gërmimet arkeologjike na njohin me pasojat e këtij pushtimi. Në një banesë të qytetit të poshtëm pranë kishës nr. VI, janë hetuar shenja djegie[30]) bashkë me të është djegur edhe një monedhë e Isakut II Engjëlli (1185-1195)[31]). Shenja djegie janë hetuar edhe në rënojat e banesave pranë murit të dytë rrethues, ku u gjetën dhe sasira të konsiderueshme llaçi e rëre që kanë shërbyer gjatë ndërtimit të kalasë[32]). Këto banesa janë më të hershme nga muri i kalasë pasi ai kalon mbi to ose përfshin pjesë të mureve të tyre, dhe datohen në shek. XI nga 5 monedha bizantine të kësaj kohe të gjetura në kthina të ndryshme të këtyre ndërtimeve.

Autorët e gërmimit mendojnë se numuri i madh i skeleteve të gjetura në varrin Nr. 10 duhet të ketë lidhje me ndonjë masakër të bërë nga pushtuesit e huaj[33]). Mund të konkludohet se muri i dytë rrethues është ndërtuar pas vitit 1184, ndoshta deri nga fillimi i shekullit XIII, duke qenë kështu të një mendimi me autorët e gërmimit që e datojnë nga fundi i shek. XII fillimi i shek. XIII[34]). Përsa i përket murit të parë rrethues nuk kemi të dhëna për një datim të saktë pasi raporti kronologjik i tij me banesat nuk del aq i qartë për shkak të ndërmjetsimit të murit të vonë antik dhe për mungesë të dhënash të sigurta për datimin e vetë banesave. Siç kemi vënë në dukje edhe gjatë përshkrimit të mureve ajo që i afron këto dy ndërtime është trashësija e njëjtë e mureve mungesa e brezave të drurit si dhe mos lidhja e plotë e kurtinës me kullat ndërsa dallimet mund të hetohen në ndryshimin e përmasave të kullave në formë të shkronjës U si dhe në egzistencën e kullave trekëndëshe shumë të ngjashme me ato të Butrintit të datuara në shek. XI[35]). Në periudhat që pasuan Sarda ka qënë nën juridiksionin e familjes feudale shqiptare të Dukagjinasve dhe ndoshta edhe të familjes sunduese të Zaharisë e cila ka qenë në kufi me të parët në vitet 1373-1444[36]). Nga ana tjetër nga një letër që i drejtohet Karl Topisë nga Papa Gregori XI, në të cilën ky i fundit e quan Karlin «Dux Dalmatiae». dhe i lutet të shtërngojë ipeshkvin e Sardës, ti paguaj selisë së shenjtë të dhjetën e detyruar, mendohet që edhe «Karl Topia të ketë sunduar në këto krahina[37]). Pak pas pushtimit nga turqit në vitin 1491 dioqeza e Sardës pushon së qenuri më vehte dhe bashkohet me atë të Sapës. Sarda vazhdon të vegjetojë deri rreth fillirit të shek. XVIII kohë pas së cilës emri i saj nuk përmëndet më.

PUNIMET KONSERVUESE

Para se të ndërmereshin punimet konservuese ishte i nevojshëm një studim i monumentit në piktamje historike, arkitektonike dhe të teknikës së ndërtimit. Me rëndësi është dallimi i fazave të ndërtimit, gjurmëve të elementëve arkitektonikë, dhe tipareve specifike të arkitekturës dhe teknikës së ndërtimit të monumentit me qëllim që të mos humbasë apo të dëmtohet ndonjë nga këto vlera. Gjatë punimeve konservuese në Shurdhah ne patëm për synim, konsolidimin e mureve në gjëndjen egzistuese, plotësime në masën e nevojshme dhe me funksjon Rivlerësimin arkitektonik të ndonjë pjese të rëndësishme të kalasë si dhe ruajtjen e ndonjë elementi arkitektonik, nëpërmjet restaurimit.

Nga kullat që mbronin hyrjen e qytetit të sipërm kishin mbetur vetëm muret e brëndëshme, në të dy anët e portës në një lartësi prej 4,50-5 m si të vetmet trakte të ruajtura (Fig. 6). Llaçi i dobët, si dhe lartësija e tyre e madhe, bënin që këto trakte të ishin në degradim të vazhdueshëm dhe paraqitnin rrezik shëmbje. Gjithashtu në të dy anët e portës dy trakte të veçuar që ngriheshin rreth 2 m mbi nivelin e ruajtur të murit rrethues ishin pjerrur në mënyrë të theksuar në anën e jashtëme. Nga ana tjetër në kurorat e mureve të kullave dhe kurtinave, nën veprimin e agjentëve atmosferikë sidomos lagështisë, gurët qenë shkëputur nga lidhja duke shkaktuar uljen progresive të lartësisë së mureve, I njejti veprim kryhej edhe në prerjet anësore të mureve sidomos tek traktet e ruaj-

29) L. Talloczy. C. Jiricek, E. Sufflay **Vep.cit. vol. I, dok. 113. C. Jiricek, Geschichte der Serben I, 265.**
30) H. Spahiu – D. Komata **vep.cit.** 281.
31) Po aty 306.
32) Po aty 283
33) H. Spahiu – D. Komata **vep. cit. 294.**
34) Po aty 312.
35) Gj. Karaiskaj – **Muret rrethuese të Butrintit në Mesjetë** (doreshkrim).
36) T. Ippen. **G.Z.M.B.H. v. XII, 1900** nr. 1 83-98.
37) A. Gegaj – **L'Albanie et l'invasion turque au XVe Siècle** Lovain 1937, 10.

DOKTORATË

tur nga kullat mbrojtëse të hyrjes. Ky proces shpejtohej edhe nga cilësija e dobët e llaçit të vjetër.

Për të konservuar dy kullat anësore të hyrjes ishte e nevojshme të ndërtoheshin kontraforta në ekstremet e mureve të ruajtur. Për këtë pasi u pastrua planimetria e kullave u ndërtuan dy muret që luanin rolin e kontraforteve duke ndjekur njëkohësisht planimetrinë e kullës. Ndërsa për dy traktet e pjerrur të kurtinave në të dy anët e hyrjes u pa më e arsyeshme plotësimi i mureve të kurtinës për bri tyre. Në këtë mënyrë jo vetëm që u konsoliduan kullat dhe muret bri tyre por ky kompleks fitoi mjaft edhe në drejtim të përceptimit arkitektonik, pa qenë nevoja të kthehet në gjëndjen fillestare por duke u ruajtur si rrënojë (Fig. 16).

Kjo pamje e re do të cënohej së tepërmi në pikpamje estetike në qoftë se plotësimet do të dallohesh̀in si njolla të bardha kundrejt mureve origjinale. Për këtë u zgjodhën me kujdes gurë me ngjyrë të errët. Kështu që vetëm duke i parë me kujdes nga afër mund të dallohen pjesët e shtuara, ndërsa nga larg kompleksi i hyrjes perceptohet si një i tërë. Mbi pjesët e sipërme të mureve të kullave dhe kurtinave u injektua lëng çimento, pastaj u rilidhën gurët e shkëputur me llaç bastard duke patur parasysh izolimin e mirë të fugave nga sipër për të mos lejuar depërtimin e shiut. Për kurtinat lindi nevoja e mbushjes së ndonjë zgavre në bazat e mureve si dhe për disa plotësime të vogla deri në nivelin e ruajtur të tyre. Në këtë rast u pat parasysh që pas konservimit të hyrjes të arrihet një ekuilibër arkitektonik gjë që ndihmon edhe në të kuptuarit më të mirë të vlerave volumore fillestare të monumentit. Në murin e parë rrethues duke ndjekur të njejtin kriter por me plotësime më



Fig. 16

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 17



Fig. 18

të vogla u konservuan dy kullat e hyrjes. Kullat C_1, C_2 Kulla A dhe një pjesë e murit pranë kësaj të fundit.

Nevoja të ngutëshme për konservim paraqiste kisha VI ku nga dy fragmentet e ruajtur të mureve anësore pranë apsidës shkëputeshin me lehtësi gurët nga lidhësi i dekompozuar, nga ana jugore rezikohej të humbiste dhe gjurma e një dritareje, ndërsa gurët e të dy qosheve nga lindja, kishin rënë në një lartësi prej më se 1,5 m. Mbi, apsidë një pjesë e rrasave prej guri të mbulesës kishin rënë, ndërsa të tjerat kishin lëvizur nga vendi (Fig. 14). Punimet e konservimit në këtë objekt konsistuan në zbulimin e planimetrisë dhe ngritjes së mureve të saj në një farë lartësije mbi nivelin e terrenit për ta bërë më të lexueshme shtrirjen planimetrike të objektit. U restaurua dritarja në murin perëndimor dhe u plotësua; ky i fundit në trajtën e një kontraforte (Fig. 17).

Në të njëjtën mënyrë u veprua edhe në murin verior duke lënë të pa plotësuar vendin që do ti takonte dritares nga e cila nuk ruhej asnjë gjurmë (Fig. 18). U plotësuan paturat e dritares së apsidës dhe u mbulua apsida me rrasa guri. U morën masa për izolimin e mureve nga sipër ashtu si për muret rrethues. Në muret shtesë nuk u zbatua e njejta teknikë si ajo e mureve origjinale pasi për këtë do të ishte e nevojshme të punohej guri, i cili në këtë rast me ngjyrën e tij të bardhë do të krijonte një kontrast të fortë me muret e vjetër. Punimet u shtrinë edhe në konservimin e një kishe tjetër rënojë muret e së cilës ruheshin deri në lartësi prej 2-3 m. Punimet në vazhdim synojnë konservimin e mureve të shumtë të banesave dhe të kishës XI të cilat ruhen në një lartësi prej rreth një metër. Një problem tjetër që kërkonte zgjidhje ishte më në fund dallimi me saktësi i mureve shtesë të para nga afër për të ruajtur autenticitetin historik të monumentit dhe për të mos sjellë konfuzjon tek studjuesit e mëvonshëm. Ky problem do të zgjidhet duke thelluar me dalë të një kanal në kufirin midis murit të ri dhe të vjetër, i cili do të mbushet me llaç duke krijuar një bordurë të dalë në sipërfaqe. Edhe në qoftë se llaçi me kalimin e kohës do të bjerë kufiri do të ruhet nëpërmjet kanalit. Në disa vende kryesore do të shënohen gjithashtu viti dhe inicialet e Institutit që ka kryer punimet. Me konservimet e mësipërme është siguruar nga degradimi i mëtejshëm një monument i rëndësishëm mesjetar. I pa cënuar nga ndërtime të reja përreth, ishulli piktoresk i Shurdhahut me monumentet e tij, paraqet një pikë turistike interesante.

Me këtë rast mund të kryhen edhe punime të tjera në të ardhmen siç është pastrimi i pyllit dhe zbulimi i monumenteve në pjesën më të lartë të kodrës, çlirimi i mureve rethues nga dherat e rrënimet, krijimi i disa rrugëve për vizitim, i një muzeu, si dhe i një moli të vogël për qëndrimin e barkave.


Kalaja e Shurdhahut
Planimetria
0 10 20 30 40 50 100 m
X
H
G
F
E
D
H
J
I
IX
VI
VIII
XI
C1
C2
B2
B1
A

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

DO NOT COPY

DONNEES SUR L'ARCHITECTURE DE LA FORTERESSE DE SHURDHAH (SARDA) ET SUR LES TRAVAUX DE CONSERVATION QUI Y ONT ETE EFFECTUES

RESUME

La ville moyenâgeuse de Shurdhah a été récemment l'objet d'études minutieuses, et cela grâce aux fouilles archéologiques effectuées systématiquement pendant les années 1967-1970 sous la direction de H. Spahiu et de D. Komata.

Comme résultat de ces fouilles on a mis au jour un matériel archéologique abondant et un complexe d'habitations et d'édifices consacrés au culte. Aussi bien les habitations se trouvant en surface que celles qu'on venait de mettre au jour exigeaient en général des travaux de conservation urgents. Entre autres un mur d'enceinte situé à proximité de la porte de la ville haute. Par ailleurs les deux tours semi-circulaires défendant cette porte, ainsi que certains édifices consacrés au culte menaçaient de crouler. C'est à cette fin que des travaux de conservation furent effectués pendant la période 1975-1976. C'est ainsi que fut éliminé le péril d'une dégradation ultérieure des monuments architecturaux se dressant dans cette importante ville moyenâgeuse. Par cet article nous chercherons de fournir des données sur ces travaux et de relever les éléments nouveaux mis au jour durant les observations faites à cette occasion.

La Forteresse de Shurdhah (Tab. I) se dresse sur une colline rocheuse à 130 m d'altitude du niveau de la mer, à 8 km au sud de la ville de Shkodër, sur la rive droite du fleuve Drin.

Identifiée par Hahn comme siège de l'épiscopat moyenâgeux de Sarde, Shurdhah était protégée par deux murs d'enceinte séparant la ville en deux parties, la ville haute et la ville basse. Ces murs couvraient un périmètre de 4,7 ha. S'étendant sur une longueur d'environ 1 km, ils étaient renforcés par une série de tours.

Par suite de la création du lac artificiel de la centrale hydro-électrique «Mao Tsétoung», près de 300 m du mur d'enceinte extérieur, situé sur le flanc occidental de la forteresse, ainsi que 7 tours qui le flanquait, ont été inondés par les eaux de ce lac. Le premier mur d'enceinte commence sur le côté oriental de la forteresse par une tour triangulaire, située à 5 mètres seulement du bord d'un précipice, ce qui rend inutile la présence d'un mur de défense de ce côté sur une longueur de 150 m (Fig. 1).

La tour (A) (Figs. 1 et 2), conservée actuellement sur une hauteur de 5 m, avance près de 4 m. hors de la courtine. Ces murs sont larges de 0,60 m.

A une distance de 55 m loin de la tour A se dressent deux autres tours disposées à proximité l'une de l'autre (B_1, B_2). C'est entre ces deux dernières tours qu'avait été aménagée l'entrée à la forteresse. Quant à leur planimétrie, elle se présente sous la forme irrégulière de la lettre U (Tab. I, Fig. 3). L'épaisseur de leurs murs varie de 0,80 à 0,90 m, tandis que leur hauteur présente est de 2-3 m. Ces tours avancent 4 m. hors des murs et sont disposées l'une à côté de l'autre, créant de la sorte une espèce de couloir au fond de laquelle se trouvait l'entrée de la ville basse. Il y avait aussi une petite entrée communiquant avec ce couloir sur le flanc occidental de la tour B_1, comme le témoigne le montan conservé sur le côté occidental de cette entrée.

A l'ouest de la tour B_2 se dresse une autre tour (C_2), dont la planimétrie se caractérise par une forme intermédiaire entre celle des tours en forme de la lettre U et celle de forme triangulaire. Toutefois, les côtés latéraux arrondis de cette tour ont une forme pointue sur sa partie frontale. Elle a été l'objet de fouilles complètes et on y a trouvé une autre tour ayant la forme de la lettre U et de petites dimensions (C_1) (Fig. 3, Fig. 4). Cette dernière tour appartient à la période la plus ancienne, aux VIe-VIIIe siècles selon les auteurs des fouilles. Elle était reliée à un mur intérieur large de 1,10 m, conservé actuellement sur une hauteur de 1-2 m et séparé par un joint du mur d'adjonction large 60-70 cm, auquel il s'appuyait de dehors. C'est à ce dernier mur que sont reliées toutes les autres tours décrites plus haut, raison pour laquelle ces constructions sont attribuées à la deuxième période.

Le mur d'enceinte de la ville basse continuait encore pour 200 mètres en direction N.-O., puis il faisait un détour en direction N.-E., pour ceindre entièrement la colline sur laquelle se dresse la forteresse jusqu'au bord du précipice mentionné plus haut. Le côté occidental où se dressaient les tours D, E, F, G, H, (Tab. I), qui était aussi la partie la plus vulné-

DO NOT COPY

rable, a été inondé par les eaux du lac artificiel. C'est justement dans cette partie de la forteresse que nous aurions pu identifier une troisième période de construction.

Dans l'esquisse reproduite sur la Fig. 5 (Ilirija III, 267), à l'intérieur de la tour H il y a un mur formant de l'intérieur un angle obtus avec la courtine et se reliant organiquement à celle-ci; les auteurs ne fournissent aucune explication à propos de cette courtine. Ce mur ne peut témoigner autre que la présence d'une tour triangulaire très ancienne et complètement détruite au moment de la construction de la tour H. Ce détail revêt une grande importance, parce qu'en plus du fait que nous avons affaire à la partie la plus vulnérable de la forteresse, il nous permet de supposer que les tours quadrangulaires sont plus récentes que celles triangulaires et, en conséquence, appartiennent à la troisième période de construction.

Le mur d'enceinte de la ville haute (Tab. I, Fig. 5) domine la partie la plus haute de la colline, il a une longueur générale d'environ 400 m. Sa partie la mieux conservée est celle s'étendant sur son côté S.-O., où se trouve aussi l'entrée principale à la ville haute; elle est flanquée de deux tours semi-circulaires (Tab. I, Figs. 6 et 7), ainsi que par une autre tour de la même forme se dressant à 14 m en direction N.-E. de l'entrée (Fig. 5).

Le mur d'enceinte de la ville haute s'interrompt, du côté oriental, à une distance de près de 30 m. du bord du précipice, du fait que sur son tracé a été construite une église (l'église VIII), conservée actuellement dans un état satisfaisant. Ce mur d'enceinte, à proximité de l'église, est pourvue sur une largeur de 90 cm d'une meurtrière. Celle-ci, haute 60 cm et large à l'intérieur 40 cm et à l'extérieur 20 cm, est couverte par des plaques de pierre disposées horizontalement.

LA TECHNIQUE DE CONSTRUCTION DES MURS D'ENCEINTE

Les murs d'enceinte de la forteresse moyenâgeuse de Shurdhah se caractérisent par une épaisseur plutôt petite de dimensions 0,60 x 0,90 m et par l'absence des bandes en bois. Ils sont construits avec des pierres extraites des carrières locales et reliées avec du mortier pauvre, comportant du matériel de remplissage fin et beaucoup de chaux. Les pierres de forme allongée ne constituent pas cependant des rangées régulières; elles ont une dimension moyenne de près de 0,35 x x 0,15 m. Par ailleurs les mars ne comportent pas des morceaux de briques. Quant aux murs des tours, ils sont reliés aux courtines rien que dans leur partie supérieure. Ainsi, les deux tours flanquant la porte d'entrée à la ville haute sont rattachées aux courtines à une hauteur au-dessus de 3 m. La seule exception est représentée par la tour triangulaire (A). Une telle particularité, surtout quand on a affaire à des ruines, peut conduire à des conclusions erronées dans la détermination des différentes phases de construction. Les courtines comme les murs des tours ne représentent pas des lignes droites et régulières, mais des lignes courbes. Partant de leur état actuel, il est difficile de déterminer la hauteur initiale des murs et des tours. Le manque d'escaliers sur les parements intérieurs des courtines, montrent que ceux-ci étaient en bois. Comme dans la forteresse de Drisht, les sentiers de passage au-dessus du mur au niveau des créneaux étaient représentés par des plate-formes de bois reposant sur des poutres. Les murs peu épais sans bandes de bois, le mode de disposition des pierres sur les faces des murs, la qualité du mortier et les petites tours semi-circulaires nous rappellent les ouvrages défensifs de Drisht. La tour-porte de l'Acropole de Drisht aussi ne se relie pas entièrement à la courtine, mais différemment des tours de Shurdhah à la partie inférieure de celle-ci jusqu'à une hauteur de 2 m.

Deux petites tours (3,5 x 3 m) en forme de fer à cheval, non reliées par des courtines mais contemporaines à celles-ci, nous les retrouvons à Kanine.

Ce qui distingue la première période de construction des périodes successives du point de vue de la technique, est précisément la liaison entière de la tour à la courtine ainsi qu'une certaine irrégularité dans sa forme planimétrique.

Les fortifications moyenâgeuses de Shurdhah se différencient en plusieurs points des autres fortifications de cette même période en Albanie, malgré les analogies susmentionnées avec les ouvrages défensifs cités plus haut. Cette différenciation consiste principalement dans le traitement architectonique des entrées, dans l'absence des bandes de bois ainsi que dans la forme planimétrique des tours. Les entrées flanquées de deux petites tours latérales en forme de la lettre U et disposées l'une près de l'autre, constituent un type connu nous rappelant celui des anciennes fortifications plus récentes d'Elbasan, de Vig, de Paleokaster, etc, qui ont servi de modèle à la forteresse de Shurdhah.

DONNEES ARCHITECTURALES SUR CERTAINS EDIFICES CONSACRES AU CULTE

Le seul édifice conservé le mieux parmi tant d'autres est celui de l'église de la Madone (voir la planimétrie, VIII) construit sur le mur en ruines de la première enceinte de la ville, à son extrémité orientale. Actuellement elle est conservée jusqu'au niveau du toit, qui est à deux pentes et couverts par des plaques de pierre. Il s'agit d'une église (Tab. II, Figs. 8, 9 et 10) du type de «basilique à une nef». Sur la face interne du mur oriental, à la droite de l'entrée, se trouve une pierre portant la date 1564. H. Spahiu et D. Komata ont relevé une phase plus ancienne au-dessous des fondements de l'église existante et précisément une abside plus ancienne au-dessous de l'actuelle. Toutefois, ces auteurs ne fournissent pas une opinion définitive sur la date de ces phases de contruction.

En suivant les traces de l'ancienne abside on relève aussi des tronçons détachés du mur septentrional de cette égli-

PHOTOCOPY

se, tandis que du côté occidental une partie de son mur haut de 1.80 m a été incorporée dans le mur de la nouvelle église. Ces données indiquent que la première église avait une longueur presque analogue à l'actuelle, mais elle était 1.60 m plus large (Tab. II). L'église de la Madone, même dans son état actuel, présente deux périodes de construction. A la période plus ancienne se rapportent le mur occidental ainsi qu'une part des murs septentrional et méridional, et cela sur une longueur de 8,50 m, tandis que la moitié orientale de l'église sur une longueur de 11.30 m, y compris l'abside, a été reconstruite et représente de la sorte la troisième période de construction. Cela apparaît clairement surtout dans la jointure de liaison des deux périodes sur le mur septentrional, où le mur plus récent repose sur la partie supérieure de l'ancien (Fig. 11). C'est à la deuxième période qu'appartient aussi la date 1564. Il est fort possible que l'église construite en 1564 ait été plus petite que celle existante, parce qu'on a pas mis au jour des substructures de cette période dans la présente abside.

En rapportant la date 1564 à la deuxième période, ainsi que le fait que l'ancienne église était entièrement détruite au moment de cette reconstruction, il est très probable que la première église ait été mise en place au plus tard dans la période allant de la fin du XIVe siècle au début du XVe. A cette même période ou à une période quelque peu plus ancienne appartient l'abandon de l'enceinte supérieure de la ville, tandis que la troisième période de construction se rapporte vraisemblablement aux XVIIe-XVIIIe siècles.

Il convient de relever que la technique de construction se rapportant à ces trois périodes apparaît plus primitive que celle de certains autres édifices du culte plus anciens, que nous allons mentionner plus loin.

L'église XI. L'édifice VI, mentionné par les auteurs des fouilles, constitue un complexe de bâtiments situé dans la partie orientale de la ville entre les deux murs d'enceinte. En fait nous sommes ici en présence de deux constructions différentes: d'une part l'église (sur le côté septentrional) et de l'autre une maison d'habitation (sur le côté méridional). La surface libre entre ces deux constructions constitue le couloir de la maison d'habitation, tandis qu'une adaptation plus récente visant à tirer profit de cette espace et des murs latéraux existants en a fait, à notre avis, une pièce d'habitation (†). En laissant de côté celle-ci, la construction mise en place dans sa partie septentrionale représente une église du type de basilique à une nef, comportant un naos et un narthex. La naos large de 5.30 m est actuellement long de 9,70 m. Son plancher était revêtu de dalles de pierres, ayant une forme régulière quadrangulaire, et ses murs étaient enduits à l'intérieur d'une couche de chaux épaisse de 2 cm. On relève encore les traces où commençait l'autel en forme de plancher à gradins d'une hauteur de 0.10 m. L'abside et le mur fermant cette pièce du côté est ne sont plus conservés. A proximité de l'église ont été construits cinq tombeaux (les tombes 5, 6, 7, 8 et 9), dont une située dans le narthex, sur le côté septentrional face à l'entrée de l'église. Sa technique de construction, en raison des pierres semi-équarries et disposées en rangées horizontales, diffère de celle des trois périodes de construction de l'église de la Madone. Dans un des tombeaux, situés à proximité de l'église (la tombe 8), on a mis au jour un anneau de bronze sur le fond duquel figure incise une étoile à cinq branches inscrite dans un cercle. Ces anneaux concernent les contrées de l'empire byzantin pendant le XIe siècle, date qui correspond plus ou moins à la période de construction de notre église.

A son état actuel sont conservées l'abside et une partie des murs latéraux à celle-ci (Figs. 13, 14). L'abside était recouverte par des plaques de pierres et illuminée par une fenêtre allongée comportant un arc de pierres taillées. Le mur septentrional aussi conserve les traces d'une fenêtre analogue à la précédente. Avant d'entreprendre les travaux de conservation, toute la planimétrie de l'église a été déblayée et nettoyée.

Le plancher était revêtu de dalles de pierres ayant une coupe irrégulière. Plus tard on avait ajouté à cette église, sur son côté occidental, un narthex communiquant à travers une porte avec son mur septentrional. Un mur large de 0.50 m et contigu au mur situé au fond du naos avait été mis en place pour y faire reposer le socle de la voûte d'une crypte, dont l'autre socle s'appuyait sur le mur situé au fond du narthex. Les faces externes des murs, en pierres semi-taillées de forme quadrangulaire irrégulière, se caractérisent par des hauteurs différentes. La technique de construction de cette église est semblable à celle de l'église XI (Tab. I) et doit appartenir à une période de construction proche de celle-ci, soit le XIe siècle ou le XIIe.

A PROPOS DE LA DATATION DES MURS D'ENCEINTE ET DES PERIODES D'EPANOUISSEMENT DE LA VILLE

A Shurdhah ont été mis au jour une série d'objets en céramique appartenant à la basse antiquité, entre autres une fibule de bronze en forme de croix et ayant des terminaisons en tête d'ail datant la fin du IIIe siècle et le IVe. C'est durant cette période que nombre de fortifications ont été mises en place sur le territoire illyrien en vue d'affronter les différentes invasions. C'est à cette période qu'appartiennent, à notre avis, les fortifications les plus anciennes construites à Shurdhah et représentées par le mur intérieur de la ville basse et par la tour C_1 qui se rattache organiquement à ce mur. Nous retrouvons des tours ayant une forme planimétrique analogue dans la forteresse d'Elbasan, attribuée à la première moitié du IVe siècle, ainsi que dans les forteresses de Vig (IIIe-IVe siècles), de Grazhdan et ailleurs. Ce type de tours a été préféré surtout pendant le IVe siècle. L'argument selon lequel la première période de construction des ouvrages de défense à Shurdhah se rapporte aux VIe-VIIIe siècles, et cela partant de

DO NOT COPY

la forme des tours caractéristique au bas moyen âge, ne nous semble pas fondé.

Dans la partie intérieure du premier mur d'enceinte ont été mis au jour une série de ruines d'habitations. A la différence des habitations mises au jour dans la partie intérieure du deuxième mur d'enceinte, qui sont plus anciennes que le mur même d'enceinte, celles de la première ceinture sont plus récentes que les habitations situées à l'intérieur du mur qui appartient à la basse antiquité. Ces habitations se dressent sur ce dernier ou surmontent les endroits où le mur d'enceinte était gravement endommagé. C'est en cette zone, où nous avons affaire à deux périodes de construction différentes, qu'a eu lieu le mélange des matériaux de construction et c'est précisément dans le même carré et à la même profondeur, à proximité du mur d'enceinte (l'édifice III reposant sur le mur d'enceinte de la basse antiquité, la pièce B), qu'a été retrouvée la fibule en forme de croix du IVe siècle ainsi qu'une monnaie du XIIe siècle.

Nous n'avons aucun besoin de considérer la fibule comme une relique pour avancer sa période d'usage jusqu'aux IVe-VIIIe siècles, du fait que ces deux objets représentent clairement deux périodes de construction différentes, celle du mur intérieur de la forteresse pendant le VIe siècle et celle de l'habitation durant le XIIe siècle. La disposition des murs des édifices, attribués aux XIe-XIIe siècles en raison du matériel archéologique mis au jour au-dessus du mur de défense de la basse antiquité, montre qu'en cette période moyenâgeuse le mur de la basse antiquité était entièrement écroulée. En conséquence la ville a manqué de fortifications pendant un long temps, ce qui peut être attribué aux invasions slaves du VIe siècle qui furent accompagnées non seulement par la dévastation de la ville et de ses fortifications, mais aussi par le massacre de ses habitants. En témoigne le grand nombre de squelettes récupérés dans la tour C_1. Un intérêt particulier présente aussi le fait que Shurdhah est mentionnée en 594, dans un document écrit, comme Sardicens et en plus comme siège d'un épiscopat. C'est durant ces années que Sarda doit avoir été occupée par les Slaves, comme l'indique aussi le sort d'un autre centre situé à sa proximité, Lis, qui était tombé en l'an 592 «dans les mains de l'ennemi» (sub. hostilus).

Dans les documents du bas moyen âge Shurdhah est mentionnée comme un siège épiscopal (episcopi Sardanenses), pendant la période allant de 1190 à 1460, placé sous l'autorité de l'archevêché de Tivar. Or, comme le montrent les matériaux archéologiques et l'architecture de la ville, pendant cette dernière période Shurdhah avait déjà traversé sa période de plein essor. En témoignent les monnaies allant de 1081 à 1195, les autres objets archéologiques mis au jour, la plupart des habitations attribuées à cette période et la décadence caractérisant l'architecture des monuments du culte dans la période successive.

Shurdhah est occupée à nouveau par les Serbes en l'an 1184; parmi les forteresses passées à Nemanja, entre autres Danje, Drisht, Shkoder, figure aussi «Sarda». Les fouilles archéologiques nous ont fait connaître les conséquences de cette invasion.

Dans une habitation de la ville basse, à proximité de l'église Nº VI, ont été relevées des traces d'incendie ayant affecté aussi une monnaie trappée par Isak II l'Ange (1185-1195). Des traces analogues ont été identifiées parmi les ruines des habitations à proximité du deuxième mur d'enceinte, où l'on a retrouvé de grandes quantités de mortier et de sable employées pendant la construction de la forteresse. Ces habitations sont plus anciennes que la muraille de la forteresse, du fait que celle-ci les surmonte ou englobe une partie de leurs murs. Elles datent le XIe siècle, du fait que 5 monnaies byzantines de cette période ont été mises au jour dans les différentes pièces.

Les auteurs des fouilles pensent que le grand nombre de squelettes découverts dans la tombe Nº 10 doit être le résultat de quelque massacre perpétré par les envahisseurs étrangers. Conclusion: le deuxième mur d'enceinte a été mis en place après 1184, peut-être même au commencement du XIIIe siècle. En ce qui concerne le premier mur d'enceinte, nous ne disposons pas de données pour sa datation exacte, et cela du fait qu'il n'existe pas un rapport chronologique clair entre ce mur et les habitations en raison de la présence du mur attribué à la basse antiquité et du défaut de données sûres relatives aux habitations mêmes. Comme cela a été relevé pendant la description des murs, ce qui rapproche ces deux constructions sont avant tout l'épaisseur identique des murs, l'absence des bandes de bois et la liaison incomplète de la courtine aux tours; quant à leurs différenciations, elles consistent dans les dimensions différentes des tours en forme de la lettre U ainsi que dans la présence de tours triangulaires très semblables à celles de Butrint, datant vraisemblablement le XIe siècle. Successivement Sarda passe sous la domination de la famille patriarcale des Dukagjinas et peut-être même de la famillle des Zaharias, dont le domaine s'étendait pendant les années 1373-1444 dans le voisinage immédiat du territoire des Dukagjinas. Par ailleurs, selon une lettre adressée à Karl Topia par le pape Grégoire XI, ce dernier appelle Karl Topia «Dux Dalmatiae» et le prie d'intervenir auprès de l'archevêque de Sarda pour le contraindre à payer au Saint Siège la dime qu'il lui devait. Ce qui montre que «Karl Topia a étendu son pouvoir sur ces contrées». Quelques années après l'invasion turque, en 1491 la diocèse de Sarda perd son indépendance et s'associe à celle de Sape. Sarde continue à végéter jusqu'au commencement du XVIIIe siècle, après quoi son nom n'est plus mentionné.

LES TRAVAUX DE CONSERVATION

Avant d'entreprendre les travaux de conservation, il fallait tout d'abord étudier le monument en question du point de vue historique, architectonique et de la technique de construction. Une importance particulière revêtaient aussi la distinction des différentes phases de construction, les traces laissées par les éléments architectoniques, ainsi que les propriétés spécifiques caractérisant l'architecture et la technique de construction de

ce monument, et cela afin de ne perdre ou abimer aucun de ses éléments de valeur. Pendant les travaux de conservation, à Shurdhah, notre but principal était donc celui de consolider les murs à leur état actuel, de compléter les éléments architecturaux dans la limite du possible, et cela afin de revaloriser sur le plan architectonique quelque élément important de la forteresse ou de le conserver à travers la restauration.

Des tours protégeant l'entrée de la ville haute il n'en restait que les murs intérieurs, des deux côtés de la porte, sur une hauteur allant de 4,50 à 5 m (Fig. 6). La mauvaise qualité du mortier et la hauteur même élevée de ces tronçons, en constante dégradation, imposaient des mesures de conservation pour éviter le péril d'écroulement.

Pour sauver les deux tours latérales de l'entrée, il fallait construire des contre-forts à l'extrémité des murs conservés. Après avoir déblayé et nettoyé le périmètre de ces tours, on a mis en place deux murs remplissant le rôle de contre-forts en tenant compte de la planimétrie de la tour. En ce qui concerne les deux tronçons inclinés des courtines, disposées des deux côtés de l'entrée, nous avons jugé comme plus raisonnable de compléter les murs de la courtine mitoyens à ces tronçons. De la sorte nous avons consolider non seulement les tours et les murs mitoyens à celles-ci, mais faciliter aussi la compréhension du monument même à son état actuel en ruines, sans qu'il fut besoin de le reporter à son état initial.

C'est en suivant le même critère, mais en effectuant des travaux plus petits de complètement, qu'ont été conservées les deux tours de l'entrée à la première muraille. Il s'agit précisément des tours C_1 et C_2.

Des travaux de conservation urgents nécessitaient aussi l'église VI, dont deux fragments appartenant aux murs latéraux à proximité de l'abside se trouvaient en état de délabrement en raison de la décomposition du liant; par ailleurs, on risquait de perdre les traces d'une fenêtre aménagée sur le côté méridional de cette église. Les travaux de conservation effectués ici ont consisté dans la mise au jour de la planimétrie et dans l'élévation des murs de l'église au-dessus du niveau du terrain, en vue de mieux en découvrir la planimétrie. Dans le même temps, on a procédé à la restauration de la fenêtre aménagée sur le mur occidental et celui-ci a été complété sous la forme d'un contre-fort (Fig. 17).

Les mêmes opérations ont été effectuées à propos du mur septentrional, en laissant vide cependant l'espace de la fenêtre dont on ne disposait aucune trace (Fig. 18).

Les travaux de conservation ont concerné aussi une autre église en ruines, dont les murs s'élevaient jusqu'à une hauteur de 2-3 m. Les autres travaux ont visé à la conservation des différents murs des habitations et de l'église XI, qui s'élevaient jusqu'à 1 mètre environ au-dessus du niveau du sol.

Par ces travaux de conservation il a été possible d'éviter la dégradation ultérieure de cet important monument moyenâgeux. Libre de construction nouvelles, l'île pittoresque de Shurdhah avec les monuments qu'il comporte constitue un point touristique très intéressant.

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

TË DHËNA TË REJA PËR KISHËN E MESOPOTAMIT

Për vetë interesin që paraqet studimi i plotë i kishës së Mesopotamit (Fig. 1), gjatë vitit 1973 ndërmorëm një ekspeditë[1]), qëllimi i së cilës ishte plotësimi i një sërë boshllëqesh dhe detyrash të pambaruara me ekspeditat dhe studimin e mëparshëm([2]). Këto detyra që i vumë vetes ishin: gërmimi i plotë i portikut dhe disa sondazhe, problemet e datimit dhe studimi i formës së veçantë të këtij monumenti.

Rezultatet kryesore të ekspeditave dhe të studimit të mëparshëm ishin sqarim i formës planimetrike me dy absida e portike nga tri anët, përcaktimi i mureve që i takojnë ndërtimit të parë dhe rindërtimeve kryesore të viteve 1793 dhe 1845, analiza strukturale dhe studimi i teknikës së ndërtimit si dhe vendosja në kohë e kishës. Gjithashtu në të trajtuam probleme të dekorit dhe në të njëjtën kohë kemi mbajtur qëndrim ndaj opinioneve të shprehura për këtë monument nga studjues të mëparshëm.

Gërmimi i plotë i monumentit filloi me rizbulimin e pjesëve të gërmuara gjatë viteve 1966-68 dhe vazhdoi me shtrirjen e tij në tërë portikun (Tab. 1) Në anën veriore dyshemeja me pllaka ruhet deri në themelin e pjesës së fundit të portikut, që lidh murin verior të kishës me themelin, në të cilin mbështeten pilastrat e portikut (lab. II, 1). Përveç pilastrave të zbuluara më parë, një tjetër doli në vazhdim të gërmimit. Ai është në gjendje të keqe, ndërtuar me tulla dhe gurë çmërs dhe ngrihej jo mbi pllaka gëlqerori si pilastrat e tjerë, por mbi mure tullash. Një veçanti që vërejtëm në të gjithë pilastrat është se menjëherë mbi pllakat prej guri gëlqeror ka një radhë tullash të trasha, si dhe të gjithë pilastrat në anën e brendshme janë me tulla, ndërsa në anën e jashtme me gurë çmërsi dhe tulla të holla (kluasonazh).

Ndërmjet dy pilastrave kryesorë të portikut në pllakat mbi murin anësor të portikut shihen gjurmë të mbërthimit të portave si dhe në mes të hapësirës një vrimë e fiksimit të tyre (Tab. II, 2). Kjo gjë, nëse do t'i pranonim si të tilla, do të thotë që portiku duhet të ketë pasur, në cilëndo formë qoftë, ndonjë mbyllje, hipotezë, të cilën e kemi shprehur dhe më parë, duke u nisur nga mënyra e punimit të pllakave ndërmjet pilastrave.[3])

Pak larg vendit ku kishim ndërprerë gërmimet vite më parë doli një panel tjetër mozaiku me përmasa 100x90 cm. Në mozaik është paraqitur një kafshë mitologjike me krahë (Fig. 2), vizatuar me një sfond gurësh gri në të kaltër që shkojnë deri në të zi, ndërsa trupi i saj është i bardhë dhe konturohet me gurë të kuq. Dragoi është me këmbë nga ana e pilastrave, ndërsa kokën e ka nga ana lindore. Ai është vizatuar në një pozë lëvizjeje me krahët hapur. Këmba e djathtë e përparme është e ngritur sipër, ndërsa tjetra është në tokë. Nga këmbët e mbrapme ruhet vetëm njëra, ndërsa tjetra e vendosur më prapa është në një sipërfaqe të prishur të mozaikut. Nga krahët, të cilët janë vizatuar në mënyrë skematike me rripa të bardhë dhe të kuq, i majti është i ngritur lart, ndërsa i djathti është përpara gati horizontal. Dy vija të kuqe janë në fillimin e krahut të majtë. Qafa e gjatë dhe e lartë përfundon me kokën me gojë të hapur. Figura e dragoit mbush gjithë panelin duke arritur deri në anët e tij, kështu pjesën e djathtë sipër e mbush bishti i gjatë që përdridhet rreth vetes. Kjo

1) Rilevimet e kësaj ekspedite janë të autorit dhe S. Dashit, vizatimet të S. Dashit, fotografitë të autorit.

2) A. Meksi, **Arkitektura e kishës së Mesopotamit** «Monumentet» 3, 1972, 47-94.

3) **Po aty,** 63.



Fig. 1

figurë është larg skematizmit elegant të skenës tjetër. Vizatimi këtu është më me detaje, por nuk ka atë bukuri si për proporcionet e figurës ashtu dhe për trajtimin në tërësi të saj.

Përveç këtij paneli, panelit me gjela dhe atij në naos, gjurmë shumë të pakta mozaiku për të gjykuar formën dhe madhësinë, ruhen dhe në një vend tjetër të portikut verior, me pjesën përpara nikes sot derë e kishës.

Krahu verior i portikut rezultoi më mirë i ruajtur dhe me më shumë elemente me vlerë se dy të tjerët. Kështu nga portiku perëndimor ruheshin shumë pak pllaka të tjera të dyshemesë, të tilla u gjetën vetëm në anën më në jug (Tab. II, 3). Për sa u përket pllakave të bazamentit të portikut ato i gjetëm vetëm në qoshen veriore të tij, të meremetuara me tulla në anën e brendshme. Përveç tyre vende-vende ruhen me llaç, në formën e disa ngritjeve të drejta, edhe fugat e takimit të pllakave të dikurshme të këtij bazamenti. Muri nën to (themeli i portikut) është me gurë e tulla me llaç të bollshëm. Për të parë thellësinë dhe strukturën e tij, ndërmorëm një sondazh në anën e brendshme të qoshes veriperëndimore të portikut (Tab III, Tab. II, 4), ku u gjet dhe një varr i çrregullt i vogël. Shënojmë se në varret pranë kishës janë përdorur mjaft nga pllakat që mungojnë. Themeli vazhdonte në një thellësi rreth 110 cm, llogaritur nga pjesa e sipërme e pllakës së bazamentit. Ai përbëhet nga pllaka e bazamentit (15 cm), nga shtresa nën të 15 cm e trashë, me gurë e tulla si rrafshim për pllakat dhe pjesa tjetër prej 80 cm, më e gjerë në pjesën e sipërme, si themel me gurë gëlqerorë dhe llaç. Që vetëm kjo pjesë e fundit është themel, e vërteton një dhëmb i formuar në nivelin e atëhershëm të tokës. Nga ana e jashtme shtresa e dytë me gurë e tulla mbulohej nga pllakat e trotuarit, të cilat i gjetëm të rralla vetëm në anën perëndimore, pranë këtij sondazhi.

Në krahun jugor të portikut na doli e njëjta pamje si në pjesën në perëndim të kontraforcës. Pllakat ruhen kryesisht në pjesën pranë murit, ndërsa më pak pranë bazamentit të portikut (Tab. II, 5). Nuk ruhet asnjë nga plakat e bazamentit. Nga gërmimi doli i plotë edhe bazamenti i pilastrit në mur pranë portës kryesore jugore. Pjesën më në lindje ne e patëm gërmuar që më parë duke gjetur pjesën më të madhe të pllakave si dhe një abside trefaqëshe të ndonjë paraklisi, që duhet t'i jetë shtuar kishës në këtë anë. Mbi bazamentin e portikut ishte i ndërtuar një varr, mbasi ai ishte fundosur, sepse vetë muri rrethues i varrit ishte më i thellë në një pikë. Mbas largimit të varrit doli qartë i tërë portiku, pllaka të bazamentit të të cilit ruheshin jo në tërë gjatësinë e tij (Tab. II, 5).

Gërmimi u përfundua me zbulimin e pjesës lindore ku dolën tërësisht themelet absidave dhe me sistemimin në tërësi të territorit rreth kishës që kohë më parë ishte përdorur për varre.

Përveç sondazhit në themelet e portikut, sonduam edhe në anën e jashtme të murit perëndimor të kishës. Themeli shkonte në një thellësi rreth 95 cm

DO NOT COPY

DOKUMENTI

dhe kishte 5 shkallëzime, nëpërmjet të cilave ai dilte jashtë murit (Tab. III).

Një problem tjetër që e pamë me vend ta sqaronim ishte dhe ai i dyshemesë së kishës, si në drejtim të pamjes së përgjithshme të saj ashtu edhe në motivet e rripave të mozaikut ndërmjet pllakave të gurit. Siç kemi vërejtur, dyshemeja paraqitej mjaft e dëmtuar, me pjesë të shtuara me beton dhe forma e saj nuk dallohej mirë. Për të realizuar detyrat që i vumë vetes, rilevuam më saktë gjurmët e mbetura të rripave të mozaikut dhe vetë formën e tyre, sepse këtë e gjykuam me interes për datimin dhe njohjen më të mirë të monumentit. Prej tyre doli se rikonstruksioni i Versaqisit[4]), të cilin e kemi pranuar dhe ne më parë, nuk është tërësisht i saktë, sepse në pikat (1) dhe (2) nuk na rezulton të ketë rripa mozaiku, gjë që sidomos në të parën do të ishte e pamundur, për shkak se pllaka nuk lejon vizatimin që na jep Versaqisi.

Për sa u përket rripave të mozaikut, ato janë disa llojesh, me gurë të kuq, të zinj dhe të bardhë. Në shumicën e rasteve gurët janë më të mëdhenj nga ata të paneleve të portikut verior. Dalluam katër mënyra vizatimi të mozaikut, të cilat po i paraqesim në vizatim (Tab. III). Ajo çka na duket më me interes është se ato janë mjaft të ngjashme me rripat e mozaikut të dyshemesë së kishës së Vllahernës në Artë[5]). Kështu në vija të përgjithshme janë të njëjta vizatimet 1 dhe A duke qenë si dhe gjithë të tjerët, më i sterholluar vizatimi ynë (gjithnjë duke gjykuar nga vizatimet e Orlandos). Vizatimi 2 ngjason me E, por në tonin ndërmjet gurëve kuadratikë janë vendosur gurë të vegjël trekëndësh që mungojnë në atë të Artës. Vizatimi 3 është i ngjashëm me atë B, vetëm se të 3 gurët trekëndsh janë më të shumtë dhe të vendosur në rreshta që alternohen. Vizatimi 4 është i njëjtë me atë. Gjithashtu nga planimetria e dyshemesë e dallojmë se një nga medalionet ka pasur një zog. Mendojmë se kjo ngjashmëri, deri në identitet në disa aspekte të dyshemesë së këtyre dy kishave nuk është diçka e rastit. Duke pasur parasysh këto, ne mendojmë se ka shumë të ngjarë që ndër ndërtuesit e kishët së Mesopotamit të ketë pasur edhe nga ata të Artës, sepse, siç do të shohim më poshtë, edhe aspekte të tjera i afrojnë këto monumente. Kështu Parigoritisa po në Artë dallohet për volumin kubik, klu-



Fig. 2

asonazhin, kornizat e rrafshta, portikun sot të humbur, influencat perëndimore dhe përdorimin e mozaikut. Një kafshë me krah e gdhendur në relievi gjendet në kishën e Vllahernës[6]). Relieve të afërta me ato të Mesopotamit ka dhe në kështjellën e Artës[7]), ku kemi dy luanë në poza të ndryshme, por që afrojnë me atë të faqes lindore dhe atë të faqes perëndimore të kishës sonë.

Këto paralele na shtyjnë të mendojmë se koha e ndërtimit të kishës së Mesopotamit, është shembulli 13, më saktë periudha rreth viteve 1272-1286, në të cilën kemi prezencën e feudalëve anzhuinë, për të cilën jemi ndalur në shkrimin tonë të parë. Lidhja në kohë e kishës së Mesopotamit me atë të Artës, në mungesë të të dhënave, është e vështirë të bëhet. Për këtë do të duhej para së gjithash të përcaktonim lidhje ndërmjet ndërtuesve të këtyre qendrave, nëse janë po ata, nëse kemi këmbime ndërmjet tyre apo influenca. Është me rëndësi të shënojmë se në fshatin Çiflig (në jug të Butrintit) kemi gjetur rrënojat e një bazilike bizantine, e cila është e ndërtuar kryesisht me mure në teknikën me tulla horizontale ndërmjet gurëve, por nuk mungon kluasona-

4) F. Versaqis, **Vizantiakos Naos en Dhelvino në Arqeollogjiko** Dheltion; 1915, 1, fig. 11.
5) A. Orlandos, **I Para tin Arton Moni ton Vllahernon.** në Arheion Vizantinon Mnimeion Elladhos, 1936, B', 1, fig. 23,24.
6) **Po aty** fig. 35.
7) A. Orlandos **To kastron tis Artis** në «Arheion Vizantinon Mnimeion Elladhes» 1936 B', 2, fig. 10, 11.

zhi dhe copëra tjegullash ndërmjet gurëve. Kjo teknikë haset dhe në kishën e Vllahernës në Artë si dhe në kisha të tjera të ndryshme. Përveç kësaj fugaturat e kësaj bazilike janë punuar me të njëjtën mënyrë si në Mesopotam, fuga të rregullta, të mbushura me një pastë ngjyrë kafe të hapët, që rrafshohet dhe thellohet me të njëjtën vegël. Prezenca edhe e kësaj kishe në këto anë do të thotë se kemi të bëjmë me një aktivitet ndërtimor jo të rastit.

Problemi tjetër jo më pak i rëndësishëm që deshëm të preknim është ai i formës së veçantë arkitekturale të kishës së Mesopotamit, që për vetë nivelin e zgjidhjes së përgjithshme arkitekturale të monumentit dhe të pjesëve të veçanta të tij, nuk mund të jetë rezultat veçse i kërkesave paraprake. Në shkrimin tonë të parë kemi hedhur hipotezën[8]) se zgjidhja me dy absida është kushtëzuar nga nevoja për dy altarë, sepse gjatë fillimit të çerekut të fundit të sh. XIII kemi në këto zona prezencën e dy kishave (katolike dhe ortodokse). Rastet e një zgjidhjeje të tillë janë shumë të pakta, por sidoqoftë ato kanë tërhequr interesin e studjuesve për shpjegimin e një gjëje të tillë. Kështu Kripta në Shpellë pranë Materës në Itali (e ashtuquajtura Kapuçino Vekio), me dy altare e dy absida në një strukturë të qartë planimetriko-volumore, forma e së cilës është akoma objekt diskutimesh duke mbizotëruar disa mendime kryesore, të cilat u referohen dhe rasteve të tjera. Së pari teza e Dilit[9]), që shpjegon një gjë të tillë me prezencën e njëkohshme të dy riteve, ortodoks e katolik; së dyti teza e Volpes[10]) që e shpjegon këtë me ndarjen për gra e burra; së treti teza e Kapelit[11]) që e shpjegon këtë me nevoja statike, sepse pa mbështetjen e mesit shkëmbi mbi të nuk do të qëndronte dot; së katërti dedikimi i kishës dy shenjtorëve[12]) dhe në rastin tonë, ku prezenca e dy riteve është e sigurtë, pra rrethanat historike e kërkonin një zgjidhje të tillë me dy altare dhe kur kisha përmendet si e dedikuar një shenjtori, mendojmë se teza e Dilit ka më shumë të ngjarë të ketë qenë arsyeja vendimtare. Nga ana tjetër shembulli që ne kemi në studim, që, siç thamë dhe më lart në asnjë rast nuk mund të jetë zgjidhje rastësore, përbën në vetvete një kontribut në favor të tezës së Dilit. Sigurisht si gjithnjë në raste të tilla mbetet karakteri subjektiv në pranimin e kësaj apo të asaj hipoteze. Ne nga ana jonë, duke u nisur nga uniteti i zgjidhjes planimetrike e vëllimore me formulimin arkitektural brenda kuadrit të arkitekturës bizantine, nga rrethanat historike dhe nga mndësia për një zgjidhje tjetër më të lehtë, jemi të prirur të besojmë se kjo zgjidhje e veçantë është rezultat i kërkesave funksionale, i nevojës për shërbimin e të dy kulteve në një kishë. Shtojmë këtu se nuk është e rastit që mbas dëmtimeve që monumenti pëson përpara vitit 1793, datë e rindërtimit të parë, pjesa e ambientit të altarit transformohet dhe kthehet në zgjidhjen e zakonshme me një absidë.

Ne mendojmë gjithashtu se edhe në rastet e tjera ku kemi dy altarë për dy ritet që janë hasur ku prezenca e popullsisë së përzier në aspektin e riteve fetare është fakt i njohur si në bregdetin perëndimor të Jonit, ka qenë pikërisht kjo veçanti që ka përcaktuar formën planimetrike. Sidoqoftë duhet të vazhdohen kërkimet në këtë drejtim për të arritur një zgjidhje përfundimtare e të pranueshme.

Me gërmimet dhe sondazhet e vitit 1973 u arrit një njohje më e mirë e monumentit, u evidentuan dhe u vlerësuan pjesët e fshehura të tij dhe u bë e mundur të saktësohen mjaft mendime dhe konsiderata të shprehura nga ne më parë dhe për më tepër të arrihet në disa përfundime për sa i përket datimit dhe formës planimetrike.

8) A. Meksi **Vep. cit.,** 72, 75.
9) Ch. Diehl **L'art byzantine dans l'Italie Meridionale,** Paris 1894, 155.
10) F.S. Volpe **Descrizione ragionata di alcune chiese di tempi – remoti esistenti nel suole campestre di Matera,** Napoli 1842, 15 v... Cituar sipas A. Venditi **L'architettura bizantine nell Italia Meridionale,** 344, N. 334.
11) B. Capelli **Le chiese rupestri nel Materano, Tivoli,** 1957; 48-49.
12) C. Enlart, **Manuel d'Archeologie française,** Paris 1902, 221. cituar sipas A. Venditi. **Vep. cit,** 344, n. 335.

DOKUMENT

DO NOT COPY



P L A N I M E T R ' A

TÁB. II













DO NOT COPY



SONDAZHI NE THEMELIN PERENDIMOR



SONDAZHI NE BAZAMENTIN E PORTIKUT



VIZATIMET E RIPAVE TE MOZAIKUT
NE DYSHEME

2



3



4



DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

NOUVELLES DONNEES SUR L'EGLISE DE MESOPOTAM

DO NOT COPY

RESUME

En raison même de l'intérêt que présente l'étude complète de l'église Shën Kolle à Mesopotam, en 1973 fut entreprise une expédition en vue d'apporter une solution aux problèmes et aux lacunes relevés pendant les expéditions et les études réalisées précédemment. Il s'agissait précisément de creuser le portique et d'affectuer des sondages, de résoudre le problème de la datation et d'étudier la forme particulière de ce monument.

Nous avons commencé par mettre à jour les parties déjà creusées dans les années 1966-1968, puis nous avons continué les travaux sur toute la surface du portique. Ainsi le portique est apparu dans la forme que nous l'avions imaginé, à l'exception des plaques de pierre calcarée du plancher et des pilastres qui manquaient en certains points. Auprès des deux principaux pilastres du côté septentrional ont été relevées les attaches des portes. Admettre une telle chose signifie que le portique, indépendamment de sa forme, a du avoir une fermeture, hypothèse que nous avions déjà exprimé en nous fondant sur le mode dont était travaillé les plaques se trouvant entre les pilastres.

Par suite du creusement effectué sur le flanc septentrional du portique est apparu un autre panneau de mosaïques de dimension 100 x 90 cm, représentant un animal mythologique ailé. Il s'agit d'un dessin plus détaillé que celui des figures mises à jour précédemment, mais moins joli dans son ensemble quant aux proportions et au traitement artistique. Outre ces deux panneaux, des traces de mosaïques ont été relevées sur le côté septentrional, tout juste devant l'actuelle porte de l'église.

D'autres sondages ont été effectués pour établir la forme des fondations aussi bien du portique que de l'église elle-même. A la suite des travaux réalisés par notre expédition, l'église dans son ensemble et ses vestiges sont apparus en pleine lumière. Un autre problème que nous avons cherché d'éclaircir est celui du dessin en bandes de mosaïques couvrant le plancher de l'église, qui, à notre avis, présente de l'intérêt pour sa datation. Le dessin de Versakis, que nous avions nous-mêmes accepté au début, n'est pas entièrement exact du fait qu'en deux points (1 et 2) y manquent les bandes de mosaïques qui sont remplacées par des morceaux des plaques. En ce qui concerne le mode dont est dessiné le mosaïque, nous en avons relevé quatre types qui ont des ressemblances allant jusqu'à la complète identité avec ceux de l'église de Vllaherne à Arte. Il ne s'agit pas ici d'une coïncidence fortuite du fait que certains des constructeurs de l'église de Mesopotam ont peut-être également participé à la construction de l'église d'Arte. Les ressemblances avec le Parigoritissa concernent le volume cubique, le portique, le cloisonnage, les corniches plates, les influences occidentales et le dessin du mosaïque. Ils concernent aussi les reliefs reproduisant des animaux.

Ces nouveaux arguments nous ont convaincu à attribuer notre monument au XIIIe siècle et plus exactement à la période allant de 1272 à 1286, qui correspond à la présence des féodaux Angevins chez nous, comme nous l'avions souligné précédemment. Il est difficile pour le moment, par manque de données complémentaires, d'établir une liaison dans le temps entre notre église et celle d'Arte. A cette fin il importe en premier lieu de déterminer les liens existant entre les constructeurs de ces deux monuments, il s'agit de savoir si ce sont les mêmes personnes ou si nous sommes en présence d'échanges ou d'influences. Il est important de relever ici que dans le village de Çiflik, dans la partie méridionale de Butrint, ont été mis au jour les vestiges d'une basilique byzantine dont la technique construction des murs est semblable à celle des murs des églises d'Arte et de Mesopotam (le même mode de travail des joints). Ce qui témoigne clairement en faveur d'une activité de constructions régulière et non fortuite.

Un autre problème abordé dans le présent article est celui de la forme particulière architecturale qui, quant au niveau de la solution architecturale en général et de ses parties distinctes en particulier, ne peut se concevoir que comme résultat d'exigences préliminaires. Dans son premier article l'auteur avait avancé l'hypothèse que la solution à deux absides est conditionnée par la nécessité de deux autels, parce qu'à l'époque il y avait dans ces zones à la fois l'église orthodoxe et l'église catholique. Ces cas, bien que peu nombreux, ont attiré l'attention des hommes d'étude qui ont voulu expliquer la raison d'être d'un tel phénomène. Ainsi la crypte de Capucino Vecchio, à proximité de Matera, a deux autels et deux absi-

des; elle se fait remarquer par une structure claire sur le plan de la planimétrie et du volume. Ce monument a été l'objet de maintes discussions et la majorité des points de vue exprimés à ce propos se rapportent aussi aux cas semblables. En premier lieu nous avons la thèse de Diehl pour qui le phénomène en question s'explique par la présence des deux rites, en deuxième lieu la thèse de Volpe qui repose sur la séparation de l'église pour hommes et femmes, en troisième lieu la thèse de Capelli qui avance les exigences statiques et en quatrième lieu la thèse selon laquelle l'église est dédiée à deux saints. Dans notre cas aussi, la présence des deux rites étant certaine du fait que les conditions historiques exigeaient la solution à deux autels, il est vraisemblable que la thèse avancée par Diehl soit le motif déterminant. Aussi notre exemple également, qui ne peut aucunement être considéré comme une solution fortuite, constitue une contribution dans ce sens. En ce qui nous concerne, partant de l'unité caractérisant la solution planimétrique et des volumes avec le traitement architectural, il nous semble que cette solution particulière est une conséquence des exigences fonctionnelles et de la nécessité d'exercer à la fois deux rites dans la même église. C'est ainsi que vers l'an 1793, après les dommages subis par notre église, son autel perd une de ses absides, donc nous sommes en présence de la solution habituelle.

Même dans les autres cas à deux autels, à notre avis, comme par exemple sur la côte occidentale de la mer Ionienne, où la présence d'une population suivant deux rites différents est un fait connu, c'est cette particularité qui a déterminé la forme planimétrique.

Les travaux effectués en 1973 ont permis une meilleure connaissance du monument, ils ont mis en évidence et valorisé ses parties dissimulées. Par ailleurs, ces études nous ont permis de rendre plus précises maintes opinions exprimées en précédence.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

VEPRIMTARIA E INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS GJATË VITIT 1975

Gjatë vitit 1975 Instituti i Monumenteve të Kulturës kreu një veprimtari intensive në drejtim të mbrojtjes, restaurimit dhe studimit të monumenteve të kulturës. Krahas kësaj kujdes ju kushtua dhe masivizimit të traditave tona në arkitekturë dhe art përmjet një sërë artikujsh në shtypin periodik, cikleshë në radio dhe televizion, bisedash të shoqëruara me diapozitivë etj. Këtë vit dolën nga shtypi dhe dy botimet shkencorë popullorë «Monumentet e kulturës në Shqipëri».

Punimet restauruese

Gjatë vitit 1975 Sektori i Qendrave Historike kreu një volum të madh punimesh konservuese dhe restauruese në të katër anët e vëndit, si në monumentet e kategorisë së I ashtu dhe në ata të kategorisë së II. Në përgjithësi këto punime, të paraprira nga studimet dhe projektet përkatës, patën si synim konsolidimin e monumentit nga ana statike, por krahas tyre në disa monumente u bënë ndërhyrje më të thella, që prekën dhe trajtimin e përgjithshëm arkitektonik, duke respektuar kriteret e njohura metodike.

Ashtu si në vitet e mëparshme dhe gjatë vitit 1975 volumi kryesor i punimeve u krye në dy qytetet-muze të Gjirokastrës dhe Beratit, të cilët ruajnë dhe vlerat më të shumta e njëherazi më të rëndësishme në lëmin e banesave popullore. Në qytetin-muze të Gjirokastrës u kryen punime restaurimi në një numër të konsiderueshëm monumentesh, thuajse në të gjitha lagjet e zonës muze dhe të mbrojtur të qendrës historike. Krahas këtyre punimeve në monumentet e kategorisë së dytë, u prekën dhe disa monumente të kategorisë së I, por punimet në këto monumente do të vazhdojnë dhe në vitin e ardhshëm. Për t'u përmëndur janë punimet e rëndësishme që kreu Dega e Monumenteve të Gjirokastrës për restaurimin e pjesës së pazarit rreth shkollës së parë shqipe të qytetit, duke plotësuar kështu me ndërhyrje restauruese krejt pazarin e vjetër. Në qytetin-muze të Beratit dhe gjatë këtij viti punimet e restaurimit prekën një serë monumentesh të të dy kategorive në lagjet Kala, Mangalem dhe Goricë. Punimet e shumta restauruese të kryera prej vitesh në këto lagje tashmë kanë bërë që këta ansamble, dhe veçanërisht ai i lagjes Kala, në të kaluarën mjaft i dëmtuar, të ripërtrihen duke i qëndruar gjithmonë besnik parimeve restauruese. Dhe në këtë qendër numrin më të madh të monumenteve të prekur e përbëjnë ata të kategorisë së dytë. Krahas tyre është punuar dhe në monumente të kategorisë së I. Për t'u përmëndur janë punimet në dy banesa të kategorisë së I, njera e tipit me gjysmëkat perpendikular në lagjen Mangalem, ndërsa tjetra një ndërtim mjaft i rrallë i tipit kullë në lagjen Goricë.

Në zonën-muze të qytetit të Korçës gjatë këtij viti u shtua numri i banesave të restauruara duke qënë ato kryesisht të kategorisë së dytë. Krahas kësaj punime restaurimi u kryen dhe në disa pjesë të pazarit të vjetër të qytetit. Ateljeja e Korçës, relativisht e re, gjatë këtij viti kreu një volum më të madh pune restauruese se vitet e mëparshëm. Punime restaurimi u kryen dhe në disa banesa, shpallur monument kulture, në qytetin e Shkodrës. Për t'u shënuar është se krahas restaurimit të pjesëve statike, në këto banesa u trajtuan dhe elementet e brendësisë punuar në dru apo në stuk relief. Punime restaurimi u kryen dhe në tre monumente, respektivisht në qytetet e Elbasanit, Krujës dhe Tiranës.

Viti 1975, shënoi fillimin e një pune restauruese në një fushë të re atë të ndërtimeve fshatare. Puna intensive kryer vitet e fundit për gjurmimin dhe vënjen në mbrojtje të ndërtimeve fshatare ka lindur nevojën e trajtimit të kësaj gjinie të re monumentesh. Kështu për herë të parë gjatë vitit 1975, simbas studimeve dhe projekteve përkatëse, u kryen punime restauruese në rreth 10 banesa shpallur monument kulture, kryesisht në zonat e Shqipërisë së Veriut.

Në monumentet e periudhës antike u kryen punime në një sërë objektesh të cilët kishin synim eli-

minimin e rrezikut të shëmbjes dhe kthimin e tyre në qendra të vizitueshme. Kështu gjatë ekspeditës në Amantie u pastrua shkallarja dhe një ambjent nga dherat, që dha mundësi për studimin e mëtejshëm të monumentit për pregatitjen e projektit të restaurimit të plotë. Njëkohësisht u restaurua dhe një ambient i vogël në anën perëndimore të stadjumit dhe u ngrit një sistem pritash për evitimin e gryerjes së tij. Në qytetin antik të Nikaes (fshati Klos i rrethit të Fierit) u krye anastiloza e hyrjes kryesore të qytetit, gjatë së cilës doli qartë në pah forma e saj planimetrike dhe e kullave mbrojtëse anësore. Punime konsolidimi u kryen dhe në një banesë të shek. II p.e.s. të zbuluar kohët e fundit. Në këtë vit përfundoj dhe pastrimi i paraskenës dhe skenës së theatrit të qytetit, i pari i zbuluar në një qytet të mirfilltë ilir. Në qytetin antik të Bylisit (në fshatin Hekal të rrethit të Fierit) u pastruan dy hyrje të murit rrethues perëndimor, si punime parapregatitore për vitin e ardhshëm. Në qytetin antik të Lisit u krye anastiloza e murit verior, ku u rimëkëmb një trakt 30 m i gjatë në lartësinë 2-4 m, dhe e një pjese të murit të brendshëm, që u mbështet mbi një bazament butobetoni për të evituar rrëshqitjen.

Në qytetin e Apollonisë dhe Butrintit krahas punimeve mirëmbajtëse u restauruan dhe një sërë monumentesh. Në Apolloni vazhduan punimet në monumentin e Agonoteteve ku u rindërtuan muret anësore të fasadës, u ngritën kollonat duke plotësuar me beton pjesët që mungojnë dhe u vendosën kapitelët ekzistues korintike, duke zëvendësuar me kapitele gjeometrike betoni ata që mungonin. Në qytetin e Butrintit u restaurua «porta me kulla», në anën lindore të rrethimit antik, ku krahas pastrimit të ambjenteve dhe koridorit të hyrjes u krye anastiloza e blloqeve të rrëzuara dhe rimëkëmbja e portave.

Përveç qendrave antike një volum i madh pune u krye dhe në monumentet e perjudhës së vonë antike dhe mesjetare. Në kështjellën e vonë antike në Paleokastër përfundoj pastrimi i plotë i mureve rrethues, që deri në këtë kohë qenë të mbuluar thuajse tërësisht prej dheut, dhe i dy kishave paleokristiane. Krahasi u konsoliduan kullat dhe muret e anës perëndimore. Në qytetin mesjetar të Sardës (Shurdhahu i rrethit të Shkodrës) u restaurua porta e qytetit të sipërm së bashku me dy kullat mbrojtëse anësore, mjaft të degraduara, në rrezikshmëri shëmbje. Punime konsolidimi u kryen dhe në monumentet e kultit të kësaj qendre. Kalaja mesjetare pranë kanalit të Vivarit në Butrint, u çlirua nga hedhurinat dhe në të u restauruan dy kulla, disa ambjente të brëndëshme dhe parapeti së bashku me frengjitë.

Në muret rrethues të kalasë së Beratit vazhduan punimet e pastrimit të akropolit, konsolidimi i mureve të tij dhe selisë që gjëndet brënda kësaj pjese. Po kështu u konsolidua qemeri i hyrjes kryesore që paraqiste rrezik shëmbje dhe kryekulla e fortifikimit. Punime në akropol u kryen në kalanë e Drishtit, ku u evitua përfundimisht rreziku i rrëzimit të mureve të tija. Punime pastrimi dhe konsolidimi u kryen dhe në kalanë e Krujës, Bashtovës, Durrësit, Elbasanit dhe Peqinit.

Në monumentet e tjerë mesjetarë u krye restaurimi i hamamit të Elbasanit, në ambjentet e banjave, sallën e ndejtjes dhe ç'veshjes e kupolat. Punime në mbulesën me kupola dhe në interjer u kryen dhe në hamamin e Shkodrës, duke i kthyer të dy këta objekte në qendra të vizitueshme. Punime restaurimi u kryen në manastirin e Ardenicës si dhe u konservuan një sërë monumentesh të tjerë kulti.

Gjatë vitit 1975 sektori i artit kreu disa ekspedita konservimi e restaurimi në monumente dhe objekte arti të periudhës mesjetare. Ndër objektet ku vazhduam punimet e nisura disa vjet më parë janë afreskat e kishës së sh. Triadhës në kalanë e qytetit të Beratit. Punimet me karakter kryesisht konservues vazhduan në afreskat e pjesës së apsidës dhe dy qemereve anësore të kësaj zone. Në to u konsoliduan nëpërmjet injektimit zonat e pikturës që kishin humbur lidhjet me murin, si dhe u plombuan pjesët e dëmtuara nga faktorë të ndryshëm dëmtues, kryesisht si rezultat i lagështirës nga e cila monumenti vuante para ndërhyrjeve restauruese në arqitekturë. Në disa zona të tjera u kryen eksperimentime të vogla për pastrimin e kriprave dhe velaturës të krijuar prej vajit me të cilën janë lyer afreskat. Punime të këtij karakteri u kryen dhe në faqen lindore të trapezarisë së Pojanit. Punimet me karakter sondazhi brenda kishës së manastirit të Apollonisë suallën si rezultat zbulimin e një zone të pikturuar dhe të ruajtur relativisht mirë në niken në të djathtë të apsidës. Piktura që dëshmon për një periudhë të hershme pikturimi të monumentit, u trajtua nëpërmjet masave me karakter konsolidimi. Gjatë këtij viti punime pastrimi e restaurimi u kryen edhe në një banesë të tipit kullë të shek. XVIII në lagjen Partizani të qytetit të Beratit, e cila ruan pikturë murale në dy ambientet e saj kryesore. Ç'vendosja e një zone afresku të faqes jugore, muri i së cilës u rikonstruktua plotësisht, ishte një nga detyrat më të vështira të punës restauruese në këtë objekt.

Restaurimi i pikturës së vajit ka qënë për sektorin një eksperiencë me vlerë të veçantë për punimet e këtij karakteri të cilat ndërmeren për herë të parë tek ne. Tablloja e madhe kompozicionale «dy rrugët» e piktorit tonë Kol Idromeno erdhi mjaft

e dëmtuar. Nëpërmjet masave të ndryshme restauruese, midis të cilave më e rëndësishmja ishte transplorimi i pikturës mbi një kanavacë të re nëpërmjet dublurës, tablloja rifitoj një pamje krejt të re si në drejtim të konservimit ashtu dhe rivlerësimit të vlerave estetike, të erësuara për shkak të dëmtimeve të ndryshme. Gjithashtu me masa restaurimi të plota u trajtua edhe një autoportret në vaj i piktorit tonë Abduraman Buza.

Ateljeja e qytetit të Shkodrës nën drejtimin e sektorit të artit kreu disa punime restaurimi në objektet e artit të aplikuar. U restauruan dy oxhaqe dekorativë në allçi dhe u pastruan dy trapazane të një banese që ruan vlera të artit dekorativ.

Punime të mirfillta restaurimi sektori kreu edhe në fushën e mozaikëve. Shtresa e dyshemesë së një bazilike të sh. VI e zbukuruar me mozaikë, e cila është gërmuar kohët e fundit, u restaurua pjesërisht duke bërë punime pastrimi, përforcimi si dhe rivendosjen e zonave të tjera mbi një suport të ri. Punime të plota restaurimi u kryen edhe në disa ikona mesjetare të degraduara dhe erësuara nga faktorë të ndryshëm prishës. Për njohjen e gjëndjes së monumenteve të artit sektori kreu disa ekspedita nga të cilat më kryesorja ishte ajo në rrethin e Korçës.

Mbrojtja e monumenteve. Në nëndor të këtij viti Instituti i Monumenteve të Kulturës organizoi në Tiranë një seminar për problemet e mbrojtjes së monumenteve të gjinive të ndryshme, ku muarën pjesë përveç punonjësve të Institutit edhe kujdestarët e monumenteve në qytete e fshatra, si edhe përgjegjësit e Degëve dhe Ateljeve të monumenteve në rrethe. Në këtë seminar u shkëmbye përvoja në fushën e mbrojtjes, administrimit dhe shfrytëzimit sa më të mirë të kësaj pasurije të përbashkët me vlerë të madhe. Nga diskutimi doli se përherë e më tepër po shtohet interesi për trashëgiminë tonë kulturore të së kaluarës. Kjo vërehet jo vetëm në gjurmimin e vazhdueshëm dhe vënien në mbrojtje shtetërore të të gjithë ndërtimeve me vlerë historike, arkitektonike, artistike dhe etnografike, por edhe në punimet konservuese e restauruese që po kryhen çdo vit me një ritëm të kënaqshëm. Rezultate të mira janë arritur edhe në lëmin e botimeve dhe propagandimit të kulturës sonë materiale në përgjithësi. Megjithatë nga diskutimet doli se megjithë kujdesin e madh që tregohet në këtë fushë, vërehet edhe ndonjë rast nënvleftësimi në trajtimin e monumenteve.

Në fund u dhanë udhëzime të ndryshme nga drejtoria e Institutit, si edhe u shtruan një sërë detyrash nga drejtoria e kulturës pranë Ministrisë s'Arsimit dhe Kulturës, me qëllim që kjo pasuri me vlerë të madhe historike dhe kulturore të shfrytëzohet sa më mirë për t'i shërbyer edukimit patriotik-revolucionar dhe estetik të masave dhe në mënyrë të veçantë brezit të ri.

Një takim tjetër u zhvillua në dhjetor në Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës me inspektorët e kulturës në rrethe dhe muzeologët e mbarë vëndit. Në këtë takim iu kushtua vëmëndje e veçantë problemit të mbrojtjes së monumenteve, popullarizimit të tyre nëpërmjet botimeve të ndryshme, si edhe përdorimit të kësaj pasurije në interes të edukimit të masave. Gjithashtu u dhanë orientime nga Ministria për t'u angazhuar edhe më tepër muzeumet me këto vlera të kulturës materiale të vëndit tonë.

E.R., A.B., H.N.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Lazër PAPAJANI

DO NOT COPY

PASQYRA BIBLIOGRAFIKE E SERISË «MONUMENTET» Nr. 1-10 (1971-1975).
INDEX BIBLIOGRAPHIQUE DU «MONUMENTET» 1-10 (1971-1975).

1. — *Adhami, Stilian.* Gjurmime rreth themelimit dhe rindërtimeve kryesore të kalasë së Krujës.
   Rés. fr. La fondation de la citadelle du Kruje et ses principales reconstructions. 1971, 1, fq. 87-101.

2. — *Adhami, Stilian.* Të dhëna rreth fizionomisë urbanistike të qytetit mesjetar të Voskopojës.
   Rés. fr. Aspects urbanistes et architecturaux de la ville médiévale de Voskopoje. 1972, 3, fq. 95-118.

3. — *Adhami, Stilian.* Një monument me vlerë i shekullit XVII në Voskopojë.
   Rés. fr. Un monument du XVIIe siècle à Voskopoje. 1975, 10.

4. — *Baçe, Apollon.* Qyteti i fortifikuar i Beratit.
   Rés. fr. La ville fortifiée de Berat. 1971, 2, fq. 43-62.

5 — *Baçe, Apollon — Karaiskaj, Gjerak.* Vrojtime arkeologjike, në rrethin e Gramshit.
   Rés. fr. Observations archéologiques la région de Gramsh. 1972, 3, fq. 199-204.

6. — *Baçe, Apollon.* S/V. Nr. 20. Vrojtime arkeologjike në rrethin e Pogradecit, luginën e Devollit dhe Shkumbinit.

7. — *Baçe, Apollon.* Vështrim mbi qëndrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos (Gjirokastër).
   Rés. fr. Apercu sur les agglomérations antiques et moyenâgeuses de la vallée du Drinos (Gjirokastër), 1972, 4, fq. 103-139.

8. — *Baçe, Apollon.* Kalaja e Vlorës.
   Rés. fr. La citadelle de Vlore. 1973, 5-6, fq. 43-57.

9. — *Baçe, Apollon — Karaiskaj, Gjerak.* Kështjella e Petrelës.
   Rés. fr. Le château de Petrele. 1973, 5-6, fq. 139-160.

10. — *Baçe, Apollon.* Qyteti i fortifikuar i Kaninës.
    Rés. fr. La ville fortifiée de Kanine. 1974, 7-8, fq. 25-54.

Shënim : Në numrin e faqeve përfshihet edhe përmbledhja e artikujve në gjuhë të huaj e cila zakonisht përbën 1/3 deri në 1/4 e volumit të çdo artikulli.
Au nombre des pages est aussi inclus le résumé des articles en langue étrangère lequel habituellement constitue de 1/3 à 1/4 du volume de chaque article.

DO NOT COPY

11. – *Baçe, Apollon.* Qendrat e fortifikuara të Gjirit të Vlorës në antikitet.
Rés. fr. Les centre fortifiés de la baie de Vlore dans l'antiquité. 1975, 10.

12. – *Baçe, Apollon.* S/V Nr. 44. Kalaja e Dunrësit dhe sistemi i fortifikimit përreth në kohën e vonë antike.

13. – *Bejko, Skënder.* Kalaja e Tepelenës.
Rés. fr. La forteresse de Tepelene. 1971, 2, fq. 103-112.

14. – *Biçoku, Kasem.* Kështjella e re (Jenixhekalaja) dhe Elbasani.
Rés. fr. La nouvelle citadelle (Jenidjékala) et Elbasan. 1972, 3, fq. 159-162.

15. – *Budina, Dhimosten – Koço, Spiro.* Punimet restauruese në disa mozaikë në qytetin e lashtë të Apollonisë.
Rés. fr. Restauration de mosaïques découvertes dans la ville ancienne d'Apollonie. 1974, 7-8, fq. 217-228.

16. – *Ceka, Hasan.* Dega jugore e Rrugës Egnatia.
Rés. fr. La branche sud de la voir Egnatia. 1971, 2, fq. 25-36.

17. – *Ceka, Hasan.* Gjurmë të trashëgimisë ilire në toponiminë e sotme të vendit tonë.
Rés. fr. Traces de l'héritage illyrien dans la toponymie actuelle de notre pays. 1973, 5-6, fq. 7-18.

18. – *Ceka, Neritan – Papajani, Lazër.* Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike.
Rés. fr. La route antique longeant la vallée du Shkumbini. 1971, 1, fq. 43-59.

19. – *Ceka, Neritan.* Vështrim arkeologjik mbi rrethin e Elbasanit.
Summary. Eng. Archaeological survey of the Elbasan region. 1972, 3, fq. 7-33.

20. – *Ceka, Neritan – Baçe, Apollon.* Vrojtime arkeologjike në rrethin e Pogradecit, luginën e Devollit dhe Shkumbinit.
Rés. fr. Observations archéologiques faites dans la région de Pogradec et dans les vallées du Devoll et du Shkumbini. 1972, 3, fq. 205-214.

21. – *Ceka, Neritan – Papajani, Lazër.* Nymfeu dhe termet e stacionit Ad Quintum.
Rés. fr. La nymphée et les thermes de la station Ad Quintum. 1972, 4. fq. 52-57.

22. – *Ceka, Neritan.* Monumente antike dhe mesjetare në luginën e Osumit.
Rés. fr. Les monuments antiques et moyenâgeux de la vallée de l'Osum. 1973, 5-6, fq. 121-137.

23.– *Ceka, Neritan.* Fortifikime të vona antike pranë rrugës Egnatia.
Rés. fr. Fortifications de la basse antiquité à proximité de la via Egnatia. 1974, 7-8, fq. 71-89.

24. – *Ceka, Neritan.* Ndërtimet sepulkrale të qyteteve ilire.
Rés. fr. Les constructions sépulcrales des cités illyriennes. 1975, 9, fq. 35-53.

25. – *Ceka, Neritan.* Qendrat e fortifikuara të Amantëve.
Rés. fr. Les centre fortifiés des Amantins. 1975, 10.

26. – *Dautaj, Burhan.* Një rrugë kryesore në Apolloni.
Rés. fr. Une rue principale à Apollonie. 1974, 7-8, fq. 55-69.

DO NOT COPY

27. — *Derveni, Lutfi.* Gjurmime të reja në kalanë e Margëlliçit.
Rés. fr. Récentes fouilles à la forteresse de Margëlliç. 1971; 2, fq. 147-151.

28. — *Dizdari, Rexhep.* Pazari i vjetër i Shkodrës.
Rés. fr. Le vieux marché de Shkodër. 1973, 5-6, fq. 203-210.

29. — *Dhamo, Dhonka.* Mbi disa vepra të panjohura të piktorit shqiptar të shek. XVI Nikollës.
Rés. fr. A propos de certaines oeuvres jusqu'ici inconnues de Nicolas, peintre albanais du XVIe siècle. 1971, 2, fq. 63-72.

30. — *Frashëri, Gjergj.* Kalaja e Ndroqit.
Rés. fr. La citadelle de Ndroq. 1972, 4, fq. 185-192.

31. — *Halilaj, Dail.* Gjurmë të vjetra në Gollobordë.
Rés. fr. Vestiges antiques à Golloborde. 1971, 2, fq. 165-166.

32. — *Haxhihyseni, Shpëtim.* Vendbanimi i fortifikuar ilir në Tërvol.
Rés. fr. L'agglomération fortifiée illyrienne de Tërvol. 1971, 2, fq. 139-145.

33. — *Islami, Selim.* Qyteti ilir në Zgërdhesh.
Rés. fr. La cité illyrienne de Zgërdhesh. 1971, 1, fq. 23-41.

34. — *Kamberi, Thanas.* Disa të dhëna mbi teknikën e ndërtimit të banesës gjirokastrite.
Rés. fr. Données sur la technique de construction appliquée dans l'habitation type de Gjirokastër. 1971, 2, fq. 157-163.

35. — *Kamberi Thanas.* S/V. Nr. 79. Kulla në fshatin Goranxi.

36. — *Kamsi, Vili.* Kështjella e Shkodrës dhe restaurimi i saj.
Rés. fr. La citadelle de Shkodër et sa restauration. 1971, 1, fq. 165-171.

37. — *Kamsi, Vili.* Fortifikimi i hyrjes kryesore të kështjellës së Shkodrës.
Rés. fr. La fortification de l'entrée principale de la citadelle de Shkodër. 1972, 3, fq. 163-170.

38. — *Karaiskaj, Gjerak.* Kalaja e Elbasanit.
Rés. fr. La citadelle d'Elbasan. 1971, 1, fq. 61-77.

39 — *Karaiskaj, Gjerak.* Të dhëna të reja për datimin e kalasë së Elbasanit.
Summary Eng. New data for the dating of the castle of Elbasan. 1972, 3, fq. 147-157.

40. — *Karaiskaj, Gjerak,* S/V. Nr. 5. Vrojtime arkeologjike në rrethin e Gramshit.

41. — *Karaiskaj, Gjerak,* Kështjella e Bashtovës.
Rés. fr. Le château de Bashtova. 1973, 5-6, fq. 59-80.

42. — *Karaiskaj, Gjerak, — Lena, Petrika.* Fortifikimet e vona antike në rrethin e Korçës.
Rés. fr. Fortifications de la basse antiquité dans le district de Korçe. 1974, 7-8, fq. 91-110.

DO NOT COPY

43. — *Karaiskaj, Gjerak.* S/V. Nr. 9. Kështjella e Petrelës.

44. — *Karaiskaj, Gjerak.* — *Baçe, Apollon.* Kalaja e Durrësit dhe sistemi i fortifikimit përreth në kohën e vonë antike.
Rés. fr. La forteresse de Durrës et les autres fortifications environnantes pendant la basse antiquité. 1975, 9, fq. 5-33.

45. — *Karaiskaj, Gjerak.* Të dhëna mbi arkitekturën dhe punimet e konservimit në kalanë e Shurdhahut (Sarda).
Rés. fr. Données sur l'architecture de la Forteresse de Shurdhah (Sarda) et sur les travaux de conservation qui y ont été effectués 1975, 10.

46. — *Koço, Spiro.* S/V. Nr. 15. Punimet restauruese në disa mozaikë në qytetin e Iashtë të Apollonisë.

47. — *Lera, Petrika.* Gjurmë të reja të Iashtësisë në rrethin e Korçës.
Rés. fr. Nouveaux vestiges antiques découverts dans la région de Korçë. 1971, 1, fq. 177-183.

48. — *Lusha, Nuredin.* Të dhëna mbi kalanë e Lekës në fshatin Selimaj të rrethit të Tropojës.
Rés. fr. Données concernant la forteresse de Leka située au village de Selimaj, district de Tropoje. 1972, 4, fq. 193-194.

49. — *Meksi, Aleksandër.* Arkitektura dhe datimi i kishës së manastirit të Apollonisë.
Rés. fr. L'église du monastère d'Apollonie, son architecture et le problème de sa datation. 1971, 1, fq. 103-117.

50. — *Meksi, Aleksandër.* Arkitektura e kullës si banesë.
Rés. fr. L'architecture de la «kulla» en tant qu'habitation. 1971, 1, fq. 193-198.

51. — *Meksi, Aleksandër.* Restaurimi i kishës së Marmiroit.
Rés. fr. Restauration de l'église de Marmiro. 1971, 2, fq. 73-83.

52. — *Meksi, Aleksandër.* Arkitektura e kishës Mesopotamit.
Rés. fr. L'architecture de l'église de Mesopotame. 1972, 3, fq. 47-94.

53. — *Meksi, Aleksandër.* Tri kisha bizantine në Berat.
Rés. fr. Les trois églises byzantines de Berat. 1972, 4. fq. 59-102.

54. — *Meksi, Aleksandër.* Të dhëna mbi rindërtimin e kupolës së kishës Ristozit në Mborje.
Rés. fr. Données concernant la reconstruction de l'église de Ristoz à Mborje. 1972, 4, fq. 199-204.

55. — *Meksi, Aleksandër.* Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Perondisë.
Rés. fr. L'architecture de l'église de Perondi et sa restauration. 1973, 5-56, fq. 19-42.

56. — *Meksi, Aleksandër.* Bazilika në Klos të Sulovës.
Rés. fr. La basilique de Klos à Sulove. 1973, 5-6, fq. 189-194.

57. — *Meksi, Aleksandër* — *Riza, Emin.* Ndërtimet në fshatin rrënoj të Kamenicës.
Rés. fr. Constructions du village en ruine de Kamenice. 1974, 7-8, fq. 139-165.

58. — *Meksi, Aleksandër.* Dy ndërtime të tipit trekonkësh.
Rés. fr. Deux constructions du type à trois conques. 1974, 7-8, fq. 229-246.

59. — *Meksi, Aleksandër.* Restaurimi i kishës së manastirit të Shën-Thanasit në Poliçan.
Rés. fr. Restauration de l'église du monastère de saint-Athanase de Poliçan. 1974, 7-8, fq. 277-287.

60. — *Meksi, Aleksandër.* Dy kisha bizantine në rreth të Gjirokastrës.
Rés. fr. Deux églises byzantines du district de Gjirokastra 1975, 9, fq. 77-105.

61. — *Meksi, Aleksandër.* Disa kapela bizantine të vendit tonë.
Rés fr. Certaines chapelles byzantines de notre pays. 1975, 10.

62. — *Meksi, Aleksandër.* Të dhëna të reja për kishën e Mesopotamit.
Rés. fr. Nouvelles données sur l'église de Mesopotam. 1975, 10.

63.. — *Miraj, Fabian.* Muret antike të Persqopit.
Rés. fr. Les murs antiques de Persqop. 1971, 2, fq. 153-156.

64. — *Myrto, Halil.* Mbi disa qendra arkeologjike midis Kavajës dhe Durrësit.
Rés. fr. A propos de certains centres archéologiques situés entre Kavaja et Durrës. 1974, 7-8, fq. 247-258.

65. — *Nallbani, Hasan.* Rreth krijimtarisë së piktorit David Selenicasit.
Rés. fr. De l'oeuvre du peintre David Selenicasi. 1971, 1, fq. 119-126.

66. — *Nallbani, Hasan.* Shënime mbi masat restauruese në pikturën e xhamisë së Beqarëve në Berat.
Rés. fr. Notes sur la restauration des peintures de la mosquée des «Beqars» à Berat. 1972, 3, fq. 171-178.

67. — *Nallbani, Hasan.* Mozaiku i kishës së amfiteatrit të Durrësit.
Rés. fr. Les mosaïques de l'église de l'amphithéâtre de Durrës. 1974, 7-8, fq. 111-118.

68. — *Nallbani, Hasan,* S/V. Nr. 86. Një ndërtim i tipit kullë në Berat. (Arkitektura, dekoracioni dhe restaurimi)

69. — *Papa, Miltiadh.* Mbrojtja ligjore e pasurive kulturale të vendit tonë.
Rés. fr. La protection légale du patrimoine culturel dans notre pays 1972, 3, fq. 139-145.

70. — *Papajani, Lazër.* S/V. Nr. 18. Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike.

71. — *Papajani, Lazër.* S/V. Nr. 21. Nymfeu dhe termet e stacionit Ad Quintum.

72. — *Papajani, Lazër.* Kalaja e Prezës.
Rés. fr. La forteresse de Preze. 1974, 7-8, fq. 167-181.

73. — *Papajani, Lazër.* Kalaja e Peqinit.
Rés. fr. La forteresse de Peqin. 1975, 9, fq. 55-76.

74. — *Popa, Theofan. H. Nallbani.* Rreth krijimtarisë së piktorit David Selenicasit.
Rés. fr. A propos de l'oeuvre du peintre David Selenicasi. 1971, 2, fq. 167-169.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

75. — *Prendi, Frano — Zheku, Koço.* Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike.
Rés. fr. Lisus â la lumière des récents données archéologjiques. 1971, 2, fq. 7-24.

76. — *Riza Emin.* Banesa e fortifikuar gjirokastrite.
Rés. fr. L'habitation fortifiée de Gjirokastër. 1971, 1, fq. 127-148.

77. — *Riza, Emin — Zheku, Koço.* Banesa tiranase.
Rés. fr. La maison tiranoise. 1971, 2, fq. 113-128.

78. — *Riza, Emin — Strazimiri, Burhan.* Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës.
Rés. fr. Aperçu de l'architecture de la ville de Korçë. 1972, 3, fq. 119-138.

79. — *Riza, Emin — Kamberi, Thanas.* Kulla në fshatin Goranxi.
Rés. fr. Les «kullas» du village de Goranxi. 1972, 3, fq. 179-188.

80. — *Riza, Emin.* Banesa popullore në Shkodër gjatë shekujve XVIII-XIX.
Rés. fr. L'habitation type shkodrane aux XVIII-XIXe siècles. 1972, 4, fq. 141-184.

81. — *Riza, Emin.* Banesa popullore në disa qendra të Shqipërisë së Mesme.
Rés. fr. La maison type de certains centres urbains de l'Albanie moyenne. 1973, 5-6, fq. 101-120.

82. — *Riza, Emin.* Banesa me gjysmëkat — përpendikular.
Rés. fr. L'habitation à demi-étage perpendiculaire. 1974, 7-8, fq. 203-215.

83. — *Riza, Emin.* S/V. Nr. 57. Ndërtimet në fshatin rrënoj të Kamenicës.

84. — *Riza. Emin.* Studim për restaurimin e një banese me çardak në qytetin e Krujës.
Rés. fr. Etude concernant la restauration d'une maison à tchardak dans la ville de Kruja. 1975, 9, fq. 107-125.

85. — *Riza, Emin.* Banesa popullore në Kurveleshin e Sipërm.
Rés. fr. L'habitation populaire dans le haut Kurvelesh. 1975, 9, fq. 141-159.

86. — *Riza, Emin, — Nallbani, Hasan.* Një ndërtim i tipit kullë në Berat. (Arkitektura. dekoracioni, dhe restaurimi).
Rés. fr. Une habitation de type «kullë» à Berat. 1975. 10.

87. — *Samimi, Genc.* Disa të dhëna mbi karakterin e ndërtimit të banesës beratase.
Rés. fr. Indications sur les procédés de construction de l'habitation type de Berat. 1971, 1, fq. 173-176.

88. — *Samimi, Genc.* Studimi dhe restaurimi i një banese karakteristike në Berat.
Rés. fr. Etude et restauration d'une habitation type de Berat. 1973, 5-6, fq. 161-175.

89. — *Samimi, Vasif.* Disa shënime dhe vërejtje mbi përkthimin e Sejahatnames në gjuhën shqipe dhe gjermanishte.
Rés. fr. Notes et remarques à propos de la traduction en albanais et allemand du «Seyahatname». 1972, 4, fq. 195-198.

DO NOT COPY

90. — *Strazimiri, Burhan — Thomo, Pirro.* Kulla e Matit.
Rés. fr. La «kulla» de la région du Mat. 1971, 1, fq. 149-163.

91. — *Strazimiri, Burhan. S/V. Nr. 78.* Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës.

92. — *Strazimiri, Burhan.* Banesa në Malësinë e Krujës.
Rés. fr. L'habitation de la Malësi de Kruja. 1974, 7-8, fq. 183-202.

93. — *Strazimiri, Burhan.* Arkitektura dhe restaurimi i banesës Bizbiqëve.
Rés. fr. Architecture et restauration de l'habitation des Bizbiq. 1975, 9, fq. 127-140.

94. — *Strazimiri, Gani.* Rezultatet dhe perspektivat e punës kërkimore restauruese.
Rés. fr. Résultats et perspectives du travail de recherche et de restauration. 1971, 1, fq. 11-22.

95. — *Strazimiri, Gani.* Gjirokastra dhe vlerat e saj kulturale.
Rés. fr. Gjirokastër et ses valeurs culturelles. 1971, 2, fq. 85-102.

96. — *Shtylla, Valter.* Studim mbi restaurimin e një banese të Shkodrës.
Rés. fr. Restauration d'une habitation à Shkodër. 1971, 2, fq. 129-137.

97. — *Shtylla, Valter.* Banesa të vjetra të fushës së Mbishkodrës.
Rés. fr. Anciennes habitations rurales de la plaine de Mbishkodër. 1973, 5-6, fq. 177-188.

98. — *Shtylla, Valter.* Banjat e mesjetës së vonë në Shqipëri.
Rés. fr. Hammams du bas moyen âge en Albanie. 1974, 7-8, fq. 119-137.

99. — *Tartari, Fatos.* Gjurmë ndërtimesh në kënetën e Durrësit.
Rés. fr. Traces de constructions dans le marais de Durrës. 1975, 9, fq. 161-164.

100. — *Toçi, Vangjel.* Amfiteatri i Dyrrahit.
Rés. fr. L'amphithéâtre de Dyrrah. 1971, 2, fq. 37-42.

101. — *Thomo, Piro.* S/V. Nr. 91. Kulla e Matit.

102. — *Velo, Maksi.* Detajet metalike të portave në qytetet shqiptare.
Détails métalliques des portes dans les villes albanaises. 1973, 5-6, fq. 195-202.

103. — *Velo, Maksi.* Banesa popullore në zonën e Ndroqit.
Rés. fr. L'habitation type de la zone de Ndroq. 1974, 7-8, fq. 259-275.

104. — *Zarshati, Faruk.* Të dhëna mbi banesën e fushës së Zadrimës.
Rés. fr. Données sur la maison type de la plaine de Zadrime. 1972, 3, fq.189-198.

105. — *Zheku, Koço.* Restaurimi i Portës së Luanit Butrint.
Rés. fr. La restauration de la Porte du Lion à Butrint. 1971, 1, fq. 79-86.

106. — *Zheku, Koço.* S/V. Nr. 75. Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike.

107. — *Zheku, Koço.* S/V. Nr. 77. Banesa tiranase.

108. — *Zheku, Koço.* Zbulime epigrafike në muret rrethuese të kalasë së Durrësit.
Rés. fr. Découvertes épigraphiques sur les murs d'enceinte de la citadelle de Durrës. 1972, 3, fq. 35-46.

109. — *Zheku, Koço.* Monumenti i Agonoteteve.
Rés. fr. Le monument des Agonothetes. 1972, 4, fq. 7-27.

DO NOT COPY

110. – *Zheku, Koço.* Të dhëna mbi kasollet fshatare në vendin tonë dhe gjurmat e tyre në lashtësi.
Rés. fr. Données concernant les chaumières de norte pays et leurs traces anciennes. 1973. 5-6, fq. 81-100.

111. – *Zheku, Koço.* Restaurimi i Portës së Brendëshme në qytetin ilir të Lisit.
Rés. fr. Restauration de la porte de la cité illyrienne de Lis. 1974. 7-8, fq. 7-24.

112 – *Zheku, Koço.* Shtëpitë e banimit në krahinën e Tomoricës.
Rés. fr. Les maisons d'habitation de la région de Tomorice. 1975, 10.

Kronikë

113, – Puna konservuese restauruese dhe kërkimore në Institutin e Monumenteve të Kulturës gjatë vitit 1969.
Le travail de conservation, de restauration et de recherche de l'Institut des Monuments Culturels en 1969. 1971, 1, fq. 199-201.

114. – Puna konservuese restauruese dhe kërkimore në Institutin e Monumenteve Kulturës gjatë vitit 1970.
Le travail de consevation, de restauration, et de recherche de l'Institut des Monuments Culturels en 1970. 1971. 2, fq. 170-173.

115. – Jeta shkencore.
Rés. fr. La vie scientifique. 1972, 3, fq. 215-221.

116. – Ligji i ri: «Mbi mbrojtjen e monumenteve kulturale e historike dhe pa natyrale të rralla.
La nouvelle loi «Sur la protection des monuments culturels et historiques et des sites naturels d'un intérêt particulier. 1972, 3, fq. 223-224.

117. – Rregullore për mbrojtjen e monumenteve kulturale dhe historike.
Ordonnance sur la protection des monuments culturels et historiques. 1972, 3, fq. 225-228.

118. – Veprimtaria kërkimore shkencore në drejtim të konservimit dhe restaurimit të monumenteve gjatë vitit 1972.
L'activité de recherches scientifiques en ce qui concerne la conservation des monuments pendant l'an 1972. 1972, 4, fq 205-207.

119. – Rregullore mbi mbrojtjen, restaurimin dhe administrimin e qytetit-muze të Gjirokastrës.
Rés. fr. Règlement sur la protection, la restauration et la gestion de la ville-musée de Gjirokastër. 1973; 4, fq. 211-217.

120. – Rregullore për mbrojtjen dhe restaurimin e ansambleve dhe ndërtimeve të tjera me vlerë historike, arkitektonike dhe urbanistike të qytetit të Korçës.
Rés. fr. Règlement sur la protection et la restauration des ensembles et des autres constructions de la ville de Korçe ayant une importance du point de vue historique, architectonique et urbaniste. 1973. 5-6; fq. 219-222.

121. – Jeta shkencore.
La vie sceintifique. 1974, 7-8, fq. 289-291.

122. – Veprimtaria e Institutit të Monumenteve të Kulturës për vitin 1975.
L'activité de l'Institut des Monuments de la Culture pendant l'année 1975. 1975, 10.

DO NOT COPY

KORIGJIM GABIMESH

Faqe	Rreshti	Si është	Si duhet të jetë
	Shën. 20, 1	kullave	tullave
22	koll. II, 45	teknikëve	teknikave
29	koll. II, 6	ndihmë	ndërtim
35	koll. I, 19	asës	kasës
59	koll. I,19	koine	koinon
60	koll. I,52	deuxième	première
62	koll. II, 54	stratégique	stratigraphiques
125	koll. I, 33	ksilot	ksilol
153	koll. I, 37	i njëjtë me atë	i njejtë me atë
167	No. 42	Lena	Lera

DO NOT COPY

Çmimi: 10 lekë

I
M
K